MESNEVI

V

Mevlana Xhelaleddin
Rumi

Bashkia Metropoliane e Konjas, Botimet Kulturore, Nr. 115

Koordinatori i përgjithshëm
Ercan Uslu

Botues
Mehmet Birekul

Korrektore
Flora Hoxha

Kapakët
Sadrettin Özçimi

Shtypur në
Sebat Ofset
+90.332.342 01 53

Konja, Maj / 2007

ISBN
978-9944-913-75-1 (kompleti)
978-9944-913-80-5 (vëll.5)

Përgatitur nga
Realizim i Shoqërisë Anonime Konya Kültür
+90.332. 352 81 11

www.mkm.gov.tr
www.konyakultur.com.tr

Mevlana Xhelaleddin Rumi

MESNEVI

V

Përkthyes
Dr. Mithat Hoxha

Bashkia Metropoliane e Konjas

30 Komenti i ajetit "Merr katër zogj dhe mblidhi pranë vetes!"

32 Shkaku që Mustafai, Zoti e mëshiroftë, e ka thënë hadithin: "Qafiri ha bukë me shtatë zorrë, besimtari, me një zorrë!"

34 Mustafai (a.s.) e hapi derën e dhomës, miku e pa dhe nuk i erdhi turp; me qëllim që i huaji të largohej si të deshte, u fsheh.

36 Ndërsa Mustafai po e lante me dorën e vet dyshekun e fëlliqur të atij njeriu, ai u kthye prapë, u turpërua, i grisi rrobat dhe filloi të qante për hallin e vet. Shkaku i kësaj.

39 Mustafai (a.s.) e qetëson dhe e merr me të mirë mikun arab që qante dhe rënkonte me pendim dhe digjej e vuante nga mungesa e shpresës.

40 Adhurimet si namazi, agjërimi, etj., janë dëshmi për dritën e brendshme.

41 Uji i pastron të gjitha fëlliqësitë dhe Zoti i lartë e pastron ujin nga fëlliqësitë; Zoti i lartë është i pastër nga të këqijat dhe i çliruar nga mangësitë.

42 Pasi turbullohet, uji i kërkon ndihmë Zotit të madh.

43 Dëshmuesia e veprimit dhe fjalës së dukur prej jashtë mbi botën e brendshme dhe dritën e brendshme.

43 Drita e njeriut të ndritshëm e dëshmon atë dritë nga brenda pa bërë ai ndonjë punë ose pa thënë ndonjë fjalë. E fshehta e arifit, e njeriut të urtë të pajisur me kulturën shpirtërore, del në shesh jo më shumë me fjalët dhe punët e tij, sesa pa thënë asnjë fjalë dhe pa bërë asnjë punë. Po kështu, pasi të lindë dielli dhe të ngjitet lart në horizont, nuk ka nevojë për zërin e këndezit, për njoftimin e muezinit dhe për shenja të tjera, drita e diellit dëshmon për vetë diellin!

45 Mustafai (a.s.) i kërkon mikut të thotë Fjalën e Dëshmisë.

46 Sipas hadithit "Shejtani u bë musliman në dorën time", drita që është ushqim i shpirtit, bëhet ushqim për trupin e të urtëve me qëllim që të bëhen shokë dhe miq të shpirtit.

47 Njerëzit trupit (njerëzit e dhënë pas botës materiale), duke mohuar ushqimin e shpirtit, dridhen para gjellës së thjeshtë.

48 Lutje.

48 Fakti që njerëzit kuptojnë nga Lehfi Mahfudh aq sa ta kenë pjesën ditore të caktuar të përfitimit prej tij, i përngjet faktit që Xhebraili kupton çdo ditë diçka prej tij.

49 Ecuritë e kundërta me njëra-tjetrën dhe përplasjet e ndryshme u përngjasin gjendjes së atyre që kërkojnë drejtimin e kibles në errësirë dhe gjendjes së zhytësve që kërkojnë margaritarë në fund të detit.

51 Komenti i ajetit "o mall, përgatitu për ata njerëz që..."

51 Shkaku që fjala ferexh do të thotë lehtësim.

54 Natyra e palloit dhe shkaku që Ibrahimi (a.s.) e theri.

56 Çdo njeri e di favorin dhe persekutimin e Zotit, kapet pas favorit dhe ikën nga persekutimi i tij. Por Zoti i madh e ka fshehur persekutimin brenda favorit dhe favorin brenda persekutimit. Në këtë mënyrë dallohen ata që shohin me dritën e Zotit dhe nuk gënjehen nga dukja. Zoti ka thënë se i provon njerëzit se kush do të veprojë më mirë.

58 Mutezilitët thonë se mendjet janë, në bazë, një; pjesëshmëria e mendjes vjen nga dija, pa përpjekje dhe pa provë. Në kundërshtim me ta, mendjet janë të ndryshme qysh në krijim.

59 Arabi që i ngordh qeni nga uria; megjithëse e ka torbën plot me bukë, nuk i jep asnjë kafshatë qenit, pastaj qan pse i ngordh; arabi që thotë vjersha dhe i bie kokës me grushta.

61 Nuk ka për njeriun asnjë sy të keq më të rrezikshëm se syri i vet që e sheh dhe e pëlqen. Eshtë tjetër gjë nëse syri i ka ndryshuar me anë të dritës së Zotit dhe ia ka arritur të fshehtës për të parë me Zotin.

61 Komenti i ajetit "Edhe për pak, qafirët do të të rrëzonin përdhe me sy!"

63 Një dijetar e sheh me habi palloin që po i shkulte puplat e veta me sqep duke e lënë trupin lakuriq e të shëmtuar dhe e pyet: "A nuk të vjen keq për veten?" Palloi i përgjigjet: "Më vjen keq, por, për mua, shpirti është më i çmuar se puplat, kurse këto pupla janë armiq të shpirtit tim!"

65 Thjeshtësia dhe pastërtia e nefsit të kënaqur turbullohet me anë të mendimeve. Po kështu, po qe se shkruan ose vizaton ndonjë gjë mbi pasqyrë dhe pastaj e fshin, prapë do të mbetet shenjë.

66 Hadithi i Pejgamberit (a.s.) "Në Islam nuk ka klerikalizëm."

67 Edhe sevapi që fiton ashiku nga Zoti është Zoti.

68 Komenti i hadithit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), "Ai që e kërkon vdekjen pa vdekur, quhet sikur s'ka vdekur. Po qe i mirë, shpejtohet të arrijë të mirën, po qe i keq, dëshiron pakësimin e së keqes!"

69 Si Haruti me Marutin që janë të burgosur në pusin e Babilit, edhe mendja me shpirtin janë të burgosur brenda në baltë.

70 Palloi jep përgjigje.

71 Aftësitë, zgjuarësia dhe malli e pasuria janë, si puplat e palloit, armiq të shpirtit të njeriut.

72 Si yjet që zhduken ditën nga drita e diellit, ata që kapërcejnë veten dhe asgjësohen në qenien e Zotit, janë të sigurt nga e keqja e aftësive dhe arteve të tyre. Për ata nuk ka rrezik.

75 Përveç Zotit, çdo gjë edhe ha, edhe hahet. Si zogu apo shpendi që gjuan karkaleca por nuk e sheh skifterin që është ngritur ta gjuajë atë vetë. O njeri, edhe ti ha dhe gjuan, por mos u ndje i sigurt nga ai që ka për të gjuajtur dhe ngrënë edhe ty! Po s'e pe dot me sytë e ballit, shihe me sytë e shpirtit dhe të përvojës që ta kuptosh të fshehtën.

78 Shkaku që Halili (a.s.) e vrau sorrën. Eliminimin e cilës nga vetitë e këqija që e shkatërrojnë myridin shënon kjo?

79 Lutje.

82 Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "T'ju vijë keq për tre vetë: për të parin e një fisi, i cili bie poshtë; për të pasurin e varfëruar; për dijetarin e bërë lodër në duar të injorantëve!"

82 I vogli i drenushës bie në stallën e gomarëve dhe mbyllet aty; gomarët herë e qëllojnë dhe herë tallen me të; ai mbetet i detyruar të hajë bar të thatë... Kjo është vetia e robit të thjeshtë të Zotit; edhe ai ka rënë në këtë gjendje mes njerëzve të dëshirave, pasioneve dhe epshit të kësaj bote. "Islami fillon i vetëm dhe mbaron i vetëm!" Pejgamberi i Zotit ka folur drejt!

83 Muhammed Harzemshahu e pushton qytetin Sebzvar me populli plotësisht rafizi. Populli kërkon falje. Ai u thotë se do t'i falë në qoftë se i dorëzojnë një person të quajtur Ebu Bekr.

87 Pjesa e mbetur e historisë se drerit në stallën e gomarëve.

88 Komenti i ajetit "Unë pashë shtatë qe të dobët të hanë shtatë qe të majmë!" Qetë e dobët Zoti i krijoi me veti luani, prandaj i hëngrën me oreks qetë e majmë. Ç'është e vërteta, qetë e treguan trajtën në pasqyrën e ëndrrës, por ti shih fytyrën e brendshme të çështjes!

89 Fakti që Halili (a.s.) e theri gjelin, për eliminimin e ç'vetie të keqe të myridit është shenjë?

90 Komenti i ajetit "Ne e krijuam njeriun me vetitë më të bukura, pastaj e bëmë më të ultin e të ultëve!" Si dhe: "Dikujt i japim jetë të gjatë, e bëjmë të mplaket, t'i pakësohen fuqia dhe bukuria!"

91 Komenti i ajetit "Dhe e bëmë atë më të ultin e të ultëve. Me përjashtim të atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira, për të cilët ka shpërblim të paprerë e të pafund!"

94 Bota e cila duket sikur s'është, por që, në të vërtetë është, dhe bota e cila, megjithëse s'është, duket sikur është.

96 Komenti i hadithit të Mustafait (a.s.): "Ty të duhet një shok që të varroset bashkë me ty. Ti varrosesh bashkë me të dhe je i vdekur, kurse ai është i gjallë. Po qe i mirë, të bën të mira, po qe i keq, të pengon shpëtimin. Ky shok janë punët që ke bërë. Përmirësoji punët me sa të të vijë për dore, bëj punë të mira!" Përfaqësuesi i Zotit ka thënë drejt.

98 Tefsiri i ajetit "Ai është bashkë me ju!"

98 Komenti i hadithit të Mustafait (a.s.): Atë që i bën të gjitha vuajtjet një vuajtje, Zoti e shpëton nga vuajtjet e tjera. Por atë që i shpërndan vuajtjet e veta, që vuan për shumë gjëra, kudo që të shkatërrohet, Zoti s'e shpëton!"

100 Kuptimi i këtij dyvargshi: "Në qofsh në rrugë, në qofsh rrugëtar, të hapin rrugë. / Në u bëfsh i paqenë, të drejtojnë qenie!"

101 Personit që pretendon për profetësi, i thonë: "Ç'ke ngrënë që je budallallepsur kështu, që flet marrëzira?" Ai u përgjigjet: "Po të kisha gjetur gjë për të ngrënë, as budallallepsesha, as flisja marrëzira!" Çdo fjalë të mirë, po iu tha dikujt që s'e kupton, i thonë marrëzi, madje, edhe sikur ai që e thotë, të jetë i ngarkuar me detyrë për ta thënë atë fjalë!

103 Shkaku që njerëzit u bëhen armiq velinjve, njerëzve të urtë e të aftë të Zotit, të cilët i ftojnë njerëzit te Zoti dhe te jeta e pasosur, si dhe shkaku që njerëzit jetojnë si të huaj me ta.

104 Njeriu punëkeq, po nguli këmbë në të keqe dhe, ndërkaq, po e pa lumturinë e arritur nga njerëzit punëmirë, bëhet shejtan, nga zilia, përpiqet ta pengojë të mirën. Si shejtan! Ai që i digjet prodhimi, kërkon që t'u digjet të gjithëve! "A s'e ke parë njeriun që fal namaz, që përpiqet ta pengojë faljen e namazit?"

106 Lutje.

108 Padishahu e pyet personin që pretendon për profetësi: "Ç'i fal njeriut ai që është pejgamber i vërtetë? Ose, ç'mirësi tjetër përveç kështillës me gojë përfitojnë prej tij njerëzit që takohen me të dhe që i shërbejnë atij?"

109 Një ashik i tregon të dashurës shërbimet që i ka kryer, besnikërinë që i ka treguar, netët e gjata pa rënë në shtrat, dhimbjen dhe dëshirën e vuajtur në ditët e gjata dhe i thotë: "Unë s'di tjetër ç'të bëj; në pastë gjë tjetër për të bërë, më drejto. Do të bëj ç'të më urdhërosh, madje, po të duash, do të hidhem në zjarr si Halili (a.s.), do të hidhem në det në gojë të egërsirës detare si Junusi (a.s.), do të vdes njëqind herë si Xherxhisi (a.s.) nëse duhet, do të bëhem qorr nga e qara si Shuajbi (a.s.)... Eshtë e pamundur të numërohen flijimet e pejgamberëve! E dashura i përgjigjet.

111 Njëri pyeti një dijetar fetar: "Po qe se dikush qan dhe rënkon me zë në namaz, a i prishet namazi?" Dijetari iu përgjigj: "Në fillim duhet parë pse u derdh ai lot, çfarë pa, pse qau. Po qe se ka qarë nga dëshira për Zotin ose ka rënkuar nga pendesa për mëkatet, namazi nuk i prishet, por i bëhet më i përkryer, sepse është thënë se "namazi pa praninë e zemrës s'është namaz". Por në qoftë se ka qarë nga një sëmundje trupore ose nga ndarja me të birin, namazi i prishet, sepse baza e namazit është braktisja e trupit, e djalit dhe, si Ibrahimi, bërja kurban

e djalit dhe hedhja në zjarrin e Nemrudit. Për t'u pajisur me këto shprehi, edhe Mustafait (a.s.) i pati ardhur urdhri: "Zbatoje sheriatin e Ibrahimit" dhe "Te Ibrahimi ka për ju shprehi dhe cilësi që duhen ndjekur!"

112 Një myrit shkoi te shehu. - Ky sheh që konsiderohej pir, domethënë, plak, nuk ishte plak nga mosha, por nga mendja, përvoja dhe intuita njohëse e Zotit. Edhe Isai (a.s.) ishte fëmijë në djep, Jahja (a.s.) shkonte në shkollën e fëmijëve, por të dy ishin pir, pejgamber. – Myriti e gjeti shehun e vet duke qarë. Edhe ai bëri si ai dhe nisi të qajë. Kur mbaroi punë dhe doli jashtë, një myrit tjetër që e njihte mirë shehun, vrapoi pas myritit të ardhur, e zuri dhe i tha: "O vëlla, dëgjo të të them: Shehu qante për hir të Zotit, por ti mos thuaj se edhe ti ke qarë. Duhet të heqësh tridhjetë vjet përkorësi, të kapërcesh rreziqe, të kapërcesh detet plot me kuçedra dhe malet e lartë plot me luanë e tigra që të fitosh të drejtën për të qarë si shehu; megjithëkëtë, mund edhe të mos e fitosh këtë të drejtë. Po të mundesh të arrish në atë pozitë, duhet të falenderosh duke thënë: "Mua m'u tregua toka!"

116 Një shërbëtore, siç u kishte mësuar dhisë dhe ariut lojëra të ndryshme, i kishte mësuar edhe gomarit të së zonjës të bënte marrëdhënie me njerëzit; kështu i jepte mundësi zonjës të kënaqte epshet. Por, që gomari të mos shkonte larg, para marrëdhënies i kalonte organit të gomarit një kungull. Një radhë, për të mbetur vetë, zonja e dërgoi shërbëtoren në një vend të largët dhe hyri vetë në stallën e gomarit dhe menjëherë iu afrua duke e harruar punën e kungullit. Prandaj vdiq për faqe të zezë. Kur erdhi shërbëtorja dhe e pa se ç'kishte ndodhur, filloi ta vajtonte me këto fjalë: "Ah, moj shpirtka ime, mos drita e syve të mi, pse e harrove kungullin? Mjetin e pe, po kungullin, pse s'e pe?" Këndoje ajetin që thotë: "Çdo e metë është e mallkuar", domethënë, çdo vështrim dhe kuptim i metë është i mallkuar. Po të mos ishte kështu, nuk do të tregohej keqardhje për qorrat dhe syvëngërit. Megjithëkëtë, për ata tregohet keqardhje, jo mallkim. Për qorrin nuk ka mundim dhe propozim. Ky ajet e ka hequr për qorrin edhe propozimin, edhe mallkimin, edhe qortimin, edhe zemërimin!"

122 Sugjerimi i pejgamberëve për bashkësitë që s'janë të afta për sugjerimin e Zotit, dhe i shehut për myritët, i ngjan punës së papagallit për të mësuar të flasë para pasqyrës me ndihmën e njeriut, me të cilin ai s'ka afërsi. Siç veprohet me papagallin, edhe Zoti e vë shehun si

një pasqyrë para myritit duke i sugjeruar, kështu, atij, pas pasqyrës. Zoti i ka thënë Pejgamberit: "Mos u nxito duke lëvizur gjuhën me përpjekje për ta thënë para Xhebrailit" dhe "Ajo që thotë Pejgamberi është vetëm fjala që i komunikon Zoti". Ja, ky është fillimi i çështjes që nuk ka fund. Papagalli e lëviz sqepin para pasqyrës nën ndikimin e personit që ndodhet pas pasqyrës dhe përpiqet ta mësojë atë.

124 Një njeri i zemrës pa një bushtër me barrë. Të vegjlit i lehnin në bark. Ai mendoi me vete se qeni leh në roje, mirëpo roje në barkun e nënës s'ka. Pastaj, qeni leh edhe për të kërkuar ndihmë, për të kërkuar qumësht, etj. Meqë është në bark të nënës, këto lehje s'kanë as kuptim, as dobi. Ç'do të thotë kjo?" Kur erdhi në vete, iu drejtua Zotit. Ai tha: "Këtë s'e di askush veç Zotit!" Nga Zoti i erdhi kjo përgjigje: Kjo është gjendja e atyre të cilët, ndërsa ende s'u janë hapur sytë, dalin me pretendime mbi një çështje dhe flasin mbi të. Por me këtë pretendim dhe me këto fjalë, as forcë fitojnë, as ndihmë dhe as dëgjuesit munden t'i çojnë në rrugë të drejtë!"

126 Darvanasit i kishin zili të varfërit dhe thoshin: Nga naiviteti, babai ynë ua jep të varfërve shumicën e prodhimit të kopshtit. Sapo bëhet rrushi, u jep një të dhjetën, sapo bëhet rrushi i thatë, një të dhjetën, sapo të gatuhet hallvë dhe paluze, një të dhjetën, sapo të mblidhen të lashtat e të bëhen duaj, një të dhjetën, sapo të mbarojë shirja, një të dhjetën, nga gruri i përzjerë me kashtë, një të dhjetën, sapo të ndahet gruri nga kashta, një të dhjetën, sapo të bluhet e të bëhet miell, një të dhjetën, sapo të piqet buka, një të dhjetën. Prandaj Zoti i kishte dhënë kopshtit një bereqet të tillë që të gjithë të tjerët që kishin kopshte e vreshta i bëheshin nevojtarë atij dhe i kërkonin edhe fruta, edhe para. Kurse i zoti e kopshtit të begatë nuk i bëhej nevojtar askujt. Të bijtë e shihnin një të dhjetën e dhënë prej tij në mënyrë të përsëritur, por s'e shihnin begatinë e madhe! Si ajo gruaja që e pa organin e gomarit, por kungullin nuk e pa dot!

130 Dhuntia dhe fuqia e Zotit nuk kanë nevojë për aftësi siç ndodh te dhuntia e njeriut, sepse aftësia është diçka e shfaqur pas. Të japë (dhunti) është atribut i Zotit, kurse aftësia është atribut i krijesës. Ai që s'ka fillim nuk është i varur nga gjëja e krijuar pas. Po qe se supozohet se varet, duhet që krijimi pas i tij të jetë i pamundur.

131 Ndërsa po krijohej trupi i Ademit (a.s.), Zoti e ka urdhëruar Xhebrailin (a.s.) "të marrë një grusht dhé mbi tokë", kurse sipas një rrëfimi tjetër, "të marrë nga një grusht dhé prej çdo vendi".

133 Zoti dërgon në tokë Mikailin (a.s.) për të marrë një grusht dhé për ta gatuar trupin e bekuar të Ademit (a.s.) i cili është ati i njerëzve dhe zëvendësi i Zotit, të cilit i kanë bërë sexhde engjëjt dhe i cili u ka shërbyer si mësues atyre.

135 Fakti që qarja e shporr të keqen e ardhur nga qielli nuk është historia e Junusit (a.s.). Zoti i lartë vepron si të dojë, prandaj qarja dhe madhërimi i Zotit i japin dobi njeriut. Kurse filozofët thonë se Zoti vepron sipas ligjeve të natyrës dhe shkaqeve dhe jo siç do, prandaj qarja nuk i ndryshon ligjet e natyrës!

135 Zoti e dërgon Israfilin (a.s.) në tokë për të marrë një grusht dhé për të krijuar trupin e Ademit (a.s.).

137 Zoti dërgon Azrailin (a.s.) që është një engjëll i vendosur e i fortë, që të marrë një grusht dhé për ta gatuar trupin e shkathët të Ademit (a.s.).

140 Krijesa që të dëmton ty në të vërtetë i ngjan një mjeti (një vegle). Arif i thonë atij që nuk sheh mjetin, por Zotin. Edhe nëse në dukje sheh mjetin, ndodh kështu jo nga padija, por se ashtu është dashur. Kështu, Ebu Jezidi (k.s.) ka thënë: "Ka shumë vite që nuk bisedoj me njerëzit dhe nuk e dëgjoj fjalën e popullit, kurse populli pandeh se bisedoj me ta dhe i dëgjoj fjalët e tyre. Sepse ata nuk e shohin dot Personin e Lartë që i flas. Për mua, ata i ngjajnë jehonës që vjen nga mali. Personi i mençur që dëgjon, nuk sheh zërin. Është e njohur proverba: "Muri e pyet gozhdën: "Pse më plagos mua?" Dhe gozhda i përgjigjet: "Shihe atë që më ngul mua!"

142 O Azrail, ai që nuk i sheh nga Zoti shkaqet, sëmundjet, plagën e shpatës, nuk e sheh as punën tënde. Ti je më i fshehtë nga ato shkaqe, por edhe ti je një shkak. Madje edhe e fshehta e thënies atij të sëmurit se "Zoti është më afër tij sesa jush por ju nuk e shihni", nuk mbetet e fshehtë.

144 Të hash dhuntitë e yndyrshme e me mjaltë të botës është e rrezikshme se bëhet pengesë për gjellën e Zotit. Kështu, Pejgamberi ka thënë: "Uria është gjella e Zotit. Me të, domethënë me urinë, ringjallen trupat e njerëzve

fjalëdrejtë." Gjithashtu, ka thënë: "Unë shkoj mik te Zoti im dhe ai më ushqen e më ngop mua!" Edhe Zoti ka thënë: "Ushqehen duke u prehur!"

145 Përgjigje personit të paditur e të shkujdesur që thotë fjalë të tilla pa kuptim, si: "Sa e këndshme do të ishte kjo botë po të mos ishte vdekja; sa e këndshme do të ishte pasuria e kësaj bote po të mos i vinte fundi!

146 Gjërat e kërkuara nga mëshira e Zotit që jep të mira pa e merituar robi. Një Zot që lëshon shi pasi njerëzit e humbin shpresën. Sa e sa largësi ka që bëhen shkak për afërsi. Sa e sa fajtorë të bekuar ka që bëhen shkak për pendesë. Sa e sa bekime ka që vijnë kur kërkohet e keqja. Në këtë mënyrë, dihet se Zoti i kthen të këqijat e robve në të mirë!

151 Ejazi kishte një odë ku vendoste opingat dhe postiqen. Meqë dera e odës ishte e shëndoshë dhe e drynosur, shokët e tij pandehnin se aty kishte një thesar.

153 Të thënat përbëhen nga trajta e jashtme e tregimit, thuhen sipas aftësisë kuptuese të atyre që munden ta kuptojnë trajtën, sipas pasqyrës së imagjinatës së tyre. Po qe se zbres në shenjtërinë e të vërtetës së kësaj historie dhe tentoj ta them, nga turpi edhe koka ka për të më humbur, edhe mjekra, edhe kalemi. Për të mençurin një shenjë mjafton!

155 Sipas konkluzionit "shihe njeriun pse u krijua", shkaku i shikimit të opingave dhe qyrkut.

155 Siç është thënë se "Zoti i krijoi xhindet nga zjarri pa tym", gjithashtu, Zoti ka thënë për Iblisin: "Nuk ka dyshim se ai ishte nga lloi i xhindve dhe doli nga urdhri i Zotit!"

159 Kuptimi i hadithit "Çdo gjë na e trego siç është", i thënies "Po të ngrihej perdja, nuk do të shihja dhe nuk do të dija më shumë se ç'di dhe se ç'shoh", si dhe i dyvargshit "Kë të shohësh me sy të keq, dije se e sheh nga korniza e qenies tënde, se e sheh keq atë nga që je vetë i keq". Hija e shkallares së shkallës së pjerrët është e pjerrët.

160 Lutja është, në dukje, e kundërta e trillit, por, në të vërtetë, i dashuruari me të dashuruarin janë Një megjithëse në dukje janë të kundërt. Kështu, pasqyra nuk ka trajtë dhe mungesa e trajtës është e kundërta e trajtës. Por mes pasqyrës dhe trajtës ka unitet. Shtjellimi i kësaj vazhdon gjatë. Për atë që ka mend, një shenjë mjafton.

162 Një e dashur e pyeti të dashurin: A mua më do më shumë, apo veten? I dashuri i tha: Unë vetë kam vdekur, kam shpëtuar nga vetja, me ty jam ringjallur. Jam bërë i paqenë nga qenia ime, nga cilësitë e mia dhe me ty jam bërë i qenë. Diturinë time e kam harruar, me diturinë tënde jam bërë zotërues dijeje. Forcën time e kam hequr nga mendja dhe kam marrë forcë me ty. Po të të dua ty, kam dashur vetveten. Personi që ka pasqyrë të njohjes kategorike, edhe nëse sheh veten në të, ka parë Zotin. Në këtë mënyrë, është thënë: "Vishu me cilësitë e mia dhe duku te njerëzit; ai që të sheh ty, më ka parë mua, ai që të drejtohet ty, më drejtohet mua!" Ja, gjithmonë kështu shkon kjo!

164 Beu prishës shkon natën me ushtarë dhe hap odën e Ejazit ku sheh të varura opingat dhe postiqen; duke e pandehur lojë këtë, rrëmon të gjitha anët e dhomës, çan vendet ku dyshon, sjell gropëhapësit, shpon muret dhe më në fund, pas s'gjen asgjë, turpërohet dhe e humb shpresën. Po kështu, ata që u kapën pas mendimeve dhe fantazive, u thanë magjistarë pejgamberëve dhe velinjve, thanë se ata e bëjnë atë punë nga vetja dhe se kërkojnë lartësim dhe hyjnitet. Pastaj, kur e hetuan të vërtetën, u turpëruan dhe nuk patën asnjë dobi!

166 Keqbërësit shkojnë te padishahu nga oda e Ejazit me torbat bosh dhe të turpëruar. Kështu, siç thuhet në ajetet "Ajo ditë është një ditë e tillë kur disa fytyra zbardhen dhe disa nxihen." dhe "Ata që i kanë atribuar Zotit gënjeshtra, i sheh tek u janë bërë fytyrat sterrë të zeza", kur u kuptua se pejgamberët ishin të pastër nga të këqijat, ata që kanë rënë në mendime të këqija për ta, turpërohen.

167 Padishahu ia lë Ejazit t'i pranojë pendesat e keqbërësve, e atyre që e hapën atë odë, dhe ia lë opinionit të tij rregullimin e ndëshkimit të tyre. Në këtë mënyrë, padishahu thotë se kjo e keqe i është bërë Ejazit dhe jo atij vetë.

168 Padishahu i thotë Ejazit në dashtë t'i falë, në dashtë t'i dënojë. Përsa i përket drejtësisë dhe favorit, secila është e drejtë dhe në secilën ka përfitime. Ashtu siç ka në drejtësi mijra favore të fshehura, ashtu dhe "Në ndëshkimin një për një (kisas) për ju ka jetë". Ai që, përsa i përket jetës së vrasësit, nuk e sheh të përshtatshëm ndëshkimin një për një, sheh vetëm jetën e tij, nuk sheh jetën e qindramijra të pafajshmëve që do të druheshin për ta bërë një punë të tillë!

170 Padishahu e urdhëron Ejazin të nxitohet, duke i thënë: "Merr shpejt një vendim, mos prit dhe mos thuaj "ditët janë tonat, disa herë ju ndihmojnë juve, disa herë, neve", sepse pritja është më e keqe se vdekja!" Përgjigjja e Ejazit.

171 Ka shumë kohë që po e vëmë në provë thashethemen; le të provojmë edhe të heshtim për një farë kohe.

172 Po i pyete qafirët, mohuesit, se kush i ka krijuar qiejt dhe tokën, të thonë se i ka krijuar Zoti. Atyre u ngjet edhe njeriu që nuk thotë fjalë të përshtatshme me gjendjen e vet dhe nuk mbron një çështje të përshtatshme për veten. Si ndodh që njeriu i cili pranon ekzistencën e një Zoti të vetëm që zotëron fuqi, i cili i ka krijuar qiejt, tokën dhe të gjitha krijesat, i cili dëgjon, sheh, është i pranishëm dhe vëzhgues, i cili vëzhgon çdo gjë dhe ndodhet në çdo vend, si ndodh, pra, që ky njeri t'i falet një idhulli të gdhendur në gur dhe të flijojë për të mallin dhe jetën?

176 Pasi të dalë qumështi nga gjiri, nuk kthehet dot më në gji. Kështu është edhe pendesa e vërtetë. Pasi të pendohet për një faj, njeriu s'e sjell më ndërmend atë faj, jo të interesohet për të; çdo çast i shtohet neveria për të. Neveria është shenjë se pendesa i është pranuar. Në fillim dëshira bëhet e pakëndshme, pastaj, vendin e saj e zë neveria. Kështu, kanë thënë: "Ashkun s'e sjell tjetërkush veç një ashku tjetër. Pse nuk i bëhesh ashik një të dashure më të bukur se ajo që ke?" Po qe se zemra e njeriut, pas pendesës, priret përsëri nga ai faj, kjo prirje tregon se pendesa s'i është pranuar, se kënaqësia e pranimit nuk e ka zëvendësuar atë faj. Pra, ende nuk është shfaqur konkluzioni "adhurimet e rënda ia lehtësojmë", por tek ai ende vepron konkluzioni "gjërat e vështira, të këqijat ia tregojmë të lehta".

177 Kërkesa e diçkaje nga Zoti prej arifit që ka arritur te Zoti, i ngjet kërkesës prej Zotit të diçkaje prej tij. Sepse është thënë: "Unë bëhem veshi, syri, gjuha dhe dora e tij" dhe "kur i gjuajte ata gurë, nuk i gjuajte ti por i gjuajti Allahu". Ka shumë ajete dhe hadithe mbi këtë çështje. Krijimi prej Zotit i shkakut e ka kapur fajtorin për veshi dhe e ka çuar te pendesa e vërtetë!

179 Radha për ta kërkuar i vjen Nasuhit dhe, kur thuhet "secilin e kërkuam, tani kërkojeni edhe Nasuhin", Nasuhit i bie të fikët nga frika. Ashtu siç i thoshte Zoti

të Dërguarit të tij - Zoti i dhëntë mëshirë dhe paqe – kur sëmurej ose e kapte ndonjë shqetësim, "nga vështirësia lehtësohesh", edhe Nasuhi shpëton nga ajo vështirësi.

180 Margaritari gjendet dhe shërbëtorët dhe shërbëtoret e sulltanit i kërkojnë falje Nasuhit.

182 Pas pendesës së Nasuhit dhe pranimit të saj, sulltani e thërret përsëri Nasuhin për detyrën e shërbyesit të hamamit, kurse Nasuhi gjen pretekste dhe nuk shkon.

182 Po qe se dikush pendohet, bën pendesë, pastaj e harron dhe kërkon ta provojë përsëri atë që e ka provuar, bie në dëm përjetësisht. Po qe se tregohet i dobët dhe i pavendosur në pendesë, po qe se nuk ndjen ndonjë përgjegjësi nga pendesa dhe pendesa nuk i pranohet, na ruajttë Zoti! Ai i ngjet një peme pa rrënjë. Çdo ditë zverdhohet edhe ca, thahet edhe ca!

183 Personi i shquar i cili ndodhet pranë Zotit **përsa i përket gjykimit të njerëzve sipas gradëve dhe hpërblimit nga ushqimi i mëshirës, me frymëzimin e Zotit, i ngjet luanit. Edhe kafshët e tjera hanë nga mbetjet e tij dhe ngopen. Por aërsia e tyre ndaj luanit nuk është përsa i përket hapësirës, por etive. Hollësitë e kësaj janë të shumta; është Zoti që çon në rrugë të drejtë!**

185 Kur gomari i druvarit pa në stallë mirëqenien e kuajve arabë, e dëshiroi atë fat. Në lidhje me këtë histori, fakti se nuk është e drejtë gjë tjetër veç kërkesës për gjykim dhe favor. Sepse njëqind lloje shërbimesh, po të jenë si shija e gjykimit, të gjitha ato mundime janë të kuajve. Po kërkove fatin e mirë por të paprovuar, ai ka edhe mundimin e vet të cilin ti s'e sheh dot. Kështu, në çdo kurth duken kokrrat e vëna aty, jo kurthi. Kurse ti je shtënë pas një kurthi të vetëm, kërkon që të gjitha kokrrat të jenë të tuat gjithmonë dhe thua me vete sikur të shkoje atje e t'i mblidhje të gjitha kokrrat! Ti pandeh se ato kokrra janë pa kurth!

186 Gomari i thotë dhelprës se është i kënaqur me kësmetin e vet dhe nuk e pëlqen fjalën e dhelprës.

187 Gomari i jep përgjigje dhelprës.

187 Përgjigjja e dhelprës për gomarin.

187 Gomari i jep përgjigje dhelprës.

188 Historia e zahidit, njeriut të devotshëm, i cili, në lidhje me mbështetjen te Zoti, kërkon ta provojë këtë mbështetje, i lë shkaqet dhe, duke u larguar nga qyteti

dhe vendet nga kalojnë njerëzit, shkon në rrëzë të një mali, e mbështet kokën nga uria mbi një gur dhe thotë me vete: O Zot, u mbështeta në krijimin e shkaqeve dhe në furnizimin prej teje, i lashë shkaqet. Në këtë mënyrë, të shoh edhe se si mbështetja tek ti krijon shkaqe.

189 Dhelpra i jep përgjigje gomarit dhe e inkurajon për fitim.

189 Gomari i përgjigjet kështu dhelprës: Mbështetja te Zoti është fitimi më i mirë. Sepse çdokush është nevojtar për të. Çdokush lutet: O Zot, ma bëj të mundur mua këtë punë! Në lutje ka mbështetje te Zoti. Mbështetja te Zoti është një fitim i tillë që ai që e fut në dorë këtë fitim, nuk ka nevojë për asnjë fitim tjetër.

190 Po qe se te ai që tregon për një mirëqenie, nuk sheh dot gjurmët dhe dritën e asaj mirëqenieje, duhet të konkludosh se ai është imitues. Në lidhje me këtë, po sjellim si shembull historinë e një deveje.

193 Ndryshimi mes fjalëve të personave që kanë fituar vlera me të kënduar me ftesë të shehut të përkryer e të arritur te Zoti.

194 Ndërsa dikush po i bënte të keqe një djaloshi, e pa hanxharin në belin e djaloshit dhe e pyeti: "Pse kjo?" Djaloshi i tha: "Po qe se dikush bie në mendime të këqija kundër meje, ja shpoj barkun me të!" Dikushi edhe kryente punën e vet, edhe thoshte "shyqyr Zotit që nuk mendoj të keqe për ty!" "Vargjet e mia poetike nuk janë vargje, por një atdhe. Tallja ime nuk është tallje, por t'u mësoj një gjë të tjerëve!" "Nuk ka dyshim se Zoti nuk turpërohet as të sjellë si shembull mushkonjën, as ata që janë më të lartë se ajo." Pra, ka provuar ndërrimin e shpirtrave të atyre më të lartë se ajo për shkak të mohimit të tyre. Ata thonë: "Ku e ka qëllimin Zoti me këtë shembull?" Si përgjigje për këtë fjalë, ai thotë: "Me këtë, dëshiron që disa t'i tërbojë e t'i nxjerrë nga rruga, kurse disa të tjerë t'i fusë në rrugë të drejtë." Sepse çdo provë i ngjet peshores. Shumë vetëve, me atë mjet u skuqet fytyra, kurse shumë të tjerë nuk e arrijnë dot qëllimin, mbeten të privuar. Ndërkaq, ai që mendon sadopak mbi këtë çështje, i gjen shumicën e rezultateve.

195 Sado që u druajt gomari, më në fund dhelpra doli më e aftë dhe e tërhoqi atë në pyllin ku ndodhej luani.

197 Nga frika, njëri e hodhi veten në një shtëpi. Fytyra i ishte zverdhur krejt, buzët i ishin mavijosur, duart i dridheshin si gjethe shelgu. I zoti i shtëpisë e pyeti: Për hajër të qoftë, ç'ndodhi? Personi iu përgjigj: Jashtë kapin gomarët dhe u ngarkojnë barrë! I zoti i shtëpisë i tha: Mirë, o i bekuar, kapin gomarët! Ti nuk je gomar, pse frikësohesh? Personi i tha: Aq shumë ishin nxehur nga puna, me aq vrull e kishin marrë, sa ishte e pamundur ta dallonin se kë kishin para dhe pata frikë se mos më marrin për gomar!

198 Dhelpra e çon gomarin te luani, gomari ikën nga luani, dhelpra e qorton luanin që ishte nxituar kur gomari ndodhej ende larg, luani i kërkon falje dhelprës dhe i lutet të shkojë edhe një herë e ta bindë gomarin.

200 Prishja e betimit dhe pendesës e çon njeriun në fatkeqësi. Kështu, për çifutët që e kanë të ndaluar të punojnë të shtunat dhe për ata që kanë ngrënë në sofrën e Isait, është thënë: "Ata i goditëm dhe i shndërruam në majmunë dhe derra!" Në këtë ummet, bashkësi, goditet zemra, kurse në kiamet, trupit i japin trajtën e zemrës.

201 Dhelpra shkon përsëri te gomari i ikur për ta bindur për të dytën herë.

202 Përgjigjja e gomarit për dhelprën.

203 Dhelpra i përgjigjet gomarit.

205 Historia e Gazneli Sheh Muhammed Serrezit (k.s. - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!)

206 Pas shumë vitesh, shehu kthehet nga shkretëtira në qytetin e Gaznes; me urdhrat e ardhur nga bota e fshehtë, shëtit me zembil në dorë duke mbledhur ndihma për t'ua shpërndarë të varfërve. Shpirtit që gjen lartësinë sublime të komunikimit hyjnor "Urdhëro, robi im!", i vijnë letra një pas një, lajmëtarë një pas një. Po ta ketë dritaren e shtëpisë të hapur, nëpër të hyn edhe dielli, edhe drita e hënës, edhe shiu, edhe letra, edhe gjëra të tjera në mënyrë të pandërprerë.

209 Kuptimi i hadithit të shenjtë "Po të mos ishe ti, nuk do t'i krijoja qiejt!"

210 Me urdhrin e Zotit, shehu shkon katër herë brenda një dite në shtëpinë e një beu me zembil për të lypur; beu e qorton dhe e fyen, shehu i kërkon të falur.

212 Beu dëgjon këshillën e shehut dhe qan; drejtësia në thelbin e shehut reflektohet te ai; pas asaj sjelljeje të keqe, beu ia dhuron thesarin shehut; shehu nuk e pranon duke i thënë se s'e merr pa urdhër.

213 Shehut i erdhi urdhër nga bota e fshehtë: Me urdhrin tim, dy vjet bëre lypësi dhe more. Këtej e tutje mos merr, jep. Fute dorën nën rrogos. Atë rrogos e shndërrova në torbë të Ebu Hurejres. Me qëllim që njerëzit e kësaj bote të kuptojnë se përtej kësaj bote ka një botë tjetër, atë që dëshiron e gjen nën atë rrogos. Ajo botë është një botë e tillë që, sikur të marrësh në dorë dhé, bëhet flori. Po të hyjë i vdekuri në atë botë, ringjallet. Pabekueshmëria më e madhe bëhet bekueshmëria më e madhe pasi të hysh atje. Atje kufri bëhet besim, helmi kthehet në kundërhelm. Ajo botë nuk është as brenda kësaj bote, as jashtë, as nën të, as mbi të. Nuk është as ngjitur me këtë botë, as veç. Ajo është një botë pa sasi e pa cilësi. Çdo çast nga ajo botë duken mijëra vepra dhe modele. Kështu, arti i dorës s'është as brenda trajtës së dorës, as jashtë, as ngjitur me të, as veç; po kështu, shikimi i syrit, aftësia shprehëse e gjuhës; për njeriun e mençur një shenjë mjafton!

214 Shehu e di pa folur se ç'mendon personi që kërkon, e kupton se sa borxhe ka borxhliu. Kjo është shenjë e hadithit të shenjtë "Shiheni popullin me atributet e mia!"

215 Shkaku që shehu dinte se ç'mendonte kushdo.

215 Gomari bëhet vegël e dhelprës si pasojë e dredhive të saj.

216 E mira e ngrënies së pakët dhe e urisë.

216 Shembull.

217 Një sheh e këndon se ç'ka brenda dervishi dhe ia kupton ambicjen; duke i dhënë këshilla me gojë, me urdhrin e Zotit, ia fal forcën për t'u mbështetur te Zoti.

218 Në një ishull të madh na paska qenë një ká. Zoti i madh e mbushte atë ishull me barëra e gjelbërime dhe kau kulloste gjer në mbrëmje duke i ngrënë të gjitha, fryhej si një shkëmb i madh, kurse natën e kalonte pa gjumë me shqetësimin se e kishte ngrënë çdo gjë dhe të nesërmen nuk do të kishte ç'të hante dhe, kështu, nga vuajtja, dobësohej për gjithë natën dhe bëhej si dragua. Pastaj, kur ngrihej në mëngjes, e gjente të gjithë ishullin

plot bar e gjelbërim dhe gjer në mbrëmje e kulloste të gjithë, pastaj në mbrëmje nuk flinte dot tërë natën nga shqetësimi për të nesërmen dhe dobësohej e tretej si dragua. Megjithëse kishte vite që e vinte re këtë, prapë nuk i besonte Zotit!

219 Luani e kap dhe nis ta hajë gomarin, e merr etja dhe shkon në një burim për të pirë ujë. Ndërkohë, dhelpra ia ha gomarit copat më të mira, mëlçitë, zemrën dhe veshkat. Kur kthehet luani dhe nuk i sheh mëlçitë dhe zemrën e gomarit pyet: Ku i ka ky zemrën dhe mëlçitë? Dhelpra i thotë: Po të kishte zemër dhe mëlçi, a do të vinte prapë këtu pasi pa atë ditë atë gjendje të tmerrshme dhe pasi e pati shpëtuar jetën me mijra dredhi? Edhe Zoti ka thënë: "Qafirët thonë: "Po të kishim dëgjuar, ose po të kishim pasur mend, nuk do të bëheshim për xhehennem!"

220 Prifti që shëtit ditën me kandil ngaqë pati rënë në një hall.

222 Muslimani fton në fe një zoroastrian. Gjendja e shejtanit në derë të Zotit.

224 Gjendja e shejtanit në derë të Zotit.

226 Muslimani sunni i jep përgjigje një qafiri determinist dhe ia argumenton se njeriu ka vullnet (aftësi zgjedhëse). Sunneti është një rrugë nëpër të cilën kanë ecur të gjithë pejgamberët (Zoti u dhëntë paqe), të cilët e kanë shkelur me këmbë dhe e kanë hapur. Në të djathtë të asaj rruge është shkretëtira e determinimit. Atje njeriu nuk sheh vullnet në veten e vet, mohon urdhrat dhe ndalimet dhe bie në interpretim. Mirëpo nga mohimi i urdhrave dhe ndalimeve del mohimi i xhennetit që është vendi i zbatuesve të urdhrave, dhe mohimi i xhehennemit që është vendqëndrimi dhe ndëshkimi i moszbatuesve të urdhrave. Atëherë, gjer ku arrin puna? Unë mos të ta them; të mençurit një shenjë i mjafton. Gjithashtu, në të majtë të asaj rruge është shkretëtira e Kaderit. Ai që devijon këtu, di që fuqia e njeriut është mbi fuqinë e krijuesit. Dhe nga kjo dalin në shesh ngatërresa të tilla që ai zoroastriani determinist i ka numëruar e thënë.

230 Njohjet ndërgjegjësore, si dëshirimi i një gjëje dhe bërja apo mosbërja e saj, ose mbetja në vështirësi, përballimi i zemërimit dhe mirëkuptimi, gjendja e ngopur dhe e uritur zënë vendin e ndijimeve, si dallimi i të verdhës prej të kuqes, i të voglës prej të madhes, i të hidhurës

prej të ëmblës, i erëmirës prej erëkeqes, me shqisën e të prekurit, i gjësë së fortë nga gjëja e butë, i të nxehtit nga të ftohtit, i gjësë djegëse e përvëluese nga gjëja shumë e nxehtë, i gjësë së njomë nga gjëja e thatë, i murit nga druri. Në këto kushte, ai që e mohon njohjen dhe kuptimin ndërgjegjësor, mohon ndijimin dhe ndjenjën, madje, më keq. Njohja dhe kuptimi ndërgjegjësor janë më të hapur se ndijimi dhe ndjenja. Sepse është e mundur që ndjenja të lidhet, që ndijimi të pengohet. Por pengimi i njohjes dhe kuptimit ndërgjegjësor është i pamundur. Të mençurit i mjafton një shenjë.

232 Tregim mbi vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të njeriut dhe mbi faktin që kazaja dhe kaderi nuk e asgjësojnë vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të njeriut.

234 Përgjigje deterministit; prova e vullnetit dhe aftësisë zgjedhëse, drejtësia e urdhrave dhe ndalimeve; justifikimi i determinizmit është i papranueshëm në asnjë sheriat dhe fe dhe ky justifikim s'ka për ta shpëtuar atë nga ndëshkimi i punës që ka bërë; tregim mbi mospranimin e shprehjes së Iblisit "Zoti im, ti më tërbove mua". E pakta është provë e të shumtës.

236 Kuptimi i hadithit "U bë ajo që deshi Allahu!" Pra, dëshira është dëshira e tij, pëlqimi i tij. Pëlqimin e tij kërkojeni. Të mos ju ngushtohet zemra nga armiqësia e të tjerëve, nga kundërshtimi i të tjerëve. Fjala "kane - u bë" e hadithit është folje e shkuar, por në punën e Zotit nuk ka të shkuar e të ardhme. Sepse "te Zoti nuk ka as mëngjes e as mbrëmje!"

238 "Kalemi i shkroi gjërat që do të bëhen dhe boja, madje, iu tha!" Kjo do të thotë se kalemi e plotësoi atë që duhej thënë dhe për të cilën nuk ka diskutim. Për shembull: Kalemi shkroi dhe u tha se adhurimi dhe mëkati s'janë një! Kalemi shkroi dhe u tha se besueshmëria dhe vjedhja nuk janë një. Kalemi shkroi dhe u tha se falenderimi dhe mosmirënjohja nuk janë një. Kalemi shkroi dhe u tha se nuk ka dyshim që Zoti nuk e humbet shpërblimin e njerëzve që bëjnë mirësi!

240 Në Herat, një i varfër pa skllevërit e stolisur e të zbukuruar të amidit të Horasanit. Kishin hipur mbi kuaj arabë, kishin veshur rroba me qëndisje ari, kishin vënë në kokë qylafë me ar, dhe plot stoli të tjera. Ai pyeti se prej nga ishin ata bejlerë e padishahllarë. I thanë se s'ishin bejlerë, por skllevër, skllevërit e Amidit të

Horasanit! I varfëri ngriti kokën drejt qiellit dhe tha: "O Zot, mëso nga Amidi se si duhet kujdesur për robin!" Atje, amidi është si një farë ministër i financave.

243 Prapë ai deterministi qafir i jep përgjigje muslimanit sunnit i cili e fton në Islam dhe e inkurajon ta braktisë bindjen deterministe; pyetja dhe përgjigjja zgjaten nga të dy anët. Gjënë e vështirë dhe fuqinë për të dhënë përgjigje e zgjidh vetëm ashku, pasioni hyjnor i vërtetë. Ashku nuk pengohet nga pyetja dhe përgjigjja. "Dhe kjo është mirësia e Zotit që ia jep kujt të dëshirojë!"

246 Padishahu e pyet Ejazin enkas që ta bëjë të flasë: "Pse ua thua dhimbjet dhe gëzimet gjërave pa shpirt si opingat dhe postiqja?"

248 Të afërmit i thonë Mexhnunit: "Bukuria e Lejlasë nuk është kush e di se çfarë, në qytetin tonë ka shumë vajza më të bukura se ajo. Të të tregojmë një a dy prej tyre dhe zgjidhe njërën që të duash dhe shpëtoje edhe veten nga ky hall, na shpëto edhe ne!" Mexhnuni u përgjigjet.

250 Xhuhai vesh çarçaf, futet mes grave dhe dëgjon predikim; pastaj, për shkak të një veprimi të tij, njëra nga gratë e njeh dhe bërtet.

252 Padishahu i thotë përsëri Ejazit ta shpjegojë punën e opingave dhe të postiqes në mënyrë që shokët të marrin kështillë, sepse "Feja është këshillë!"

252 Në kohën e Bajezidit, kur një qafiri i thanë "bëhu musliman", ai dha një përgjigje për këtë.

253 Një muezin me zë të shëmtuar këndon ezan në një vend jomusliman dhe një qafir i bën një dhuratë.

255 Një grua i tha të shoqit se mishin e kishte ngrënë macja; burri e peshoi macen në peshore dhe, pasi macja erdhi gjysmë oke, burri i tha gruas se mishi peshonte gjysmë oke dhe ca më tepër, dhe, në këtë ras, mungon ose macja, ose mishi!

257 Një bej i thotë skllavit të shkojë e t'i sjellë verë. Duke e sjellë verën, gjatë rrugës, skllavi e dëgjon këshillën e një zahidi dhe e thyen shtambën me gur. Kur beu e mori vesh si qëndroi puna, e ndëshkoi zahidin. Kjo ngjarje ka ndodhur në kohën e Isait (a.s.) kur vera s'ishte e ndaluar, por zahidi që sillej me devotshmëri, e pengonte popullin nga dëfrimet dhe kënaqësitë e këtij lloji.

259 Zija Delki e kishte shtatin shumë të gjatë. Kurse i vëllai shehislam Taxh Belhi ishte mjaft shtatshkurtër. Shehislami turpërohej shumë nga i vëllai. Një ditë, Zijai shkoi në mësim te i vëllai. Aty ndodheshin e gjithë parësia e Belhit. Zijai nderoi dhe kaloi. Shehislami i ngrit përgjysmë nga vendi. Atëherë, Zija i tha: Po, je shumë shtatgjatë, vidh një copë prej shtatit!

261 Beu shkon me zemërim për ta ndëshkuar zahidin.

262 Delkaku e zë mat Sejjid Shah Tirmidhiun.

263 Për shkak të dukjes me vonesë të Xhebrailit (a.s.), Mustafai (a.s.) mërzitet dhe kërkon të hidhet nga mali Hira. Xhebraili (a.s.) i bën zë të mos hidhet se para vetes ka fat të madh.

265 Beu u thotë ndërmjetësuesve dhe komshinjve se nuk do ta falte zahidin që kishte treguar paturpësi duke e thyer shtambën. Ai u thotë se është betuar ta ndëshkojë.

265 Zahidi me komshinjtë dhe ndërmjetësuesit i bien ndër këmbë për të dytën herë beut dhe i luten.

266 Beu u jep përgjigje prapë.

267 Komenti i ajetit "Dijeni se ahireti është vendbanesa e jetës së përhershme." Pra, dera, muri, uji, shtamba, fruti, pema e asaj bote janë gjithmonë të gjalla. Flasin dhe dëgjojnë. Prandaj Mustafai (a.s.) ka thënë: "Bota është kufomë, kurse ata që e duan atë, janë qenër!" Po të mos kishte gjallje në ahiret, edhe ai do të bëhej kufomë. Kufomës i thonë kështu se është i vdekur, jo nga era e keqe dhe ndyrësia.

270 Padishahu e urdhëron edhe një herë Ejazin që ta shuajë kureshtjen e kureshtarëve dhe vështirësinë e atyre që e qortojnë dhe i thotë se lënia e tyre në pozitë të vështirë nuk është burrëri.

271 Trupi i njeriut i ngjan shtëpisë së miqve, mendimeve të ndryshme dhe miqve të ndryshëm. Arifi është dakord me ato mendime të gëzuara e të dëshpëruara, pothuaj i ngjet pejgamberit Halil që i kënaq të vetmuarit. Edhe porta e tij ishte gjithmonë e hapur për të pritur dhe respektuar edhe qafirin, edhe besimtarin, edhe të besueshmin, edhe tradhtarin. Të gjithë miqve u tregonte fytyrë të qeshur.

271 Në një shtëpi shkoi një mik. Gruaja e të zot të shtëpisë tha: Filloi shiu, miku na mbeti në qafë!

273 Mendimi që i vjen zemrës çdo ditë, i ngjet mikut që vjen qysh në të zbardhur, i jep urdhra të zot të shtëpisë, sillet i shkujdesur. Fama e të qenit zot shtëpie është pikërisht në pritjen dhe respektimin e mikut dhe në durimin e trilleve të tij.

275 Padishahu i shfaq konsideratë Ejazit.

275 Një baba e paralajmëron kështu të bijën: "Ruaje veten të mos mbetesh me barrë me tët shoq!"

277 Ishte njëri që kishte luftuar me nefsin, me vetveten, kishte vuajtur nga ashku, ishte rritur nën hije dhe kishte hyrë në rrugën e sofizmit ngaqë populli i bënte sexhde vetëm atij, ia puthte dorën, e shihte me respekt dhe e tregonte me gisht si sofiun e kohës. Ashtu siç e sëmurën fëmijët mësuesin duke i thënë je i sëmurë, edhe ky, duke u krenuar e duke fantazuar, thoshte: Unë jam burrë i xhihadit, mua më thonë pehlivan i kësaj rruge. Në luftën e madhe nuk kam shok, kurse lufta e vogël për mua s'është gjë. Tha se duhet të shkonte në luftë me gazinjtë dhe të tregonte trimëri. Shkoi në luftë, por atje u tregua i paaftë dhe frikacak. Mirëpo ai mbahej si luan, kurse gjendja e luanit i thoshte: "S'është ashtu... Së afërmi do ta shihni dhe do ta kuptoni... Prapë, së afërmi do ta shihni dhe do ta kuptoni!"

279 Gazinjtë e këshillojnë: "Ty të bie të fikët vetëm nga pulitja e syve të një qafiri dhe të bie shpata nga dora. Duke pasur një zemër të tillë, një zjarr të tillë, mos eja në luftë të demaskohesh, por kujdesu për kuzhinën e teqes!"

280 Ajjaziu që e mëshiroftë Zoti, me shpresën për të rënë dëshmor, shkon shtatëdhjetë herë në luftë me gjoksin hapur; më në fund, kur i pritet shpresa për të rënë dëshmor në luftën e vogël, drejtohet nga lufta e madhe dhe mbyllet në vetmi. Në këtë mes, dëgjon daullen e gazinjve, ndjen nefsin që kërkon të këpusë zinxhirët e të shkojë në luftë dhe, për shkak të kësaj dëshire, e vë nefsin nën dyshim.

282 Një trim lufte, çdo ditë, nga torba plot me para argjendi, nxirrte një grosh dhe e hidhte në hendek. Nga nefsi iu këput një ambicje dhe një dëshirë: Meqë i hedh këto para në hendek, hidhi menjëherë dhe të shpëtojmë nga ky mundim. Prerja e plotë e shpresës është njëra nga dy prehjet. Por ai trimi i tha nefsit se nuk do t'ia jepte as këtë prehje!

283 Një njeri i tregon kalifit të Egjiptit portretin në letër të një skllaveje. Kalifi dashurohet pas portretit dhe dërgon një bej me ushtri për ta sjellë atë vajzë që ishte shërbëtorja e emirit të Musulit. Në këtë luftë vriten shumë njerëz dhe shemben shumë vende.

284 Për të mos u derdhur më shumë gjaku i muslimanëve, emiri i Musulit ia fal shërbëtoren kalifit.

287 I penduar për krimin që kishte bërë, kryekomandanti e vë shërbëtoren të betohet se nuk do t'ia tregojë këtë punë kalifit.

289 Argumentet e atyre që e mohojnë ahiretin dhe dobësia e atyre argumenteve që përbëhen nga shprehja "ne nuk shohim botë tjetër veç kësaj".

290 Kalifi shkon pranë bukuroshes për t'u takuar me të.

290 Skllavja, duke parë dobësinë e epshit të kalifit, i kujtohet forca e beut dhe fillon të qeshë; kalifi kupton diçka nga kjo e qeshur.

291 Kalifi e kërcënon se do ta vrasë skllaven po s'ia tregoi sekretin e të qeshurës dhe ajo, nga frika e shpatës, ia zbulon sekretin.

293 Pasi e kupton punën, padishahu vendos ta mbulojë atë pabesi dhe, meqë i bëri padrejtësi emirit të Musulit, siç thonë ajetet "Kush bën të keqe ia bën vetes" dhe "Nuk ka dyshim se Zoti yt të sheh e të vëzhgon ty", e kupton se e ka zënë kjo e keqe dhe mendon se, po të marrë shpagim, do ta pësojë edhe nga kjo dhe prandaj vendos t'ia kthejë skllaven emirit të Musulit.

295 Sipas konkluzionit "Ne i përpjesëtuam furnizimet e tyre", Zoti i jep dikujt epshin dhe fuqinë e gomarëve, dikujt tjetër, fuqinë e pejgamberëve dhe engjëjve. Të hedhësh nga koka iluzionet dhe dëshirat është shenjë lartësie. Braktisja e iluzioneve dhe dëshirave është fuqi e posaçme e profetëve. Farërat që s'kanë epsh, nuk shpërthejnë gjë tjetër veçse kiamet.

296 Padishahu u tregon pjesëmarrësve në Divan një margaritar dhe ia jep vezirit duke e pyetur se ç'vlerë ka. Veziri e mbiçmon vlerën e margaritarit. Atëherë, padishahu e urdhëron që ta thyejë margaritarin, kurse veziri nuk pranon duke sjellë justifikime të ndryshme.

298 Duke kaluar dorë më dorë, margaritari erdhi te Ejazi. Ejazi e theu margaritarin pa bërë si të tjerët, pa u gënjyer për mallin e pasurinë që mund t'i jepte padishahu, pa u kapur pas rrobave të shumta dhe lavdërimit të mendjes së atyre që ranë në gabim. Nuk është e drejtë që imituesi të quhet musliman. Rrallë, edhe imituesi, me mbrojtjen e Zotit, mbështetet në bindjen e tij dhe shpëton shëndoshë nga provat, sepse e Vërteta (Zoti) është një, por ka shumë të kundërta të saj që i ngjajnë asaj dhe e gënjejnë njeriun. Imituesi nuk e njeh dot atë të kundërtin, prandaj nuk e njeh edhe të Vërtetën. Por edhe sikur ai të mos e njohë të Vërtetën, po ta shohë e Vërteta me sy të mirë, kjo mosnjohje nuk i jep dëm imituesit.

299 Bejlerët e qortojnë Ejazin pse e theu margaritarin dhe ai u jep përgjigje.

300 Padishahu urdhëron vrasjen e bejlerëve, kurse Ejazi ndërmjetëson duke thënë se "falja është më e drejtë".

302 Kur Faraoni do t'i vriste magjistarët, ata thanë: "S'ka gjë, ne do të kthehemi te Zoti ynë!" Komenti i kësaj.

304 Ejazi e quan veten fajtor për ndërmjetësimin dhe kërkon falje për këtë faj; edhe në kërkimin e faljes e di se është fajtor. Ky lloj dëshpërimi shkaktohet nga njohja e madhështisë së sovranit. Pejgamberi ka thënë: "Unë e njoh më mirë nga ju Zotin dhe e kam frikë Zotin më shumë se ju!" Edhe Zoti i lartë ka urdhëruar: "Kjo është fjalë, përtej kësaj nuk ka. Nga Zoti frikësohen robtë që e njohin atë!"

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut Mëshirues e Shpërblyes!

Prej Tij kërkojmë ndihmë, te Ai mbështetemi!
Çelësi i zemrave është pranë Tij!
Qofshin të mëshiruar më i dobishmi i krijesave, Muhammedi, bashkë me familjen e tij dhe të gjithë muslimanët që e kanë parë atë!
Ky libër është i pesti i Mesnevisë dhe i deklaratës shpirtërore; ky tregon se sheriati i përngjet qiririt, ndrit rrugën. Megjithëkëtë, rruga nuk kapërcehet vetëm duke e marrë qiririn në dorë. Pasi të drejtohesh në rrugë, ecja jote është tarikati; pasi të arrish synimin, ai është hakikati (e vërteta). Prandaj është thënë se "po të zbuloheshin të vërtetat, rrugët dhe sheriatet do të bëheshin të kota!". Kështu, nëse bakri bëhet vetvetiu flori ose është në thelb flori, atëherë, ç'nevojë ka për njohuri kimike, ç'nevojë ka ta fusësh atë në reaksione kimike? Njohuritë kimike janë sheriati, kurse hyrja në reaksione kimike, tarikati. Prandaj, kanë thënë se "është keq edhe të kërkosh prova pas arritjes te gjëja ku duhet arritur, edhe ta lësh provën para se të arrish te gjëja ku duhet arritur!" Shkurt, sheriati i përngjet mësimit të diturisë kimike nga mësuesi ose libri. Kurse tarikati është përdorimi i lëndëve kimike, futja e bakrit në reaksione kimike, shndërrimi i bakrit përmes reaksioneve kimike. Dhe, hakikati (e vërteta) është kthimi i bakrit në flori. Ata që e njohin kiminë, gëzohen se e zotërojnë këtë dije. Ata

që e gjejnë të vërtetën, gëzohen se u bënë flori, se shpëtuan edhe nga njohuria, edhe nga përpunimi, se u bënë njerëzit e lirë të Zotit. "Çdo grup lavdërohet dhe gëzohet me gjënë që ka merituar dhe arritur" ose sheriati i përngjet njohurisë së mjekësisë, kurse tarikati është të mbash pehriz sipas asaj njohurie ose të marrësh ilaçe e t'i përdorësh ato sipas asaj njohurie! Ndërkaq, hakikati (e vërteta) është të gjesh shërimin e përjetshëm duke shpëtuar nga të dyja ato; po që se njeriu i jep fund kësaj jete, vdes e shkon, për të s'mbetet as sheriat, as tarikat, as hakikat! Por po qe se gjatë jetës së vet ka arritur te e vërteta (hakikati), klith duke thënë: "Eh, sikur ta dinin njerëzit e mi se për çfarë më gjykoi Zoti im!" Po të mos ketë arritur, bërtet: "Eh, sikur të mos më ishte dhënë libër, të mos e dija llogarinë time; eh, sikur vdekja të më kish marrë të tërin që të mos ringjallesha më! Malli e pasuria s'më shpëtuan, s'më bënë dobi, më lanë fuqitë!" Sheriati është dijeni, tarikati është rrugë, kurse hakikati, arritja tek Zoti. "Kush dëshiron të arrijë tek Zoti, të bëjë punë të mira dhe të mos bëjë askënd ortak në adhurimin e Zotit!" Mëshira e Zotit qoftë mbi më të dobishmin e krijesave, Muhammedin, familjen e tij dhe të gjithë muslimanët që e kanë parë dhe janë takuar me të!

MESNEWI
V

Drita e yjeve, shah Husameddini, kërkon fillimin e vëllimit të pestë...

O Husameddin bujar, dritë e Zotit, ti je mësues-mjeshtër për mësuesit-mjeshtër të atyre që janë kulluar nga turbullitë njerëzore!

Po qe se populli nuk do të ndodhej pas perdes, sytë e popullit do të ishin të hapur dhe gryket nuk do të ishin të ngushta e të dobëta,

Ia hyja një mënyre shpirtërore për të të lavdëruar ty, hapja një buzë që të thoshte fjalë të tjera nga këto fjalë.

Por kafshatën e skifterit, trumcaku s'e gëlltit dot! Zgjidhja është përzjerja e ujit me vaj (njomja dhe lyerja me vaj).

Eshtë e panevojshme të të lavdërosh ty para atyre që jetojnë në këtë botë të errët. Vetitë e tua mund t'ua them vetëm bashkësisë së shpirtërorëve!

Përshkrimi yt për banorët e kësaj bote është me dëm. Unë të mbaj fshehur ty si të fshehtën e ashkut, pasionit hyjnor!

Të lavdërosh, të përshkruash, do të thotë ta grisësh perden. Mirëpo dielli s'ka nevojë as për të treguar për të, as për ta përshkruar atë!

Kush lavdëron diellin, lavdëron veten; ai kërkon të thotë se të dy sytë i ka me dritë, se nuk i ka me sklepa dhe se nuk i dhembin.

Ta fyesh diellin në këtë botë, do të thotë ta fyesh veten duke i quajtur dy sytë e tu të verbër, të errët e të vegjël.

Fale ti personin që e ka zili diellin i cili ia ka arritur qëllimit në këtë botë!

A mund ta mbulojë, a mund ta fshehë njeriu diellin nga sytë? A mund ta zbehë dhe rrudhë freskinë e tij?

Apo a mund ta pakësojë dritën e tij që s'ka fund? Ose a mund ta zbresë nga grada që ka?

Zilia ndaj të mëdhenjve është vdekje e përjetshme për ziliqarin!

Vlera dhe pozita jote e kaloi me kohë gradën që mund ta kuptojë mendjet. Mendja u çorodit dhe mbeti e paaftë për të të përshkruar ty!

Ç'është e vërteta, kjo mendje u bë e paaftë në përshkrim, por përsëri duhet që ta bëjë përshkrimin ashtu, paaftësisht!

Sepse dijeni se gjëja që nuk përshkruhet dot plotësisht, nuk hidhet!

Po s'e pive dot tufanin e resë tënde, si mund ta braktisësh pirjen e ujit?

Po qe se nuk e hap dhe e vë në shesh dot të fshehtën, trego për lëvoret, me to rinoji kuptimet!

Sipas teje, fjalët janë lëvore, por sipas kuptimeve të tjera janë plotësisht tul, përmbajtje.

Sipas arshit, qielli është poshtë, mirëpo sipas një grumbulli dheu, qielli është shumë i lartë!

Ngaqë mund të të humbin ty, ngaqë mund ta humbin rastin, të të lavdëroj ty pa rënë në mall, dhe të gjejnë rrugë.

Ti je dritë Zoti. Shpirtin e tërheq me forcë drejt Zotit, kurse populli i thjeshtë ndodhet në errësirat e iluzionit dhe dyshimit.

Ky nuri yt i bukur është kusht që këta të pasy të heqin syrme, e lartëson atë nur.

Personi i aftë veshshpuar e gjen nurin. Sepse ai nuk është ashik ndaj errësirës si miu!

Çipitë, sydobëtit, që përsillen netëve, si mundet ta bëjnë tavaf pishtarin e besimit?

Idetë dhe fjalimet e holla e të vështira janë një lak i natyrshëm për personat që nuk e kanë arritur ende nurin e besimit, që kanë mbetur në rrugë.

Një njeri i tillë nuk i hap dot sytë ndaj diellit për ta thurur dhe stolisur aftësinë e vet.

Ai nuk lëshon dot degë e gjethe drejt qiellit si hurma, por, si brejtës, e bën token vrima-vrima!

Për njeriun ka katër gjëra që ia mërzitin shpirtin; këto katër gjëra janë bërë druri i kryqëzimit për të!

Komenti i ajetit "Merr katër zogj dhe mblidhi pranë vetes!"

O ti që e ke shikimin si dielli, ti je Halili i kohës. Vraji këta katër zogj grabitqarë!

Sepse secili prej këtyre, si sorrat, ua gërryejnë dhe ua nxjerrin sytë e mendjes të mençurve.

Katër vese që i përkasin trupit, u ngjajnë zogjve të Halilit. Therja e tyre i hap rrugë shpirtit.

O Halil, për të shpëtuar nga e mira dhe nga e keqja, preua kokën atyre dhe të të shpëtojnë këmbët nga pengesa.

E tëra je ti, të gjitha janë pjesët tënde. Zgjidhjau këmbët; këmbët e tyre do të thotë këmbët e tua.

Prej teje, bota bëhet një vend ku fluturojnë dhe mblidhen shpirtrat; një kalorës mban qindra ushtri!

Sepse ky trup është vendqëndrimi i katër veseve; emrat e atyre katër veseve janë zogj intrigantë e ngatërrestarë.

Po deshe që ky popull të jetë i gjallë përjetësisht, prejua kokat këtyre katër zogjve të këqinj.

Pastaj ringjalli ata në një lloj tjetër që prej tyre të mos vijë ndonjë dëm.

Zogu moralo-shpirtëror që grabit katër rrugët e ka bërë vendbanimi zemrën e popullit.

Po u bëre urdhërues për të gjitha zemrat, o njeri, në këtë kohë ti je zëvendësi i Zotit.

Prijua kokat këtyre katër zogjve të gjallë dhe popullin i cili s'është i përjetshëm, përjetësoje!

Këta zogj ose shpendë janë patoku, palloi, korbi dhe këndezi. Të ngjashmit e këtyre brenda janë katër veset.

Patoku është ambicje, këndezi është epsh. Pozita i ngjet palloit, korbi, dëshirës.

Dëshira e korbit është të bëhet i përjetshëm ose të ketë jetë të gjatë, gjë që e shpreson vazhdimisht.

Patoku ambicje e gropos në tokë të njomë e të thatë, ç'të gjejë.

Gryka s'i pushon asnjë çast; nga urdhrat e Zotit ka dëgjuar vetëm urdhrin "hani!"

I ngjet grabitësit; gërmon shtëpinë dhe sheh ta mbushë torbën shpejt e shpejt.

Dhe e fut në torbë çdo gjë: të mirë apo të keqe. Aty i ngjesh edhe kokrrat e margaritarëve, edhe kokrrat e qiqrrës.

Po të vijë një armik, i thotë të mos fusë në thes asgjë, pavarësisht se ç'është, e njomë apo e thatë!

Koha është e ngushtë, rasti ikën. Duke pasur frikë nga kjo, ai, pa pushuar, ç't'i bjerë në dorë, e merr nën sqetull shpejt e shpejt.

Nuk ka besim te i zoti se mos i sjell ndonjë armik tjetër.

Mirëpo besimtari ka besim në atë mënyrë jetese, prandaj vazhdon të marrë ngadalë-ngadalë dhe duke bërë pushim.

E di se si e shkatërroi padishahu armikun, prandaj ka besim edhe se s'do ta humbë rastin, edhe se armiku s'do të vijë!

E di dhe është i sigurt se shokët fqinjë nuk do ta trazojnë, se nuk do t'ia rrëmbejnë atë që ka rrëmuar dhe mbledhur ai.

E njeh drejtësinë e padishahut, e ka parë se si i ka shtrënguar nënshtetasit, se askush nuk e qorton tjetrin.

Shkurt, nuk nxitohet, është i qetë, është i sigurt se s'ka për t'i ikur dore pjesa e vet.

Prandaj duron, e ka syrin të ngopur, atë që i bie në dorë ua dhuron të tjerëve, rrobën e ka të pastër.

Sepse ngadalësia është dritë e Zotit. Kurse nxitimi shkaktohet nga nxitja e shejtanit.

Sepse shejtani e frikëson me varfëri, ia nervozon kalin e durimit dhe ia vret.

Dëgjoje nga Kur'ani, shejtani të kërcënon dhe të tremb me varfëri të rëndë.

Në këtë mënyrë, edhe ti bën siç thotë ai, duke nxituar, ha gjëra të fëlliqura, fut në dorë vende të fëlliqura. As burrëri të mbetet, as durim, as mendim për të bërë mirësi!

Shkurt, qafiri ha bukë me shtatë barqe, fenë dhe zemrën i ka të dobëta, por barkun, të madh!

Shkaku që Mustafai, Zoti e mëshiroftë, e ka thënë hadithin: "Qafiri ha bukë me shtatë zorrë, besimtari, me një zorrë!"

Qafirët, mohuesit, shkuan miq te Pejgamberi. Në kohën e mbrëmjes shkuan në faltore.

O ti që i pret miq në konakun tënd të gjithë që ndodhen në botë, o padishah, të erdhëm miq!

Nuk kemi ushqim me vete, vijmë prej larg. Menjëherë na lësho mëshirë dhe dritë!

Pejgamberi u tha sahabeve, shokëve: o shokë, ndajini mes jush këta, sepse ju jeni të mbushur plot me mua dhe me shprehitë e mia!

Trupi i çdo ushtari është i mbushur me padishahun. Prandaj u heqin shpatë atyre që janë armiq të pozitës dhe gradës së padishahut.

Ti e tund shpatën me zemërimin e padishahut, prandaj, pse zemërohesh me vëllezërit?

Me reflektimin e zemërimit të padishahut e godet rëndë vëllain e pafajshëm!

Padishahu është një shpirt, por ushtria është e mbushur me të. Shpirti është si uji, këta trupa i ngjajnë lumit.

Po qe se uji i shpirtit të padishahut është i ëmbël, të gjithë lumenjtë mbushen me ujë të ëmbël.

Sepse populli është në fenë e padishahut; kështu ka urdhëruar padishahu i sures "Abese".

Çdo shok zgjodhi një të ardhur; mes tyre ishte njëri me trup të madh që s'i ishte parë shoku!

Ishte aq trupmadh, sa askush nuk pati guxim ta merrte me vete. Si llumi i verës në kupë, edhe ai mbeti në faltore.

Pasi ai mbeti i fundit, Mustafai e mori me vete. Në tufë kishte shtatë dhi që jepnin qumësht.

Dhitë ishin kthyer në shtëpi për t'u mjelur se ishte koha e ngrënies.

Ai njeriu i babëzitur hëngri edhe bukën, edhe gjellën. Ai e përlau edhe qumështin e të shtatë dhive!

Njerëzit e shtëpisë prisnin qumështin e dhive, prandaj u zemëruan.

Ai njeri i pangopur e ktheu stomakun në daulle; i vetëm, hëngri sa për tetë vetë!

Kur do të binte të flinte, hyri në dhomë. Shërbëtorja e zemëruar ia mbylli derën.

Nga jashtë i vuri zinxhirin dhe e lidhi. Ishte zemëruar shumë me të, ishte dëshpëruar shumë prej tij.

Në mesnatë apo afër agimit, qafirit i erdhi nevoja, bargu filloi t'i gurgullojë.

U ngrit nga shtrati dhi vrapoi te dera, ia hodhi dorën për ta hapur, por e gjeti mbyllur.

Dhe megjithëse përdori shumë dredhi për ta hapur derën, nuk mundi t'ia arrijë qëllimit.

Njeriu mbeti keq, nevoja po e shtrëngonte shumë dhe oda ishte e ngushtë. Ai mbeti i shtangur pa parë para vetes asnjë lloj rrugëdaljeje.

Më në fund vendosi të bjerë sërish në gjumë për ta kapërcyer kështu këtë vështirësi. E zuri gjumi dhe në ëndërr pa një rrënojë.

Në kujtesë kishte një rrënojë prandaj e pa në ëndërr.

Me ta parë veten në një rrënojë të vetmuar e të qetë, menjëherë u ul ta kryente nevojën që po e shtrëngonte akoma më keq.

Por kur u zgjua, pa se dysheku ishte mbushur plot pisllëk. Nga halli, u marros!

Ai vinte vërdallë duke menduar se këtë turp s'e mbulonte as toka!

Në gjumë, më keq se zgjuar. Këtu ha, atje e nxjerr!

Ashtu siç bërtet qafiri nga fundi i varrit, ashtu dhe ai bërtiste e thoshte se do të ishte më mirë të kishte ngordhur!

Dhe u vu të priste mbarimin e asaj nate të vështirë dhe hapjen e derës.

Ai llogariste që, sapo të hapej dera, të dilte jashtë si shigjetë e të ikte pa e kuptuar kush se ç'kishte ndodhur!

Historia është e gjatë, prandaj po e pres shkurt! Më në fund, porta u hap dhe ai shpëtoi nga halli!

Mustafai (a.s.) e hapi derën e dhomës,
miku e pa dhe nuk i erdhi turp;
me qëllim që i huaji të largohej si të deshte, u fsheh.

Mustafai erdhi herët në mëngjes dhe e hapi derën. Mëngjesi i tregoi udhën njeriut që e kishte shtrembëruar udhën.

Me qëllim që personi të cilin e kishte gjetur belaja, të mos turpërohej, Mustafai u fsheh.

Mendonte që personi të mos e shihte kush e hapi derën dhe të dilte jashtë lirisht.

Ose u fsheh pas diçkaje, ose prehri i Zotit e fshehu Mustafain nga ai.

Boja e Zotit disa herë mbulon, perden e Zotit pa sasi e cilësi, e vë para atij që sheh.

Në këtë mënyrë, armikun nuk e tregon edhe duke e pasur pranë. Fuqia e Zotit është më e madhe se kjo!

Mustafai e shihte gjendjen e tij të mbrëmshme.

Por fermani i Zotit bëhej pengesë që atij t'i hapej rrugë pa ia njoftuar gabimin, që ai të mos binte në gropë me atë të keqe.

Urtësia e Zotit dhe urdhri i zbritur nga qielli nuk donte që Mustafai ta shihte atë në atë gjendje.

Sa e sa armiqësi ka që dalin në miqësi. Sa e sa shembje ka që kthehen në ndërtim.

Një llafazan, për inat, e solli atë dyshekun pranë Pejgamberit.

Dhe i tha: pa shihe, një herë, se ç'ka bërë ai miku yt! Mustafai që ishte mëshirë për botët, qeshi.

Sille atë ibrikun t'i laj të gjitha me dorën time!

Çdonjëri i tha: "Për hir të Zotit, mos e bëj, që t'u bëfshin kurban edhe shpirti ynë, edhe trupi ynë!

Dhe lëre ta lajmë ne këtë pisllëk. Kjo punë është punë dore e jo zemre!

O ti për të cilin Zoti është betuar në jetën tënde! Ai të bëri zëvendës, të uli në fronin e zëvendësit!

Ne jetojmë për të të shërbyer ty; po të ngrihesh ti për shërbim, ç'bëhemi ne? "

Pejgamberi tha: "Edhe unë e di, mirëpo tani këtë unë do ta laj. Në larjen e saj personalisht nga unë ka urtësi."

Kjo ishte fjalë pejgamberi, prandaj të gjithë heshtën dhe u vunë të presin që të dilte sekreti i asaj pune.

Me urdhrin e Zotit, Pejgamberi po e lante atë pisllëk mirë e mirë, jo sa për sy e faqe!

Sepse zemra i thoshte ta lante ai vetë se në atë punë kishte shumë e shumë urtësi!

Ndërsa Mustafai po e lante me dorën e vet
dyshekun e fëlliqur të atij njeriu,
ai u kthye prapë, u turpërua, i grisi rrobat
dhe filloi të qante për hallin e vet. Shkaku i kësaj.

Qafiri i shkretë kishte një statujë dhuratë. Me ta parë se e kishte humbur, nuk i mbeti më vendosmëri.

Tha se e kishte harruar në dhomën ku kishte qenë mbrëmë.

I vinte turp, por ambicja e tërhiqte nga ajo anë. Ambicja është kuçedër, s'është gjë e vogël!

Duke rënë pas statujës, shkoi me vrap dhe e pa në dhomën e Mustafait.

E pa, por ai dora e Zotit po e lante vetë atë pisllëk, sytë e këqinj qofshin larg tij! Qafiri e pa këtë!

E pa dhe statuja i doli mendsh. Te ai u shfaq një trazirë, ai u shqetësua shumë dhe filloi të griste rrobat.

I binte me pëllëmbë fytyrës, e përplaste kokën pas murit dhe derës.

Nga hundët e nga koka nisi t'i rrjedhë gjak dhe atij Pejgamberi të madh i erdhi keq për të.

Bërtiste e thërriste. Kur njerëzit iu mblodhën te koka, filloi t'u thotë: O njerëz, ruhuni!

O kokë pa mend, thoshte, dhe i binte; o gjoks pa nur, shoshte, dhe e rrihte gjoksin.

Binte me ballin në tokë duke thënë: o i tëri i kësaj toke, kjo copë e pavlerë po turpërohet prej teje!

Megjithëse je një i tërë, ti i nënshtrohesh urdhrit të tij, kurse unë, megjithëse jam pjesë, bëj padrejtësi, bëj të këqija dhe tërbohem.

Duke qenë i tërë, ti tregohesh i përulur ndaj Zotit, dridhesh prej tij, kurse unë, duke qenë pjesë, copë, veproj në kundërshtim me të!

Çdo çast e ngrinte kokën drejt qiellit dhe thirrte: O kiblja e botës, unë s'kam fytyrë!

Kur filloi të dridhej e përpëlitej me të tepërt, Mustafai e mori në krahë.

E qetësoi, e mori me të mirë, ia hapi sytë dhe ia bëri të njohur veten.

Po s'qau reja, si qesh gjelbërimi? Po s'qau fëmija, si shpërthen qumështi?

Edhe fëmija njëditësh e di rrugën. Të qaj, thotë, që të vijë dadoja që i vjen keq për mua!

Ti nuk e di se edhe dadoja e dadove të jep pak qumësht po s'qave.

Vëri veshin, "qani shumë" tha. Qani që të rrjedhë qumështi i mirësisë së Zotit!

Shtylla e botës është qarja e resë dhe djegia e diellit. Ti kapu mirë pas kësaj shtylle!

Po të mos ishin nxehtësia e diellit dhe loti i resë, si do të zhvilloheshin trupi dhe toka?

Po të mos ishin themel kjo nxehtësi dhe kjo qarje, si do të rregulloheshin katër stinët?

Ashtu siç nxehtësia e diellit me qarjen e resë i japin kënaqësi botës dhe e japin botës një gjendje të këndshme,

Edhe ti ndize diellin e mendjes dhe bëje syrin një re që derdh lot.

Ashtu si fëmijës së vogël, edhe ty të duhet një sy që qan. Ha pak bukë, sepse buka të prish nderin.

Trupi zhvillohet natë e ditë me të; po vuri gjethe dega e shpirtit, i derdh gjethet dhe bie në stinën e vjeshtës.

Ushqimi i trupit rezulton menjëherë me mbetjen e shpirtit pa ushqim. Ushqimi i trupit duhet pakësuar, ushqimi i shpirtit duhet shtuar.

"Zotit jepini borxh." Edhe ti jep borxh nga ushqimi i trupit që, si shpërblim, në zemrën tënde të mbijë gjelbërim

Jep borxh dhe pakësoje kafshatën e trupit, në këtë mënyrë, fytyra që "nuk e shohin sytë", të duket, të shihet.

Po qe se trupi e pastron veten nga pisllëqet, mbushet me vlera të larta, aroma të mira dhe margaritarë!

Një njeri i tillë shpëton nga ky pisllëk, arrin të jetë i pastër dhe trupi i tij arrin enigmën: "Zoti dëshiron që ju të pastroheni nga këllirat!"

Por shejtani të thotë: "Kujdes, kujdes, se pastaj pendohesh dhe bie në dëshpërim!

Po qe se i fshin nga trupi këto dëshira, po qe se i eliminon ato, do të pendohesh shumë, do të biesh në vuajtje.

Haje këtë se të jep nxehtësi, është shërim për natyrën, kurse këtë pije për dobi, është ilaç.

Dhe kuptoje këtë qëllim! Ky trup është kafshë shale; puna më e mirë është të japë atë gjë për të cilën është mësuar!

Kurrë mos u mëso me urinë se të prishet shëndeti dhe në tru ze në zemër të dalin shumë sëmundje."

Ai Shejtan i poshtër vjen me kërcënime të tilla, i këndon popullit qindra magjira.

Në mjekim e tregon veten Galinos dhe këtë e bën për të ta gënjyer zemrën tënde të sëmurë.

Të thotë: "Ky është një ilaç që ti të shpëtosh nga ankthi dhe vuajtja!" Kështu i pati thënë edhe Ademit për grurin!

Vjen me të thirura krenare dhe i shtrëngon buzët siç ia shtrëngojnë kalit me mëgojëzën kur e mbathin.

Pastaj t'i mbyll buzët edhe ty, të kap për veshi si të kapte veshët e kalit dhe të tërheq në ambicje dhe fitime.

Mos dysho se t'i mbath këmbët me potkonj dhe pastaj ti mbetesh në rrugë.

Potkoi i tij të lëshon ty në lëkundje midis dy punëve. dhe ti nuk di se kë të bësh, këtë apo atë. Mblidhi mendtë në kokë dhe eja në vete!

Bëj punën që ka zgjedhur Pejgamberi, jo atë që bëjnë i marri dhe fëmija!

"Xhenneti është rrethuar." Me se është rrethuar? "Me gjëra që njeriu nuk i do, nuk i pëlqejnë!" Sepse me to zhvillohen dhe shtohen të mbjellat!

Shejtani ka shumë magjira me dredhira dhe mashtrime. Edhe kuçedrën e fut në shportë!

Edhe sikur njeriu të jetë ujë që rrjedh, e kap dhe e lidh; edhe sikur të jetë njeriu më i mençur e më i ditur i kohës, e mashtron dhe e përqesh.

Bëje mendjen tënde mik me mendjen e një miku, këndoje ajetin "Puna e tyre është te këshillimi" dhe sipas kësaj bëj punë!

Mustafai (a.s.) e qetëson dhe e merr me të mirë mikun arab që qante dhe rënkonte me pendim dhe digjej e vuante nga mungesa e shpresës.

Kjo fjalë nuk ka fund. Arabi mbeti i habitur nga mirësia dhe favori i madh i atij padishahu.

Po çmendej, po i ikte mendja, por dora e mençur e Mustafait e tërhoqi këtej.

Në këtë anë eja, i tha. Dhe ai u zgjua siç zgjohet njeriu nga një gjumë i rëndë dhe shkoi në atë anë që i thanë.

Mustafai i tha: "Eja në këtë anë, mos e bëj këtë gjë, eja në vete. Në këtë anë për ty ka shumë punë!"

Ia spërkati fytyrën me ujë dhe i tha: "O dëshmitar i Zotit, fol dhe dëshmo!"

Edhe unë të bëhem dëshmitar e të dal jashtë. Kur ndodhem në atë shkretëtirë, më mërzitet shpirti!

Në këtë korridor të kadiut të vendimit të lartë, ne ndodhemi për të marrë pjesë në gjyqet "Bela" dhe "Elest".

Ne thamë "Bela, Po" dhe fjala dha puna jonë përsa i përket provës, është për ta zbatuar dhe dëshmuar këtë!

Pse po qëndrojmë në korridorin e kadiut? A nuk erdhëm ne për të dëshmuar?

O dëshmitar, pse do të burgosesh në korridorin e një gruaje? Jepe atë dëshmi dhe shpëto!

Ty të thirrën këtu që të mos bësh kryeneçësi, por të dëshmosh.

Mirëpo ti, nga kryeneçësia, je ulur në këtë vend të ngushtë, ke lidhur duart, ke mbyllur buzët.

O dëshmitar, po s'e bëre këtë dëshmi, si mund të shpëtosh nga ky korridor?

Kjo punë mbaron në një çast, bëje dhe mbaroje. Mos ia zgjat vetes punën për në dimër!

Qoftë në shekull, qoftë në këtë çast, jepe këtë amanet dhe shpëto!

Adhurimet si namazi, agjërimi, etj., janë dëshmi për dritën e brendshme.

Namazi, agjërimi dhe lufta janë dëshmi për besimin.

Zeqati, dhurimi dhe lënia e zilisë janë njoftime për të fshehtën e vet.

Të bësh mirësi, të ushqesh, të ftosh miq do të thotë "o të mëdhenj, ne jemi me ju, besuam me një mendim drejt jush".

Dhuratat, të dhënat janë provë që duan t'i thonë atij që i jepen: "Unë jam me ty, unë të dua ty!"

Kushdo që përpiqet me ndonjë mall ose fjalë të magjishme, do të thotë se brenda ka një margaritar.

Drojtja nga Zoti ose bujaria janë margaritarë që dëshmohen me zeqat dhe agjërim.

Agjërimi thotë: Ky u drojt nga hallalli; dije se nuk ka mundësi të shkojë në haram!

Zeqati thotë: Ky jep edhe mallin e vet; atëherë, si vjedh nga ai me të cilin është në të njëjtën fe, në të njëjtën rrugë?

Por nëse këto punë i bën me hipokrizi dhe gënjeshtër, ata dy dëshmitarë nuk pranohen në gjykatën e drejtësisë së Zotit!

Gjahtari lëshon kokrra dridhi por jo nga mëshira, por për të gjuajtur.

Edhe macja agjëron në muajin e agjërimit, por e tregon veten sikur po fle, me qëllim për të gjuajtur.

Nga kjo shtrembëri, qindra fise janë pandehur për të këqinj. Ky njeri i keq e ka nxjerrë për të keq edhe emrin e personave bujarë dhe që agjërojnë.

Por favori dhe mirësia e Zotit, pavarësisht se ai bën punë të shtrembra, më në fund e pastron atë prej të gjithave.

Mëshira e tij e ka kapërcyer atë të keqe dhe i ka dhënë atë dritë që nuk ia ka dhënë as hënës pesëmbëdhjetë!

Zoti e shemb përpjekjen e atij pa u përzier me këtë të keqe, mëshira e tij e pastron atë nga ky gabim.

Dhe në këtë mënyrë del në shesh bamirësia e Zotit; një kokardë e mbulon qerosën e robit.

Shiu bie nga qielli për të pastruar gjërat e pista...

Uji i pastron të gjitha fëlliqësitë dhe Zoti i lartë e pastron ujin nga fëlliqësitë; Zoti i lartë është i pastër nga të këqijat dhe i çliruar nga mangësitë.

Uji që rri, fëlliqet dhe, pasi fëlliqet, ndjenja neveritet prej tij, nuk e do atë.

Zoti e çon atë përsëri në detin e drejtësisë dhe atje ai ujë pastrohet nga bujaria e ujit të atyre ujërave.

Vitin tjetër vjen duke e hequr fundin zvarrë. Po e pyetën se ku ndodhet, thotë se ndodhet në detin e kënaqësive.

Unë këtu u fëlliqa dhe shkova. Pastaj erdha i pastër. Vesha rroba dhe arrita në tokë.

O të fëlliqur, ejani tek unë, sepse unë kam marrë shprehitë e Zotit.

Të gjithë fëlliqësinë jua pranoj dhe, si engjëll, i fal pastërti edhe shejtanit, madje.

Pasi të fëlliqem, shkoj prapë atje, arrij në origjinën e origjinës së pastërtive.

Hirkën time të fëlliqur e heq atje dhe ai më jep mua përsëri një rrobë të pastër.

Puna e tij është ajo, puna ime është kjo. Zoti i botëve e stolis dhe e zbukuron botën.

Po të mos ishin fëlliqësitë tona, si do t'i jepej certifikatë ujit?

Uji i ngjet dikujt që ka vjedhur nga dikush qeset me florinj dhe vrapon nga të katër anët duke kërkuar ndonjë nevojtar ose të varfër!

Ose derdhet në barërat e mbira, ose ia lan sytë ndonjërit me sy të palarë!

Ose nëpër dete, pa duar e pa këmbë e bart gjeminë si hamalli në shpinë!

Në të ka qindramijra ilaçe të fshehura. Sepse çdo ilaç formohet dhe zhvillohet prej tij siç është.

Shpirti i çdo margaritari, zemra e çdo kokrre të ngrënshme noton në ujin që është si farmaci e vërtetë.

Ai i ushqen jetimët në tokë, ai i bën të ecin njerëzit e tharë e të mbetur ulokë.

Por sapo t'i mbarojë majaja, turbullohet dhe ashtu si ne, mbi tokë, shtanget i habitur.

Pasi turbullohet, uji i kërkon ndihmë Zotit të madh.

Fillon të thërrasë nga brenda: O Zot, më dhe, ç'më dhe, tani kam mbetur i varfër!

Kapitalin e derdha te i pastri dhe i pisti dhe e shpenzova. O ti që jep kapital, a s'ka më?

Zoti i thotë resë ta çojë atë në një vend të mirë. Edhe diellit i thotë ta tërheqë atë lart.

E shtyn atë në lloj-lloj rrugësh dhe, më në fund, e çon në detin pa anë e pa kënd.

Me këtë ujë e kemi fjalën për velinjtë, të urtit. Ai shpirt i pastron mirë papastërtitë tuaja!

Sapo të turbullohet nga pabesitë e atyre të tokës, prapë shkon në arsh, te ai që fal pastërti!

Prapë, nga ajo anë vjen duke e tërhequr fundin dhe vrapon t'u japë mësim atyre të tokës nga pastërtitë e oqeanit.

Sapo të lodhet nga qëndrimi bashkë me popullin, atë radhë thotë: "O Bilal, me zërin tënd na jep qetësi, prehje e kënaqësi!

O Bilal me zërin e bukur, ngjitu në vendin ku këndon ezan dhe bjeri daulles së mërgimit!"

Shpirti shkoi në fushatë, trupi është në kijam (në këmbë). Prandaj, kur mbaron namazi, jepet selam.

Tejemmumi e shpëton çdo njeri; ata që kërkojnë kiblen, i bën të heqin dorë, e tregon kiblen.

Sjellja e shembujve është mjet (ndërmjetës) midis fjalëve. Mjeti është kusht që të kuptojnë të gjithë.

Kush mund të hyjë në zjarr pa mjete përveç Salamandrës që ka shpëtuar nga vartësia prej provës?

Për ta sjellë natyrën tënde në gjendje të përshtatshme e të këndshme me zjarrin, ke për mjet hamamin.

Meqë s'ke për të hyrë dot në zjarr si Halili, hamami t'u bë përfaqësues dhe uji, provë.

Ngopja është prej Zotit, por si ndodh që njerëzit e zakonshëm (natyralë) ngopen pa bukë?

Favori është prej Zotit, por njerëzit materialë (të lidhur pas trupit) nuk mund ta gjejnë atë favor pa perden e livadhit dhe barit.

Por kur të mos mbetet mjeti trup pa perde, njeriu, ashtu si Musai, dritën e hënës e sheh dhe e gjen përsëri në vetvete.

Edhe këto aftësi janë dëshmitarë se zemra e ujit është e mbushur plot me favorin e Zotit.

Dëshmuesia e veprimit dhe fjalës së dukur prej jashtë mbi botën e brendshme dhe dritën e brendshme.

Veprimi dhe fjala janë dëshmitarë të botës së brendshme. Shihi këta të dy dhe kuptoje se si është bota e brendshme.

Po s'hyre dot në të fshehtën e brendshme, shih shurrën e të sëmurit.

Ja, pra, fjala i përngjet shurrës së të sëmurëve, e cila është një provë dhe argument për mjekun e trupit.

Mirëpo mjeku i shpirtit hyn në shpirt dhe nga rruga e shpirtit arrin gjer në besim.

Ata nuk kanë nevojë për fjalë të bukur e për punë të bukur.

Ruhuni prej tyre se ata janë spiunët e zemrave!

Këta dëshmitarë të fjalëve dhe punëve kërkoji te ata që, si lumi, nuk kanë arritur ende në det!

Drita e njeriut të ndritshëm e dëshmon atë dritë nga brenda
pa bërë ai ndonjë punë ose pa thënë ndonjë fjalë.
E fshehta e arifit, e njeriut të urtë të pajisur me kulturën shpirtërore, del në shesh jo më shumë me fjalët dhe punët e tij, sesa pa thënë asnjë fjalë dhe pa bërë asnjë punë.
Po kështu, pasi të lindë dielli dhe të ngjitet lart në horizont,
nuk ka nevojë për zërin e këndezit, për njoftimin e muezinit
dhe për shenja të tjera, drita e diellit dëshmon për vetë diellin!

Por shkretëtirat dhe fushat janë mbushur me dritën e udhëtarit që e kalon masën.

Ai nuk i jep rëndësi as vështrimit të bukurisë, nuk i kushton vëmendje as përballimit të vështirësive, as lojës me të gjithë zemrën me to, as bërjes së bujarive.

Kur drita e atij margaritari bie jashtë, atëherë ai ka shpëtuar nga këto privime.

Atëherë mos kërko më prej tij dëshmi pune dhe fjale se për shkak të asaj drite është hapur si trëndafil në të dy botët!

Le të jetë fjalë, le të jetë punë apo diçka tjetër... Ç'është kjo dëshmi? A s'është zbulim i të fshehtës?

Synimi është nxjerrja në shesh e sekretit të margaritarit. Cilësia është e përhershme, kurse kjo shenjë, e përkohshme.

Gjurma që lë floriri në gurin e provës, nuk mbetet, por nuk ka dyshim se floriri mbetet si diçka me emër të mirë.

As ky namaz, kjo luftë dhe ky agjërim nuk mbesin, por mbetet shpirti me emër dhe nam të mirë!

Shpirti shfaqi fjalë të tilla, punë të tilla dhe e shtroi margaritarin e vet në gurin e provës së urdhrit;

Dhe tha: "Besimi im është i drejtë. Ja, edhe dëshmia ime, këtu është! Por dëshmitarët janë të dyshimtë!"

Dije se dëshmitarët kanë nevojë për pastrim. Pranimi i çështjes tënde varet nga pastrimi i dëshmitarëve.

Thënia drejt e fjalës është te dëshmia e fjalës dhe mbrojtja e premtimit është te dëshmia e punës.

Dëshmitari i fjalës kundërshtohet po të flasë shtrembër, edhe dëshmitari i punës kundërshtohet po të ecë e të vrapojë shtrembër.

Nuk duhet të ketë ndryshim mes fjalës dhe punës në mënyrë që këta dëshmitarë të pranohen.

"Jeni duke punuar veç e veç; jeni të ndarë." Ditën qepni, natën shqepni!

Mirë, po kush ia vë veshin dëshmitarit që nuk i përputhen fjalët? Vetëm nëse Zoti, me mirësinë e tij, tregon butësi.

Fjala dhe puna e nxjerrin të fshehtën në shesh. Që të dyja e zbulojnë të fshehtën.

Nëse dëshmitari yt pastrohet, pranohet,përndryshe, numëron në vend, hiqet këmbadoras.

O kryeneç, sa të bësh ti kryeneçësi, edhe ata bëjnë. Ti rri e priti ata; edhe ata presin!..

Mustafai (a.s.) i kërkon mikut të thotë Fjalën e Dëshmisë.

Kjo fjalë s'ka fund. Mustafai i tha atij të pohojë besimin dhe ai pranoi.

Ajo dëshmi e bekuar i zgjidhi nyjet e lidhura.

Ai besoi. Mustafai i tha: "Rri si miku ynë edhe këtë natë."

Njeriu i tha: "Vallahi, jam miku yt përjetësisht. Kudo që të jem, kudo që të shkoj, jam miku yt.

Ti më ringjalle mua, prandaj të jam skllavi yt që më ke dhënë lirinë, të jam roje i portës tënde! Edhe në këtë botë në krye të sofrës tënde, edhe në atë botë!

Atij që zgjedh sofër tjetër veç kësaj sofre të zgjedhur, i mbetet kocka në grykë!

Dije se kush shkon nga sofra jote në një sofër tjetër, Shejtani ha gjellë në një qase me të!

Nuk ka dyshim se atij që ikën nga fqinjësia jote, i bëhet fqi Shejtani.

Atij që ikën në një rrugë larg teje, i bëhet bashkudhëtar Shejtani i cili ulet bashkë me të në një sofër.

Po të hipë në një kalë të bukur e të lartë, i bëhet ziliqar hënës dhe atëherë i bëhet shok Shejtani.

Nëse gruaja e tij nazemadhe i lind një djalë, Shejtani i bëhet ortak në soj.

O besimtar, Zoti e ka urdhëruar Shejtanin në Kur'an: "Bëhu ortak i qafirëve në pasurinë dhe fëmijët e tyre!"

Pejgamberi ia ka thënë hapur këtë Aliut përmes fjalësh të paçmueshme.

Miku tha: "O i dërguari i Zotit, si një diell i pare e plotësove profetësinë, e vure në vend krejt qartësisht.

Këtë që bëre ti, nuk e bëjnë dot dyqind nëna. Isai, madje, nuk ia bëri këtë Azerit!

Për shkak tënd, shpirti më shpëtoi aty për aty nga vdekja! Edhe Azeri u ringjall, por vdiq përsëri po atë çast!"

Arabi qëndroi si mik i Profetit atë natë. Ai mundi të pijë vetëm gjysmën e qumështit të mjelë nga një dhi, fshiu buzët dhe u hoq mënjanë.

Sado që Profeti i tha me këmbëngulje që të pinte qumësht e të hante bukë të ngrohtë, ai iu betua se me të vërtetë ishte ngopur.

I tha se po thoshte të vërtetën, se ishte ngopur më shumë se një natë më parë.

Të gjithë njerëzit e shtëpisë u çuditën. Ata u habitën se si kandili u mbush me vajin e një kokrre ulliri të vetme!

Thanë se si mundet që ushqimi i një dallëndysheje ta ngopë elefantin!

Gra e burra nisën të pëshpërisin se ai njeri me trup elefanti ha ushqimin e një mize!

Ambicja dhe fantazia e mohimit u përmbysën, kuçedra u ngop me ushqimin e një milingone.

Sypangopësia e mohimit iku prej tij, ushqimi i besimit e mbushi dhe e zhvilloi!

Burri i kapur nga sëmundja e urisë prej kau, pa, si Merjemja, frutin e xhennetit!

Fruti i xhennetit vrapoi dhe arriti te trupi i tij. Stomaku i tij që ishte si xhehennem, u tulat, u qetësua.

O ti që kënaqesh vetëm me një fjalë nga besimi, që mjaftohesh vetëm me të, besimi është një dhunti e lartë, një ushqim i madh!

Sipas hadithit "Shejtani u bë musliman në dorën time",
drita që është ushqim i shpirtit,
bëhet ushqim për trupin e të urtëve
me qëllim që të bëhen shokë dhe miq të shpirtit.

Në të vërtetë, ushqimi i shpirtit është një ushqim që e hanë zemra dhe syri, por, o bir, edhe trupi ka pjesë prej tij!

Po qe se trupi që i ngjet shejtanit, nuk do ta hante atë, Profeti nuk do të thoshte "Shejtani im u bë musliman"!

Si mund të bëhet musliman Shejtani po të mos hajë nga ai ushqim që e ringjall të vdekurin?

Shejtani është i pasionuar pas botës. Eshtë qorr, është shurdh. Një pasion mund ta shuajë një pasion tjetër.

Po qe se ha e pi fshehtaz në shtëpinë e besimit të padyshimtë, pasioni mblidhet e hiqet për atje.

O ti i pangopur i barkut, kështu lartësohu! Rruga e kësaj është vetëm ndërrimi i ushqimit.

O i sëmurë i zemrës, kapu pas ilaçit! E gjithë masa që duhet të marrësh është ndërrimi i natyrës tënde!

O ti që ke rënë peng i ngrënies, po qe se e duron të pritesh nga qumështi, së afërmi shpëton!

Në uri ka shumë ushqime. Ato kërkoji, ato dëshiroji, o ti që ke neveri për to!

Ushqehu me dritë, ngjaji syrit! O më i dobishmi i njerëzve, përshtatiu engjëjve!

Bëj ushqim për vete madhërimin e Zotit si të ishe engjëll, dhe shpëto, si engjëjt, nga mundimi!

Xhebraili nuk i sheh aspak gjërat e ndyra, nuk vjen vërdallë rreth tyre! A mos vallë për këtë shkak është më poshtë se kushdo në fuqi?

Ç'sofër të këndshme, ç'sofër të bukur ka shtruar Zoti në gjithësi! Por ajo sofër është shumë e fshehur nga sytë e njerëzve të ulët!

Edhe sikur bota të jetë e mbushur plot me të mira, prapëseprapë, miu dhe gjarpri hanë dhé.

Njerëzit trupit (njerëzit e dhënë pas botës materiale),
duke mohuar ushqimin e shpirtit,
dridhen para gjellës së thjeshtë.

N'daç të jetë dimër, n'daç të jetë behar, ushqimi i tyre është dheu. Por ti je zotëria i qenies, si ndodh që të hash dhé?

Krimbi brenda dërrasës thotë: "Kush ka hallvë të tillë kaq të mirë?"

Krimbi i halésë jeton në halé dhe nuk njeh meze tjetër veç mezes së saj!

Lutje.

O Zot, që s'ke shok e s'ke të ngjarë, meqë na e bëre këtë fjalë vëth në vesh, bëna një të mirë e shpërndaji këto fjalë me të shumtë!

Kapna për veshi dhe na tërhiq e na ço në kuvendin ku ata sarhoshë pinë verën e kulluar!

Meqë na bëre të marrim një aromë prej kësaj, o Zot i fesë, mos e mbyll gojën e atij tullumbi.

O Zot, te i cili kërkohet mbështetje, o Zot, prej të cilit kërkohet ndihmë, mos u kurse, na bëj një të mirë që burra e gra, kushdo, të pijë verën tënde!

O Zot që i dëgjon lutjet para se të thuhen, që i plotëson kërkesat pa t'u kërkuar, Ti i hap zemrës portë për çdo çast!

Ato ç'ke shkruar janë vetëm disa shkronja. Por edhe gurët, madje, u tretën me dashurinë për ato shkronja, u bënë qiri!

Si intrigë për qindra mendje e mendime i shkruajte shkronjën nun të vetullës, shkronjën sad të syrit dhe shkronjën xhim të veshit!

Për shkak të atyre shkronjave, mendja nisi të endte hollë. O shkrimtar me shkrimin e bukur, prishe këtë!

Sipas çdo mendimi, çast pas çasti je duke qëndisur një imagjinatë të bukur për mosqenien;

Në tabelën e imagjinatës je duke shkruar shkronja të papara, si syri, faqja dhe fytyra.

Mirëpo unë jam i dashuruar pas mosqenies, nuk rri duke e parë qenien e të dehem pas saj! Sepse dashuria për mosqenien, sipas meje, është më besnike!

Zoti ia lexoi mendjes ato forma dhe, në këtë mënyrë, duke e bërë atë të heqë dorë nga masat, dëshiroi që ajo ta kërkojë Zotin!

Fakti që njerëzit kuptojnë nga Lehfi Mahfudh aq sa ta kenë pjesën ditore të caktuar të përfitimit prej tij, i përngjet faktit që Xhebraili kupton çdo ditë diçka prej tij.

Çdo mëngjes, mendja, si engjëll, merr një mësim nga Levhi Mahfudh.

Shihi shkrimet e shkruara pa gisht mbi mosqenien; ata që janë kredhur në këtë botë, kanë mbetur të hutuar pas të zezës së atyre shkrimeve!

Çdokush është shtënë pas një imagjinate, është duke i fryrë një buxhaku. Dikush, për të gjetur thesar, është duke gërmuar një buxhak.

Dikush ka rënë pas një imagjinate dhe, megjithëse është madhështor, i ka kthyer sytë nga mineralet në male.

Tjetri ka rënë në një ëndërr dhe, me përpjekje e rropatje, është drejtuar te deti me qëllim për të nxjerrë margaritar!

Dikush tjetër është mbyllur në kishë për t'u bërë prift, kurse një tjetër, plot ambicje, ka rënë pas arës e pas të mbjellave!

Ai grabitqari ka ëndërruar shpëtimin, kurse ky, sipas imagjinatës së vet, është bërë melhem për të sëmurin!

Njëri është vënë të thërrasë perí duke humbur zemrën dhe mendjen, kurse tjetri, duke u kapur pas astrologjisë, e ka vënë nallanen mbi yll.

Këto veprime, për shkak të fantazive të brendshme shumëngjyrëshe, duken të kundërta me njëra-tjetrën edhe jashtë!

Ky, i habitur, duke pasë se ç'bën tjetri. Çdokush që shijon nga tjo verë, bëmat e tjetrit i gjen të kota!

Po qe se këto fantazira nuk do të ishin të kundërta me njëra-tjetrën, si do të ndodhte që veprimet e dukura do të ishin e do të dukeshin të kundërta me njëra-tjetrën?

Që të gjithë e kanë humbur kiblen (orientimin) e zemrës, prandaj çdokush e ka kthyer fytyrën në një anë më vete!

Ecuritë e kundërta me njëra-tjetrën dhe përplasjet e ndryshme u përngjasin gjendjes së atyre që kërkojnë drejtimin e kibles në errësirë dhe gjendjes së zhytësve që kërkojnë margaritarë në fund të detit.

Kështu, një pjesë njerëzish kërkojnë se ku është kiblja, jepen pas një iluzioni dhe mbeten duke u kthyer sa nga një anë, në tjetrën!

Kur bëhet mëngjes dhe Qabja e tregon fytyrën, kuptohet se kush e ka humbur udhën!

Ose si puna a zhytësve, apo jo! Të gjithë zhyten në det dhe në fundin e tij, secili mbledh me nxitim ç't'i kapë dora!

Dhe i mbushin torbat me këtë e atë me shpresën e kapjes së margaritarit të vyer!

Dhe sapo të dalin nga fundi i atij deti të thellë, zbulohet se tek kush ndodhet ai margaritari i vyer!

Dhe zbulohet margaritari i vogël i atij tjetri si dhe kuptohet se një tjetër ka mbledhur vetëm copa gurësh dhe guaska.

Ja, pra, kësaj i përngjet edhe kiameti i cili ka për t'i zgjuar ata nga gjumi, i cili është zbulues i të këqijave dhe persekutues!

Çdo grup, ashtu si fluturat e natës rreth qiririt, vjen vërdallë pa pushim në këtë botë!

E hedhin veten në një zjarr, por, në të vërtetë, vazhdojnë të rrotullohen përreth qiririt të vet.

Dhe shpresojnë zjarrin e Musait fatbardhë, nga flaka e të cilit druri u gjelbërua më shumë.

Çdo kopé e ka dëgjuar mirësinë e atij zjarri; çdokush e pandeh çdo shkëndijë të atij zjarri si zjarrin vetë!

Por sapo të lindë koha e mëngjesit, sapo të lindë drita e amshueshmërisë, secili e sheh se ç'lloj qiriu është drita rreth së cilës ka ardhur rrotull!

Atij që e ka djegur krahun me atë qiri fitoreje, ai qiri i fal tetëdhjetë krahë të tjerë!

Sa e sa flutura i kanë mbyllur sytë dhe janë hedhur mbi një qiri të keq, i kanë djegur krahët dhe kanë rënë nën të!

Ato vazhdojnë të përpëliten me forcë e me pendesë dhe mjerohen që i kanë sytë të lidhura e, kështu, që bien verbërisht në një atmosferë të tillë!

Dhe qiriri mendon se vetë u dogj, të paktën ato t'i shpëtojë pa u djegur, pa hequr mundim.

Dhe thotë duke qarë: "Edhe mua m'u dogj koka, si mund ta ndriçoj tjetrin tani?"

Komenti i ajetit "o mall, përgatitu për ata njerëz që..."

Dhe thotë: "E pashë gjendjen tënde dhe ndjeva krenari; e pashë me vonesë gjendjen tënde!"

Qiriri u shua, vera u mbarua, e dashura nga mendimi ynë i gabuar u turpërua, u fundos mes dallgëve e u harrua!

Dobitë janë bërë vetë dëmi dhe fatkeqësitë. Tashmë lëri ankesat ndaj Zotit!

Mirëpo sa të mirë janë muslimani i besueshëm, njeriu besimtar dhe shpirtrat e vëllezërve që falen!

Çdokush është kthyer në një anë. Kurse ata njerëz të vyer janë kthyer nga ai që nuk ndodhet vetëm në një anë të caktuar!

Çdo pëllumb ka fluturuar në një udhë, kurse ky pëllumb, në anën e paanë!

Ne s'jemi as zogj ajri, as zogj shtëpie. Ushqimi ynë është ushqimi i paushqimshmërisë.

Prandaj furnizimi me ushqime dhe të mira na vjen kështu me bollëk, sepse nëse ne qepim rrobë, do të thotë se grisim rrobë!

Shkaku që fjala ferexh do të thotë lehtësim.

Një sofi ra në shqetësime të brendshme, e grisi xhyben para dhe atëherë u hap e u lehtësua!

Dhe asaj xhybeje të grisur ia vuri emrin "ferexhi", "lehtësim"! Ky llagap u përhap pas atij burri të lehtësuar e të shpëtuar!

U përhap, por esencën ia mori shehu, kurse njerëzve u mbeti vetëm emri që është mbeturina, llumi.

Kështu, çdo gjë ka anën e vet të kulluar dhe pa llum, kurse emrin ia ka lënë botës si mbeturinë, si llum.

Kush e ka bërë zakon të hajë dhé, kapet pas llumit, kurse sofiu shkon menjëherë në atë anë ku ndodhet pjesa e kulluar.

Dhe thotë se, gjithsesi, gjëja e turbullt ka anën e kulluar të saj dhe, me këtë argument, zemra arrin në kullim.

Llumi është vështirësia, kurse pjesa e kulluar, lehtësia. Pjesa e kulluar i ngjet hurmasë, kurse llumi, aguridhes së saj.

Vështirësia ndodhet bashkë me lehtësinë, pra, eja në vete, mos e pri shpresën. Pas kësaj vdekjeje, ka rrugë për në jetë!

O bir, në daç të lehtësohesh, grise xhyben që të nxjerrësh kokë menjëherë nga ai mjedis i kulluar!

Sofiu është personi që dëshiron thjeshtësinë. Sofizmi s'bëhet me rroba të zgjedhura, të qepura te rrobaqepësi, dhe duke ecur ngadalë-ngadalë.

Mirëpo, sipas njerëzve të ulët, sofizmi është rrobaqepësí dhe perversitet.

Ajo thjeshtësi, ai emër i mirë, ajo imagjinatë janë të mira,

Por me kusht që me atë imagjinatë të shkohet gjer në origjinë, jo si ata që e adhurojnë imagjinatën kat më kat!

Imagjinata është nëpunësi i përpjekjes që të pengon ty për të hyrë në mjedisin e çadrës së bukurisë.

Ai u bëhet pengesë të gjithë kërkuesve të rrugës duke u thënë se andej s'ka rrugë. Kur vjen imagjinata e tij, të thotë ty: "Qëndro!"

Veçse personin veshshpuar dhe të kuptueshëm s'e ndalon dot, sepse ai është mbështetur te ushtria e ndihmës së Zotit, në sajë të së cilës është emocionuar dhe ngritur peshë.

Ai as nga fantazmat frikësohet e ikën, as sovranitet pretendon. Ai e tregon shigjetën që ia ka dhënë sovrani si simbol, dhe shkon në rrugën e vet!

Zoti im, fali një shigjetë kësaj zemre të hutuar, jepu një shigjetë këtyre harqeve të tendosura më dysh!

I hodhe një gllënjkë faqes së tokës nga kupa e fshehtë që pinë ata të mëdhenjtë!

Në flokët dhe fytyrat e atyre të bukurve është shenja e asaj gllënjke verë. Prandaj sovranët rrinë duke lëpirë bukuritë që krijohen nga toka!

Ti rri natë e ditë duke e puthur me qindra zemra bukurinë që krijohet nga ajo tokë, sepse në të ndodhet një grimcë e asaj bukurie.

Ty të deh e të marros një gllënjkë verë bukurie e përzjerë me dheun; ç'mund të të bëjë, atëherë, esenca e saj?

Para një cope qerpiçi, çdokush gris jakë e mëngë, mirëpo ai qerpiç zotëron një gllënjkë, një grimcë bukurie!

Në hënë, në diell, në konstelacionet qiellore ka një gllënjkë verë bukurie. Në arsh, në katedrën hyjnore në yllin Venus ka një grimcë bukurie!

A po i thua asaj një gllënjkë apo thua një gjë e çuditshme kjo kimi? Me një të fërkuar të saj dalin në shesh kaq shumë bukuri!

O njeri i mençur, dëshiro me gjithë zemër fërkimin ndaj saj. Por këtë kimi "mund ta prekin vetëm të pastërtit!"

Në ar, në margaritarë ka një gllënjkë nga vera e asaj bukurie; një gllënjkë nga ajo verë në verë, në meze, në frut!

Gjithashtu një gllënjkë në fytyrat krejt të pastra të bukurive. Si është, atëherë, esenca e kulluar e saj?

Ti rri dhe e lëpin një gllënjkë verë të përzjerë në tokë. Në ç'gjendje do të vije po ta shihje atë të papërzjerë në tokë, të kulluar?

Në kohën e vdekjes, ajo gllënjkë vere e kulluar ndahet me anë të vdekjes nga kurmi-dhé.

Çka mbetet, pothuaj nuk e sheh. Shih se në ç'gjendje ardhka me anë të saj ky trup kaq i shëmtuar!

Po qe se shpirti shfaqet nga këto pa qenë trupi, unë nuk ta tregoj dot hijeshinë e atij bashkimi!

Po qe se hëna shpërndan dritë pa qenë kjo re, atë s'mund ta përshkruajë askush!

Sa e këndshme është ajo kuzhinë e mbushur plot me sheqere dhe ëmbëlsira! Këta sovranë rrinë dhe e lëpijnë atë kuzhinë!

Sa i bukur është lëmi i asaj fushe të fesë! Çdo lëmë mbledh kallinj prej atje.

Sa i lartë është deti pa vuajtje e ankthe i jetëgjatësisë! Dhe shtatë detet janë një kokërr breshëri e krijuar prej tij!

Sakiu i kuvendit hyjnor ka hedhur një gllënjkë mbi këtë tokë të ulët e të thatë

Dhe toka është entuziazmuar me atë shkak. Edhe ne, gjithashtu! Zoti ynë, u bëmë shumë të padëshirë, shumë dembelë, pra hidh edhe një gllënjkë!

Në u lejoftë të thuhet, jam duke klithur nga mosqenia, jam duke u përpjekur të tregoj për mosqenien. Në s'u lejoftë, ja ku po hesht!

Kjo duhej ta tregonte ambicjen e dyfishtë! Mëso nga Halili, ai rosaku i ambicjes duhet therur!

Në kaza ka edhe shumë dobi të tjera, ka të këqija, por më shumë se kaq s'mund të them, druhem se s'mbetet kohë!

Natyra e palloit dhe shkaku që Ibrahimi (a.s.) e theri.

Tani erdhëm te palloi dyngjyrësh që përdridhet për emër e për famë!

Zelli i tij e gjuan me të mirë e me të keq popullin që s'di gjë për fundin dhe dobinë e kësaj pune!

Rri duke zënë gjah si të ishte kurth apo lak. Ç'dinë kurthi apo laku për synimin?

Kurthi apo laku nuk kanë nga gjahu as dëm, as dobi; ja, pra, unë habitem me këtë gjueti të kotë të tij! O vëlla, u bëre shok me dyqind të bukur, u bëre mik, pastaj i braktise përsëri ata.

Kjo është puna jote që ditën kur ke lindur. Vazhdon të gjuash njerëz me kurthin e dashurisë.

Hiq dorë nga kjo gjueti, nga kjo rrëmujë, nga kjo sevda kryesimi. A thure gjë me këto, a shtive në dorë ndonjë gjë nga kjo?

Shumica e jetës të kaloi, dita iu afrua mbrëmjes, kurse ti ende vazhdon të gjuash njerëz!

Atë kape, këtë liroje nga laku dhe, si njerëzit e poshtër, gjuaj një tjetër!

Pastaj, braktise dhe këtë dhe kërko një tjetër... Kjo punë është një lojë fëmijësh që s'marrin vesh nga asgjë!

Ia beh mbrëmja dhe në kurthin që ke ngritur nuk ka asnjë gjah. Kurthi për ty s'është gjë tjetër veç dhimbje koke, veç një lak!

Atëherë, do të thotë se ti gjuajte vetveten! Sepse re në burg, s'ia arrite synimit, mbete i privuar!

A ka, vallë, në botë një kokëtrashë tjetër si ne që të gjuajë vetveten?

Në kurthin e personave të ulët e të poshtër bie derri. Mëshirë e pafundme, pastaj, ngrënia e tij!

Gjëja që e vlen të gjuhet, është vetëm ashku. Mirëpo edhe ashku, a bie në kurthin e çdo njeriu?

Vetëm nëse ti vjen dhe i bëhesh gjah atij. Vetëm nëse ti e lë kurthin dhe shkon e bie në kurthin e tij.

Ashku thotë: Unë punoj dalngadalë; të gjuhesh prej meje është më mirë se të zësh gjah!

Bëhu admiruesi im dhe lavdërohu! Lëre diellin dhe bëhu grimcë!

Ulu në derën time. Mbetu pa shtëpi e pa vatër! Mos pretendo të bëhesh qiri, por bëhu flutur!

Në këtë mënyrë, ke për të gjetur mbretërimin e ringjalljes dhe ke për të parë sovranitetin e fshehur në robëri!

Ke për të parë në botë potkonj të mbathur mbrapsht, ke për të dëgjuar t'u jepet robërve titulli sovran!

Një pjesë e madhe e njerëzve i thonë sovran dikujt që ia kanë shkuar lakun në qafë e që e kanë ngjitur në trekëmbësh.

Si varret e mohuesve, qafirëve: jashtë, plot stoli; brenda, mundimi dhe persekutimi i Zotit!

Ata i kanë lyer varret me gëlqere, i kanë stolisur, dhe perden e pandehmës ua kanë hedhur syve!

Edhe natyra jote e varfër është gëlqerizuar e stolisur me mjeshtëri, por i pëlqen pemës artificiale prej dylli: as gjethe ka, as fruta jep!

Çdo njeri e di favorin dhe persekutimin e Zotit,
kapet pas favorit dhe ikën nga persekutimi i tij.
Por Zoti i madh e ka fshehur persekutimin brenda favorit
dhe favorin brenda persekutimit. Në këtë mënyrë dallohen ata
që shohin me dritën e Zotit dhe nuk gënjehen nga dukja.
Zoti ka thënë se i provon njerëzit se kush do të veprojë më mirë.

Një dervish i tha një dervishi tjetër: "Thuaj, si e pe Zotin?"

Dervishi i tha: E pashë të pakunërueshëm e të pacilësueshëm, por, për të folur për të, po ta përshkruaj me një shembull të shkurtër.

Pashë se kishte në të majtë një zjarr dhe, në të djathtën, një lumë begatish.

Në të majtë, një zjarr i tmerrshëm që djeg e përvëlon njerëzimin, në të djathtë, një lumë të bukur.

Një pjesë njerëzish kishin hedhur dorë në atë zjarr, kurse një pjesë tjetër ishin të gëzuar e të dehur se kishin arritur në atë lumë!

Mirëpo kjo ishte një lojë shumë e çuditshme dhe me të kundërta që do ta çudiste çdo njeri të keq dhe çdo fatmirë.

Kush hidhej në atë zjarr e në atë prush, në anën tjetër e nxirrte kokën nga uji!

Kush hidhej në ujë, menjëherë e gjente veten brenda zjarrit.

Kush shkonte djathtas dhe zhytej në atë ujë të mirë, dukej në anën e majtë nga brenda zjarrit.

Nëse zhytej në zjarr në të majtë, dilte në anë të djathtë.

Të fshehtën e kësaj pak vetë e kuptonin, shkurt, pak vetë hidheshin në atë zjarr.

Vetëm kush kishte mbi krye shenjë fati, e linte ujin dhe ikte për te zjarri.

Populli e ka bërë hyjni kënaqësinë e gatshme në dorë; shkurt, populli e ka humbur këtë lojë, ka hyrë në humbje në këtë lojë.

Ata që shkojnë pas ambicjeve të tyre tufa-tufa, radhë-radhë, druhen nga zjarri dhe ikin tek uji.

Por kush zhytet në ujë, nxjerr kokë nga zjarri. O ti që s'di gjë për të vërtetën, merr shembull, merr shembull!

Zjarri, o kokëtrashë të papjekur, thotë se nuk është zjarr, por një burim i pëlqyer!

O të verbër, juve jua kanë mbyllur sytë! ejani tek unë, mos ikni nga shkëndijat e mia!

O Halil, këtu nuk ka as shkëndija, as tym. Kjo që duket është veçse magjia, dredhia e Nemrudit!

Nëse edhe ti je i mençur si Halili, zjarri është soji yt, ti je një flutur nate!

Shpirti i fluturës së natës thërret pa pushim: Eh, sikur të kisha një mijë krahë

Dhe, megjithë verbërinë e të huajve, të digjeshin në zjarr në një mënyrë të pamëshirshme!

Personit të paditur, për shkak të gomarllëkut të tij, i vjen keq për mua, kurse mua më vjen keq për të ngaqë jam i ditur dhe i sjellshëm!

Pa le ky zjarri që është shpirti i këtyre ujërave! Në kundërshtim me ne, flutura e natës sheh zjarr dhe kridhet në dritë!

Ja, të tilla lojëra ka Zoti i madh me qëllim që ti ta shohësh se kush është bir Halili!

Zjarrit i ka dhënë një trajtë të tillë, kurse brenda zjarrit ka bërë të gurgullojë një burim uji!

Mes një grumbulli njerëzish, me magjinë e tij, magjistari e tregon sahanin e mbushur me oriz si të mbushur me akrepë!

Ai e tregon shtëpinë të mbushur plot akrepë, por ata nuk janë akrepë të vërtetë.

Mendo, tani, se, kur magjistari tregon mjeshtëri të tilla, ç'mund të bëjë krijuesi i magjistarit!

Shkurt, me anë të magjisë së Zotit, kohë më kohë, sa e sa burra kanë fjetur poshtë tjetrit si gratë!

Magjistarët janë robër, skllevër të tij. Që të gjithë kanë rënë në lak si zogjtë!

Eja në vete dhe këndo në Kur'an dhe kupto sesi mashtrimet e mëdha sa malet përmbysen dhe shihe mashtrimin me tallje!

Unë nuk jam faraon që të shkoj në Nil! Unë shkoj në zjarr si Halili!

Ai nuk është zjarr, por ujë i kulluar! Mirëpo tjetri, me anë të mashtrimit, duket ujë si zjarr!

Pejgamberi i cili i sheh të lejueshme gjërat e mira, sa bukur që tha: "Një grimcë mendje të është më e dobishme edhe se agjërimi, edhe se namazi!"

Sepse mendja të është margaritar, kurse këto të dyja, lëvozhga. Këto të dyja, domethënë, agjërimi dhe namazi, bëhen të detyruara për ty kur të kesh mend!

Në këtë mënyrë bëhet e mundur shkëlqimi i asaj pasqyrës, pastrimi i zemrës me anë të adhurimeve!

Por nëse pasqyra është e prishur në bazë, lustrimi i saj është i vështirë, ajo lustrohet me vështirësi!

Kurse pasqyra e zgjedhur, e mundshme për t'iu dhënë lustër e shkëlqim, shndërrit me pak lustrim, një lustrim i pakët është i mjaftueshëm për të!

Mutezilitët thonë se mendjet janë, në bazë, një; pjesëshmëria e mendjes vjen nga dija, pa përpjekje dhe pa provë.
Në kundërshtim me ta, mendjet janë të ndryshme qysh në krijim.

Ky ndryshim në mendjet dije se, për nga grada, është sa ç'është qielli larg nga toka!

Ka mendje si diell, ka mendje që ndodhet më poshtë se Venusi, se meteorët!

Ka mendje si qiriri i të dehurit, ka mendje si shkëndijë flake!

Kur davaritet reja para mendjes si diell, mendjet që e shohin dritën e Zotit, përfitojnë!

Arsyeja e Pjesshme e ka fëlliqur emrin e mendjes. Qëllimi material i kësaj bote e ka shndërruar njeriun në një qenie pa qëllim!

Ai e ka parë bukurinë e gjahtarit nga një gjah. Ky ka rënë në gjueti, prandaj e ka zënë halli i gjahut!

Me anë të shërbimit, ai ka arritur përkëdhelinë e personit që i bëjnë shërbim, kurse ky ka dëshiruar t'i shërbejnë, prandaj është kthyer mbrapsht nga udha e tij e lartë!

Me faraonizmin e tij, ai është bërë i kapuri në lak nga uji; për shkak të burgosjes, izraelitët kanë shtënë në dorë qindra forca kundërshtimi!

Kjo është një lojë me të kundërta, është një lojë shahu e zakonshme. Përdore pak lojën, se kjo është punë fati!

End sa më pas fantazi dhe hile, sepse Zoti i vetëmjaftueshëm i tregon pak rrugë hilexhiut!

Në bëfsh hile, bëj në rrugën e shërbimit të mirë në mënyrë që të përfitosh profetësi mes një bashkësie!

Bëj hile dhe shpëto nga hilja jote! Bëj hile dhe ndahu nga kurmi, mbetu vetëm!

Bëj hile dhe bëhu një rob nga më të thjeshtit. Ec me thjeshtësi dhe bëhu zotëri!

O ujk i madh, mos tento të bëhesh dhelpër, mos shpreso zotnillëk me hile dhe shërbim!

Por hidhu në zjarr si flutura e natës, mos e mbush qesen me zjarr duke e prishur ushqimin, shpëto nga çdo gjë!

Lëre forcën dhe fuqinë por nisu të qash. O i varfër, për qarjen ndihet dhembshuri!

Qarja e personit të etur e të dobët është shpirtërore, është e drejtë! Kurse qarja e ftohtë është vetë gënjeshtra e personit mendjemadh e brutal!

Qarja e vëllezërve të Jusufit ishte gënjeshtër, sepse zemrën e kishin të mbushur me smirë, me sëmundje!

Arabi që i ngordh qeni nga uria;
megjithëse e ka torbën plot me bukë,
nuk i jep asnjë kafshatë qenit, pastaj qan pse i ngordh;
arabi që thotë vjersha dhe i bie kokës me grushta.

Qeni i një arabi ishte gati në të ngordhur. Arabi derdhte lot si shi dhe thoshte se ç'mjerime po i binin mbi kokë!

Aty pari kaloi një lypsar. Ai tha: "Pse qan? Për kë po klith e po vajton?"

Arabi tha: "Kisha një qen me vese të mira, por ja që po më ngordh, mu këtu, anës rrugës!

Ditën e kisha gjuetar, natën, roje! Ishte symprehtë, e kapte gjahun menjëherë. E përzente vjedhësin aty për aty!"

Lypësi e pyeti: "Ç'pati, a mos u plagos?" Arabi i tha: "Jo, uria e solli në këtë gjendje!"

Lypësi i tha: "Duroje këtë hall, këtë mundim, se Zoti u shkon në ndihmë atyre që bëjnë durim!"

Pastaj vazhdoi: "O njeri i lirë, ç'ke në atë torbë të fryrë në dorë?"

Arabi iu përgjigj: "Eshtë buka që më ka tepruar që mbrëmë! E bart që të më japë forcë e fuqi!"

Lypësi e pyeti: "Pse s'i dhe bukë e gjellë edhe qenit?" Arabi iu përgjigj: "S'jam aq i mëshirëshëm!

Buka s'gjendet në rrugë, pa para, kurse lotët janë pa para!

Atëherë, lypsari ia priti: "Të fshiftë dheu, o i paudhë! Domethënë, sipas teje, buka është më e mirë se lotët, ë?

Loti është gjak; me vuajtje, kthehet në ujë! Buka e krijuar nga dheu nuk e vlen të derdhësh gjak kot!"

Arabi, si djalli, e kishte shndërruar tërë trupin në diçka të shëmtuar. Pjesa e kësaj të tëre është vetëm një gjë e ulët dhe e pavlerë!

Iu bëfsha rob unë atij që nuk ia shet qenien e vet tjetërkujt veç të zotit të bujarisë dhe mirësisë!

Po qau ai, edhe qielli qan. Po vajtoi ai, edhe qielli fillon ta thërrasë Zotin!

Iu bëfsha rob unë bakrit mirëbërës që nuk i përkulet tjetërkujt veç kimisë!

Kur të bësh lutje, ngriji duart drejt Zotit me përulje të thellë sepse mirësia dhe mëshira e Zotit fluturojnë për tek personi i përvuajtur!

Po deshe të shpëtosh nga kjo gropë e ngushtë, ktheji sytë pa pushim nga zjarri, o vëlla!

Shih hilen e Zotit, lëre hilen tënde! Zoti im, që i bën me turp dhe i huton edhe iluzionistët para dredhive të tyre!

Kur hilja jote të të asgjësohet në hilen e Zotit, do të përftosh për vete një pusi të habitshme!

Një pusi të tillë që cilësia më e ulët e saj është përjetshmëria! Që aty, ngjitesh lart përjetësisht;

Nuk ka për njeriun asnjë sy të keq më të rrezikshëm se syri i vet që e sheh dhe e pëlqen. Eshtë tjetër gjë nëse syri i ka ndryshuar me anë të dritës së Zotit dhe ia ka arritur të fshehtës për të parë me Zotin.

Dhe mos shih pendët siç bën palloi, por shih këmbët që syri i keq të mos të ngrejë kurth!

Edhe mali, madje, lëviz nga vendi nga syri i keq. Këndoje në Kur'an ruajtjen nga syri dhe kupto!

Edhe Ahmeti sa një mal u zu nga syri i keq në rrugë pa pasur shi dhe baltë, dhe nisën t'i dridhen këmbët!

Ç'janë ky pengim, kjo rrëshqitje, kjo dridhje këmbësh? Dhe ai u habit duke menduar se ishte e pamundur që kjo ngjarje të ishte e rastit!

Më në fund, erdhi ajeti që të bëri të ditur urtësinë se ajo gjendje të erdhi nga syri i keq!

Zoti tha: "Po qe se do të ishte dikush tjetër në vendin tënd, menjëherë do të përfshihej nga ai sy i keq e do të tretej!

Por ishte mbrojtja ime që të shpëtoi dhe kjo rrëshqitje e kjo dridhje ishte për të ta njoftuar ty këtë urtësi!"

Prandaj, o njeri, merr mësim nga ai Pejgamber sa një mal dhe mos e dëshiro pastaj aftësinë dhe pasurinë e njeriut më të pavlefshëm se fija e kashtës!

Komenti i ajetit "Edhe për pak, qafirët do të të rrëzonin përdhe me sy!"

O Pejgamberi i Zotit, në atë kuvend ka njerëz të tillë që marrin mësysh edhe zogjtë e kujtdo, që i ngordhin edhe zogjtë!

Nga syri i keq i tyre i çahet koka edhe luanit që bulëron dhe ai nis të rënkojë!

E bëjnë devenë e fuqishme ta godasë vdekja me anë të syrit të keq dhe pastaj i thonë skllavit:

Shko e na blij dhjamë nga ajo deve. Skllavi e sheh devenë të sakatosur!

Deveja që vraponte një për një me atin e shpejtë, ishte sëmurur dhe ia kishin prerë kokën!

Nuk ka dyshim se, me anë të smirës, me anë të syrit të keq, edhe rrotullimin e qiellit e kthejnë nga ana tjetër!

Uji është i fshehtë, kurse mashtrimi, sheshit. Në fakt, është uji që rrotullohet dhe ecën!

Ilaçi i syrit të keq është syri i mirë. Syri i mirë e merr syrin e keq ndër këmbë dhe e asgjëson.

Përparimi është atribut i mëshirës, edhe syri i mirë është prej mëshire! Kurse syri i keq vjen nga persekutimi dhe mallkimi!

Mëshira e Zotit është mbi ndëshkimin e tij, prandaj, çdo pejgamber ka dalë mbi kundërshtarët, i ka mundur ata!

Sepse pejgamberi është rezultat i mëshirës. Kurse i kundërti i tij është fytyrëndyrë, rezultat persekutimi!

Ambicja e patokut është një, kurse ambicja e këtij plot pesëdhjetëfish më shumë. Ambicja e epshit është gjarpër, kurse ambicja e pozitës është kuçedër!

Ambicja e patokut krijohet nga epshi i llupjes, kurse në ambicjen për të qenë krye janë mbledhur plot njëzet epshe të tilla!

Zotëruesi i postit dhe pozitës, për shkak të pozitës së vet, pretendon për hyjnitet. Ai lakmon të bëhet partner i Zotit; si mund t'i falet atij kjo gjë?

Gabimi i vogël që bëri Ademi ndodhi për shkak të grykës dhe grykësisë, kurse faji i Iblisit, djallit, për shkak të mendjemadhësisë dhe pozitës që kishte!

Por Ademi bëri shpejt pendesë, kurse ai i mallkuar nuk e përuli veten të bënte pendesë!

Edhe ambicja e grykës dhe e llupjes është e keqe, por po të mbetet vetëm ajo, pra, po të mos shoqërohet edhe me ambicjen e pozitës, s'është dhe aq e keqe!

Ndërkaq, po të nisem të flas për degët dhe rrënjët e ambicjes së pozitës, duhet një vëllim i veçantë!

Arabi i tha Shejtan kalit të pafre, jo kalit të përhapur në shkrim!

Në fjalor, djallëzia prin në krye. Ky atribut është i denjë për mallkim!

Rreth një sofre ulen njëqind vetë, hanë e pinë. Kurse dy vetë që kërkojnë të bëhen krye, nuk i nxë bota!

Njëri nuk e do të gjallë tjetrin! Madje, padishahu e vret të atin se mos i bëhet ortak në sundim!

E ke dëgjuar që salltaneti është shterp. Kush ndjek kauzën e padishahllëkut, nga frika ther të afërmit, i zhduk të gjithë!

Sepse salltaneti, mbretërimi, sundimi janë shterpë, nuk bëjnë fëmijë! Askush s'ka miqësi me njeriun që është si zjarri!

Kë të gjejë, e djeg, e shqyen. dhe, kur s'gjen askënd, ha vetveten!

Bëju asgjë që të shpëtosh nga dhëmbët e tij. Shpreso pak për mëshirën e atij zemërguri!

Sapo të bëhesh hiç, mos ki frikë më prej atij zemërguri. Çdo mëngjes merr mësim për mosqenien absolute!

Madhështia është rroba e Zotit që është qendra e madhështisë. Kush tenton ta veshë atë, hyn nën përgjegjësi të rëndë!

Kurora është e tij, qemeri është yni. mjerë për atë që e kalon kufirin!

Ky krah palloi është provë për ty! Po u dhe pas tij, do të thotë se pretendon të bëhesh partner me Zotin, të pretendosh se, si Zoti, edhe ti je i pastër nga cilësitë e mangësisë!

Një dijetar e sheh me habi palloin që po i shkulte
puplat e veta me sqep
duke e lënë trupin lakuriq e të shëmtuar dhe e pyet:
"A nuk të vjen keq për veten?" Palloi i përgjigjet:
"Më vjen keq, por, për mua, shpirti është më i çmuar
se puplat,
kurse këto pupla janë armiq të shpirtit tim!"

Në fushë, një pallua po i shkulte pendët. Ndërkaq, një dijetar kishte dalë për shëtitje.

Ai e pa palloin dhe i tha: "O pallua, ç'po bën kështu që po i shkul e po i hedh përtokë këto pendë të bukura? A s'të dhimbsen aspak?

Si ta thotë zemra ta shkulësh këtë stoli e ta hedhësh në baltë?

Hafizët i mblidhnin ato pendë që u pëlqenin shumë, dhe i vinin si shenjë mes fletëve të Kur'anit.

Populli bënte me ato pendë elpaze për t'u freskuar.

Atëherë, ç'është kjo mosmirënjohje, ky guxim i marrë? A s'e di ti se kush është stolisësi yt?

Ose e di dhe bën naze dhe i shkul enkas ato stoli!

Janë disa naze që bëhen faj, që ia ulin vlerën nënshtetasit para sundimtarit!

Vetëpërkëdhelia është më e ëmbël se mjalti, por ka qindra rreziqe!

Rruga e lutjes është rrugë e sigurt. Lëri nazet dhe nisu për asaj rruge!

Sa njerëz të vetëpërkëdhelur ka që rrahin krahët, mirëpo, në fund, ajo gjendje u kthehet në vuajtje!

Edhe nëse bukuria e nazes të ngre lart ty për një çast, frika e fshehtë e saj të tret e të shkatërron!

Sa për lutjen dhe përgjërimin, kjo të dobëson. Të dobëson, por të çon në qoshen e kryevendit duke të ulur aty si hëna pesëmbëdhjetë!

Ai që vdes pasi ta ketë tërhequr dhe nxjerrë të gjallin nga i vdekuri, e gjen rrugën e drejtë!

Dhe uni i gjallë pasi ta ketë nxjerrë të vdekurin nga i gjalli, orientohet nga ana e vdekjes, kthehet e përsillet nga ana e vdekjes!

Vdis që Zoti i cili s'ka nevojë për asgjë, të krijojë të gjallin nga i vdekuri! Allahu të nxjerrë në shesh nga ky trup i vdekur, një të gjallë!

Po të jesh dimër, sheh ardhjen e pranverës, po u bëre natë, sheh formimin e ditës!

Mos i shkul ato pendë sepse nuk i ngjit dot më në vend. O fytyrëbukurosh, mos bjer në zi e mos çirr fytyrën!

Çjerrja e asaj fytyre të bukur që i përngjet diellit të paradites, është një punë e gabuar!

Plagosja e një fytyre të tillë me thonj është herezi. Edhe hëna, madje është kah po qan nga ndarja prej saj!

Apo nuk e sheh fytyrën? Lëre këtë kokëfortësi, këtë mendim!

Thjeshtësia dhe pastërtia e nefsit të kënaqur turbullohet me anë të mendimeve.
Po kështu, po qe se shkruan ose vizaton ndonjë gjë mbi pasqyrë
dhe pastaj e fshin, prapë do të mbetet shenjë.

Fytyrën e nefsit mutmaine, domethënë, unit të bindur plotësisht e të kënaqur, në trup, e plagosin thonjtë.

Mendimin e keq dije për thua të helmosur. Sa më shumë të ngulet thellë ky thua, e çjerr fytyrën e shpirtit!

Kërkon t'i hapë nyjet e vështirësisë, mirëpo kjo pothuaj i ngjet lëshimit të nevojës në një enë të florinjtë!

O ti që arrin në fundin e punës, quaje nyjen të zgjidhur. Kjo nyje është një nyje e fortë dhe e pazgjidhshme e bërë në një qese boshe!

U plake duke u përpjekur të zgjidhësh nyje! Pra zëre se zgjidhe edhe disa nyje të tjera!

Nyja e vërtetë e pazgjidhshme në grykën tonë është kjo: Njihe veten, një herë, a je njeri i ulët, apo njeri fatmirë!

Në je burrë, zgjidhe këtë vështirësi! Nëse e zotëron unin njerëzor, në këtë rrugë harxhoje frymën!

Zëre se i dite ç'janë gjëja e domosdoshme dhe e rastit; ç'del nga kjo? Thelbësore është të njohësh veteveten nga e cila s'ka ikje!

Pasi ta njohësh veten, kapërceje, më në fund, këtë kufi, o ti që shosh dhé, dhe arri në botën e pakufi!

Jeta të kaloi me shqetësimin për të gjetur se me ç'duhej marrë. Sytë s't'u hapën, jeta të kaloi me gjëra të dëgjuara!

Çdo argument pa rezultat dhe pa ndikim, doli bosh. Ti shih përfundimin që ke arritur vetë!

Bërësin e pe vetëm me anë të bëmave të tij, e kuptove me analogji të afërta!

Në çështjen e tij, filozofi i shumëfishon vazhdimisht provat dhe argumentet e veta! Mirëpo robi zemërpastër i Zotit, në të kundërt të tij, as nuk i sheh fare provat dhe argumentet!

Ikën nga argumenti dhe mbulesa, e ndjek pas atë që argumentohet dhe e tërheq në vetvete.

Sipas filozofit, tymi është provë e zjarrit, por, sipas nesh, hedhja në zjarrin pa tym është më e këndshme!

Pa le zjarri që formohet nga afërsia dhe dashuria! Ajo është për ne më afër se tymi!

Shkurt, kapja pas fantazive që janë shkaqe aksidentale të shpirtit, dhe vrapimi drejt tymit, për pasojë, humbja e shpirtit, është një punë shumë e keqe, një fatkeqësi shumë e madhe!

Hadithi i Pejgamberit (a.s.)
"Në Islam nuk ka klerikalizëm."

Mos i shkul pendët, dashurinë për të shkule dhe nxirre nga zemra! Sepse për të luftuar është kusht që të kesh armik!

Po të mos ekzistojë armiku, nuk ka mundësi lufte. Po të mos kesh epsh, është e pamundur ta zbatosh urdhrin për shmangien prej tij!

Po të mos kesh prirje, durimi s'ka kuptim. Po të mos ketë armik, ç'nevojë ka për ushtri?

Eja në vete dhe mos u tredh, mos u bëj prift! Sepse ruajtja. Shmangia dhe ndenjja pastër janë e kundërta e epshit.

Po të mos ketë dëshira dhe pasione, është e pamundur të thuhet ruhuni nga dëshirat dhe pasionet! Të vdekurve s'u jepet titulli gazi!

Eshtë thënë: Jepuni të varfërve, ngopini ata, prandaj fito! Sepse po të mos kesh në dorë diçka që ke fituar më parë, s'ke ç'shpenzon!

Në të vërtetë, ai ka thënë në mënyrë absolute "ushqeni të varfërit", por ti lexoje këtë si "fitoni, pastaj ushqeni të varfërit!"

Gjithashtu, ai sovran urdhëroi: "Duroni!" Duhet të jetë një dëshirë që të shmangesh prej saj duke treguar durim!

Urdhri "hani!" është një kurth për epshin, kurse urdhri "mos shpërdoroni që vjen më pas, është pastërti!

Po të mos ketë epsh, a ka mundësi ikjeje prej tij?

Po të mos të të bjerë në kokë mundimi për të duruar, nuk mund të fitosh, në këmbim të tij, dobi dhe shpërblim!

Sa i këndshëm është ai kusht dhe ç'gjë e gëzueshme është ai shpërblim! Ai shpërblim që hap zemrat dhe u shton shpirtrave shpirt!

Edhe sevapi që fiton ashiku nga Zoti është Zoti.

Ai është edhe gëzimi i ashikëve, dashnorëve të pasionuar të Zotit, edhe ankthi i tyre, edhe pagesa që marrin si shpërblim për shërbimet që kryejnë!

Po qe se ashiku kridhet në soditjen e tjetërkujt veç të dashurit të vet pas të cilit është pasionuar, ky nuk është ashk, pasion, por një sevda pa bazë.

Ashku është ai zjarr i përqëndruar që, po të shkëlqejë, djeg çdo gjë tjetër veç të dashurit të vet!

Shpata "la" (jo, nuk) pret e fshin çdo gjë tjetër veç Zotit. Pa shih, ç'mbetet pas "la"-së?

Mbetet "il'lallah", çdo gjë ikën. Gëzohu, mbushu me hare, ej ashk i fuqishëm që djeg e përvëlon dualitetin!

Fundja, edhe të parët ishin ai, edhe të pasmit! Dualiteti është vetëm vështrim i syrit të vëngër; kështu shihe këtë!

Ç'gjë e çuditshme! A mund të bëhet gjë tjetër e bukur nga reflektimi i tij? Trupi mund të lëvizë vetëm me anë të shpirtit!

Trupin pa shpirt në daç përpiqu ta ushqesh me gjalpë e me mjaltë, prapë është e kotë!

Këtë e di ai që ngjallet sa për një ditë, ia merr nga dora kupën këtij shpirti të shpirtrave dhe e pi atë verë!

Por ky tym u duket shpirt atyre, syri i të cilëve nuk is sheh ato fytyra!

Ngaqë s'e ka parë Omerin, të birin e Abdylazizit, Haxhxhaxhi është autori i sa e sa drejtësive.

Ai nuk e ka parë kuçedrën e Musait dhe pandeh se në rripat e magjistarëve ka shpirt.

Zogu që s'pi ujë të pastër e të kulluar, përplas krahët brenda ujit të zi!

Po s'pati të kundërt, e kundërta s'njihet. Kur të vihet re plaga fillon mjekimi i saj!

Shkurt, bota është krijuar më parë që ti ta dish vlerën e klimës së Elestit, marrëveshjes me Zotin në botën e shpirtrave!

Por pasi të kesh shpëtuar prej këtu e të kesh arritur atje, rri duke falenderuar në punishten e amshuar të karameleve!

Dhe thua: "Sikur atje vetëm të kem shoshitur dhé! Paskam ikur vazhdimisht nga kjo botë e pastër!

Sikur të kisha vdekur më herët dhe vuajtjet në atë baltovinë të ishin më të pakta!

Komenti i hadithit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), "Ai që e kërkon vdekjen pa vdekur, quhet sikur s'ka vdekur. Po qe i mirë, shpejtohet të arrijë të mirën, po qe i keq, dëshiron pakësimin e së keqes!"

Ja, për këtë arsye, Pejgamberi që di gjithçka, ka thënë: "Kush vdes dhe e braktis kurmin,

Nuk vuan nga malli pse vdes, pse mërgon. Vetëm vuan nga malli për shkak të hallit, për shkak se e la rastin t'i ikë dore!

I vdekuri dëshiron kështu: Eh, sikur t'ia kisha arritur qëllimit më parë!

Kurse i keqi, po të kishte vdekur më parë, do të kishte më pak të këqija. Kurse i miri do të vinte në atdheun e mirësisë më parë!

I keqi thotë: S'paskam ditur gjë, unë s'paskam bërë gjë tjetër veçse t'i shtoj perdet para vetes për çdo çast!

Po të kisha emigruar këtu më parë, këto perde do të më ishin më pak!"

Mos bjer në ambicje, pra, çirre sa më pak fytyrën e ngopjes dhe kënaqjes me atë që ke. Mos u mbaj më të madh, pra preke pak fytyrën e inferioritetit.

Copëtoje sa më pak fytyrën e bujarisë për shkak të koprracisë, sa më pak bukurinë e këndshme të sexhdes për shkak të djallëzisë.

Mos i shkul pendët që e stolisin atë parajsë. Mos i këput krahët që i mbulojnë ato rrugë!

Palloi, kur e dëgjoi këtë këshillë, pa nga ai dhe pastaj filloi të qajë me ngashërime.

Vajtimi i atij të mjeri i bëri të qajnë edhe ata që ndodheshin aty.

Ai që e pyeti se pse i shkulte pendët, mbeti pa përgjigje dhe nisi të qajë i penduar.

Pse u shpejtova dhe e pyeta? Ai paska qenë vetë i mbushur me dëshpërim, kurse unë e bëra të zhytet i tëri në vajtim!

Lotët që i rridhnin nga sytë, i pikonin mbi tokë. Në secilin centimetër katror kishte qindra përgjigje!

Vajtimi me të drejtë dhe i ndjerë i prek shpirtrat, edhe tokën dhe qiellin, madje, i bën të qajnë!

Nuk ka dyshim se mendjet dhe zemrat i përkasin arshit; ato lindin brenda mbulesave nga drita e arshit.

Si Haruti me Marutin që janë të burgosur në pusin e Babilit, edhe mendja me shpirtin janë të burgosur brenda në baltë.

Si Haruti me Marutin. Edhe ata dy engjëj të pastër janë të burgosur në këtë botë në një gropë të frikshme!

Ranë në botën e ulët të epshit dhe për shkak të fajeve, mbetën të lidhur në këtë gropë.

Nga këta dy engjëj i mësuan të mirët me të këqinjtë magjinë dhe gjërat që prishin magjinë.

Por ti eja në vete, mos e mëso magjinë, hiq dorë nga kjo sevda.

Të thonë: Ne ta mësojmë ty këtë magji për të të vënë në bela e për të të provuar.

Kusht në provë është zotërimi i mundësisë për të zgjedhur. Pa fuqi s'ka as mundësi zgjedhjeje.

Dëshirat dhe kërkesat i ngjajnë qenit që e ka zënë gjumi. Edhe e mira dhe e keqja te qentë është e fshehur.

Meqë s'kanë fuqi, janë shtrirë përtokë dhe kanë mbetur ashtu si copa drurësh!

Por sapo t'u hidhet pranë ndonjë gjë e fëlliqur, ajo sikur u fryn qenve ambicjen!

Po qe se në atë sokak rrëzohet e ngordh ndonjë gomar, qindra qenë që flenë, zgjohen!

Hajdutët që kanë shkuar në fshehtësinë e padukshme, nxjerrin kokën nga skutat dhe vihen në sulm.

Qimet e çdo qeni bëhen dhëmbë dhe, për mashtrim, fillojnë të lëkundin bishtin!

Qeni bëhet mashtrim në mes e poshtë, tërbim në mes e sipër dhe kthehet në zjarr të dobët që ka gjetur dru.

Tejhapësira vjen me rrebesh nga dora, flaka e dalë nga zjarri ndrit gjer në qiell.

Prandaj qindra qenër kanë fjetur në kurmin e njeriut dhe janë fshehur sepse nuk ka ndonjë gjah.

Ose u ngjajnë zogjve që lindin me sy të mbyllur. Pas perdes digjen me një sevda për gjah.

Por hiqjani qylafin skifterit i cili, sa ta shohë gjahun, menjëherë fillon të bredhë nëpër male!.

Dëshira e të sëmurit është tulatur; ai dëshiron vetëm të shërohet!

Por kur sheh bukë, mollë dhe shalqin, kërkon t'i hajë dhe, me këtë dëshirë, frika nga dëmi fillon të luftojë.

Po të durojë, shikimi i tyre i bën dobi të mirës së tij, sepse rënia në atë emocion i bën mirë natyrës së topitur.

Por po të mos durojë, është më mirë që të mos i shikojë. Është më mirë që shigjeta të jetë larg njeriut pa mburojë!

Palloi jep përgjigje.

Kur i mbaroi të qarët, palloi tha: Ik tutje, ti je kapur pas ngjyrës dhe aromës!

A nuk e sheh se për shkak të këtyre pendëve më bien nga çdo anë qindra bela?

Sa e sa gjahtarë të pamëshirshëm ngrenë kurthe për mua për shkak të këtyre pendëve!

Sa e sa shigjetarë, për pendët e mia kanë ngrehur harqet dhe më lëshojnë shigjeta!

Nuk kam më fuqi, nuk e mbroj dot veten, nuk kam mundësi shpëtimi nga kjo e keqe!

Meqë puna është kështu, është më mirë që të jem i shëmtuar në mënyrë që të jem i sigurt në male e fusha!

O trim, këto pendë m'u bënë armë mendjemadhësie. Kurse mendjemadhësia i fut në qindra bela mendjemëdhenjtë!

Aftësitë, zgjuarësia dhe malli e pasuria janë, si puplat e palloit, armiq të shpirtit të njeriut.

Sa e sa aftësi dhe arte ka që njeriun e paformuar e shkatërrojnë. Sepse ai vrapon pas kokrrave, kurse kurthin s'e sheh.

Zotërimi i kujdesit është i mirë për njeriun që e zbaton urdhrin "ruhuni" dhe e zotëron veten!

Po pe se s'e mbron dot veten dhe nuk shmangesh dot nga të këqijat, ruhu, largoje atë vegël, lëre zgjedhjen.

Edhe për mua, gjëja me të cilën përkëdhelem dhe mbahem për i zgjedhur, janë pendët e mia, prandaj po i shkul sepse po më bien kokës!

Durimtari e quan të paqenë krahun e tij dhe, në këtë mënyrë, krahu nuk e shtyn në mendime të këqija.

Prandaj thuaji: Mos i shkul pendët e krahut se s'po të bëjnë dëm. Po t'i vijë shigjeta këtij lloj njeriu, vë para mburojën.

Kurse për mua, ky krah i bukur është armik. Sepse nuk bëj dot durim dhe vetëpërkëdhelem!

Po qe se drojtja dhe ruajtja do të më tregonin rrugë, për shkak të kujdesit, madhështia dhe fuqia do të më shtoheshin!

Unë i ngjaj fëmijës ose sarhoshit, nuk kam durim për t'u vënë në provë. S'është e lejueshme të më japësh mua shpatë në dorë!

Po të kisha mend dhe shpata të më pengonte, do të më bëhej mjet fitoreje në dorë!

Duhet një mendje që shpërndan dritë si dielli, që të mos godasë me shpatë ndryshe veçse drejtpërdrejt.

Unë s'kam ndonjë mendje të ndritshme dhe shprehi të mirë, prandaj, pse të mos e hedh në pus armën time?

Kjo armë do të më bëhet armik mua. Prandaj po i hedh në pus shpatën me mburojën!

As kam fuqi në krahë, as një vend ku të mbështetem. Po të mos e hedh shpatën, armiku ma merr prej dore dhe më plagos me të!

Kjo vetvetja me vese të këqija nuk e mbulon fytyrën. Edhe unë, për inat të saj, jam duke e çjerrë fytyrën!

Në këtë mënyrë, kjo lartësi e kjo bukuri të pakësohen dhe, kur të mbarojnë krejtësisht, edhe unë të bie sa më pak nën ndëshkim!

Unë s'kam faj që po e çjerr fytyrën me këtë qëllim. Sepse këtë fytyrë duhet ta mbuloj me plagë.

Po qe se zemra ime do të kishte shprehinë për t'u fshehur, fytyra do të më shkëlqente dhe zbukurohej nga dita në ditë.

S'kam fuqi, s'kam forcë, as drejt të mirës s'prirem dot. E pashë këtë, e pashë dhe armikun tim dhe e thyeva menjëherë armën time!

Dhe, në këtë mënyrë, arrita që ajo të mos triumfonte mbi mua, që hanxhari im të mos bëhej fatkeqësi për mua!

Kur më lëviz damari, iki, sepse njeriu e ka të lehtë të ikë nga vetvetja.

Kush ikën nga tjetri, gjen qetësi pasi shpëton prej tij!

Mirëpo edhe armiku im jam unë vetë, edhe ai që ikën nga armiku, unë vetë. Prandaj, puna ime gjer në kiamet është të iki pa pushim!

Po qe se njeriut i bëhet armik hija e vet, gjen siguri edhe në Indi, edhe Indu!

Si yjet që zhduken ditën nga drita e diellit,
ata që kapërcejnë veten dhe asgjësohen në qenien e Zotit,
janë të sigurt nga e keqja e aftësive dhe arteve të tyre.
Për ata nuk ka rrezik.

Po qe se një njeri arrin mosqenien dhe e bën mosqenien stoli për vete, ai njeri, si Muhammedi, s'ka më hije.

Mosqenia është stoli për të fshehtën "mosqenia është krenaria ime!" Ky lloj njeriu është pa hije si flaka e qiririt!

Qiriri përbëhet prej flake fund e krye. Hija nuk afrohet dot në mjedisin e tij!

Qiriri iku edhe nga vetja, edhe nga hija e vet! Bëri sipas dëshirës së derdhësit të qiririt, u mbështet në dritën e tij!

Derdhësi i qiririt i thotë qiririt: Të derdha ty që të asgjësohesh. Dhe qiriri i përgjigjet: Edhe unë ika në mosqenie!

Kjo dritë ekzistente është dritë e nevojshme, jo si drita e përkohshme dhe aksidentale!

Kur qiriri të asgjësohet plotësisht në zjarr, atëherë prej tij nuk sheh as shenjë, as dritë!

Zjarri i trajtës, për ta hequr errësirën, qëndron në trajtën e qiririt!

Qiriri i kurmit është e kundërta e qiririt që duket, kur asgjësohet, drita e shpirtit i shtohet!

Kjo është dritë e përjetshme, kurse qiriri, i përkohshëm. Flaka e qiririt të shpirtiti përket Zotit!

Meqë ky zjarr i krijuar nga zjarri, është dritë, hija kalimtare është larguar prej tij.

Hija e resë bie përtokë. Kurse hija nuk bie e ngrihet me hënën!

O person fatbardhë, të kapërcesh vetveten, do të thotë të shndërrohesh në gjendje pa re. Kur ta kesh kapërcyer vetveten, i ngjet hënës së rrumbullaktë.

Por nëse era heq zvarrë e sjell një re, drita e hënës bie në gjendje më të mangët se hëna.

Për shkak të resë dhe pluhurit, hëna duket si fantazmë.

Ja, pra, edhe reja e kurmit na shtyn ne në mendimin e iluzionit.

Shih favorin e hënës se edhe kjo është favori i saj, sepse na ka thënë se retë janë armiku ynë!

Hëna nuk pyet as për renë, as për pluhurin. Ajo ndodhet në lartësitë qiellore!

Reja është armike e shpirtit tonë. Reja na e fsheh hënën nga sytë!

Kjo perde e fuqizon hyrinë si trim legjendar, hënën e plotë e bën më të mangët se hëna e re.

Hëna na ka ulur ne në prehrin e lartësisë sublime, armikun tonë e ka quajtur armik të vetin.

Edhe brishtësia dhe shkëlqimi i resë është e tillë, por kush i thotë resë hënë, ka rrëshqitur mjaft nga rruga.

Po t'i bjerë drita e hënës resë, e shkëlqen si hënë fytyrën e saj të errët.

Ç'është e vërteta, është ngjyer me të njëjtën bojë si hëna. Edhe kjo është një fat, por drita në re është e huazuar.

Në kiamet s'mbetet as diell, as hënë. Syri merret me origjinën e dritës.

Në këtë mënyrë, pasuria me themel veçohet nga pasuria e huazuar. Ky konak i përkohshëm ndahet nga vendbanimi i përhershëm.

Dadoja është për pak ditë. O nënë, ti merrna në prehër!

Krahu im është re. Ai është perde dhe nuk e tregon atë që ka përpara. Ai fiton tejdukshmëri vetëm me favorin e Zotit.

T'i shkul pendët, t'i hedh nga rruga ime bukuritë e krahëve dhe të njëjtën bukuri ta shoh nga hëna!

Unë nuk dua dado, nëna është më e këndshme. Unë jam Musa, dadoja ime është nëna ime.

Unë nuk dua ta fitoj favorin e hënës me ndërmjetës. Sepse kjo lidhje u bë shkak për shkatërrimin e shumëve.

Ose reja asgjësohet në rrugën e Zotit dhe atëherë nuk shërben më si perde për fytyrën e hënës!

Trajtën e vet e tregon në formë mosqenieje. Si kurmi i pejgamberëve dhe velinjve!

Ajo lloj reje nuk bën punën e perdes. Madje, puna e saj si perde për sa i përket kuptimit, është më dobi!

Me të vërtetë, drita reshon pika në mëngjes, por në qiell nuk ka re.

Reshimi i atij shiu ishte mrekulli e Pejgamberit. Reja u tret, qielli mori ngjyrën e vet!

Ishte re, por shprehia e resë prej saj kishte ikur. Ja, kështu bëhet me durim edhe kurmi i ashikut!

Eshtë kurm, por cilësia si kurm ka humbur, është ndryshuar; nga ai ka ikur edhe ngjyra, edhe aroma!

Krahu është i tjetërkujt, koka më duhet mua. Koka është vendbanimi i ndjenjës dhe edukatës dhe shtylla e kurmit.

Dije se sakrifikimi i shpirtit për gjahun e tjetërkujt është mohim, herezi absolute, është mungesë shprese për mbarësi!

Eja në vete dhe mos i ngjaj sheqerit që u vënë para papagajve. Ngjaji helmit dhe shpëto nga dëmtimi!

Ose, për ta dëgjuar ftesën për t'u mbushur me gëzim dhe hare, përngjaja veten të vdekurit para qenve.

Edhe Hizri e shpoi gjeminë për ta shpëtuar nga njeriu që do ta pushtonte.

Prandaj fjala "mosqenia është krenaria ime" u bë një fjalë e lartë, hapi rrugë për të ikur nga sypangopurit, te Zoti i ngopur e i pasur!

Për të shpëtuar nga ambicja e atyre që rrinë në ndërtesat e rregulluara, thesaret i groposin në vende të rrënuara.

Po s'dite t'i shkulësh pendët, ec para, hyr në vetmi dhe mos i shpenzo krahët për këtë e për atë!

Sepse ti je edhe kafshatë, edhe ngrënës kafshate. O shpirt, mblidhi mendtë në kokë se edhe ha, edhe hahesh!

Përveç Zotit, çdo gjë edhe ha, edhe hahet.
Si zogu apo shpendi që gjuan karkaleca
por nuk e sheh skifterin që është ngritur ta gjuajë atë vetë.
O njeri, edhe ti ha dhe gjuan, por mos u ndje i sigurt nga ai
që ka për të gjuajtur dhe ngrënë edhe ty!
Po s'e pe dot me sytë e ballit, shihe me sytë e shpirtit dhe të përvojës
që ta kuptosh të fshehtën.

Një zog gjuante krimba. Ndërkaq, macja gjeti rast dhe e rrëmbeu!

Hante, hahej por, ndërsa gjuhej vetë, s'dinte gjë për një gjuetar tjetër!

Hajduti vjedh një copë tekstili, por pas tij, bashkë me armiqtë e hajdutit, është edhe nëpunësi i shtetit.

Mendja e hajdutit është te dyert dhe drynat; ai s'di gjë për nëpunësin dhe se, kur të gdhihet, ka për të bërë "ah!"

Aq shumë është zhytur në sevdanë e vet, saqë s'di gjë fare për ata që e kërkojnë.

Sapo bari të pijë ujë të kulluar, vjen menjëherë një kafshë dhe e kullot.

Bari edhe ushqehet, edhe ushqen. Ja, kështu është çdo qenie tjetër veç Zotit!

Zoti "ju ushqen, por vetë nuk ushqehet" sepse as ha, as hahet, sepse s'është prej mishi dhe lëkure!

Kush ha dhe hahet, si mund të jetë i mbrojtur nga një ngrënës i fshehur në pusi?

Siguria e gjërave që hahen jep, më në fund, vetmi dhe zi. Ec para dhe shko te pragu i Zotit që nuk ha e nuk pi!

Çdo iluzion ha një iluzion tjetër, çdo mendim kullot një mendim tjetër!

Ti nuk shmangesh dot nga iluzioni ose nuk shpëton dot prej tij duke fjetur.

Mendimi yt është grenzë, kurse gjumi, ujë. Edhe sikur të flesh, sapo që të zgjohesh, grenzat të sulen dhe mblidhen mbi kokë!

Sa e sa grenza të imagjinuara fluturojnë dhe të shtyjnë ty sa andej-këndej!

Kjo imagjinatë është më e ulta e ngrënësve. Kurse të tjerat i di Zoti që është qendra e madhështisë.

Eja në vete dhe ik nga ai grupi i ngrënësve të trashë e të ashpër dhe strehohu te Zoti që thotë "Ne të mbrojmë ty!"

Ose, po qe se nuk të vjen për dore të vraposh te ai mbrojtës e të shpëtosh, ik te personi që ka fituar atributin e mbrojtësit!

Mos ia jep dorën tjetërkujt veç Pirit. Është Zoti që mban dorën e Pirit.

Mendja jote e plakur është bërë si fëmijë duke e fituar këtë shprehi në mjedisin e vetvetes. Ai ndodhet nën perde.

Bëja shok mendjes një mendje të pjekur, në mënyrë që mendja të të heqë dorë nga ajo shprehi e keqe!

Sapo t'ia japësh dorën dorës së tij, shpëton nga dora e ngrënësve!

A nuk ka thënë Zoti se "Dora e Zotit është mbi ta"? Ja, pra, edhe dora jote bëhet një nga duart e atyre njerëzve të besës!

Me t'ia dhënë dorën dorës së Pirit, me ta ndjekur atë Pirin e madh i cili di gjithçka, do të thotë se ke shpëtuar!

Sepse ai, o myrit, është pejgamberi i kohës. Drita e Pejgamberit shfaqet tek ai!

Sapo t'i përshtatesh atij, sapo ta zësh atë prej dore, bëhesh njëri prej sahabeve që u ndodhën në Hudejbije dhe i dhanë besën Pejgamberit!

Quhesh ndër dhjetë personat e përgëzuar me xhennetin. Dhe kthehesh në ar të pastër që, edhe po të futet e të shkrihet në potë, nuk i bie karati!

Kjo njohje është e drejtë, sepse njeriu është i ngjashëm dhe i njëvlershëm me atë që do.

Eshtë bashkë me të edhe në këtë botë, edhe në tjetrën. Ky është hadith i Ahmedit me shprehi të mira.

Ai ka thënë: "Njeriu rri me atë që do!" Zemra nuk ndahet nga ajo çka dëshiron!

Qëndro pak atje ku ka kurth dhe karrem. Ec para, o i gjymtuar dhe shihi të gjymtuarit si ti!

O i mbrapshti i të mbrapshtëve, dije edhe këtë se ka të epërm mbi të epërm!

Sa gjë e çuditshme, ti je edhe vetë i mbrapshtë, edhe kërkon të kapësh dorën e të mbrapshtëve. Edhe gjah je, edhe kërkon të gjuash!

Mos u bëj pritë para dhe pas tyre. Sepse ti s'e sheh armikun, por ai armik është në shesh.

Ambicja për gjueti e bën njeriun indiferent ndaj faktit se edhe ai vetë ka për t'u gjuajtur. Tregon burrëri, por është pa zemër.

Në kërkesë dhe dëshirë mos u bëj më poshtë se një zog. Edhe trumcaku, madje, vëren para e pas.

Dhe kur shkon te vendi ku ndodhet ushqimi, i vjen disa herë para e pas.

Duke menduar: A mos vallë është ndonjë gjahtar në këto anë? Po të jetë, është më mirë të heq dorë nga kjo kafshatë!

Shihi historitë e të këqinjve dhe vështroji gjendjet e tyre. Dhe merr shembull nga vdekjet e shokëve dhe miqve!

Si i shkatërroi ata pa armë e pa gjë? Pa shih! Ai ndodhet pranë teje në çdo situatë.

Zoti torturon, por pa duar. Dije se Zoti zbaton pa duar!

Po të ketë Zot, ku është? Ai që thotë kështu, sapo t'i nënshtrohet torturës, pohon: "Ai është, ka Zot!"

Ai që thotë se ekzistenca e Zotit është diçka për t'u cuditur, larg mendjes, derdh lot dhe vihet t'i lutet: "O Zot, që je më afër meje se unë vetë...!"

Ikja nga kurthi është domosdoshmëri, por kurthi yt të është ngjitur në krahë!

Ja, pra, prandaj unë po ia shkul rrënjët kurthit dhe dua që, për t'ia arritur qëllimit, të mos i bëj gjuhën dhe qiellzën të më dhembin!

E thashë këtë fjalë në përshtatje me mendjen tënde. Kupto dhe mos ia kthe shpinën kërkimit e hetimit.

Dhe zgjidhe këtë nyje të përbërë prej ambicjes dhe zilisë. Mendo për litarin në qafën e gruas së Ebu Lehebit!

Shkaku që Halili (a.s.) e vrau sorrën. Eliminimin e cilës nga vetitë e këqija që e shkatërrojnë myridin shënon kjo?

As fund ka kjo fjalë, as di të mbarojë! O Halili i Zotit, pse e vrave sorrën?

Iu përshtate urdhrit. E drejtë. Por cila ishte urtësia e këtij urdhri? Duhen treguar pak nga të fshehtat e tij!

Sorra e zezë krakarit sepse kërkon jetë të gjatë e të vazhdueshme në këtë botë.

Si Iblisi, kërkon nga Zoti jetën e kësaj bote gjer në kiamet.

Edhe Iblisi tha: "Më lër të jetoj gjer në ditën e kiametit!" Eh, sikur të thoshte: "Zoti ynë, u penduam!"

Jeta pa pendim e pendesë është fund e krye agoni. Vdekja e gatshme dhe e pashmangshme është indiferentizëm ndaj Zotit.

Bashkë me njerëzit, edhe jeta, edhe vdekja janë të këndshme, por pa Zotin, edhe eliksiri është zjarr!

Kërkimi i jetës së pafundme nga një pozitë e tillë e lartë është nën ndikimin e mallkimit.

Të kërkosh nga Zoti tjetër gjë veç Tij, në dukje është kërkesë për shtimin e gjësë së dëshiruar, por, në të vërtetë, është të dëshirosh pakësimin e saj të plotë.

Veçanërisht jeta e cila kalon me ndarje dhe veçime. Kjo pothuaj i ngjan pretendimit për dhelpëri përballë luanit!

Do të thotë "më jep më shumë jetë që të kthehem prapë e më prapë, zgjatma afatin që të bie poshtë e më poshtë"!

Më në fund, ajo bëhet shenjë për mallkim, kurse personi që kërkon mallkim është njeri i keq!

Jeta e këndshme është të ushqesh shpirt nga bota e afërsisë. Kurse jeta e sorrës është për të ngrënë ndyrësi.

"Më jep jetë me të tepërt që të ha ndyrësi sepse kjo është natyra ime!"

Po qe se ajo sorrë që i qelbej goja, nuk do të hante ndyrësi, nuk do të lutej ta shpëtonin nga vesi i sorrës!

Lutje.

O Zot që e kthen tokën përmbys, që bën një tokë tjetër at të njerëzve!

Puna jote është t'ua ndryshosh gjendjen gjërave, të bësh favore e mirësi, kurse puna ime, të bie në gabim, të harroj dhe të mëkatoj!

Me diturinë tënde, ndryshomi për mirë të metat e gabimet! Unë përbëhem prej qurresh fund e krye, kurse ti shndërromë mua në dije e durim!

O ti që e kthen tokën djerrë në bukë, o ti që i jep gjallëri bukës së vdekur, që e bën jetë atë!

O ti që e udhëzon shpirtin e trullosur, o ti që e bën pejgamber satë që e ka shmangur rrugën!

Ti e bën qiell një copë tokë. Ti ia shton gëzimin tokës me anë të yjeve!

Kush përfton një eliksir nga kjo botë, atij i vjen vdekja më shpejt se të tjerëve!

Syri i zemrës që sheh në gjithësi, vëren se këtu ka gjëra që vazhdimisht prishen e rregullohen përsëpari!

Qepja e kësaj pelerine kurmi pa pe e pa gjilpërë s'është gjë tjetër veç ndryshimit të së dukshmes dhe eliksirit që e kthen bakrin në flori!

Atë ditë që u krijove, ti ishe ose zjarr, ose erë, ose dhé.

Po qe se do të ishte e mundur të mbeteshe përjetësisht në atë gjendje, a do të të bëhej e mundur ty kjo lartësi sublime?

Zoti të ndryshoi ty. Qenia jote e mëparshme s'mbeti. Në vend të saj të dhe një qenie më të mirë.

Në këtë mënyrë, ti u veshe nën qindramijra qenie, nga të cilat vazhdimisht e dyta qe më e mirë se e para.

Shihe Zotin si ndryshues të këtyre dhe lëri ndërmjetësit. Sepse, po të jepesh ndaj ndërmjetësve, largohesh nga origjina.

Kudo që të shumohen mjetet dhe ndërmjetësit, arritja humbet e mbaron.

Hutimin e ke ngaqë çdo gjë e njeh si pasojë shkaqesh. Kurse mahnitja të hap rrugë për në atë fron!

Këto qenie i gjete nga mosqeniet. Atëherë, pse e shmang fytyrën nga mosqenia?

Ç'dëm pësove nga ajo mosqenie që u ngjite pas qenies, o mi toke?

Meqë gjendja e dytë është më e mirë se e para, kërko mosqenien dhe faliu atij që e ndryshon njeriun nga një gjendje në tjetrën!

O kryeneç, qysh nga koha kur re në qenie, gjer tani, për çdo çast pe qindramijëra ringjallje.

Kur s'dije gjë, kalove nëpërmjet zhvillimit nga bota e ngurtë dhe jo e gjallë, në botën e bimëve. Pastaj, nga bota e bimëve re në botën e jetës dhe pasioneve!

Pastaj, përsëri, shkon në botën e arsyes dhe dallimit duke shpëtuar nga këto pesë shqisa dhe bota e gjashtë anëve!

Këto gjurmë këmbësh shkojnë gjer në breg të detit. Pastaj, brenda detit, gjurmët e këmbëve asgjësohen e mbarojnë!

Sepse në distancat e botës së thatë, për dallim, ka fshatra, vendbanime, konaqe.

Kurse konaqet e detit janë dallgëzimet e tij që s'dinë të pushojnë, që s'kanë truall dhe tavan!

Ato distanca nuk kanë shenja dhe emërtime.

Mes dy konaqeve nga bota e bimëve gjer në botën e shpirtit ka qindra konaqe si këto.

Në mosqeniet e pe këtë qenie dhe si iu ngjite kështu qenies trupore?

Eja në vete, o sorrë, eja në vete dhe jepe këtë shpirt e bëhu skifter. Luaj me kokën e me shpirtin përballë ndryshimit që bën Zoti nga një gjendje në tjetrën!

Merre të renë dhe lëre të vjetrën. Sepse çdo viti yt është më i pasur e më epror se tri vitet e kaluara.

Po qe se s'bëhesh dot mirëbërës si fidani i hurmasë, shtoji vjetërsirat njëra mbi tjetrën dhe grumbulloji në hambar!

Atë gjënë e vjetër, të kundërmuar e të rrënuar, dhurojua qorrave!

Kush sheh të renë, s'të merr ty. Ai i bëhet gjah Zotit, nuk kapet pas teje!

O ujë i zi e i kripur, të gjithë zogjtë qorra që ndodhen kudo, të mblidhen tufa-tufa mbi kokë!

Dhe, në këtë mënyrë, u shtohet verbëria. Sepse uji i zi e shton verbërinë.

Për këtë shkak, sytë e zemrës të njerëzve të kësaj bote janë të verbër; ata pinë ujë të turbulluar me baltë!

Meqë nuk ke eliksir në një botë të fshehtë, jepi ujin e zi e të kripur dhe merr të keqen në këtë botë!

Dhe, me këtë gjendje, kërkon edhe qenie, atë e kujton, hë! Mirëpo ti je i gëzuar siç është zezaku me fytyrën e tij të zezë!

Në të vërtetë, zezaku është i kënaqur me atë ngjyrë të zezë sepse ashtu ka lindur, sepse është në origjinë zezak.

Por nëse një ditë i ndryshon fytyra dhe zbukurohet dhe pastaj nxihet prapë, vihet të kërkojë shërim!

Po qe se zogu që fluturon mbetet në tokë, fillon të dëshpërohet e të vajtojë.

Kurse shpendët shtëpiakë kënaqen duke bredhur e kullotur mbi tokë!

Sepse nuk janë kafshë fluturuese, kurse ai tjetri është kafshë fluturuese!

Pejgamberi (a.s.) ka thënë:
"T'ju vijë keq për tre vetë: për të parin e një fisi, i cili bie poshtë;
për të pasurin e varfëruar; për dijetarin e bërë lodër në duar të injorantëve!"

Pejgamberi tha: Ju betohem për shpirtin tim se duhet t'ju vijë keq për të pasurin që ka rënë në varfëri,

Për njeriun e lartë të rënë poshtë e të poshtëruar si dhe për dijetarin e thjeshtë e të pastër që ka rënë në mesin e fisit Mudar që është bërë i famshëm për injorancë!

Pejgamberi tha: Edhe sikur të jeni gur e mal, të tregoni mëshirë për këta tre grupe njerëzish!

Sepse i pari, ndërsa në fillim ishte në krye, ra poshtë. Tjetri, ndërsa ishte i pasur, ra në varfëri, mbeti pa para.

Dhe i treti, është dijetari që ka pësuar ngatërresa në mesin e njerëzve të njohur botërisht si kokëtrashë!

Sepse të biesh nga pozita e lartë dhe e nderuar, në pozitë të ulët e të pavlerë, është si të presësh një gjymtyrë të trupit.

Gjymtyra e ndarë nga trupi, vdes; në fillim, ajo lëviz pak, por kjo s'vazhdon gjatë.

Ai që ka pirë vjet verë nga kupa e Elestit, këtë vit zihet nga dhimbja e kokës, dpimbjet e mundimet.

Ç'kërkon padishahlläku te personi i ulët si qen?

Fajtori bën pendesë. Personi që ka humbur rrugën, bën "ah!"

I vogli i drenushës bie në stallën e gomarëve dhe mbyllet aty;
gomarët herë e qëllojnë dhe herë tallen me të; ai mbetet i detyruar të hajë bar të thatë...
Kjo është vetia e robit të thjeshtë të Zotit;
edhe ai ka rënë në këtë gjendje mes njerëzve të dëshirave, pasioneve dhe epshit të kësaj bote.
"Islami fillon i vetëm dhe mbaron i vetëm!"
Pejgamberi i Zotit ka folur drejt!

Një gjahtar kapi një dre. Ai njeri i pamëshirshëm e mbylli drerin në ahur.

Ahuri ishte plot me qe dhe gomerë. Dhe ai njeri i pamëshirshëm, ashtu si tiranët, e burgosi drerin në atë ahur!

Nga frika, dreri ikte nga të katër anët. Natën, gjahtari u shtinte gomerëve bar e kashtë.

Çdo ka e çdo gomar, nga uria, e hante kashtën si sheqer, madje, duke i ardhur më i ëmbël se sheqeri!

Dreri ikte sa nga njëra anë, në tjetrën, e kthente fytyrën mënjanë nga pluhuri dhe tymi!

Që ta vënë bashkë me të kundërtin e vet, është sikur ta vënë nën mundimet e vdekjes.

Edhe Sulejmani pati thënë se, nëse zogu lajmëtar nuk paraqet justifikim të pranueshëm se është i detyruar të ikë,

Ose e vras, ose e vë nën një mundim të pallogaritshëm!

O person i besueshëm, pa mendo! Ç'është ai mundim? Mbyllje brenda një kafazi bashkë me të huaj!

O njeri, ndodhesh nën mundime brenda këtij kafazi! Zogu i shpirtit tënd është kapur me ata që s'janë të llojit tënd.

Shpirti është skifter, kurse natyrat janë sorra. Skifteri plagoset nga sorrat dhe korbat.

Ja, pra, edhe zogu i shpirtit ka mbetur duke qarë me ngashërime mes tyre si Ebu Bekri në qytetin Sebzvar.

Muhammed Harzemshahu e pushton qytetin Sebzvar me populsi plotësisht rafizi.
Populli kërkon falje.
Ai u thotë se do t'i falë në qoftë se i dorëzojnë një person të quajtur Ebu Bekr.

Muhammed Alp Ulug Harzemshah kishte shkuar për të luftuar kundër sebzarvarët që ishin dobësuar krejtësisht.

Ai i shtrëngoi ushtarët. Ushtria e tij filloi t'i vriste armiqtë.

Qytetarët shkuan e i ranë ndër këmbë. I thanë: Vërna vathë në vesh, bëna robër, por na e fal jetën!

Do të ta japim çdo taksë që të të duhet, do të të japim dhurata që do t'i shtojmë çdo vit!

O ti me shprehi luani, jeta jonë është e jotja, lërnae neve amanet edhe për pak kohë!

Padishahu u tha: "Po të mos më sillni dikë me emrin Ebu Bekr, nuk e shpëtoni dot jetën!

Po të mos ma paraqisni si dhuratë dikë me emrin Ebu Bekr nga qyteti juaj,

Do t'ju bëj të këqija, do t'ju korr si me drapër. As taksa marr, as përgjërime dëgjoj!

Ata i thanë: Mund të shtrosh në rrugë një thes me flori, por nga ky qytet mos kërko dikë me emrin Ebu Bekr!

Si mund të ndodhet Ebu Bekri në Sebzvar? A mund të ndodhet në mes të përroit copë toke e palagur?

Duke hequr dorë nga floriri, padishahu tha: O adhurues të zjarrit, pa ma sjellë si dhuratë dikë me emrin Ebu Bekr,

S'bën dobi. Unë s'jam fëmijë që të mbetem i mahnitur pas arit e argjendit!

O njeri i dobët, edhe ti, pa bërë sexhde, nuk shpëton dot edhe sikur ta fshish e ta pastrosh faltoren me prapanicën tënde!

Qytetarët dërguan fluturim lajmëtarë majtas e djathtas që u vunë të pyesin e të kërkojnë edhe në vende të shembura se mos ishte dikush me emrin Ebu Bekr.

Pasi vrapuan e u pluhurosën tri ditë e tri net me radhë, mezi gjetën një Ebu Bekr të imtë.

Paskej qenë udhëtar që paskej mbetur në një skutë të një rrënoje duke u tharë nga sëmundja.

E gjetën tek po flinte në skutën e një gërmadhe. Shpejt – i thanë –

Ngrihu se të kërkon padishahu. Prej teje, qyteti ynë do të shpëtojë nga vdekja!

Njeriu u tha: Po të kisha këmbë, qo të gjeja fuqi për të ecur, do të shkoja ku kisha për të shkuar!

A do të rrija këtu, në këtë vend armik? Do të vrapoja për të shkuar në qytetin e të dashurve!

Sollën një tezgë për të bartur të vdekur dhe e shtrinë Ebu Bekrin mbi të.

Ua lanë hamallëve dhe e çuan para Harzemshahut.

Kjo botë është Sebzva. Njeriu i Zotit humbet këtu.

Harzemshah është Zot i Madh. Ai kërkon zemër nga ky popull faqezi.

Pejgamberi ka thënë: "Zoti nuk ju sheh pamjen, por zemrat. Vërini në rregull punët e zemrës!"

Zoti thotë: Unë të shoh ty nga një njeri i zemrës. Unë s'ta shoh sexhden, s'të shoh se jep flori!

Ti e pandehe zemrën zemër dhe e le kërkimin e njerëzve të zemrës.

Zemra është një qenie e tillë që sikur shtatë copë si shtatë qiej, t'i vësh në mes, humbasin e shkojnë!

Mos u thuaj zemër këtyre copërave të thyera zemre. Në Sebzvar mos kërko Ebu Bekr!

Njeriu i zemrës është pasqyrë me gjashtë faqe. Zoti sheh në atë pasqyrë në të gjashtë anët.

Zoti nuk ia hedh vështrimin njeriut që ndodhet në gjashtë anët, që nuk ka shpëtuar dot nga këto anë, pa qenë ndërmjetës ai njeriu i zemrës.

Nëse s'e pranon dikë, për të e bën. Nëse e pranon, prapë ai është ndërmjetës.

Pa të, Zoti s'i jep ushqim askujt. Ja, pra, unë thashë pakëz gjë nga gjendja e personit që arrin bashkimin me Zotin.

Zoti e vë mirësinë në dorën e tij dhe atyre që janë për t'u mëshiruar, u bën mirësi nga dora e tij.

Me pëllëmbën e tij është njësuar deti i tërësisë. Ai është i pavlerësueshëm në sasi dhe cilësi, por i përkryer plotësisht.

Eshtë e pamundur të shprehet me fjalë ky njësim që s'e nxënë fjalët.

O i pasur, edhe sikur të sjellësh qindra thasë flori, Zoti thotë: O njeri i kërrusur më dysh, zemër sill!

Nëse zemra është e kënaqur me ty, edhe unë jam i kënaqur. Nëse zemra e kthen fytyrën mënjanë prej teje, edhe unë e kthej!

Nuk shoh nga ty, por nga ajo zemër. O ti me zemrën në portën time, mua sillëm zemër si dhuratë!

Si të jetë njeriu i zemrës me ty, ashtu jam dhe unë. Xhennetet ndodhen nën këmbët e nënave!

Ai është edhe nëna e njerëzve, edhe babai, edhe origjina. Lum për personin që mundet ta veçojë zemrën nga lëkura dhe kurmi!

Ti thua se ja ku të kam sjellë zemër. Por ai të thotë: Kutia (qyteti) është i mbushur plot me zemra të tilla!

Ti sillmë mua zemrën që është kulmi i botës. Ajo zemër është shpirti i shpirtit të shpirtit të njeriut!

Ja, prandaj ai sovran zemrash është duke pritur zemrën plot bukuri e mirësi.

Sikur për ditë të tëra ta shëtisësh qytetin e Sebzvarit, nuk mund ta gjesh atë lloj zemre!

Më në fund, gjen një zemër të zbehur e të rrënuar, e vë në tezgë dhe e çon në atë anë.

Dhe i thua: O sovran i sovranëve, të solla zemër. Në këtë Sebzvar nuk ka zemër më të mirë se kjo!

Dhe ai të thotë: O i paturpshëm, a mos vallë këtu është varrezë që më sjell një zemër të vdekur?

Ik, sillmë zemër me shprehi sovrani që Sezvari të gjejë shpëtim!

Sikur ajo zemër është fshehur nga kjo botë! Sepse errësira me dritën nuk ndodhen në një vend. Sepse janë e kundërta e njëra-tjetrës.

Armiqësia e natyrës së Sebzvarit për atë zemër ka mbetur trashëgim nga dita Elest.

Sepse ai është skifter, kurse qyteti i botës, sorrë. Vështrimi i atij që s'është nga lloji i vet, e plagos njeriun!

Nëse njeriu i tregon butësi atij që s'është nga lloji i vet, i tregon për hipokrizi, nëse e mpin, e mpin për të fituar diçka.

Sepse kjo sorrë e poshtër që kërkon kërmë, ka hile të shumëfishta.

Po t'ia pranojnë hipokrizinë, shpëton; hipokrizia i bëhet diçka e drejtë që i jep dobi.

Sepse njeriu i zemrës, bashkë me madhështinë dhe pompozitetin e vet, është i turpëruar në tregun tonë.

Në s'je pa shpirt, kërkoje njeriun e zemrës. Nëse s'je i kundërt me padishahun, shih të bëhesh i të njëjtit lloj me zemrën.

Mirëpo personi, hipokrizia e të cilit të pëlqen dhe është në përshtatje me natyrën tënde, është miku yt. Eshtë miku yt, por jo mik i Zotit!

Kush çon ujë në mullirin tënd, është, sipas teje, ose shenjtor, ose pejgamber!

Ec, lëri dëshirat dhe pasionet dhe merr një aromë, ndjeje atë aromën e mirë të myshkut!

Nëse shkon pas dëshirave dhe pasioneve, të prishet ekuilibri i mendjes. Sipas teje, myshku dhe parfumi s'vlejnë për asgjë!

Kjo fjalë s'ka fund, kurse dreri ynë vazhdon të ikë nga njëri skaj i ahurit, në tjetrin!

Pjesa e mbetur e historisë se drerit në stallën e gomarëve.

Ai dre me gjendrra myshku kishte ditë që po torturohej në ahurin e gomarëve.

Hiqte shpirt si peshku i mbetur në tokë të thatë, përpëlitej pa pushim.

Një gomar thoshte: Hë, ky babai i kafshëve ka shprehitë e padishahëve dhe bejlerëve; heshtni!

Një gomar tjetër, duke parë ecejaket e tij dhe duke u tallur, thoshte: Ky ka gjetur një margaritar, si po e shet lirë?

Një gomar tjetër thoshte: Thojini që, me këtë delikatesë që ka, të shkojë e të mbështetet në fronin e padishahut!

Kurse një gomar tjetër që kishte ngrënë shumë dhe e kishte mbushur barkun me të tepërt, e thirri drerin për të ngrënë.

Dreri ngriti kokën dhe i tha: S'kam oreks, jam i pafuqishëm!

Gomari tha: E di se bën naze. Ose ke turp dhe prandaj druhesh.

Dreri thoshte me vete: Ajo gjellë është gjella jote. Me të ringjallen e rinohen pjesët e trupit tënd!

Kurse unë jam shok i çaireve. Unë dëfrehem me ujëra të kthjellta, kopshte e vreshta!

Po qe se kazaja dhe kaderi na rrëzojnë në vuajtje, si mund të na ndryshojnë natyra e bukur dhe shprehitë e mira?

Edhe nëse jam varfëruar, si mund të ndodhë që të veproj si i varfër? Nëse më është vjetëruar rroba, unë jam i ri.

Unë edhe zymbylët, tulipanët dhe lulet e tjera i haja me qindra naze dhe pa dashur.

Gomari tha: Po, fol me vete sa të duash, se në vetmi mund të thuhen shumë budallallëqe!

Dreri tha: Barku im dëshmon për fjalët e mia. Nuk po u jep rëndësi as bimëve aromatike!

Por ai që s'ka nuhatjen e duhur, si do t'i ndjejë këto? Ajo aromë është e ndaluar për gomarin që i falet ndyrësisë.

Gomari në rrugë i merr erë ndyrësisë së gomarit. Si mund t'ua ofroj kyre lloj krijesave myshkun?

Prandaj ai Pejgamber mirëbërës ka thënë alegorinë "Islami është i vetëm në botë"!

Sepse, megjithëse individualiteti i tij është i njëkohshëm me engjëjt, edhe farefisi ikin prej tij!

Njerëzit shohin pamjen e tij, e pandehin të llojit të vet, por aromën tek ai nuk e ndjejnë.

Si luani në trajtë kau. Ti e sheh nga larg atë, por mos tento t'ia çash barkun.

Po ia çave, hidhe kaun-trup, se ai me shprehi luani e copëton kaun!

Nayra prej kau të bën ta humbësh kokën; shprehia kafshërore të ndan nga kafshët.

Edhe sikur të jesh ka, pranë tij bëhesh luan. Por nëse ti e pëlqen të jesh ka, mos kërko të bëhesh luan!

Komenti i ajetit "Unë pashë shtatë qe të dobët të hanë shtatë qe të majmë!"
Qetë e dobët Zoti i krijoi me veti luani, prandaj i hëngrën me oreks qetë e majmë.
Ç'është e vërteta, qetë e treguan trajtën në pasqyrën e ëndrrës,
por ti shih fytyrën e brendshme të çështjes!

Fisniku egjiptian, pasi iu hap porta e të fshehtave, pa në ëndërr se

Shtatë qe të paushqyer e të dobët hëngrën shtatë qe të ushqyer mirë e të majmë!

Shtatë qetë e dobët ishin, në të vërtetë, shtatë luanë, ndryshe, nuk mund t'i hanin shtatë qetë e majmë!

Në këto kushte, edhe njeriu i punës duket në trajtë njeriu, por, në të vërtetë, në të është i fshehur një luan që ha njerëz!

E ha njeriun mirë e mirë dhe e shndërron një një gjë të vetme abstrakte. Po të ketë ndonjë hall, ia kullon turbullirën dhe e shndërron në gjendje të pastër!

Për shkak të një halli, ai shpëton nga të gjitha turbullitë dhe e vë këmbën në kokë të yllit Arusha e Madhe.

Pse të fillosh të krakarisësh si sorrë? Pse t'i thuash Halilit pse e theri gjelin?

Halili thotë: Zbatova urdhrin. Mirë, po cila ishte urtësia e atij urdhri? Thuaje dhe unë do ta madhëroj Zotin me çdo qimen time!

Fakti që Halili (a.s.) e theri gjelin, për eliminimin e ç'vetie të keqe të myridit është shenjë?

Gjeli është lloj epshi, ai i falet shumë epshit. Ai është i dehur nga vera e keqe dhe e helmët.

Po të mos ishte epshi për të prodhuar soj, Ademi do ta kishte tredhur veten nga turpi.

Iblisi i mallkuar tha: Për t'u gjuajtur nga Zoti, mua më duhet një kurth i fortë.

Zoti i tregoi atij ar, argjend dhe kuaj dhe i tha se mund ta gënjente popullin me ato.

Iblisi e pëlqeu në dukje këtë. E pëlqeu, por e thartoi fytyrën dhe i vari buzët.

Zoti i dhuroi atij që ngordhtë, flori dhe margaritarë.

Dhe i tha: O i mallkuar, merre edhe këtë kurth. Djalli Iblis i tha: O ndihmues i mirë, shto edhe më shumë!

Dhe i dha, bashkë me gjëra të yndyrshme e me mjaltë, verëra të rënda e të çmuara dhe shumë rroba të mëndafshta.

Shejtani i tha: O Zot, më ndihmo, dua edhe më shumë! Jepmë që t'i lidh mirë e mirë ata me gjalmat e mia!

Në këtë mënyrë, sarhoshët burra dhe me zemër t'i këpusin burrërisht ato gjalma!

Dhe me këta kurthe dëshirash e pasionesh, gjalmat t'i ndajnë burrat e tu nga burracakët!

O sovran i fronit të lartësisë sublime, kërkoj një kurth tjetër, një kurth të tillë që të jetë aq i fuqishëm dhe mashtrues, sa ta rrëzojë njeriun kokëposhtë!

Zoti solli verën dhe muzikantin dhe ia vuri para. Kur i pa këto, Shejtani buzëqeshi lehtë dhe u gëzua përgjysmë.

Dhe tha: Dërgoji lajm azganëve të përjetshëm dhe shpërthe pluhur nga fundi i detit të intrigës!

A s'ishte edhe Musai njëri nga robtë e tu? A nuk hodhi perde pluhuri nga fundi i detit?

Uji u tërhoq nga të gjitha anët dhe nga fundi i detit u ngrit pluhur.

Kur Zoti i tregoi atij bukurinë e femrës që ua merr mendtë dhe durimin meshkujve,

Filloi të luante duke kërcitur gishtërinjtë dhe tha: Jepmë, jepmë, tani për tani ja arrita qëllimit!

Kur mendja ia pa ato sy të përgjumur që e bëjnë mendimin të paqëndrueshëm,

Kur soditi fytyrat e dilberëve që e përvëlojnë këtë zemër si të skuqur në vaj të nxehtë, u mbush me hare.

Fytyra, nishani, vetullat, buzët si qershi. Sikur të kishte shndërritur Zoti nga një perde e hollë.

Me ta parë atë lojë sikur të ishte shfaqur Zoti përmes një perdeje të hollë, Shejtani nisi menjëherë të hidhet nga vendi e të hedhë valle!

Komenti i ajetit "Ne e krijuam njeriun me vetitë më të bukura,
pastaj e bëmë më të ultin e të ultëve!"
Si dhe: "Dikujt i japim jetë të gjatë, e bëjmë të mplaket,
t'i pakësohen fuqia dhe bukuria!"

Ademi ishte model bukurie, engjëjt i patën bërë sexhde atij. Por pasi ra nga kjo bukuri,

Ademi tha: Ajme, rashë nga qenia në mosqenie. Zoti i tha: Faji yt është ky: ke jetuar shumë!

Xhebraili e kapi për flokësh dhe i tha të dilte nga grupi i të bukurve dhe nga ai xhennet.

Ademi i tha: "Pas asaj lartësie, ç'është kjo rënie poshtë? Xhebraili i tha: Ai ishte favor, kurse ky është persekutim!

Ademi i tha: O Xhebrail, pata bërë sexhde me gjithë zemër e me gjithë shpirt. Tani pse më nxjerr nga xhenneti?

Ashtu siç derdhen gjethet e pemëve në vjeshtë, edhe mua më fluturojnë nga trupi këto rroba të bukura për shkak të një vënieje në provë.

Fytyra me shkëlqim prej hëne, në pleqëri kthehet në kurriz zhapiu.

Ato flokë e ajo kokë që shkëlqejnë në rini, kur vjen pleqëria prishen për dreq, flokët derdhen, koka bëhet tullë!

Shtati që lëkundet me naze e përkëdheli dhe është i drejtë si heshtë, kur vjen pleqëria kërruset dhe bëhet si hark i përkulur.

Fytyra në ngjyrë tulipani i ngjet shafranit. Pasi ka qenë i fuqishëm si luan, burrit i priten fuqitë dhe bëhet i pafuqishëm si grua.

Dikur, në mundjet, e rrëmbente kundërshtarin nën sqetull dhe e hidhte poshtë, kurse tani e mbajnë për sqetullash se nuk mbahet dot vetë!

Kjo është vetëm shenjë ankthi, nishan rrënimi. Secili prej këtyre është ambasador i dërguar nga vdekja!

Komenti i ajetit "Dhe e bëmë atë më të ultin e të ultëve.
Me përjashtim të atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira,
për të cilët ka shpërblim të paprerë e të pafund!"

Por nëse mjeku i një njeriu është drita e Zotit, atij s'i vjen gjë nga sëmundja dhe pleqëria.

Dobësia e tij është si dobësia e të dehurit. Edhe në dobësi ai është i fuqishëm aq sa t'ia kenë zili trimat legjendarë.

Po të vdesë, kockat i mbyten në kënaqësi, e gjithë qenia e tij kridhet nëdritën e haresë.

Kurse njeriu pa dritën e Zotit është si kopshti pa fruta. Vjeshta e kthen atë përmbys.

I mbeten vetëm gjembat e zinj, zverdhet si kashtë, mbetet pa prodhim.

O Zot, ç'gabim bëri ai kopsht që u zhvesh nga ato rroba të bukura?

E pa veten. Vështrimi i vetvetes është një helm vrasës, o person që vihesh në provë, eja në vete!

Ç'faj ka i bukuri, nga dashuria e të cilit qan gjithë bota, që çdokush e largon nga vetja?

Faji i tij është ky: Stolitë dhe zbukurimet i ka të huajtura. Megjithëkëtë, ngrihet të pretendojë se janë të tijat!

Ta marrim atë dhe ta shohë nga afër se lëmi është yni, kurse të bukurit mbledhin kokrrat.

Ta dijë se ajo stoli e zbukurim është i huajtur, është një dritë e diellit të qenies.

Ajo bukuri, fuqi, vlerë dhe aftësi janë nga dielli i bukurisë i cili ka rënë në këtë anë.

Drita e atij dielli, ashtu si yjet, prapë largohet nga këto mure ku ka rënë!

Dhe pasi të ikë drita e diellit, çdo mur mbetet në errësirë të zezë!

Drita në fytyrën e të bukurve e cila e mahnit njeriun, është drita e diellit që bie nga xhami tringjyrësh.

Xhamat ngjyra-ngjyra kështu na e tregojnë neve atë dritë.

Po të mos mbeten xhamat ngjyra-ngjyra, në ato kohë, drita pa ngjyrë të mahnit ty.

Bëjeni zakon ta shihni dritën pa xham, në mënyrë që, kur të thyhet xhami, të mos mbeteni të verbër!

Je kënaqur me dijeninë e mësuar e mbajtur mend përmendësh, e ke ndriçuar syrin me dritën e tjetërkujt.

Dhe ajo e rrëmben qiririn e vet nga ty që ta kuptosh se atë dritë e ke marrë hua.

Por po të falenderosh dhe të punosh e përpiqesh, mos u mërzit. Të jep qindra të tjerë si ky.

Por po të mos falenderosh, qaj me lot të përgjakur, sepse ajo bukuri është larguar nga qafiri!

Ata që janë bashkësi e mohimit, kufrit, i kanë punët borxh. Ata që janë bashkësi e besimit, i kanë zemrat të pastërta dhe origjinën, të kulluar.

Nga ai që s'falenderon, humbet edhe bukuria, edhe aftësia, edhe arti. Ai s'sheh më shenjë prej tyre!

Farefisnia dhe dashuria largohen në atë mënyrë që s'të shkojnë më ndërmend.

O mohues! Ajeti "bëmat u kanë shkuar kot" është humbje për secilin që ka arritur një qëllim të caktuar.

Vetëm fitimet e njerëzve të falenderimit e të besës nuk humbasin, sepse fati i mirë është pas tyre!

Fati i ikur dore si do të të japë fuqi? Fuqia dhe forca për njeriun vjen nga fati.

Zbatoje urdhrin "jepni borxh" dhe jep borxh nga ky fat. Në këtë mënyrë, para teje ke për të parë qindra fate!

Pi pak nga kjo gjë që pihet në mënyrë që para vetes të gjesh hauzin e begative!

Si mund të ndodhë që nga personi që derdh një gllënjkë në dheun e besës, të mund të ikë gjahu i fatit të mirë?

Zoti i kënaq zemrat e tyre. "Thelbi i tyre është drejtuar, është kulluar". Zoti u jep të mira atyre edhe pasi t'u kenë humbur të mirat që u ka dhënë!

Dhe thotë: O vdekje, o turk që grabit fshatin, ktheji prapë ç'ke marrë nga këta robtë që falenderojnë!

Vdekja jep, jep, por nuk e pranojnë, sepse janë mbushur me dhuntira nga dhuntitë e zemrës!

Ne jemi sofinj, i hodhëm hirkat. Meqë luajtëm dhe u gëlltitëm, nuk marrim prapë.

Ne fituam mirësi si shpërblim të gjërave që dhamë; nga ne ikën nevoja, ambicja dhe marazi!

Ne dolëm nga uji i kriqur dhe shkatërrues dhe u hodhëm në ujin e kulluar, në burimin e të mirave!

O botë, ato që u ke bërë të tjerëve, janë pabesi, hile, përkëdheli të tepruara!

Dhe thonë: Ne t'i derdhëm mbi kokë të gjitha ato gjëra që fituam si mirësi ndaj gjërave që dhamë, sepse ne jemi burra që kemi hyrë në luftë, që kemi rënë dëshmorë në luftë!

Edhe ti, në këtë mënyrë, dije se Zoti ka rob të tillë trima e zemërfortë

Që ia shkulin mustaqet gënjeshtrës së botës dhe që i ngrenë çadrat përmbi yjësinë e ndihmës!

Këta dëshmorë bëhen përsëpari fitimtarë. Këta të zënë rob marrin përsëri ndihmë.

Pastaj rishfaqen nga e paqena dhe shih të thonë nëse ti nuk je qorr i lindur nëne!

Edhe ti, në këtë mënyrë, dije se në paqenësi ka diej. Ai që quhet diell këtu, është ylli Arusha e madhe atje.

O vëlla, si bëhet e qena në të paqenë? Si futet e kundërta brenda të kundërtës?

Dije fjalën që thotë se "e nxjerr të gjallën nga e vdekura". E paqena është shpresa e adhuruesve!

Bujku me hambarin bosh a nuk gëzohet me të paqenën?

A nuk gëzohet se nga ajo e paqenë do të mbijë fara dhe do të japë prodhim? Po qe se e kupton këtë punë, mendohu!

Edhe ti pret për çdo çast nga e paqena kuptim, kënaqësi, qetësi e mirësi.

Nuk ka leje për ta nxjerrë në shesh këtë të fshehtë. Ndryshe, Ebhazin, një qytet pa vlerë, e sillja në gjendjen e Bagdatit!

Prandaj, e paqena është thesari i artit të Zotit. Prej tij vazhdojnë të vijnë mirësi për çdo çast!

Zoti vazhdon të krijojë pa u ndalur gjëra të pashoqe. Gjëra të pashoqe krijon edhe ai person i cili, megjithëse nuk ka një bazë, një mbështetje, e krijon dhe e nxjerr në shesh të dytën!

Bota e cila duket sikur s'është, por që,
në të vërtetë është,
dhe bota e cila, megjithëse s'është, duket sikur është.

Zoti e tregoi të paqenën të qenë e madhështore, kurse të qenën e shfaqi në formë të paqene.

E mbuloi detin dhe nxori në shesh shkumën; e mbuloi erën dhe të tregoi ty pluhurin.

Dheu ngjitet lart si minare duke u rrotulluar rreth vetes. Si ndodh që dheu të ngjitet në lartësi vetvetiu?

O i sëmurë, dheun e sheh në lartësi, por erën nuk e sheh por e kupton atë me provë.

Ti sheh se si shkuma shkon në çdo anë. Por shkumë nuk mund të ketë pa det!

Shkumën e sheh me anë të shqisave, kurse detin e kupton me provë. Mendimi është i fshehur, kurse thashethemet janë sheshit.

Kurse ne, thënien jo e kemi pandehur për provë të po-së. Paskemi pasur një sy që e pakësh parë jo-në!

Ç'mund të shohë syri i përgjumshëm tjetër veç fantazisë dhe jo-së?

Shkurt, na janë marrë mendtë nga mendjemadhësia dhe ashtu kemi mbetur të hutuar. Ngaqë e vërteta është e fshehtë, ka dalë në shesh fantazia.

Si na e nguli këtë mosqenie para syve? Si ndodhi që e vërteta të na fshihet nga sytë?

Të lumtë, o mjeshtër që bën magjira! Atyre që druheshin prej teje, ujin me llum ua tregove të kulluar!

Para syve të pazarllinjve, magjistarët e masin dhe e presin dritën e hënës dhe marrin para e fitojnë.

Ja, me këtë matje e prerje fitojnë para, kurse nga dora e blerësit edhe para del, edhe copën e blerë e humbet!

Edhe kjo botë është magjistar. Ne bëjmë tregti në të, ne blejmë prej saj dritën e hënës të matur e të prerë!

Si magjistari, ajo shpejt e shpejt mat pesëqind arshin dritë hëne!

Por, o i zënë, a e ke marrë paranë e jetëgjatësisë sate? Edhe paranë e humb, edhe copë plaçke s'të bie në dorë, edhe qesja të mbetet bosh fare!

Po të këndoj ty "kul eudhu...", o Zot i vetëm, ki mirësinë dhe mbromë mua prej këtyre të fryrave, prej këtyre nyjeve të lidhura për magji!

Ato plaka magjistare u fryjnë nyjeve. Tek ti strehohem nga e keqja e tyre, o Zot që u shkon nevojtarëve në ndihmë!

Por, o i shtrenjtë, këtë lutje duhet ta këndosh edhe me gjuhën e punës e të përpjekjeve. Fjala e zbut gjuhën.

Në kohën e sotme për ty ka tre bashkudhëtarë. Njëri është i besës, dy të tjerët, të pamëshirshëm.

Njëri janë miqtë e tu, tjetri është pasuria jote, kurse i treti, punët e mira; ky i treti është besëtari.

Malli nuk vjen bashkë me ty, nga shtëpia, madje, nuk del. Miku të vjen, të vjen, por gjer në kokë të varrit!

Ditën e vdekjes, miku të thotë me gjuhën e qëndrimit të vet:

Jam bashkudhëtari yt gjer këtu, nuk mund të shkoj më tutje. Do të të rri një copë herë në krye të varrit!

Vetëm punët që ke bërë janë të besës. Kapu pas tyre se ato vijnë me ty gjer brenda në varr!

Komenti i hadithit të Mustafait (a.s.):
"Ty të duhet një shok që të varroset bashkë me ty.
Ti varrosesh bashkë me të dhe je i vdekur, kurse ai është i gjallë.
Po qe i mirë, të bën të mira, po qe i keq, të pengon shpëtimin.
Ky shok janë punët që ke bërë.
Përmirësoji punët me sa të të vijë për dore, bëj punë të mira!"
Përfaqësuesi i Zotit ka thënë drejt.

Pejgamberi tha: Për këtë rrugë nuk ka shok e bashkërrugëtar më të besës se puna.

Në e paç punën të mirë, të bëhet shok përjetësisht, por në e paç të keqe, të bëhet gjarpër në varr.

Or babë, si mund të ndodhë që kjo punë në rrugën e së drejtës, ky fitim, të arrihet pa mësues, pa prijës?

Edhe zanati më i thjeshtë në këtë botë, madje, a mund të mësohet pa usta?

Çdo art e prin njohuria, pastaj vjen puna. Në këtë mënyrë, edhe puna jep dobi pas një farë kohe ose pas vdekjes.

O njeri me mend, përpiqu për të fituar zanat duke e mësuar atë nga një person i aftë në atë zanat, bujar dhe i pastër.

O vëlla, margaritarin kërkoje brenda në sedef, po kështu, edhe zanatin dhe artin kërkoji nga zanatçiu dhe artisti!

Sapo t'i shihni këshilluesit, mbahuni pas tyre dhe përpiquni të mësoni prej tyre pa u druajtur!

Po qe se edhe zanatçiu i tabakëve, duke bërë tabakë, vesh një përparëse të ndotur, ajo nuk ia pakëson vlerën dhe aftësinë!

Po qe se hekurpunuesi vishet me një rrobë të vjetër e të grisur kur rreh hekurin, respekti që gëzon ai nga populli nuk i pakësohet!

Atëherë, nxirre nga trupi rrobën e mendjemadhësisë dhe, për të mësuar e mbajtur përmendësh diçka, vishu me një rrobë të pavlerë!

Fjalët janë rruga për t'u bërë zotërues njohurish. Përdore rrugën e mësimit të artit dhe zanatit!

Po deshe mosqenie, ajo bëhet me takim dhe bisedim. Në këtë punë s'të vlejnë as gjuha, as dora!

Shpirti e mëson dijen e mosqenies nga një shpirt tjetër. Kjo njohuri s'mësohet as nga defteri, as nga gjuha!

Po qe se ajo shenjë ndodhet në zemrën e udhëtarit dhe ai thotë se i njeh shenjat, do të thotë se ende nuk i di shenjat!

Po qe se zemra e udhëtarit hapet e ndriçohet, atëherë Zoti i thotë: "A s'ta hapëm gjoksin, a s'të qetësuam?"

Ta hapëm trupin, ta lehtësuam gjoksin.

Kurse ti ende e kërkon atë nga jashtë. Ti je vendi ku milet qumësht dhe ti pret që të tjerët të mjelin qumësht.

Tek ti është një burim qumështi pa breg e pa anë. Pse kërkon ti qumësht në calik?

O ti që tërheq ujë, ti ke një vrimë, një rrugë në det. Të kesh turp që tërheq ujë nga pusi!

Siç bëhet e ditur në ajetin "elem neshrah", a nuk t'u hap gjoksi ty? Atëherë, pse mërzitesh, pse kërkon të të hapet prapë?

Shih hapjen dhe lehtësimin e gjoksit tënd brenda teje që të mos pësosh qortimin e ajetit "ata nuk i shohin provat e Zotit në veten e tyre"!

Tefsiri i ajetit
"Ai është bashkë me ju!"

Mbi kokë ke një sepet plot me bukë, kurse ti ende vrapon andej-këndej duke kërkuar bukë!

Mos je turbulluar, apo çfarë? Shih rreth vetes. Pse troket në çdo derë? Ec, trokit në derën e zemrës!

Ke hyrë në përrua gjer në gjunjë dhe s'di gjë për veten, prandaj i kërkon ujë këtij e atij!

Ke edhe para, edhe pas ujë që do të të vinte në ndihmë ty, por për të arritur gjer te burimet, ke prita edhe para, edhe pas!

Ke hipur në kalë, kurse kalorësi kërkon kalin. Ç'është kjo? Ai thotë: Nëse thuhet kalë, ku është kali?

Hej, more, hej! Ç'është ky kali që ke nën vete? Mirë, po kush e pa atë?

Sarhosh uji, kurse ujin e ka para syve. Vetë është brenda ujit, por nuk di gjë fare për ujëvarën!

Si puna e margaritarit. Edhe margaritari është brenda në det, po deti, ku është? Muri i tij është imagjinata si sedefi i margaritarit!

Thënia "ku?" i bëhet mbulesë vetes, bëhet një re që e vesh dritën e diellit!

Syri i keq i tij i bëhet perde syrit të tij. Thënia e tij se e ngriti pritën i bëhet pritë atij.

Mendja i bëhet shtupë veshit. O i hutuar i Zotit, jepja mendjen Zotit!

Komenti i hadithit të Mustafait (a.s.):
Atë që i bën të gjitha vuajtjet një vuajtje, Zoti e shpëton nga vuajtjet e tjera. Por atë që i shpërndan vuajtjet e veta, që vuan për shumë gjëra, kudo që të shkatërrohet, Zoti s'e shpëton!"

E shpërndave mendjen në shumë vende. Mirëpo ajo përpjekja jote pa kuptim nuk vlen një qime!

Po qe se lëngun e mendjes ta tërheq çdo gjemb, si do të mund të arrijë ai lëng te frutat?

Eja në vete dhe prej atë degë të keqe, krasite. Ujite këtë degë të mirë dhe bëje të gjallërohet!

Tani të dyja janë të gjelbra, por shihu fundin. Në fund, kjo s'do t'i vlejë asgjëje, kurse tjetra do të japë fruta.

Uji i kopshtit është hallall për këtë dhe haram për atë. Ndryshimin mes tyre e sheh në fund!

Ç'është drejtësia? T'u japësh ujë pemëve. Ç'është padrejtësia? Ta ujitësh gjembin!

Drejtësi është ta vësh një të mirë në vendin e vet, jo të ujitësh çdo rrënjë që tërheq ujë!

Ç'është padrejtësia? Të mos ta përdorësh një gjë në vendin e vet, ta vësh atje ku s'e ka vendin. Dhe kjo bëhet burim vetëm për ngatërresa e kokëçarje.

Të mirën e Zotit jepja shpirtit, mendjes, jo natyrës me shqetësime të brendshme, të mbushur plot me nyje dhe shqetësime!

Trupit ngarkoja luftën e vuajtjes së kësaj bote duke ia dhënë pak ta shijojë atë agoni zemrës, shpirtit!

Dengun e barrës ia ka vënë në kokë Isait, kurse gomarin që hedh shqelma dhe shtrihet përtokë e lëshon të lirë në çajire.

Nuk i heqin syrme veshit! Nuk është kusht ta kërkosh nga kurmi punën e zemrës!

Nëse je zemër, ec, bëj ledhe, mos hiq keq; nëse je kurm, mos ha sheqer, por shijo helm!

Helmi është i dobishëm për kurmin, kurse sheqeri, i dëmshëm. Eshtë më mirë që kurmi të mos marrë ndihmë!

Kurmi është dru zjarri për xhehennemin, pra, pakësoje atë; po të mbijë edhe një dru tjetër, preje menjëherë!

Ndryshe, në të dy botët bëhesh drubartës si gruaja e Ebu Xhehlit, drubartës!

Dalloje degën e bimës së lotusit nga druri i zakonshëm; që të dy janë të gjelbër, o trim, por nuk janë e njëjta gjë!

Esenca e asaj dege është qielli i shtatë.

Kurse esenca e këtij druri është zjarri dhe tymi.

Për nga ndjenja, i ngjajnë njëri-tjetrit, sepse vetia e syrit dhe ndjenjës është shikimi gabim.

Përpiqu e lodhu për të arritur në zemrën që i duket këtij syri të shpirtit!

Po s'pate këmbë, rrokullisu dhe, më në fund, shihi çdo të paktë e çdo të shumtë!

Kuptimi i këtij dyvargshi:
"Në qofsh në rrugë, në qofsh rrugëtar, të hapin rrugë.
/
Në u bëfsh i paqenë, të drejtojnë qenie!"

Zelihaja i mbylli dyert nga të gjitha anët, por te Jusufi nuk u pa asnjë lëvizje!

Dryni dhe dera u hapën prapë, rruga u pa, sepse Jusufi ishte mbështetur te Zoti, ai mund të lëvizte nga çdo anë!

Edhe në botë nuk duket ndonjë e çarë, por duhet vrapuar nga të gjitha anët i mahnitur si Jusufi.

Që dryni të hapet, dera të duket dhe mungesa e hapësirës të bëhet vend për ju!

O njeri që je vënë në provë, erdhe në këtë botë, por a nuk e sheh fare rrugën nga ke ardhur?

Ti erdhe nga një vend. A e di rrugën nga ke ardhur? Jo?

Meqë nuk e di, mos thuaj se s'ka rrugë. Nga kjo rrugë pa rrugë na duket neve ikja.

Në ëndërr ti shkon majtas e djathtas i gëzuar. A e di se ku është rruga e atij sheshi?

Ti mbylli sytë, dorëzoje veten që ta shohësh veten në atë qytet të vjetër!

Por si mund t'i mbyllësh sytë kur qindra sy të përgjumur të rrëmbejnë ty prej teje ende pa i mbyllur sytë!

Ti i ke hapur sytë e i ke bërë katër me pasionin për një myshteri dhe je dhënë pas shpresës për t'u bërë i madh, për t'u bërë krye!

Edhe sikur të flesh, e sheh në ëndërr myshteriun. A sheh gjë tjetër në ëndërr veç rrënojave korbi i keq?

Çdo çast e kërkon myshteriun duke u përdredhur. Por çfarë ke që ta shesësh? Ti s'ke asgjë, asgjë!

Po të të ndodhej në zemër një bukë, një gjellë sille, s'do t'ua vije veshin, madje, blerësve!

Personit që pretendon për profetësi, i thonë:
"Ç'ke ngrënë që je budallallepsur kështu, që flet marrëzira?"
Ai u përgjigjet:
"Po të kisha gjetur gjë për të ngrënë, as budallallepsesha, as flisja marrëzira!"
Çdo fjale të mirë, po iu tha dikujt që s'e kupton, i thonë marrëzi,
madje, edhe sikur ai që e thotë, të jetë i ngarkuar me detyrë për ta thënë atë fjalë!

Njëri thoshte: Unë jam pejgamber mbi të gjithë pejgamberët!

E lidhën për qafe, e çuan te padishahu dhe i thanë: Ky thotë se është i dërguar i Zotit!

Populli e kishte sulmuar dhe i qe mblidhur mbi kokë si milingona dhe karkalecë, duke i thënë: Ç'është ky mashtrim, kjo gjë e keqe?

Po qe se ka ardhur nga bota e mosqenies si i dërguar, edhe ne të gjithë jemi të dërguar, të lartë!

Edhe ne skemi ardhur që atje të vetëm, ç'është ky pejgamberllëk i posaçëm vetëm për ty?

Edhe ju të tjerët, a nuk keni ardhur si një fëmijë që fle, pa ditur gjë për rrugën dhe ndalesat e saj?

Ju kaluat nëpër stacione në gjumë dhe të dehur. Nuk dinit asgjë për rrugën, për lartë e për poshtë!

Kurse ne ecëm të zgjuar dhe të kënaqur nga përtej botës së pesë shqisave dhe gjashtë anëve gjer në botën e pesë shqisave dhe gjashtë anëve!

Kallauzi ynë kishte dijeni, e dinte rrugën.

Prandaj i pamë bazën dhe themelin e vendqëndrimeve.

Dhe thanë padishahut: Fute në tortura atë që është ngritur të pretendojë për pejgamberllëk që të mos i thotë edhe një herë këto fjalë!

Padishahu e pa atë shumë të dobët e të lëshuar. Sikur një shpullë t'i jepej, do të vdiste në çast!

A kishte mundësi të rrihej e të torturohej ai? Trupi i tij pothuaj ishte kthyer në qelq!

Padishahu mendoi t'i fliste me të mirë se pse i kishte hyrë kësaj çështjeje të marrë.

Ashpërsia e sjelljes nuk bënte punë këtu. Gjuha e ëmbël e nxjerr edhe gjarpërin nga vrima!

Ai i largoi njerëzit e mbledhur rreth tij. Padishahu ishte burrë i mirë.

E uli njeriun diku dhe e pyeti nga ishte e ku banonte. E pyeti se me ç'merrej e si përshkohej.

Njeriu i tha: Jam nga Darusselami, prej atje dola në rrugë dhe rashë në këtë vend ku të shajnë e të poshtërojnë.

As shtëpi kam, as njeri që të bjerë e të ngrihet bashkë me mua. A mund të këtë hëna shtëpi në tokë?

Duke i folur me humor, padishahu e pyeti: Ç'ke ngrënë, ç'ke si ushqim për sillë?

A ke oreks? Ç'hëngre në mëngjes që ke ardhur kështu si i dehur dhe flet kodra pas bregu?

Njeriu i tha: Po të kisha bukë të freskët a të thatë, a do të ngrihesha për çështjen e pejgamberllëkut?

T'i bësh pejgamberllëk këtij kallaballëku i ngjet kërkimit të zemrës nga mali!

Askush nuk kërkon nga mali dhe gurët mendje dhe zemër, s'kërkon mençuri dhe zgjuarsinë se mësimit të gjërave të vështira.

Ç'të thuash ti, edhe mali ta kthen menjëherë atë gjë; si tallësit, tallet me ty!

Ç'është ky popull e ç'është t'i japësh lajm këtij populli! Kush kërkon shpirt nga një gjë pa shpirt?

Po u tregove për një femër ose për para, të gjithë t'i vënë para mallin dhe shpirtin.

Po t'u thuash se diku i thërret një djalë i bukur që është bërë ashik pas tyre, këtë e kuptojnë.

Por po t'u japësh lajm të pastër nga Zoti e po t'i ftosh të gjithë t'i japin besën Zotit,

T'u thuash të heqin dorë nga kjo botë e vdekur e të shkojnë në botën e ushqimit dhe fitimit, se, meqë është mundësia për t'u bërë i përjetshëm, pse t'i kështillosh për të mbetur të vdekshëm e të përkohshëm,

Të kërkojnë kokën dhe gjakun. Por jo për fanatizëm fetar dhe aftësie!

Shkaku që njerëzit u bëhen armiq velinjve, njerëzve të urtë e të afërt të Zotit, të cilët i ftojnë njerëzit te Zoti dhe te jeta e pasosur, si dhe shkaku që njerëzit jetojnë si të huaj me ta.

Madje, për shkak se janë kapur pas mallit e pasurisë, dëgjimi i këtyre fjalëve u vjen i hidhur.

Po qe se plagës së gomarit i lidh një leckë dhe ajo leckë i ngjitet në plagë dhe, pastaj, po deshe ta heqësh atë leckë,

Gomari fillon menjëherë të hedhë shqelma me të katër këmbët! Ç'lumturi për atë njeri që s'i futet kësaj pune!

Pa le sikur gomari të ketë pesëdhjetë plagë dhe pesëdhjetë lecka të ngjitura në plagë, eja ti e parashikoje se ç'mund të bëjë!

Malli e pasuria janë si copa e leckës, kurse ambicja për to, si plaga. Kush të ketë amicje me të tepërt, edhe plagë ka me të tepërt!

Malli e pasuria e korbit është vetëm rrënoja. Ai as që do të dëgjojë për qytetet e Tabesit dhe Bagdatit!

Kur skifteri i padishahut vjen nga rruga te korbat, u çon atyre qindra lajme nga padishahu.

Dhe u tregon atyre për qendrën e sulltanatit, kopshtet dhe vreshtat e atjeshme, lumenjtë e përrenjtë. Ua tregon, por për të mjerohen qindra armiq

Që thonë: Skifteri po na tregon përralla të vjetra, rri e prallis budallallëqe!

Kurse janë ata që me të vërtetë janë vjetëruar, që janë kalbur përjetësisht, kurse fryma e tij e rinon të vjetrën!

Të vdekurve të vjetër u jep shpirt, u vë në kokë kurorën e arsyes, u fal dritën e besimit!

Mos e kurse shpirtin për të bukurin që dhuron shpirt. Ai po të hip ty mbi kalë të bardhë!

Mos e largo kokën nga ai trim me kokë të lartë i cili jep kurora. Ai zgjidh qindra nyje në këmbën e zemrës!

Por kujt t'i flas? Ku ka një të gjallë mes tërë një fshati? Kush vrapon nga ana ku ndodhet eliksiri?

Sapo të shohësh një gjë të ulët, ti ikën menjëherë nga ashku. Po ku di gjë ti për ashkun veçse për emrin e tij?

Ashku ka qindra ledhe, paraqitje, cilësi të larta! Ashku mund të arrihet me qindra ledhe!

Meqë është vetë besëtar, ashku e blen atë që është besëtar. Ai as që i hedh vështrimin njeriut të pabesë!

Njeriu i përngjet pemës, kurse fjala e tij e dhënë, rrënjëve. Duhet punuar për përmirësimin dhe forcimin e rrënjëve!

Fjala e me rregull të prishur është rrënjë e kalbur. Pema me rrënjë të kalbura nuk jep fruta.

Edhe sikur t'i ketë degët dhe gjethet të jeshilta, më në fund, një ditë prej ditësh, qindra gjethe të përshëndesin me dorë!

Mos u kreno me diturinë tënde, por shih ta plotësosh fjalën. Sepse njohuria i ngjet lëvozhgës, kurse fjala e dhënë është buka e saj!

Njeriu punëkeq, po nguli këmbë në të keqe dhe, ndërkaq,
po e pa lumturinë e arritur nga njerëzit punëmirë,
bëhet shejtan, nga zilia, përpiqet ta pengojë të mirën.
Si shejtan!
Ai që i digjet prodhimi, kërkon që t'u digjet të gjithëve!
"A s'e ke parë njeriun që fal namaz, që përpiqet ta pengojë faljen e namazit?"

Sapo të shohësh se njerëzit e besës kanë përfituar, ti, si shejtani, i ke zili!

Personi me natyrë dhe karakter të prishur nuk ia do të mirën askujt.

Po s'ishe ziliqar si shejtani, lëre portën e davasë dhe eja në portën e besës.

Meqë nuk ke besë, të paktën mos fol me vete! Sepse fjalët e shumta janë çështje egoizmi që nisen nga "unë" e nga "ne"!

Kjo fjalë është një fjalë që e zhvillon zemrën. Duke heshtur, zemra arrin qindra zhvillime!

Sapo që gjëja e brendshme del në majë të gjuhës, shpenzohet e shkon. Mos sshpenzo shumë që gjëja e mirë e brendshme të mbesë!

Te njeriu që flet pak ka një mendim të thellë. Po u shtua lëvozhga e thënies, e brendshmja asgjësohet.

Po u bë lëvozhga e trashë, e brendshmja zvogëlohet, dobësohet. Po u poq e brendshmja, buka, dhe u zbukurua, po u rrit e u shtua, lëvozhga hollohet.

Pa shihi këto tre fruta që shpëtojnë nga papjekuria e jeshiltë dhe piqen e bëhen për t'u ngrënë: arra, bajamja dhe lajthia!

Kush kundërshton, bëhet shejtan dhe ndjen zili për mirëqenien e të mirëve!

Po qe se ia mban besën fjalës që i ke dhënë Zotit, edhe Zoti, me bujarinë e tij, ta mbron fjalën.

Kurse ti i ke mbyllur sytë ndaj besës së dhënë Zotit. A nuk e ke dëgjuar ajetin që thotë "kujtomëni që t'ju kujtoj"?

Vërja veshin "Mbajeni fjalën që më keni dhënë", që nga i dashuri të të vijë fjala "T'i tregoj besë fjalës suaj"!

O njeri i dëshpëruar, ç'është fjala që kemi dhënë ne dhe borxhi që japim ne? Si mbjellja e farës në tokë të thatë.

Prej saj as vendit i vjen ndonjë shkëlqim, as pronari i vendit pasurohet.

Kjo do të thotë se ti je që ma jep thelbin e kësaj nga bota e mosqenies, se kjo është një shenjë për të treguar se unë kam nevojë për këtë!

Do të thotë "hëngra dhe e solla farën si shenjë, pra na fal prapë neve nga kjo e mirë"!

Atëherë, o njeri me fat, lëre lutjen e thatë! Kush kërkon pemë, mbjell farë!

Po të mos kesh farë, Zoti prapë, për shkak të asaj lutjeje, të fal një fidan që ata që shohin, të thonë: Sa mirë ka punuar dhe sa fidan të bukur që ka nxjerrë!

Si Merjemja! Kishte hall, por s'kishte farë. Për shkak të këtij halli, Zoti artist e bleroi atë drurin e thatë të hurmës!

Sepse ajo grua e pastër dhe e lartë, ishte e besës. Prandaj Zoti ia plotësoi qindra qëllime pa ia kërkuar ajo.

Populli besëtar e ka përhapur këtë besë në të gjithë botën.

Edhe detet u janë përshtatur urdhrave të tyre, edhe malet. Katër elementët, madje, u janë bërë atyre skllevër.

Kjo është një dhuratë e Zotit që mohuesit ta shohin hapur dhe të besojnë.

Ata kanë merituar dhurata dhe mirësi të fshehura, të tilla që as mendja t'i merr, as fjala t'i shpreh!

Fundja, puna është te dhurata dhe mirësia e përjetshme, që nuk ndërpritet, që nuk ka mundësi të konsumohet!

Lutje.

O Zot, që dhuron ushqim, maturi dhe vendosmëri, shpëtoje popullin nga kjo pavendosmëri!

Ndihmoje dhe drejtoje këtë nefs të kërrusur më dysh kur duhet të jetë i drejtë e i palëkundur!

Jepu durim atyre, bëj që t'u rëndohet ana e mirë e kandarit të tyre, shpëtoji ata nga mashtrimi i atyre që sajojnë trajta!

O zotërues i bujarisë, largoji ata nga zilia që të mos bëhen shejtanë të gjuajtur me gurë për shkak të zilisë!

Populli digjet nga zilia në synim të mallit dhe kurmit të përkohshëm.

Pa shih padishahët! Për shkak të zilisë, ngrenë ushtri dhe vrasin të afërmit!

Ashikët mashtrues të mbushur në ndyrësi, synojnë t'i derdhin gjakun e t'i marrin jetën njëri-tjetrit.

Këndo historitë e Vises, Ramiut, Husrevit, Shirinit dhe shih se ç'kanë bërë ata kokëtrashë për shkak të zilisë!

Edhe i dashuri u asgjësua, edhe i dashuruari. Fundja as ata ishin ndonjë gjë, as dashuritë dhe pasionet e tyre!

Eshtë ai Zot i pastër që e bën të paqenin të dashur të të paqenit, që i përplas mosqeniet me njëra-tjetrën e që nxjerr punë prej tyre!

Në zemrën e asbhikut me zemër të rrënuar, ngrenë krye zilitë. I qeni e fut të paqenin në këto lloj vështirësish, kështu e lë të detyruar.

A s'janë këto gratë më të mëshirshme se kushdo dhe falëse? Megjithëkëtë, dy ortakë e hanë njëri-tjetrin nga zilia!

Mendo meshkujt zemërgurë dhe mendo se në ç'gjendje bien ata për shkak të zilisë!

Po pe se sheriati nuk do të këndonte një magji të hollë, çdokush do të shqyente trupin e armikut, do t'ia bënte copë-copë!

Sheriati përdor një mendim për ta larguar të keqen dhe e burgos shejtanin në shishen e provës.

Shejtanin grykës e hesht me dëshmi, me betim, me kthim nga fjala e dhënë dhe, në këtë mënyrë, shejtani hyn në shishe!

Sheriati i ngjet një peshoreje që i kënaq dy të kundërta. Ai i bën bashkë talljen me seriozitetin!

Dije se sheriati i ngjet peshores. Me pretekstin e tij, dy armiq shpëtojnë nga lufta dhe urrejtja.

Po të mos ishte peshorja, si do të mund ta imagjinonte ai armik se kishte bërë dëm, ishte mashtruar?

Prandaj, në këtë botë të fëlliqur, çfarëdo që të ketë, është e gjitha zili, armiqësi, mundim.

Kur bota është kështu, mendo se si bien në zili njerëzit dhe xhindet për të shtënë në dorë pushtet dhe përparim!

Fundja, ata shejtanë janë ziliqarët e vjetër! Ata s'bëjnë dot asnjë çast, madje, pa ngritur pritë në rrugë!

Edhe të bijtë e Ademit të cilët mbollën farën e kundërshtimit dhe revoltës, për shkak të zilisë janë bërë shejtanë!

Lexo Kur'an dhe shih. Edhe shejtanët e njerëzve, me goditjen e Zotit, janë bërë të llojit të shejtanit!

Sapo që shejtani mbetet i paaftë për ta bindur ndokënd, nga këta njerëz kërkon ndihmë!

U thotë: Ju jeni miq, jeni nga tanët që janë miqtë tanë, pra, mbani anën tonë!

Sapo që në këtë botë t'i presin rrugën dikujt, ta tërbojnë dhe nxjerrin nga rruga dikë, shejtanët që janë dy llojesh, gëzohen.

Sapo që dikush të ketë dhënë shpirt me besim, t'i jetë rritur grada e fesë, dy grupe vihen të bërtasin e të qajnë me të madhe!

Sapo që një i edukuar t'i japë mend dikujt e ta sjellë atë në rrugë të drejtë, dy grupe të tjerë fillojnë të mjerohen e të hanë dhëmbët!

Padishahu e pyet personin që pretendon për profetësi:
"Ç'i fal njeriut ai që është pejgamber i vërtetë?
Ose, ç'mirësi tjetër përveç këshillës me gojë përfitojnë prej tij njerëzit
që takohen me të dhe që i shërbejnë atij?"

Padishahu e pyeti: Pa na thuaj, pra, ç'është vahji ose ç'përfiton ai që është pejgamber?

Njeriu i tha: Çfarë ka që pejgamberi të mos e shtijë në dorë ose ç'mirësi ka që pegamberi të mos e ketë arritur?

Le ta zëmë se vahji që i vjen pejgamberit, nuk është thesari i sekreteve të Zotit, por nuk është as më poshtë se vahji që i vjen bletës!

Me të ardhur ajeti "Zoti i frymëzoi bletës" shtëpia e saj u mbush me ëmbëlsira!

Dhe me vahjin e Zotit të Lartë e mbushi botën me dyllë e me mjaltë!

Kurse unë jam njeri dhe për mua u tha: Ne e lartësuam atë! Njeriu shkon drejt lartësive. Atëherë, si ndodh që vahji që i vjen njeriut të jetë më poshtë se vahji që i vjen bletës?

A nuk e ke lexuar ajetin "Ne ty të dhamë kevther, të gjitha të mirat dhe një brez që nuk shuhet"? Po ta kesh lexuar, pse mbete kështu, si i ngrirë?

Apo mos je faraon që kevtheri të bëhet ty gjak si Nili e fëlliqet, o njeri i fëlliqur?

Bëj pendesë dhe hiq dorë nga armiqtë. Në shtambën e tij nuk ka ujë kevtheri!

Po të shohësh dikë që i është skuqur fytyra nga kevtheri, rri me të e bëhu si ai! Sepse ai është pajisur me shprehitë e Muhammedit!

Vepro kështu dhe quaju ndër ata që "duan për hir të Zotit"! Sepse molla që mbin në pemën e Ahmedit është prej tij.

Po të shohësh dikë me buzë të thara se s'ka pirë nga uji i kevtherit, quaje atë armik si vdekjen dhe ethet!

Edhe sikur të jetë nëna dhe babai yt, ai është, në të vërtetë, një armik që të pi gjakun!

Këtë mësoje nga Halili i Zotit. Ai në fillim u dëshpërua për të atin.

Bëhu i tillë dhe, në fronin e Zotit, futu ndërmjet atyre "që duan për hir të Zotit dhe urrejnë për hir të Zotit" rdhe zelli i ashkut të të mos qortojë ty!

Pa e kënduar fjalën "Nuk ka zot tjetër veç Allahut", ti nuk mund ta gjesh gjurmën e kësaj rruge!

Një ashik i tregon të dashurës shërbimet që i ka kryer, besnikërinë që i ka treguar, netët e gjata pa rënë në shtrat,
dhimbjen dhe dëshirën e vuajtur në ditët e gjata dhe i thotë:
"Unë s'di tjetër ç'të bëj; në pastë gjë tjetër për të bërë, më drejto.
Do të bëj ç'të më urdhërosh, madje, po të duash, do të hidhem në zjarr si Halili (a.s.),
do të hidhem në det në gojë të egërsirës detare si Junusi (a.s.),
do të vdes njëqind herë si Xherxhisi (a.s.) nëse duhet,
do të bëhem qorr nga e qara si Shuajbi (a.s.)...
Eshtë e pamundur të numërohen flijimet e pejgamberëve!
E dashura i përgjigjet.

Një ashik i numëronte në prani të saj një e nga një punët që kishte bërë. Ai thoshte:

Për ty i bërë këtë e atë. Në aksh fushë lufte u bëra shenjë për shigjetat.

Malli më iku, fuqia më iku, nderi më iku. Nga dashuria për ty pësova shumë gjëra të padëshiruara.

Asnjë mëngjes s'më gjeti në gjumë ose të qeshur. Asnjë mbrëmje s'më gjeti në rregull.

Dhe, kështu, ai i numëronte një e nga një e hollësisht ç'gjëra të turbullta e të kulluara kishte pirë.

Ia numëronte këto të dashurës jo për mirënjohje, por si prova të dashurisë së tij.

Për ata që kanë mend, një shenjë mjafton. Se, kur mbaron etja e dashnorëve për të dashurat?

E përsërisin fjalën pa u mërzitur. A ngopet peshku me ujë të kulluar vetëm me një shenjë?

Duke iu ankuar vetes se ka harruar t'i thotë një fjalë, i përsëriste qindra fjalë për atë hall të kaluar!

Tek ai kishte një zjarr, por nuk e dinte ç'ishte. Vetëm se qante pa pushim si qiriu nga nxehtësia e tij.

E dashura i tha: E drejtë, të gjitha këto i bëre, por hapi veshët mirë e dëgjo.

Eshtë një gjë që është thelbi i dashurisë, që s'e ke bërë, kurse të gjitha këto janë gjëra të dyta.

Ashiku e pyeti menjëherë: Thuaje, ç'është ajo gjë thelbësore? E dashura i tha: Të vdesësh e të bëhesh hiç!

Të gjitha i bëre, por akoma je gjallë! Po qe se je ashik që luan me shpirtin, vdis menjëherë!

Ashiku u shtri në çast dhe dha shpirt! Luajti, si trëndafili, me kokën e tij dhe vdiq duke buzëqeshur si trëndafili, i gëzuar!

Ajo buzëqeshje mbeti e përjetshme te ai, si mendja dhe shpirti i arifit që nuk pësojnë mundim!

A fëlliqet drita e hënës pse bie mbi çdo të mirë e të keq?

Ajo rikthehet krejt e pastër ashtu siç rikthehet te Zoti drita e mendjes dhe shpirtit.

Edhe sikur të takojë ndyrësi gjatë rrugës, drita e hënës mbetet gjithmonë e pastër.

Ajo nuk ndyhet nga ndyrësitë dhe fëlliqësitë e rrugës.

Drita e diellit ka dëgjuar urdhrin "kthehu pas" dhe me shpejtësi është kthyer në origjinë.

As është fëlliqur në vatrat e hirit, as ka marrë aromën e trëndafilishteve!

Drita e syrit dhe personi që ka parë dritë, janë kthyer në origjinë, kurse dashuria i ka mbetur në fusha e shkretëtira!

Njëri pyeti një dijetar fetar:
"Po qe se dikush qan dhe rënkon me zë në namaz, a i prishet namazi?"
Dijetari iu përgjigj: "Në fillim duhet parë pse u derdh ai lot, çfarë pa, pse qau.
Po qe se ka qarë nga dëshira për Zotin ose ka rënkuar nga pendesa për mëkatet,
namazi nuk i prishet, por i bëhet më i përkryer, sepse është thënë se
"namazi pa praninë e zemrës s'është namaz".
Por në qoftë se ka qarë nga një sëmundje trupore ose nga ndarja me të birin,
namazi i prishet, sepse baza e namazit është braktisja e trupit, e djalit
dhe, si Ibrahimi, bërja kurban e djalit dhe hedhja në zjarrin e Nemrudit.
Për t'u pajisur me këto shprehi, edhe Mustafait (a.s.) i pati ardhur urdhri:
"Zbatoje sheriatin e Ibrahimit"
dhe "Te Ibrahimi ka për ju shprehi dhe cilësi që duhen ndjekur!"

Dikush e pyeti fshehurazi myftiun: Po qe se dikush qan e ngashërehet në namaz,

A i prishet namazi, apo jo? A lejohet qarja në namaz?

Myftiu i tha: Pse rrodhën ata lot? Ç'pa personi, pse qau? Kjo duhet parë në fillim.

Ç'gjë të fshehtë pa, vallë, dhe i rodhi ajo çezmë lotësh?

Po qe se personi ka parë botën tjetër, namazi i bëhet më i pëlqyeshëm e më i pranueshëm me atë të qarë.

Por nëse ajo e qarë ka qenë nga mundimi i trupit, do të thotë se edhe peri është këputur, edhe gjilpëra është thyer!

Një myrit shkoi te shehu.
- Ky sheh që konsiderohej pir, domethënë, plak, nuk ishte plak nga mosha,
por nga mendja, përvoja dhe intuita njohëse e Zotit.
Edhe Isai (a.s.) ishte fëmijë në djep, Jahja (a.s.) shkonte në shkollën e fëmijëve,
por të dy ishin pir, pejgamber. –
Myriti e gjeti shehun e vet duke qarë. Edhe ai bëri si ai dhe nisi të qajë.
Kur mbaroi punë dhe doli jashtë, një myrit tjetër që e njihte mirë shehun,
vrapoi pas myritit të ardhur, e zuri dhe i tha:
"O vëlla, dëgjo të të them: Shehu qante për hir të Zotit, por ti mos thuaj se edhe ti ke qarë.
Duhet të heqësh tridhjetë vjet përkorësi, të kapërcesh rreziqe,
të kapërcesh detet plot me kuçedra dhe malet e lartë plot me luanë e tigra
që të fitosh të drejtën për të qarë si shehu;
megjithëkëtë, mund edhe të mos e fitosh këtë të drejtë.
Po të mundesh të arrish në atë pozitë, duhet të falenderosh duke thënë:
"Mua m'u tregua toka!"

Një myrit shkoi te piri i vet. Piri po qante me ngashërime.

Kur e pa shehun e vet që po qante, edhe ai u vu të qante dhe nga sytë nisën t'i derdheshin lot.

Kujt i dëgjojnë veshët, nëse një mik i bën humor një miku të vet, qesh një herë, kurse shurdhi, dy herë.

E qeshura e parë është imitim i qeshjes së popullit që e sheh.

Edhe ai qesh si ta por pa kuptuar gjë pse qeshin.

Prandaj i pyet pse qeshin dhe, kur e kupton, fillon të qeshë përsëdyti.

Edhe imituesi , me gëzimin e vet, i ngjan krejt të shurdhit.

Bie drita e shehut, reflektohet natyra e tij dhe myritëve u vjen frymëzim e gëzim. Prandaj, kjo begati nuk është e vetë myritëve, por e shehut.

Kjo situatë i ngjan dritës që bie mbi shportën që rri mbi ujë e mbi xham. Po qe se ato e njohin këtë ndriçim nga vetja, gabohen, kjo është mangësi e tyre!

Kur kryeneçin e nxjerrin nga lumi, e kupton se lagështirën e ka nga lumi e jo nga vetja!

Edhe xhami, pas perëndimit të hënës, e kupton se ajo dritë ka qenë drita e hënës!

Kur urdhri "ngrihu" ia hap sytë, qesh për të dytën herë si mëngjes.

Këtë radhë i vjen për të qeshur për të qeshurën në atë botën e imitimit, pra qesh ëmbël e ëmbël.

Dhe thotë: Erdha nga rrugë mjaft të gjata e të largëta. Por e vërteta qenka gjithë po ajo e vërtetë, të fshehtat, gjithë po ato të fshehta!

Në atë shesh unë gëzohesha larg nga vetja ime, thurja iluzione nga verbëria dhe papjekuria ime,

Mirëpo ç'shpresova e ç'më doli! Kuptimi i shtrembër më paskësh treguar trajta të shtrembra e të gabuara!

A ka mendim prej burri te fëmija që hiqet këmbadoras në rrugë? Ku është imagjinata e tij, ku e vërteta e vërtetë?

Mendimet e fëmijëve janë ose dado, ose qumësht. Ose rrush i thatë, ose arrë, ose bërtitje dhe qarje!

Edhe imituesi i ngjet një fëmije me të tilla mangësira. Ua hyn temave të holla, sjell prova e argumente, por mos ia vër veshin!

Ai thellim në gjetjen e provave dhe argumenteve, në kryerjen e punëve të vështira, ia pengon atij tejpamësinë.

E ka lënë të vërtetën që është bojë mbi të fshehtën dhe ia ka hyrë thënies së gjërave të vështira.

O imitues, kthehu nga Buharaja dhe ec drejt thjeshtësisë, se vetëm kështu mund të bëhesh një trim luan!

Më në fund, brenda vetes sheh një Buhara tjetër që edhe trimat që çajnë radhët e armikut, madje, në kuvendin e saj e kanë humbur veten dhe s'kanë kuptuar gjë.

Ç'është e vërteta, çaushi ecën shpejt e me shkathtësi mbi tokë, por kur arrin në det, i këputet damari!

Në tokë ai vetëm të fshehtën "i ngarkuam ato" njeh. Burrë i vërtetë është ai që i ngarkon barrët në det!

Vrapo, o njeri i dhënë pas fantazisë dhe trajtës, edhe padishahu ka shumë të mira e favore!

Edhe ai myriti i pafajshëm e naiv bëri sipas atij shenjtori dhe u vu të qajë për imitim!

Edhe ai imitues, si shurdhi, pa atë që qan dhe filloi të qante pa ditur gjë për shkakun.

Dhe pasi qau gjatë e doli jashtë, iu vu pas dhe e arriti një myrit tjetër i zellshëm e i devotshëm.

Dhe i tha: O ti që qan pa ditur gjë, si reja, që, duke imituar qarjen e shehut i cili e bën njeriun njeri vetëm me shikim, vihesh të qash pa ditur gjë prej gjëje!

O myrit besëtar, eja në vete, për hir të Zotit! Ç'është e vërteta, edhe nga imitimi ke dobi,

Por me kusht që të thuash se e pe atë padishah duke qarë, prandaj qave edhe ti si ai! Sepse kjo fjalë është herezi!

Qarja e mbushur me padituri, imitim dhe pandehmë nuk i ngjan qarjes së personit të besueshëm!

Ti mos e krahaso këtë qarje me atë qarje. Mes këtyre dy qarjeve është një rrugë e gjatë.

Ajo qarje arrihet plot pas tridhjetë vitesh luftë. Mendja nuk arrin dot në atë pozitë!

Mes mendjes dhe atij posti ka njëqind konaqe. Mendja nuk mund ta njohë atë pikëmbërritje, mos pandeh se e njeh.

Qarja e tij nuk është as prej ankthit, as prej lehtësimit. Shpirti e njeh qarjen që është vetë e vërteta!

Nga ajo anë është edhe qarja e tij, edhe qeshja. Ajo ndodhet jashtë gjërave që mund të imagjinojë mendja!

Loti i tij i ngjet syrit. Si mund t'i ngjasë syri që s'sheh syrit që sheh?

Eshtë e pamundur të preket ajo që sheh ai. Ajo as me krahasimin e mendjes dihet, as me rrugët e shqisave!

Sapo që nata ta shohë dritën që larg, ikën. Në këto kushte, si mund ta njohë errësira e natës dritën?

Miza ikën nga era. Atëherë, si mund ta shijojë kënaqësinë e erës?

Po të vijë ai që s'ka fillim, ai që është i pasëm bëhet i kotë. Në këto kushte, si do ta njohë ai që s'ka fillim atë që është i pasëm?

Kur ai që s'ka fillim reflektohet mbi gjënë e pasme, e mahnit atë. Dhe kur ta asgjësojë atë, e ngjyen me bojën e vet.

Po deshe, mund të gjesh qindra të ngjashme. Por për mua nuk ka nevojë, o i varfër!

Se shkronjat "Elif.Lam.Mim." dhe "Ha.Mim." i ngjajnë krejt shkopit të Musait.

Edhe shkronjat, në pamje këtyre shkronjave u ngjajnë, por nuk kanë cilësitë e këtyre.

Shkopi i personit që ka marrë në dorë një shkop për shkak të provës, a shndërrohet në shkop të Musait për të kryer një punë?

Kjo frymë është fryma e Isait, nuk është frymë e ardhur nga çdo erë, nga çdo fryrje që të formohet nga hareja apo ankthi!

Or babush, këto "Elif.Lam.Mim." dhe "Ha.Mim." kanë ardhur nga Zoti, sovrani i njerëzve!

Si do t'u përngjajë këtyre çdo elif dhe lam? Në ke shpirt, mos i shih ato me këtë sy!

Ç'është e vërteta, janë formuar nga shkronjat, madje, u ngjajnë fjalëve të njerëzve të krijuara nga shkronjat e njerëzve.

Edhe Muhammedi është formuar nga mishi dhe lëkura dhe, në këtë specifikë, çdo trup është i llojit të tij.

Ka mish, ka lëkurë, ka kocka. Por a u ngjet këtyre trupave?

Në atë sintezë janë shfaqur mrekulli të tilla, që të gjitha sintezat e tjera u dorëzuan!

E tillë është edhe sinteza "Ha.Mim." në Kur'an. Eshtë shumë e lartë ajo, kurse sintezat e tjera janë shumë të ulta!

Sepse nga kjo sintezë formohet jetë; çdo gjë e tulatur ringjallet sikur të kishte fryrë briri i ringjalljes!

Me favorin e Zotit, "Ha.Mim.", si shkopi i Musait, bëhet kuçedër, çan dete!

Pamja i ngjet pamjes së fjalëve dhe sintezave të tjera, por buka e rrumbullakët është shumë larg nga hëna e rrumbullakët!

Edhe qarja e tij s'është nga vetja, edhe qeshja, edhe fjala. Të gjitha këto janë vetëm shprehi të Zotit.

Por ngaqë kokëtrashët kapen pas dukjes, gjërat e holla kanë mbetur plotësisht të fshehura prej tyre!

Shkurt, nuk ia kanë arritur dot qëllimit, kanë mbetur nën perde dhe, për shkak të kundërshtimit, ajo gjë e hollë u ka ikur!

Një shërbëtore, siç u kishte mësuar dhisë dhe ariut
lojëra të ndryshme,
i kishte mësuar edhe gomarit të së zonjës të bënte
marrëdhënie me njerëzit;
kështu i jepte mundësi zonjës të kënaqte epshet.
Por, që gomari të mos shkonte larg, para
marrëdhënies i kalonte organit të gomarit një
kungull.
Një radhë, për të mbetur vetë, zonja e dërgoi
shërbëtoren në një vend të largët
dhe hyri vetë në stallën e gomarit dhe menjëherë iu
afrua duke e harruar punën e kungullit.
Prandaj vdiq për faqe të zezë. Kur erdhi shërbëtorja
dhe e pa se ç'kishte ndodhur,
filloi ta vajtonte me këto fjalë:
"Ah, moj shpirtka ime, mos drita e syve të mi, pse e
harrove kungullin?
Mjetin e pe, po kungullin, pse s'e pe?"
Këndoje ajetin që thotë: "Çdo e metë është e
mallkuar",
domethënë, çdo vështrim dhe kuptim i metë është i
mallkuar.
Po të mos ishte kështu, nuk do të tregohej keqardhje
për qorrat dhe syvëngërit.
Megjithëkëtë, për ata tregohet keqardhje, jo mallkim.
Për qorrin nuk ka mundim dhe propozim.
Ky ajet e ka hequr për qorrin edhe propozimin,
edhe mallkimin, edhe qortimin, edhe zemërimin!"

Një shërbëtore, për shkak të epshit të madh që kishte, për shkak të ambicjes së tepruar, e kishte mësuar gomarin ndaj vetes.

Gomari e kishte bërë zakon të hynte në marrëdhënie me të, me njerëzit.

Shërbëtorja mashtruese kishte një kungull. Ajo ia shkonte kungullin veglës së gomarit që gomari t'i afrohej me masë.

Ajo e bënte këtë që, gjatë marrëdhënies, t'i hynte vetëm gjysma e organit të gomarit.

Sepse po t'i hynte e gjithë vegla e gomarit, i copëtoheshin edhe mitra, edhe damarët!

Ndërkaq, gomari dobësohej për ditë. Kurse e zonja e gomarit rrinte duke menduar se pse i dobësohej gomari! Mirëpo kurrsesi s'po e kuptonte si qëndronte puna!

Edhe pse ua kishte treguar nallbanëve dhe i kishte pyetur për shkakun,

Askush nuk shihte dot ndonjë shenjë sëmundjeje, askush nuk e kuptonte dot të fshehtën!

Atëherë, gruaja filloi ta hetojë mirë e mirë këtë punë. Ajo e ndiqte vazhdimisht gjendjen e gomarit dhe përpiqej ta kuptonte shkakun e dobësimit.

Njeriu duhet t'ia kushtojë veten plotësisht një pune, sepse ai që e kërkon mirë një gjë, më në fund e gjen!

Ndërsa po e ndiqte gjendjen e gomarit, ç'të shohë? Shërbëtorja ishte shtrirë nën gomarin.

Këtë e pa nga e çara e derës dhe u çudit shumë!

Ashtu siç bëjnë burrat me gratë, edhe gomari ia kishte hipur shërbëtores dhe po ia bënte mirë e bukur atë punë!

Gruas i hipi zilia! Ajo mendoi: Ky është gomari im, si ndodh kjo gjë? Këtë punë duhet të ma bëjë mua, unë jam më e përshtatshme për këtë!

Gomari e kishte mësuar punën. Pothuajse sofra ishte shtruar dhe qirinjtë ishin ndezur!

Duke bërë sikur nuk ka parë gjë, gruaja trokiti në derë. Dhe i bëri zë kështu: Moj vajzë, gjer kur do të vazhdosh të fshish ahurin?

Me këto fjalë deshte ta fshihte punën, vetëm t'i jepte të kuptonte se kishte ardhur dhe ajo duhej ta hapte derën.

Gruaja heshti para kësaj ngjarjeje, nuk i tha asgjë shërbëtores. E fshehu nga lakmia!

Shërbëtorja i fshehu të gjitha veglat e intrigës dhe e hapi derën.

E kishte thartuar fytyrën, i kishte përlotur sytë dhe i lëpinte buzët duke dashur të thoshte se ishte e agjëruar.

Kishte marrë në dorë një fshesë me bisht të thyer dhe bënte sikur ishte duke e fshirë ahurin që të shtriheshin devetë.

Dhe kur e hapi derën me fshesë në dorë, gruaja tha nën buzë: Hë, moj mjeshtre ti!

E ke thartuar fytyrën, e ke marrë fshesën në dorë, po ky halli i gomarit ç'është?

Gomari që i kishte mbetur puna përgjysmë, ishte i nxehur, kurse vegla i tundej sa andej këndej. I mbante sytë nga dera duke pritur shërbëtoren!

Duke i menduar këto dhe duke e bërë veten sikur s'ka kuptuar gjë,

I tha shërbëtores: Hidhe menjëherë çarçafin, shko në filan shtëpi dhe bëju të fala prej meje.

Pastaj thuaju kështu e ashtu dhe bëj këtë e atë! Nejse, unë po i pres shkurt përrallat e grave.

Kurse ti merre thelbin e asj që dua të të tregoj. Pasi e nisi shërbëtoren,

Gruaja që ishte dehur nga epshi, e mbylli derën menjëherë dhe tha: Oh!

Ja ku mbeta vetëm! Dhe ja ku shpëtova nga ato punët gjysmake të burrave!

Gruaja u gëzua sikur t'i ishin bërë delet një mijë! E kishte humbur fare nga zjarri epshor i gomarit!

Ç'dele? Aty, nën gomar, ishte bërë e urtë si dele! S'ishte për t'u çuditur që ajo kokëtrashë ta poshtëronte veten në atë mënyrë!

Kur epshi e verbon dhe e shurdhon zemrën, e tregon edhe Jusufin e krijuar prej një cope drite, si copë zjarri!

Sa e sa të dehur nga zjarri ka, që kërkojnë zjarr dhe veten e pandehin dritë të vërtetë!

Vetëm robi i Zotit s'është i tillë. Vetëm nëse Zoti e tërheq dikë dhe e sjell në rrugë të drejtë, e kthen fletën nga ana tjetër! Kjo është tjetër gjë!

Ai që është i tillë, e di se ai zjarr është i imagjinuar, e di se ajo fantazmë është e marrë hua në rrugë.

Ambicja i tregon të shëmtuarit të bukur. Nuk ka nga fatkeqësitë e rrugës më të keqe se epshi!

Epshi i ka nxjerrë të këqinj qindramijëra emra të mirë. Qindramijëra burra të mençur e të zgjuar i ka lënë të hutuar!

Nëse epshi, edhe gomarin, madje, e tregon të bukur si Jusufi, si mund ta tregojë vetë Jusufin?

Pa mendo: me magjinë e tij, epshi ta tregon ndyrësinë mjaltë; po sikur t'i hipë inati, si mund ta tregojë mjaltin?

Epshi krijohet nga e ngrëna, prandaj ha pak. Ose ik edhe nga një grua me kurorë!

Po të hash e të pish mirë, epshi të tërheq në haram. Sigurisht, ajo që është marrë duhet shpenzuar.

Në këto kushte, kurora i përngjet "Lahavle"-s. Lexo që epshi të të mos fusë në ngatërresë edhe me gruan e lidhur me kurorë!

Meqë ke ambicje për të ngrënë e për të pirë, merr shpejt një grua e martohu, ndryshe, dije se të vjen macja e ta rrëmbin bishtin e majmë!

Ngarkoja barrën e gurëve gomarit që hedh vickëla, ngarkoje para se të hidhet përpjetë e të të ikë!

S'mund ta dish se ç'mund të bëjë zjarri, prandaj hidhu që atje. Me kaq sa di, mos rri të vish rrotull rreth zjarrit!

Po qe se s'di ta vësh çomlekun në zjarr për të bërë supë, dije se s'mbetet as çomlek, as supë!

Uji duhet të jetë gati dhe ti duhet ta dish gatimin që supa në atë enë të mos derdhet, por të zjejë e të bëhet.

Po s'e dite mjeshtërinë e kovaçit, kur të kalosh pranë vatrës së kovaçit të digjen mjekër e mustaqe!

Gruaja e mbylli derën, e tërhoqi me gëzim gomarin snga vetja dhe ia shijoi ndëshkimin!

E tërhoqi gomarin në mes të ahurit dhe u shtri nën të.

Për t'ia arritur qëllimit, ajo grua idiote ushtri mbi stol siç e kishte parë të shtrirë shërbëtoren.

Gomari e ngriti këmbën dhe ia rrasi veglën. Nga vegla e gomarit gruas iu bë sikur i ra zjarr përbrenda.

Gomari i mësuar ra mbi gruan dhe sapo ia rrasi veglën gjer te topet, gruaja ngordhi.

Nga forca e veglës së gomarit, iu copëtua mëlçia, iu këputën damarët.

Dha shpirt menjëherë pa marrë frymë. Stoli ra mënjanë, ajo mënjanë.

Ahuri u mbush me gjakra, gruaja u përmbys e vdiq. Ishte një vdekje e keqe.

Vdekja e keqe i erdhi bashkë me qindra turpe, o babush! A ke parë ti ndonjë njeri të bjerë dëshmor nga vegla e gomarit?

Dëgjoje nga Kur'ani ndëshkimin e tupshëm dhe mos jep shpirt me një faqe të zezë të tillë!

Dije se ky nefs kafshë është një gomar! Rënia nën të është gjendje më e turpshme se ajo e gruas.

Nëse vdes nga egoizmi në rrugën e nefsit, domethënë, egos, dije se, në të vërtetë, edhe ti je si ajo gruaja!

Zoti i ka dhënë nefsit tonë trajtën e gomarit. Dhe trajtat janë në përshtatje me shprehitë.

Ky është zbulimi i të fshehtave në kiamet. Për hir të Zotit, ik nga nefsi që i ngjan gomarit!

Zoti i ka frikësuar qafirët me anë të zjarrit. Edhe ata, nga turpi, i kanë thënë zjarrit i mbarë.

Zoti ka thënë jo, ai zjarr është e vërteta e turpeve. Si zjarri që e vrau atë gruan.

Nga ambicja, nuk hëngri gjellë sa për t'u ngopur, por deshi me të tepërt. Dhe kafshata e vdekjes së keqe i mbeti në grykë!

O lakmitar, ha sa për t'u ngopur, madje, edhe sikur të kesh për të ngrënë hallvë apo paluze!

Zoti i dha peshores gjuhë. Mblidhi mendtë në kokë dhe këndo nga Kur'ani suren Rahman!

Eja në vete dhe mos e braktis peshoren për shkak të lakmisë. Lakmia dhe pangopësia janë një armik që të tërbon!

Lakmia i do të gjitha, por mbetet shijuar asgjë! O buçko, mos iu fal lakmisë!

Shërbëtorja e shkretë, edhe shkonte në rrugë, edhe mjerohej. Ajo thoshte me vete: O grua, e hodhe ustain rrugëve!

Deshe të bësh punë pa usta. Nga padituria, u ngrite të luash me jetën!

Vodhe një njohuri prej meje, por të erdhi turp të pyesje për llojin e kurthit!

Zogu mblidhte kokrra, por fija e lakut i mbështillej për qafe!

Ha pak kokrra pa u bërë kaq grykës. Nëse ke lexuar urdhrin "hani", lexo edhe urdhrin "mos shpërdoroni"!

Në këtë mënyrë, edhe kokrra ha, edhe në lak mos bjer. Dija dhe maturia këtë kërkojnë!

Njeriu i mençur nuk ha vuajtjen e botës, por të mirat e saj. Kurse të paditurit mbeten duke bërë pendesë pa pushim.

Po t'u përdrodh filli për qafe, ngrënia të bëhet haram.

Si mund ta hajë zogu kokrrën në lak? Po të tentojë ta hajë, kokrra në lak i kthehet në helm!

Kokrrën në lak e ha zogu i paditur e indiferent. Ashtu si hanë njerëzit të mirat në lakun e kësaj bote!

Zogjtë e mençur e me përvojë e tërheqin fort mirë veten prej kokrrës në lak.

Sepse kokrrat brenda lakut janë të helmuara. Eshtë i verbër ai zog që kërkon kokrra prej lakut!

I zoti i lakut ua pret qafën budallenjve. Kurse të bukurit e të pashmit i tërheq e i çon nëpër kuvende.

Sepse budallenjve u vlejnë vetë mishrat. Kurse të bukurve e të hijshmëve u vlejnë zërat e bukur!

Shkurt, me ta parë shërbëtorja nga e çara e derës se e zonja kishte dhënë shpirt nën gomar,

Tha: O grua torollake, ç'është kjo që bëre? Nëse ustai yt të tregoi një gjë,

Ti u kape vetëm pas dukjes, kurse mjeshtëria të ishte e fshehur. E hape dyqanin pa u bërë ende usta!

E pe mjaft mirë atë veglën, por, o lakmitare, kungullin pse s'e pe?

Apo ishe dalldisur aq shumë ndaj pasionit të gomarit sa s'ta panë sytë kungullin?

Pe nga ustai dukjen e artit dhe, tërë gëzim, ia nise punës!

Sa e sa njerëz kokëtrashë hipokritë dhe që s'marrin vesh nga puna ka, që nga rruga e burrave kanë parë vetëm stofrat!

Sa e sa grykës ka, që kanë mësuar vetëm pak gjë, kurse nga padishahët s'kanë mësuar tjetër veçse llafe!

Secili prej tyre ka marrë në dorë një shkop si Musai! Secili, duke e pandehur veten për Isa, është ngritur t'u fryjë budallenjve si vetja e vet!

Një ditë, e drejta e të drejtave ka për të kërkuar prej teje gurin e provës! Mjerë për atë ditë!

Tashmë, ç'ka mbetur, pyete nga ustai. Të gjithë këta lakmitarë janë qorra e memecë!

Të gjitha i kërkove, deshe t'i fusësh në dorë, por mbete pas të gjithëve! Kjo kope budallenjsh është bërë gjah për ujqit!

Pe një pamje dhe nise të flasësh për të, ndërsa, si papagallët, s'kupton gjë, madje, për fjalët që thua!

Sugjerimi i pejgamberëve për bashkësitë që s'janë të afta për sugjerimin e Zotit,
dhe i shehut për myritët, i ngjan punës së papagallit
për të mësuar të flasë para pasqyrës
me ndihmën e njeriut, me të cilin ai s'ka afërsi.
Siç veprohet me papagallin, edhe Zoti e vë shehun si një pasqyrë para myritit
duke i sugjeruar, kështu, atij, pas pasqyrës.
Zoti i ka thënë Pejgamberit:
"Mos u nxito duke lëvizur gjuhën me përpjekje për ta thënë para Xhebrailit"
dhe "Ajo që thotë Pejgamberi është vetëm fjala që i komunikon Zoti".
Ja, ky është fillimi i çështjes që nuk ka fund.
Papagalli e lëviz sqepin para pasqyrës nën ndikimin e personit që ndodhet pas pasqyrës
dhe përpiqet ta mësojë atë.

Papagalli ka përpara një pasqyrë dhe sheh në të pasqyrimin e vetvetes.

Pas pasqyrës është fshehur ustai i cili, me një gjuhë të bukur, thotë fjalë me edukatë.

Papagalli e pandeh për folës atë papagallin që sheh në pasqyrë!

Në këtë mënyrë, nuk di gjë për hilen e atij ujku të madh, por gjase mëson të flasë nga papagalli që është nga lloji i vet!

Ai zog i aftë mëson fjalë, por nuk di gjë aspak për kuptimin dhe sekretin e tyre.

Ai e fikson thënien e fjalëve nga njeriu. Por ç'mund të marrë e të mësojë tjetër nga njeriu një papagall i shkretë?

Edhe myriti i mbushur plot të këqija, krejt si papagalli, sheh veten në pasqyrën e trupit të shehut dhe kujdestarit të vet.

E si do ta shohë në kohën e fjalëve e të punës Arsyen e Përgjithshme pas pasqyrës?

Ai pandeh se flet njeriu. Mirëpo kjo është një sekret tjetër, kurse ai nuk di asgjë për këtë.

Ai e fikson thënien e fjalëve, por fikson të fshehtën e pafund. Mirëpo ai nuk është i barazvlershëm me këtë të fshehtë, është një papagall, nuk mund ta dijë këtë!

Edhe njerëzit imitojnë këngën e zogjve. Kjo është një gjë që mund ta bëjnë gryka me gojën.

Ndërkaq, imituesit e zërave të zogjve nuk dinë asgjë mbi kuptimin e atyre zërave. Gjuhën e zogjve e njihte vetëm Sulejmani me vështrim të këndshëm.

Edhe shumë vetë i mësojnë fjalët e dervishëve dhe me to u japin shkëlqim minbereve dhe kuvendeve.

Ndërkaq, ose ata s'kanë kësmet tjetër veç këtyre fjalëve, ose, më në fund, mëshira e Zotit u tregon rrugë atyre.

Një njeri i zemrës pa një bushtër me barrë. Të vegjlit i lehnin në bark.
Ai mendoi me vete se qeni leh në roje, mirëpo roje në barkun e nënës s'ka.
Pastaj, qeni leh edhe për të kërkuar ndihmë, për të kërkuar qumësht, etj.
Meqë është në bark të nënës, këto lehje s'kanë as kuptim, as dobi.
Ç'do të thotë kjo?" Kur erdhi në vete, iu drejtua Zotit.
Ai tha: "Këtë s'e di askush veç Zotit!" Nga Zoti i erdhi kjo përgjigje:
Kjo është gjendja e atyre të cilët, ndërsa ende s'u janë hapur sytë,
dalin me pretendime mbi një çështje dhe flasin mbi të.
Por me këtë pretendim dhe me këto fjalë, as forcë fitojnë, as ndihmë
dhe as dëgjuesit munden t'i çojnë në rrugë të drejtë!"

Dikush, ndërsa ndodhej i tërhequr në vetmi, pa në ëndërr një qen rrugësh me barrë.

Ai dëgjoi se si të vegjlit i lehnin në bark. Ata duhet të ishin që lehnin se përreth nuk kishte qen të tjerë!

Ai u habit mjaft se si mund të lehin qentë në bark të nënës. Kush e ka parë këtë në botë?

Kur u zgjua nga gjumi dhe erdhi në vete, habitja i shtohej çdo çast e më shumë.

Mirëpo në kthinën ku ndodhej nuk kishte tjetër njeri që ta zgjidhte këtë nyje. Këtë punë mund ta zgjidhte vetëm nga lartësia e Zotit të Lartë.

Ai tha: O Zot, ç'është kjo punë e ngatërruar, kjo thashetheme? U habita në kthinën time dhe mbeta pa të përmendur Ty!

Pra, hapmi krahët të fluturoj e të shkoj në bahçen e zikrit e të mollëve!

Erdhi menjëherë një zë i lehtë: Dije se kjo i ngjet fjalë të njerëzve të paditur.

Me sytë të lidhur, që s'kanë dalë jashtë mbulesës, perdes Megjithatë, vazhdojnë të flasin kot.

Lehja e këlyshit në barkun e nënës është punë e kotë. As gjahut i shërben, as rojes së natës.

Nuk ka parë ujk që ta përzërë. Nuk ka rënë hajduti që ta ndjekë!

E kishte vështrimin të paturpshëm nga padurimi dhe sevdaja pë të dalë në krye, por edhe i hedhur për të thënë fjalë.

Eshtë dhënë pas haresë për të gjetur myshteri, por ia ka hyrë punës me zell të madh, por me sy mbyllur!

Ia thotë shenjat hënës pa e parë fare, fshatarin, në këtë mënyrë, e shtyn në një mendim të kundërt.

Për të gjetur myshteri, për të fituar pozitë, jep qindra shenja për hënën megjithë s'e ka parë.

Myshteriu që jep fitim është i vetëm, por ata janë në dyshim dhe pandehmë mbi myshteriun.

Këta njerëz i shesin ajër myshteriut i cili s'ka asnjë cilësi e vlerë të lartë.

Myshteriu ynë është Zoti: "Allahu blen" Tashmë edhe ti mos bjer pas hallit të çdo myshteriu, shpëto nga kjo punë!

Kërkoje myshteriun që të kërkon ty, gjej myshteriun që njeh fillimin dhe fundit tënd!

Eja në vete. Mos i hidh dorë çdo myshteriu. Eshtë keq të kesh dy të dashura!

Edhe në bleftë, madje, prej tij nuk mund të kesh fitim. Te ai nuk ka aftësi për t'i dhënë vlerë mendimit dhe arsyes!

Kur ai s'ka para as për gjysëm nallaneje, ti e kap dhe i tregon smerald.

Ashtu siç shejtani e ka sjellë veten në gjendje për t'u gjuajtur me gurë, edhe lakmia, krejt si ai, të ka bërë qorr, të ka lënë krejt pa gjë!

Siç ka bërë ai shejtani mundues që të gjuhen me gurë shoqëruesit e elefantit dhe fisi i Lutit, edhe ata i ka bërë të gjuhen me gurë, i ka shkatërruar!

Ata që durojnë, e gjejnë myshteriun, sepse ata nuk vrapojnë pas çdo myshteriu.

Kush e kthen fytyrën mënjanë nga ai myshteri, nga ai njeri e kthejnë fytyrën mënjanë edhe fati, edhe mirësia, edhe përjetësia!

Ashtu siç patën mbetur darvanasit të përmalluar përjetësisht për shkak të zilisë, edhe lakmitarët kanë mbetur përjetësisht në përmallim!

Darvanasit i kishin zili të varfërit dhe thoshin:
Nga naiviteti, babai ynë ua jep të varfërve shumicën e prodhimit të kopshtit.
Sapo bëhet rrushi, u jep një të dhjetën, sapo bëhet rrushi i thatë, një të dhjetën,
sapo të gatuhet hallvë dhe paluze, një të dhjetën,
sapo të mblidhen të lashtat e të bëhen duaj, një të dhjetën,
sapo të mbarojë shirja, një të dhjetën, nga gruri i përzjerë me kashtë, një të dhjetën,
sapo të ndahet gruri nga kashta, një të dhjetën, sapo të bluhet e të bëhet miell, një të dhjetën,
sapo të piqet buka, një të dhjetën.
Prandaj Zoti i kishte dhënë kopshtit një bereqet të tillë
që të gjithë të tjerët që kishin kopshte e vreshta
i bëheshin nevojtarë atij dhe i kërkonin edhe fruta, edhe para.
Kurse i zoti e kopshtit të begatë nuk i bëhej nevojtar askujt.
Të bijtë e shihnin një të dhjetën e dhënë prej tij në mënyrë të përsëritur,
por s'e shihnin begatinë e madhe!
Si ajo gruaja që e pa organin e gomarit, por kungullin nuk e pa dot!

Ishte një njeri i pastër i Zotit. Mendja ia priste për çdo gjë, fundin e punës e shihte.

Ishte në qytetin Darvan pranë Jemenit. Kishte fituar emër të mirë me dhënie lëmoshe, me shprehi të mira!

Mjedisi përreth tij ishte bërë si Qabe prej të varfërve. Ata që shpresonin diçka gjithë po tek ai shkonin!

Me gjithë zemër, jo për dyfytyrësi, jepte një të dhjetën e prodhimit; pastaj, edhe kur shihej gruri,

Kur bluhej e bëhej miell, kur bëhej bukë, jepte përsëri një të dhjetën.

Jepte një të dhjetën e çdo të ardhure, të dhjetën e të mbjellave ua shpërndante katër herë të varfërve.

Dhe gjithmonë i këshillonte të bijtë:

Për hir të Zotit, pas meje, të mos shkoni pas lakmisë e të mos rrini pa e dhënë të drejtën e të varfërve.

Jepeni një të dhjetën dhe, me mbrojtjen e Zotit, prodhimi t'ju mbetet në dorë!

Nuk ka nevojë për supozim e për dyshim; Zoti është që i jep nga bota e padukshme edhe bukën, edhe frutat!

Po shpenzove në kohën e vjeljes së prodhimeve, ky shpenzim është fitim.

Shumica e fshatarëve e mbjell përsëri farën e marrë prej arës.

Tepricën pas ngrënies e bën farë. Sepse nuk dyshon se përsëri ka për të mbjellë.

Meqë farën e siguroi nga toka, nuk druhet ta hedhë përsëri në tokë!

Edhe këpucari, me paranë e tepruar nga buka, blen shollë dhe lëkurë.

Dhe thotë me vete: Ç'të më bjerë në dorë, nga këto më bie. Rizku i mbyllur me këto më hapet.

Dhe shpenzon për to një përqindje të parasë që i ka rënë në dorë.

Ndërkaq, toka dhe lëkura për të cilat po flasim, janë perde. Rizkun e vërtetë dije prej Zotit!

Po qe se fitimin e arritur e mbjell në atë vend nga ku e arrite, për një pjesë fiton njëqind mijë!

Le ta zëmë tani se e mbolle farën në vendin që e pandeh shkak.

Po qe se ajo farë nuk jep prodhim për dy-tre vjet, ç'bën ti? Ç'ke në dorë tjetër veçse t'i hapësh duart e t'i lutesh Zotit?

I bie kokës me grushta para Zotit dhe kjo provon se është ai që e jep rizkun.

Në këtë mënyrë e kupton dhe e di se ai është baza e bazës së rizkut. Edhe ai që kërkon rizk, atë e kërkon!

Prej tij kërkoje rizkun, jo prej Zejdit dhe Amrit! Dehjen prej tij kërkoje, jo prej drogës dhe verës!

Pasurimin lute jo prej thesarit, mallit e pasurisë, por prej tij! Ndihmën kërkoje jo prej dajës e prej xhaxhait, por prej tij!

Sepse, në fund, të gjitha këto do t'i lësh e do të ikësh. Eja në vete dhe atëherë mendoje se kë do të thërresësh, prej kujt do të kërkosh ndihmë!

Dhe, tani, atë kërkoje, lëri të tjerët veç tij. Lëri dhe bëhu trashëgimtar i pasurisë botërore!

Do të vijë një kohë që "njeriu do të ikë nga i vëllai", "djali do të ketë frikë nga i ati"!

Atë çast, çdo mik do të të bëhet armik, sepse ata ishin idhulli yt që të pengonin në udhë!

E pate kthyer kokën nga piktori te piktura, sepse ashtu të kënaqej zemra, me pikturën ngushëllohej.

Kurse tani, nëse miqtë të dalin kundër, e kthejnë fytyrën mënjanë prej teje dhe nisen të të bëhen armiq,

Thuaj menjëherë: Ja ku të erdhi dita; ajo që pati për t'u bërë nesër, u bë sot!

Të këtushmit, të gjithë, m'u bënë kundërshtarë. A s'do të ndodhte kështu në kiamet? Kurse mua më ndodhi që tani!

E kuptova se kush ishin pa e kaluar ditën me ta, pa e mbaruar jetën me ta.

Po të mos ndodhte kjo, do të kisha blerë një copë me të meta. Lavdëruar qoftë, e mësova qysh më parë se copa është me të meta.

E kuptova punën pa më dalë prej dore kapitali që kisha, ndryshe, më në fund, e meta e asaj cope do të dilte në shesh.

Edhe malli do të shkonte, edhe jeta. Për një copë të grisur do të jepja edhe mallin, edhe shpirtin!

Do të jepja mallin dhe pasurin dhe do të merrja para kallpe dhe, pastaj, plot gëzim, do të merrja rrugën e shtëpisë!

Falenderuar qoftë që doli në shesh se floriri ishte kallp para se të më shpenzohej jeta për shkak të tij!

Ndryshe, floriri kallp do të më mbetej në qafë gjer në fund dhe do ta çoja kot jetën për asgjë!

Meqë u kuptua qysh tani se paraja është kallpe, edhe unë ta heq këmbën prej tani prej saj.

Po qe se miku të bën armiqësi dhe e nxjerr jashtë zilinë dhe urrejtjen,

Mos qaj pse të ktheu shpinën, mos e ul veten duke u treguar kokëtrashë dhe i paditur!

Falenderoje Zotin, jepu bukë të varfërve se në thesin e tij nuk u vjetërove, nuk u konsumove!

Dhe dole shpejt nga thesi për të kërkuar një mik të drejtë e të përjetshëm.

Ç'mik i besës është ai që edhe pas vdekjes, miqësia e tij trefishohet, fuqia në lidhjen pas tij shtohet tre gradë!

Ai mik është padishah, është sovran ose një rob i tij, i zgjedhuri i tij, që i shkon fjala tek ai!

Shpëtove nga miku mashtrues, hileqar, hipokrit, ia pe dyfytyrësinë pa vdekur!

Po qe se e di mundimin e ushtruar nga njerëzit mbi ty në këtë botë, kjo quhet për ty një thesar i fshehtë floriri.

Po qe se njerëzit sillen keq ndaj teje dhe, më në fund ti mbetesh i pashpresë, ua kthen shpinën të gjithëve.

Ta dish mirë këtë se më në fund të gjithë do të të bëhen armiq, armiq që të heqin kokën!

Kurse ti, në varr, do të bërtasësh: "O Zot, mos më lër të vetëm!"

O mik i mirë që vuan për fjalën e besëtarëve, edhe besa e tyre është prej teje!

O i zoti i hambarit, dëgjoja fjalën arsyes dhe grurin hidhe në tokën e Zotit!

Hidhe që të jetë i sigurt edhe nga hajduti, edhe nga morri i grurit! Dhe vraje shpejt shejtanin bashkë me të birin!

Sepse ai të frikëson ty vazhdimisht me papasje. O skifter, gjuaje atë sikur të gjuaje dre!

Eshtë turp sikur skifteri i stërvitur i padishahut të gjuhet nga dreri!

Njeriu mbolli mjaft farë kështillash për të bijtë, por vendi ishte i thatë e djerr prandaj s'bëri dobi.

Këshilluesi le të përpiqet sa të dojë; për t'iu dëgjuar këshilla, duhet që te dëgjuesi të ketë veshë për ta pranuar këshillën!

Ti i jep këshilla atij duke i bërë shumë favore, por këshilla jote as që i hyn në vesh!

Njeriu kryeneç që s'dëgjon, i lë me gisht në gojë qindra këshillues!

Kush ka qenë më këshillues, më fjalëmirë se pejgamberët? Fjala e tyre bënte efekt edhe mbi gurin!

Malet e gurët i dëgjuan fjalët e tyre, fjala e tyre ndikoi edhe mbi male e gurë, por jo mbi njeriun e keq që mbeti i shurdhër!

Zemrat e rëna pas egoizmit të tipit "unë" dhe "ne", u bënë më të ngurta se gurët!

Dhuntia dhe fuqia e Zotit nuk kanë nevojë për aftësi siç ndodh te dhuntia e njeriut, sepse aftësia është diçka e shfaqur pas.
Të japë (dhunti) është atribut i Zotit, kurse aftësia është atribut i krijesës.
Ai që s'ka fillim nuk është i varur nga gjëja e krijuar pas.
Po qe se supozohet se varet, duhet që krijimi pas i tij të jetë i pamundur.

Kjo zemër mund të përmirësohet me anë të favorit dhe mirësisë së Zotit i cili e kthen njeriun nga një gjendje, në tjetrën. Ndërkaq, aftësia e njeriut nuk është kusht për përfitimin nga favori dhe mirësia e Zotit!

Ndoshta është e kundërta, domethënë, që favori dhe mirësia e tij janë kusht për të pasur aftësi. E dhëna e Zotit është tuli i frutit, kurse aftësia e njeriut, lëvozhga.

Vëre: Shkopi i Musait bëhet kuçedër, kurse dora i shkëlqen si diell!

Qindramijëra mrekulli të pejgamberëve që nuk na i nxënë mendja dhe mendimi,

Nuk janë pasoja shkaqesh, por krijime të Zotit. Nga u vjen aftësia gjërave të paqena?

Po qe se aftësia do të ishte kusht në punën e Zotit, asnjë e paqenë nuk do të vinte në botën e qenies.

Ai vuri një zakon nën këtë perden qiellore për kërkuesit, krijoi shkaqe dhe rrugë.

Shumica e gjërave që ndodhin, ndodhin sipas atij zakoni. Por ndodh edhe që fuqia ta shqyejë e ta ngrejë atë zakon.

Ai vuri zakon dhe mënyrë me të mirë dhe ëmbëlsi, pastaj i prishi ato dhe kjo u quajt mrekulli.

Neve s'na vjen lartësim pa shkak. S'na vjen, por fuqia e Zotit s'është e paaftë për ta hequr shkakun.

O ti që jepesh pas shkakut, mos fluturo jashtë shkakut, por as mos tento ta quash të kotë krijuesin e shkakut!

Zoti që krijon shkakun, bën ç'të dëshirojë. Fuqia e tij absolute i prish dhe i heq shkaqet.

Por me qëllim që kërkuesi t'ia arrijë qëllimit, shumë herë i bën dhe i krijon punët me anë të shkaqeve.

Po të mos jetë shkaku, si do të kërkojë rrugë myriti? Në këto kushte, në rrugë duhet të duken shkaqet.

Këto shkaqe janë perde për vështrimet. Sepse çdo sy nuk është i denjë për ta parë artin e tij.

Duhet një sy që ta grisë shkakun me qëllim që t'i heqë perdet nga rrënjët.

Dhe, në këtë mënyrë, ta shohë krijuesin e shkaqeve në vendin e tejhapësirës, t'i quajtë të kotë dyqanin dhe fitimin.

Çdo e mirë dhe e keqe vjen nga krijuesi i shkakut të tyre. Shkaqet dhe ndërmjetësit, or babush!

Një pjesë kohe s'është gjë tjetër veçse një iluzion i përqendruar mbi rrugën kryesore me qëllim që të kalojë periudha e padijes dhe indiferencës!

Ndërsa po krijohej trupi i Ademit (a.s.),
Zoti e ka urdhëruar Xhebrailin (a.s.) "të marrë një grusht dhé mbi tokë",
kurse sipas një rrëfimi tjetër, "të marrë nga një grusht dhé prej çdo vendi".

Kur Zoti, zotëruesi i artit, dëshiroi ta krijonte Ademin për ta vënë në provë përmes të mirës dhe të keqes,

E urdhëroi Xhebrailin me esencën të drejtë: "Shko dhe merr nga toka një grusht dhé hua!"

Dhe Xhebraili, duke iu përkushtuar shërbimit, erdhi në tokë për ta zbatuar urdhrin e Zotit.

Ai rob urdhri vuri dorën në tokë dhe toka u tërhoq drejt tij.

Dhe toka që i erdhi goja, filloi t'i lutej: Për hir të krijuesit të vetëm, lërmë, ik, falma jetën! Hiqi prej meje frerët e atij kali shale!

Njeriu që do të krijohet prej meje, do të përballohet me propozime, do të bjerë në rreziqe. Për hir të Zotit, lërmë, mos më merr!

Zoti ty të zgjodhi, dijen në levhi Mahfudh ty ta tregoi. Për hir të atij favori, hiq dorë prej meje!

Me mirësinë e Zotit, u bëre mësues i engjëjve. Vazhdimisht je duke biseduar me Zotin.

Do të bëhesh edhe ndërmjetës për pejgamberët. Ti je jeta e shpirtit të vahjit, jo trupi i tij.

Israfili u jep shpirt trupave, kurse ti i jep shpirtit shpirt. Prandaj je më i lartë se Israfili.

Ai i fryn Bririt dhe trupave u vjen shpirt. Fryma jote u fal shpirt zemrave të zhveshura nga trupi.

Shpirti i shpirtit në trup është gjallëria e zemrës. Prandaj, mirësia jote është më e lartë se mirësia e Israfilit.

Pastaj Mikaili u jep trupave rizk. Kurse përpjekja jote e furnizon zemrën e ndriçuar.

Ai e ka mbushur prehrin me sa i ka dhënë shiniku, kurse rizkun tënd shiniku s'e nxë.

Ti je më i lartë edhe se Azraili që zotëron forcën dhe dhunën. Siç e ke mëshirën më të madhe se ndëshkimin.

Këta të katër e bartin arshin. Ti je sovrani i tyre. Në të vërtetë, për sa i përket zgjuarsisë, je më i larti i të katërtve.

Dhe vazhdoi duke i thënë: Ditën e ringjalljes sheh se si arshin e bartin tetë engjëj. Atëherë, prapë ti do të jesh më i larti ndër të tetë.

Ja, kështu po i thoshte e po i lutej duke qarë. Sepse e kishte kuptuar qëllimin.

Xhebraili ishte me natyrë të turpshme. Ajo betime ia prenë rrugën.

Meqë toka iu lut shumë dhe iu betua, u kthye prapë dhe i tha Zotit: O Zoti i robve!

Unë nuk jam i pabindur ndaj punës tëndepor ti e di më mirë se ç'u fol mes nesh.

Dhe përmendi një emër nga emrat e tu që, o Zot që sheh gjithçka, nga frika e atij emri e ndalojnë rrotullimin të shtatë qiejt!

U turpërova, u mërzita nga ai emër. Ndryshe, të sjellësh një grusht dhé është e lehtë!

Ti engjëjve u ke dhënë një fuqi të tillë që edhe qiejt, madje, i grisin!

Zoti dërgon në tokë Mikailin (a.s.) për të marrë një grusht dhé për ta gatuar trupin e bekuar të Ademit (a.s.) i cili është ati i njerëzve dhe zëvendësi i Zotit, të cilit i kanë bërë sexhde engjëjt dhe i cili u ka shërbyer si mësues atyre.

Zoti i tha Mikailit: Zbrit mbi tokë dhe, si luan, rrëmbe prej saj një copë!

Kur Mikaili zbriti në tokë dhe do të rrëmbente një copë prej saj,

Toka u dridh dhe filloi të qante, të lutej e të derdhte lot.

U lut me zemër të përvëluar, u betua duke derdhur lot të përgjakur dhe tha:

Për hir të Zotit të pashok e mirëbërës, i cili të futi ty mes engjëjve të lartë që e bartin arshin,

Ti që je nëpunësi i shinikëve me të cilat e furnizon botën me ushqime e të mira, që u jep ujë me grushte të eturve të favorit dhe mirësisë sate,

Që prandaj të është dhënë edhe ky emër,

Ki mëshirë për mua dhe lërmë të lirë! Shih, jam mbytur në lot të përgjakur dhe kështu po bisedoj me ty!

Engjëlli është mishërim i mëshirës së Zotit. Ai tha: Tani, si të hedh unë kripë mbi këtë plagë?

Kurse shejtani është mishërim i dhunës dhe persekutimit. Prandaj ankohet për njerëzit, të bijtë e Ademit!

O trim, mëshira është mbi ndëshkimin, është më shumë se ndëshkimi. Favori si një nga atributet e Zotit, qëndron mbi ndëshkimin dhe persekutimin e tij.

Edhe robtë janë të shprehive të tij, calikët janë të mbushur me ujin e tij.

I Dërguari i Zotit ai udhërrëfyes, ka thënë: Njerëzit janë në fenë e sundimtarit të tyre.

Mikaili shkoi te froni i Zotit me duar bosh!

Dhe i tha: O ti sovran i vetëm që i di të fshehtat, toka qau e rënkoi dhe ma preu rrugën!

Loti ka një vlerë për ty, prandaj s'qëndrova dot indiferent.

Për ty, klithjet e rënkimet kanë vlerë të lartë, pra, nuk më erdhi doresh ta shkel atë drejtësi!

Për ty, syri i përlotur ka një vlerë të lartë, pra, si mund të bëja kryeneçësi?

Robi thirret pesë herë në ditë të vijë në namaz e të klithë.

A nuk thotë muezini "ejani në shpëtim"? Ai shpëtim është kjo qarje, ky rënkim!

Atë që ti kërkon ta bësh të sëmurë me anë të vuajtjes, ia mbyll zemrës së tij rrugën e qarjes.

Dhe, në këtë mënyrë, kokëçarja ia beh pa gjetur pengesë, sepse nuk gjendet ndërmjetësues për rënkimin.

Nëse dëshiron ta shpëtosh dikë nga kokëçarja, ti i jep në zemër qarjen dhe rënkimin.

Në Kur'an, për bashkësitë që kanë pësuar ndëshkim të rëndë, ke thënë:

Ata nuk qanë e rënkuan në atë çast, që e keqja të kthehet mbrapsht e të largohet prej tyre!

Ngaqë i kishin zemrat të ngurta, fajet e veta u dukeshin adhurime!

Gjersa kryeneçi të mos e njohë veten fajtor, si mund të ndodhë që t'i përloten sytë e të qajë?

Fakti që qarja e shporr të keqen e ardhur nga qielli nuk është historia e Junusit (a.s.). Zoti i lartë vepron si të dojë, prandaj qarja dhe madhërimi i Zotit i japin dobi njeriut. Kurse filozofët thonë se Zoti vepron sipas ligjeve të natyrës dhe shkaqeve dhe jo siç do, prandaj qarja nuk i ndryshon ligjet e natyrës!

Fisit të profetit Junus i ranë fatkeqësi. Nga qielli u shkëput një re plot zjarr.

Shpërthenin rrufetë dhe i digjnin gurët. Qielli bubullinte dhe i zverdhte fytyrat!

Të gjithë ata ishin ngjitur në pjesët e sipërme të shtëpive e mbi çati. Ishte natë. Kjo e keqe e rënë nga qielli kishte ndodhur natën!

Të gjithë zbritën poshtë. Zbuluan kryet dhe zunë udhën e fushës.

Nënat u ndanë nga fëmijët dhe fëmijët, nga nënat! Të gjithë filluan të qanin e të klithnin!

Nga namazi i mbrëmjes e gjer në të zbardhur të ditës tjetër, ata njerëz hodhën dhé mbi koka.

Që të gjithë vajtuan pa pushim e u lutën. Zotit i erdhi keq për atë popull kryeneç.

Pas mungesës së shpresës, pas klithmave dhe rënkimeve pa durim, reja filloi të shpërndahej dalngadalë.

Historia e profetit Junus është e gjatë dhe e shumanshme. Kurse tani është koha për të treguar për tokën dhe për të dhënë frymëzim.

Shkurt, qarja dhe rënkimi kanë vlerë te Zoti. Po ku kanë tjetër?

O shpresë, ngrehu menjëherë dhe shtrëngoje mirë mesin! Ngrehu, o ti që qan dhe qeshu përgjithmonë!

Sepse Zoti i Lartë i mban njëlloj të larta lotët me gjakun e dëshmorëve!

Zoti e dërgon Israfilin (a.s.) në tokë për të marrë një grusht dhé për të krijuar trupin e Ademit (a.s.).

Pas kësaj, Zoti i tha Israfilit të shkonte, ta mbushte grushtin me dhé e ta sillte.

Edhe Israfili zbriti në tokë, por prapë toka filloi të qante e rënkonte.

Dhe tha: O engjëlli i Bririt, o det jete! Të vdekurit me frymën tënde ringjallen!

Aq ma fuqi i fryn bririt, saqë njerëzit e kalbur ngjallen, vijnë në sheshin e mbledhjes dhe e mbushin atë fushë!

I fryn bririt dhe thua: Ejani, o dëshmorët e Qerbelasë, ngrihuni!

O ju të shkatërruarit me shpatën e vdekjes, ngrini kokën nga dheu si degët dhe gjethet!

Nga mëshira dhe ajo fryma jote e efektshme, kjo botë mbushet me të ringjallur.

Ti je engjëll i mëshirës, mëshiron. Ti e bart arshin, ti je kibleja e mirësive dhe favoreve!

Arshi është mishërim mirësie dhe drejtësie. Nga poshtë tij rrjedhin katër lumenj të mbushur plot falje.

Lumenj të përjetshëm qumështi, mjalti, vere dhe ujëvarash.

Këta shkojnë nga arshi në xhennete. Edhe në këtë botë duket pak gjë prej atyre lumenjve.

Ç'është e vërteta, pjesët e dukura këtu të atyre katër lumenjve janë të turbullta. Pse? Nga helmi i mosqenies së hidhur!

Nga ata katër lumenj spërkatën mbi këtë tokë të zezë një gllënjkë dhe shpërthyen një intrigë!

Në këtë mënyrë, ata njerëz të ulët dëshiruan të kërkojnë bazën e tyre. Por ata që s'ishin njerëz të vërtetë, u kënaqën me kaq dhe shkuan.

Zoti dha qumësht për të ushqyer e rritur fëmijët, gjoksin e çdo gruaje e bëri burim të këtij lumi qumështi.

Lumin prej vere e bëri të rrjedhë prej rrushit me qëllim për ta larguar mërzitjen dhe dëshpërimin, për t'i larguar mendimet e zymta dhe për t'i dhënë njeriut fuqi dhe guxim.

Dhe bletën e bëri burim për lumin e mjaltit dhe e bëri të rrjedhë atë lumë për të shëruar sëmundjet e trupit.

Kurse ujin ia fali secilit për pastrim dhe pirje.

Në këtë mënyrë, dëshiroi që të vëzhgoheshin këto dhe të gjurmoheshin burimet e tyre. Mirëpo, o llafazan, ti u kënaqe me kaq.

Tani dëgjo ato që po heq toka! Shih se ç'magjira i këndon ai zotëruesi i fuqisë Israfilit!

E thartoi fytyrën kundrejt Israfilit, iu lut në qindra mënyra.

Dhe tha: Për hir të Zotit të Lartë, mos e shih të merituar për mua këtë ndëshkim!

Unë nga kjo punë nuhas pak, kurse në kokë më hyri një dyshim i keq.

Ti je engjëll i mëshirës, ti mëshiron. Trumcaku nuk nget asnjë zog!

O engjëll që je mëshirë dhe shërim për të vuajturit, edhe ti bëj si ata dy të tjerët!

Israfili u kthye shpejt në fronin e sovranit, solli justifikim dhe ia tregoi ç'kishin ndodhur!

Dhe i tha: O Zot, Në dukje më the të marr dhé, por në zemër më frymëzove të kundërtën.

Veshit m'i the merr dhé, por mendjes m'i urdhërove të kundërtën.

Mëshira jote është më tepër se ndëshkimi yt, ia kaloi ndëshkimit tënd, o Zot që s'ke shok e që bën punë të mira!

Zoti dërgon Azrailin (a.s.) që është një engjëll i vendosur e i fortë, që të marrë një grusht dhé për ta gatuar trupin e shkathët të Ademit (a.s.).

Zoti i tha Azrailit: Shko shpejt dhe shihe gjendjen e tokës së kapur pas atyre iluzioneve!

Gjeja atë mizor të pagjumë, merr një grusht dhé dhe eja!

Çaushi i kazasë dhe kaderit, Azraili, zbriti në globin tokësor për ta zbatuar urdhrin e Zotit.

Siç e kishte bërë zakon, toka përsëri nisi të qante, të rënkonte e të betohej. Ajo bëri shumë betime.

Dhe i tha Azraelit: O ti rob i vërtetë i Zotit, o ti që bart arshir, o ti që të binden në qiej e në tokë!

Për hir të Zotit të vetëm e të gjithëmëshirshëm, shko. Për hir të Zotit që të favorizon, shko!

Për hir të sovranit të vetëm që adhurohet, që nuk përzë askënd që qan e lutet në prani të tij!

Por Azraili i tha: Me këtë lloj mashtrimi, unë s'i kthej shpinën zotëruesit të urdhrit të dukshëm e të fshehtë!

Toka i tha: Ai ka urdhëruar edhe diturinë. Që të dyja janë urdhra. Ki mirësinë të më mbështetësh mua me rrugën e dijes, atë urdhër zbatoje!

Mirëpo Azraili i tha: Ai urdhër është ose interpretim, ose analogji. Në urdhrin e hapur bëj pak sipas interpretimit dhe analogjisë!

Eshtë më mirë të interpretosh mendimin tënd. Eshtë më mirë se të interpretosh këtë urdhër të hapur që nuk i ngjet asnjë urdhri!

Më digjet shpirti nga lutjet e tua, nga lotët e tu të hidhur m'u mbush zemra me gjak.

Nuk jam i pamëshirshëm, madje jam më i mëshirshëm se ata tre engjëjt e tjerë të pastër; unë vuaj me vuajtjen tënde!

Po qe se unë i jap një shpullë një jetimi, kurse një njeri i butë i jep një gjë të ëmbël,

Shpulla ime është më e këndshme se ëmbëlsira e tij! Mjerë për atë jetim nëse gënjehet nga ëmbëlsira e atij!

Më digjet mëlçia nga klithma jote. Por Zoti nuk më ka mësuar mirësi tjetër!

Mirësia e fshehtë ndodhet brenda persekutimeve, si ndodhja e margaritarit të paçmuar brenda në ndyrësi!

Persekutimi i Zotit është njëqindfish më i mirë se butësia ime. Sa i mirë është Zoti i botëve dhe sa e mirë është ndihma e tij!

Në persekutimin e tij ndodhen të fshehura mirësi dhe favore; të japësh shpirtin për të ia shton jetën njeriut! Eja në vete dhe lëre pandehmën e keqe dhe sjelljen e ashpër. Meqë Zoti thotë eja, bëje kokën këmbë dhe vrapo!

Ftesa e tij i jep njeriun lartësi, i fal dehje, bashkëshorte, kënaqësi.

Unë kurrsesi s'mund ta interpretoj urdhrin e tij të lartë!

Toka e vuajtur i dëgjoi të gjitha këto, por ajo pandehmë e keqe i qe bërë vëth në vesh, prandaj nuk hoqi dot dorë prej saj!

Toka e ulët filloi përsëri të lutej e përgjërohej e të binte në gjnjë si e dehur.

Azraili i tha: Mjaft, mos e tepro më! Dhe prej meje s'të vjen dëm. Po deshe, po ta lë peng kokën, shpirtin!

Mos mendo të lutesh dhe mos iu lut tjetërkujt veç atij sovrani të mëshirshëm e të drejtë!

Unë jam zbatues i urdhrit, nuk e braktis urdhrin. Urdhri i tij shkëput pluhur prej detit!

Përveç urdhrit të atij Zoti që ka krijuar veshët, sytë dhe kokën, nuk dëgjoj nga vetja as të mirë, as të keqe!

Veshët e mi janë të shurdhër për çdo urdhër tjetër veç urdhrit të tij. Ai është për mua më i ëmbël se shpirti im!

Shpirti prej tij ka ardhur, jo ai prej shpirtit! Ai jep qindramijëra shpirtra pa shpërblim!

Ç'është shpirti që ta kursej prej zotëruesit të bujarisë? Ç'është pleshti që ta djeg jorganin për të?

Unë nuk njoh mirësi tjetër veç mirësisë së tij. Veç tij, ndaj gjithkujt tjetër jam i shurdhër, memec, i verbër!

I kam veshët të shurdhër ndaj atyre që qajnë e klithin. Unë jam si një heshtë në dorën e tij!

Krijesa që të dëmton ty në të vërtetë i ngjan një mjeti (një vegle).
Arif i thonë atij që nuk sheh mjetin, por Zotin.
Edhe nëse në dukje sheh mjetin, ndodh kështu jo nga padija, por se ashtu është dashur.
Kështu, Ebu Jezidi (k.s.) ka thënë: "Ka shumë vite që nuk bisedoj me njerëzit
dhe nuk e dëgjoj fjalën e popullit, kurse populli pandeh se bisedoj me ta dhe i dëgjoj fjalët e tyre.
Sepse ata nuk e shohin dot Personin e Lartë që i flas.
Për mua, ata i ngjajnë jehonës që vjen nga mali.
Personi i mençur që dëgjon, nuk sheh zërin.
Është e njohur proverba: "Muri e pyet gozhdën: "Pse më plagos mua?"
Dhe gozhda i përgjigjet: "Shihe atë që më ngul mua!"

Mos shpreso mëshirë nga heshta si kokëtrashë, por nga sovrani që e mban heshtën në dorë!

Si mund t'u lutesh heshtës dhe shpatës? Ato janë robër në dorën e atij personi të lartë!

Në art, ai është Azer, kurse unë, idhull. Ç'vegël që të bëjë prej meje, ajo jam unë!

Po të më bëjë kupë mua, kupë bëhem, po të më bëjë haxhar, hanxhar.

Po të bëjë çezmë, jap ujë, po të mëbjë zjarr, jap dritë.

Po të më bëjë shi, reshoj, i jap prodhim arës dhe lëmit, po të më bëjë shigjetë, ngulem në trup.

Po të më bëjë gjarpër, helmoj, po të më bëjë ndihmë, ndihmoj.

Unë jam si kalem mes dy gishtave. Nuk jam i lëkundur në radhën e faljes.

Azraili ia vuri syrin tokës dhe, atë çast, shkëputi një grusht dhé nga toka.

Mori mjeshtërisht një grusht dhé nga toka, por toka nuk e pa dhe nuk mori vesh gjë sepse atë çast ishte e zënë me sytë.

Ai mori një grusht dhé pa pëlqimin e tokës dhe e çoi te froni i Zotit siç çohet në shkollë fëmija që nuk do, duke i hequr këmbët zvarrë.

Zoti i tha: Për hir të diturisë sime të qartë, do të të bëj ty xhelatin e këtij populli.

Azraili i tha: Populli do të më bëhet armik mua. Po ua shtrëngova grykën njerëzve në kohën e vdekjes, çdo njeri do të më bëhet armik.

A e sheh me vend, o Zot, që njerëzit të më urrejnë, që të më bëhen armiq?

Zoti tha: Unë krijoj shkaqe të tilla, si ethet, plagët, etj.,

Që ata t'i largojnë sytë prej teje, të kapen krejtësisht pas atyre sëmundjeve dhe shkaqeve dhe të mos shohin tjetër veç tyre!

Azraili tha: O Zoti im i lartë, ti ke rob të tillë, që ata i shqyejnë shkaqet.

Sytë e tyre i kapërcejnë shkaqet dhe, me mirësinë tënde, i kalojnë perdet tejpërtej.

Lyejnë sytë me syrmenë e bashkimit nga mjeku i syve të gjendjes dhe shpëtojnë edhe nga sëmundja, edhe nga shkaqet.

As nga ethet shohin, as nga barku, as u japin fare rëndësi këtyre shkaqeve.

Sepse secila nga këto sëmundje ka shërim. Sëmundja që nuk pranon shërim janë kazaja dhe kaderi.

Dije se çdo sëmundje ka patjetër një shërim. Siç është shërimi i sëmundjes së të ftohtit veshja e qyrkut.

Megjithëse, po të dojë Zoti ta ngrijë një njeri, i ftohti e zë edhe sikur njëqind copë qyrqe të veshë!

Dhe trupi fillon t'i dridhet në atë mënyrë, që as me rroba s'ngrohet, as me shtëpi!

Kur vijnë kazaja me kaderin, mjeku budallallepset. Edhe ilaçi e ngatërron rrugën në çështjen e dhënies së dobisë!

Si ndodh që këto shkaqe që i gjuajnë kokëtrashët, të bëhen perde për aftësinë kuptuese të atij që është syçelë?

Kur syri të jetë i shëndoshë, e sheh të vërtetën, por po të jetë i vëngër, sheh të dytën!

O Azrail, ai që nuk i sheh nga Zoti shkaqet,
sëmundjet, plagën e shpatës,
nuk e sheh as punën tënde.
Ti je më i fshehtë nga ato shkaqe, por edhe ti je një shkak.
Madje edhe e fshehta e thënies atij të sëmurit se
"Zoti është më afër tij sesa jush por ju nuk e shihni",
nuk mbetet e fshehtë.

Zoti tha: si ndodh që njeriu që e njeh të vërtetën, të të shohë ty në mes?

E fshehe veten nga njerëzit, por sipas atyre që i shohin të vërtetat sheshit, edhe ti je një perde.

Ndërsa atyre u duket vdekja si sheqer, a mund t'u dehen sytë ndaj pasurisë dhe mirëqenies së kësaj bote?

Pr ta, vdekja që është e trupit, nuk është e hidhur, sepse ata shkojnë nga pusi e nga burgu në livadhe e në blerim. Ata shpëtojnë nga kjo botë e mbushur me vuajtje. A qan njeriu për humbjen e një hiçi?

Po qe se dikush nga të padishahut e shemb murin e burgut, a prek atë zemra e atij që ndodhet në burg?

Ajme, ky gur mermeri theu dhe na e shpëtoi shpirtin dhe zemrën nga burgu.

Ai mermer i bukur, ai gur me vlerë të lartë as murit të burgut i kishte hije, as ishte përshtatur bukur me të!

Si ndodhi që të thyejë e të më shpëtojë mua nga burgu? A thotë që atij i duhet thyer dora për këtë faj?

Asnjë i burgosur tjetër veç atij që nxirret nga burgu dhe dërgohet në trekëmbësh, nuk thotë fjalë të tilla të pakuptim.

Po qe se dikujt i japin sheqer duke e shpëtuar prej helmit të gjarpërit, a i vjen kjo gjendje e hidhur atij?

Shpirti shpëton nga grindja e trupit. Pa patur këmbë trupi, fillon të fluturojë me flatrat e zemrës.

Si puna e atij njeriut të burgosur në gropën e burgut, i cili fle dhe sheh në ëndërr trëndafilishten.

Ky njeri thotë: Zoti im, mos më kthe më në trup në mënyrë sqë të tundem e të shëtis në këtë trëndafilishte!

Edhe Zoti i thotë: T'u pranua lutja, mos u kthe. Zoti e di më mirë se ç'është e drejtë, apo jo!

Pa shih se sa e këndshme është kjo lloj ëndrre! Njeriu shkon në xhennet pa e parë vdekjen!

Tashmë, a e zë malli atë njeri për t'u zgjuar, për të jetuar në fund të pusit i lidhpur me zinxhirë?

Po të kesh besuar, eja në radhën e luftës se kuvendi yt është në qiell!

Ngrehu me qindra shpresa për arritje, o rob, dhe dëgjo si qiri para mihrabit!

Si qiriri që i është prerë koka, qaj gjithë natën për shkak të kërkimit dhe dëshirimit, derdh lot, qëndro i epur.

Mbylle gojën ndaj të ngrënit e të pirit, vrapo për në sofrën e qiellit!

Çdo çast, lidhe shpresën ndaj qiellit. Me ajrin e qiellit dridhu si shelg!

Ty të vjen ujë dhe zjarr çdo çast prej qiellit. Dhe ta shton rizkun!

Dhe mos u habit nëse të çon edhe ty atje. Mos ia shih dobësinë, por dëshirën!

Sepse kjo dëshirë është amanet i Zotit tek ti. Dëshira e çdokujt që dëshiron, është me vend!

Përpiqu që kjo dëshirë të të shtohet. Dhe, në këtë mënyrë, zemra të të dalë nga gropa e këtij trupi

Le të thonë populli se dikushi i varfër vdiq, kurse ti thuaju: o të pamarrëvesh, unë jam i gjallë!

Trupi im është shtrirë i vetëm, ka fjetur, por tetë xhennete më janë hapur në zemër!

A në këtë ndyrësi të ka mbetur trupi pasi ka fjetur brenda trëndafilave dhe blerimit? Sa keq!

Ç'di gjë shpirti për trupin e fjetur? Le të flerë në trëndafilishte a në vatër të hirit!

Shpirti lëshon thirrje në këtë botë me ngjyrë uji: "Eh, sikur fisi im ta dinte se pse më fali Zoti im!"

Po qe se shpirti nuk e do këtë jetesë pa trup, vendbanimi i kujt do të bëhej qielli?

Po qe se shpirti yt nuk e dëshiron jetesën pa trup, e kujt do të bëhej dhuntia "Rizku yt është në qiell"?

Të hash dhuntitë e yndyrshme e me mjaltë të botës
është e rrezikshme
se bëhet pengesë për gjellën e Zotit. Kështu,
Pejgamberi ka thënë:
"Uria është gjella e Zotit. Me të, domethënë me urinë,
ringjallen trupat e njerëzve fjalëdrejtë."
Gjithashtu, ka thënë: "Unë shkoj mik te Zoti im dhe
ai më ushqen e më ngop mua!"
Edhe Zoti ka thënë: "Ushqehen duke u prehur!"

Po shpëtove nga këto thërrime të pavlera të rizkut, bëhesh i merituar i të mirave të larta e të hijshme.

Po të hash mijëra okë gjellë nga ato të mira shpirtërore, përsëri shkon i pastër dhe i lehtë si pendë!

1745 Ajo gjellë as gazra bën tek ti, as bark, as të jep dhimbje barku!

Po të hash pak, mbetesh i uritur si sorrë; po të hash shumë, fillon të gogësish, të fryhek barku.

Po të hash pak, bëhesh me vese, prapësohesh. Po të hash shumë, fryhesh.

Por ha detra të tëra nga ushqimi i Zotit, nga ai furnizim i shijshëm, prapëseprapë qëndron mbi ujë si anijet dhe vozit.

Kapu pas agjërimit, duro, mos e braktis agjërimin, çdo çast, rizkun e Zotit prit!

1570 Sepse Zoti punëmirë u jep dhurata atyre që presin.

Njeriu i ngopur nuk pret bukë. Buka dhe gjella le t'i vijnë herët apo vonë!

Kurse njeriu i uritur pyet vazhdimisht se ku është buka, ushqimi. Pret dhe kërkon me uri.

Po nuk prite, s'të vjen ajo pasuri e madhe shtatëdhjet katëshe!

Or babush, prite gjellën e vlerave të larte sikur po të vjen nga çasti në çast!

1755 Çdo i uritur, më në fund gjen diçka për të ngrënë. Sigurisht që ka për t'i rënë dielli i mirësisë!

Po qe se miku i mirë ha pak gjellë, i zoti i shtëpisë i sjell gjellë edhe më të mira!

Përveç të zotit të shtëpisë që është koprrac! Për atë s'kemi ç'themi! Mos mendo për keq përballë ushqyesit bujar!

O ti njeriu që qëndron, që je i besueshëm, ngrije kokën lart si mali që rrezet e para të diellit të të bien ty!

Pa shih, edhe maja e atij mali që s'lëviz vendit, rri e pret rrezet e para të diellit!

Përgjigje personit të paditur e të shkujdesur që thotë
fjalë të tilla pa kuptim, si:
"Sa e këndshme do të ishte kjo botë po të mos ishte
vdekja;
sa e këndshme do të ishte pasuria e kësaj bote po të
mos i vinte fundi!

1760 Njëri thoshte: Sa e këndshme do të qe bota sikur të mos ishte vdekja që na kap për cepi të rrobës e na tërheq!

Kurse një tjetër thoshte: Po të mos ishte vdekja, kjo botë e mbushur plot vuajtje s'do të vlente për asgjë!

I ngjante një dengu drithi të grumbulluar në fushë dhe të lënë ashtu.

Kurse ti e pandehe vdekjen, në të vërtetë, ringjallje, farën e mbolle në vend të thatë e djerr!

Mendja gënjeshtare çdo gjë e sheh në të kundërtën e saj, edhe ringjalljen e pandeh vdekje, o kokëtrashë!

1765 O Zot, na e trego çdo gjë siç është në atë vend mashtrimi!

Asnjë i vdekur nuk mjerohet për vdekjen e vet, por për ushqimin e pakët.

Kurse i vdekuri del nga gropa, në fushë të hapur e të gjerë, në mirëqenie dhe jetesë të bukur!

Ai shtegton nga ky konak pesimizmi, nga ky shtrat i ngushtë deveje, në një fushë të gjerë!

Ai vend është pozitë drejtësie, jo ombrellë gënjeshtre. Atje ka një verë të posaçme, me të cilën njeriu bëhet sarhosh, jo dhallë!

1779 Ai vend është një pozitë drejtësie e tillë që me të atje rri Zoti. Ai ka shpëtuar nga kjo baltovinë që është faltorja e adhuruesve të zjarrit!

Nëse s'jeton me një trajtë të ndriçuar, të ka mbetur një frymë jetë, të paktën vdis sikur të ka ardhur vdekja!

Gjërat e kërkuara nga mëshira e Zotit që jep të mira pa e merituar robi.
Një Zot që lëshon shi pasi njerëzit e humbin shpresën.
Sa e sa largësi ka që bëhen shkak për afërsi.
Sa e sa fajtorë të bekuar ka që bëhen shkak për pendesë.
Sa e sa bekime ka që vijnë kur kërkohet e keqja.
Në këtë mënyrë, dihet se Zoti i kthen të këqijat e robve në të mirë!

Me hadith na është përcjellur se ditën e kiametit, çdo trupi i vjen urdhri "ngrihu!"

Fryrja e Briritit është urdhri i Zotit: O molekula, ngrini kryet nga toka!

Dhe atëherë, shpirti i secilit i hyn në trupin e vet ashtu siç na vjen mendja në kokë kur ngrihemi në mëngjes!

1775 Ditën e kiametit, shpirti njeh veten e vet dhe, si të ishte thesar, futet në atë rrënojë që i përket vetëm atij!

Çdo shpirt njeh trupin e vet dhe hyn në atë trup. Si mund të ndodhë që shpirti i argjendarit të hyjë në trupin e rrobaqepësit?

Shpirti i të diturit hyn në trupin e të diturit, shpirti i mizorit, në trupin e mizorit!

Ashtu siç në mëngjes, qengji e njeh t'ëmën dhe delja, birin e vet, edhe dija e Zotit u ka dhënë shpirtrave një aftësi të tillë njohëse!

Kur edhe këmba e njeh këpucën e vet në errësirë, o i bukuri im, si të mos e njohë shpirti trupin e vet?

1780 O ti që mbështetesh te Zoti, mëngjesi është një ringjallje e vogël. Eshtë edhe ringjallja e madhe që krahasoje me të!

Ashtu siç fluturon shpirti në tokë, edhe libri i punëve fluturon sa djathtas, majtas!

Dhe njeriut ia vënë në dorë librin e koprracisë dhe bujarisë, të shkruar me bëmat e tij të mira e të këqija.

Sapo të zgjohet nga gjumi në mëngjes, të mirat e të këqijat i vijnë mu aty ku ndodhet.

Po ta ketë bërë zakon dyfytyrësinë, ato i vijnë pranë kur zgjohet.

1785 Po qe se dje ka bërë të këqija dhe e ka tepruar, libri që i jepet nga e majta, i kthehet në letër zije!

Po qe se dje ka jetuar i pastër, i ruajtur nga të këqijat dhe si besimtar, kur zgjohet fiton margaritarin e çmuar.

Gjumi dhe zgjimi ynë janë dy prova për vdekjen dhe ringjalljen.

Ringjallja e vogël tregon ringjalljen e madhe; vdekja e vogël ndriçon vdekjen e madhe.

Por ky libër është imagjinar, i fshehtë. Ai del në shesh në ringjalljen e madhe!

1790 Kjo imagjinatë është këtu e fshehtë, i duken vetëm gjurmët, kurse atje merr trajtë të caktuar.

Shihe inxhinierin se si imagjinon një shtëpi si të ishte duke mbjellë farë.

Ajo imagjinatë bëhet e dukshme jashtë, pothuajse siç mbin fara nga toka.

Çdo imagjinatë që zë vend në zemër, ditën e ringjalljes do të marrë një trajtë të caktuar.

Imagjinatën e ngritur nga inxhinieri në zemër, zëre si bima e mbirë diku pasi është hedhur aty fara e saj.

1795 Synimi im për t'i shprehur përmbledhtazi këto dy ringjallje, është një metaforë; ata që besojnë e marrin pjesën e vet të mësimit prej kësaj!

Kur të lindë dielli i ditës së kiametit, çdokush, qoftë i bukur a i shëmtuar, ngrihet prej toke menjëherë!

Çdokush vrapon për në gjyqin e lartë të kazasë dhe kaderit; edhe paraja e vlefshme hynë në potën e shkrirjes, edhe paraja kallpe!

Paraja e vlefshme duke u gëzuar e duke bërë ledhe, kurse paraja kallpe, duke e tretur e përvëluar!

Dhe vijnë provat çast pas çasti, në trup duken të fshehtat e zemrës.

1800 Ashtu si kandili që duket me ujë e me vaj, që ndriçohet dhe del në shesh, ose si jep toka prodhim duke i nxjerrë të fshehta jashtë.

Ashtu siç i nxjerr dora e beharit qepën, hashashin, ashtu siç e vë në shesh të fshehtën e dimrit.

Njëri krejt i gjelbër duke thënë "ne jemi nga ata që druhen prej Zotit", tjetri, si meneksheja, me kryet poshtë!

Frika nga rënia në rrezik është shtresuar në zemër, prandaj burimet gurgullojnë dhe formohen dhjetë përrenj.

Sytë janë hapur, rrinë e presin se mos librat vijnë nga e majta.

Dhënia e librave të punëve nga e djathta nuk është gjë e lehtë, prandaj sytë vëzhgojnë djathtas e majtas!

Ndërkaq, një robi i jepet në dorë një libër i zi i mbushur plot me faje, mëkate e të këqija!

Brenda tij nuk ka as ndonjë dobi, as kryerje e ndonjë pune të mirë. Vetëm prekje e zemrës së atyre me thelbin të drejtë.

I mbushur nga koka te këmbët me të keqe, faje, fishkëllima ndaj njerëzve të rrugës mistike, tallje me ta!

Librin e tij e kanë zënë dredhitë e tij, vjedhjet, thëniet "unë", "ne" si faraonët.

Ai rob punëkeq, sapo ta këndojë librin, e kupton se s'ka vend tjetër ku të shkojë veç qelisë së errët!

Në sheshin e fajit dhe mëkatit, rruga e justifikimit, e zënë. Atëherë fillon të ecë, si hajdutët, drejt trekëmbëshit!

Ato mijëra argumente, ato mijëra fjalë të këqija, ia kanë gozhduar gojën si ndonjë gozhdë e pistë.

Në trup, në shtëpi i kanë dalë gjërat që ka vjedhur, përralla që thotë është bërë të mos e dëgjojë më kush!

Dhe vihet të ecë drejt qelisë së xhehennemit. Sepse s'ka mundësi shmangieje nga zjarri!

Edhe engjëjt, si nëpunësit, i rrinë para e pas. Fillimisht ishin të fshehtë, tani dalin në shesh si ushtarët!

E shtyjnë atë, e shpojnë me hostenët që mbajnë në duar duke i thënë: Ec, o qen, hyr në hangarin e kashtës!

Në çdo kryerruge, ai i heq këmbët zvarrë me shpresën se mos shpëton nga ajo gropë!

Rri në pritje, hesht, kapet pas një shprese dhe e kthen kokën pas.

Dhe derdh lot si shirat e vjeshtës, shpresa i është tharë, ç'i vjen doresh tjetër veç kësaj?

Çdo çast e kthen fytyrën pas dhe kthehet në drejtim të fronit të shenjtë të Zotit.

Ndërkaq, nga Zoti vjen një fjalë: O engjëjt e vendit të dritës, thojini atij dembel i zhveshur nga të gjitha shprehitë e mira!

O esencë e së keqes, ç'pret? O i hutuar, pse e kthen fytyrën pas?

Ja libri yt, libri që të ka ardhur në dorë, o ti që e fyen Zotin, që i falesh shejtanit!

E pe librin ku janë të shkruara gjërat që ke bërë! Ç'sheh tani? Shihe ndëshkimin e asaj që ke bërë!

Pse rropatesh kot më një vend?Ku është shpresa e dritës në një gropë të tillë?

As në dukje s'ke ndonjë adhurim, as brenda vetes një qëllim mirësie të fshehur!

As netëve u lute e u fale, as ditëve u shmange nga haramet, as agjërove!

As gjuhën s'e mbajte për të mos prekur këndd, as pe para e pas për të nxjerrë mësim!

Fundja çfarë ke para përveç agonisë me përmendjen e vdekjes dhe pas nga vdekja e miqve?

As bëre pendesë duke vrapuar duke u djegur nga padrejtësitë dhe mizoritë e tua, as qave e rënkove, o njeri i ulët që shite elb duke e treguar për grurë!

Peshoren e pate të shtrembër, të prapë. Tashmë pse e pret që peshorja e shpërblimit të të jetë e drejtë?

Në tradhti, në peshimin e magët pothuajse u bëre këmbë e majtë, pra, si mund të ndodhë që peshorja të të vijë nga ana e djathtë?

O shtatthyer, shpërblimi dhe ndëshkimi janë si hije; sigurisht që edhe hija jote do të të bjerë para e thyer më dysh!

Të tilla fjalë të ashpra të vijnë nga Zoti, ashtu që, sikur t'i dëgjonte mali, do ztë bëhej kurrizo!

Robi thotë: O Zot, unë jam njëqind herë më i keq se ç'thua ti, njëqind herë më i keq, njëqind herë më i keq!

Ti m'i mbulove të këqijat me butësinë tënde, kurse sti m'i di të këqijat që kam bërë!

Por le t'i lëmë mënjanë luftën time, punët e mia përtej së mirës e së keqes, herezinë, ç'kam bërë e s'kam bërë,

Lutjen time ndaj teje me dobësinë time, fantazinë time ose të qindra robve të tjerë si unë.

Unë e lidha shpresën vetëm te mirësia jote. T'i lëmë mënjanë drejtësinë ose kryeneçësinë time!

O bujar që s'mban zemërim, kam lidhur shpresë ndaj mirësisë dhe favorit tënd pa shpërblim.

Prandaj nuk e shoh punën time, por, duke u kthyer pas, shoh bujarinë tënde pa kusht!

Me atë shpresë e ktheva fytyrën. Ti ma dhe ekzistencën kur unë ende s'isha.

Më fale rrobë ekzistence pa shpërblim. Kësaj i besoja unë gjithmonë!

Kur robi i numëron gabimet dhe fajet e veta, i arrin mirësia dhe falja e Zotit.

Dhe thotë: O engjëj, sillmani prapë atë, sepse syri i zemrës së tij është në lutje dhe përgjërim!

Edhe unë të mos ia vë re, ta lë të lirë, t'u heq vizë atyre gabimeve!

Të mos i kushtosh rëndësi diçkaje është normale për personin të cilit nuk i vjen gjë prej të mirës apo të keqes së dikujt!

Nga bujaria jonë le të ndezim një zjarr të këndshëm në mënyrë që të mos i mbesë pak a shumë asnjë gabim dhe faj!

Të ndezim një zjarr të tillë që edhe shkëndija më e parëndësishme t'ia djegë edhe fajet, edhe shtrëngimet, edhe parapëlqimet!

Të lëshojmë një breshëri në vendin ku ndodhen rëndesat e njeriut, që gjembishtja të shndërrohet në një trëndafilishte!

Nga qielli i shtatë ne dërguam esencën "që jua rregullon punët tuaja"!

Tashmë, përballë asaj drite të vazhdueshme e të përjetshme, ç'janë shkëlqimi dhe maturia e atit të njerëzve?

Gjuha që e thotë atë është një copë mish, syri që e sheh, një kafshatë mish!

Veshi që e dëgjon, përbëhet prej dy copa eshtrash, kurse zemra që i ndjen, prej dy pikash gjak!

Ti je një krimbth i mbushur plot ndyrësi. Por lëshove në botë një zhurmë dhe rrapëllimë.

U krijove nga sperma, pra lëre egoizmin. O Ejaz, kujtoji opingat!

Ejazi kishte një odë ku vendoste opingat dhe postiqen.
Meqë dera e odës ishte e shëndoshë dhe e drynosur, shokët e tij pandehnin se aty kishte një thesar.

Ngaqë ishte shumë i zgjuar e i mençur, Ejazi i kishte varur postiqen dhe opingat në një dhomë.

Çdo ditë shkonte në atë dhomë bosh, i thoshte vetes të mos niste ta mbante veten më të madh se ja ku i kishte opingat!

Padishahut i thanë se ai kishte një dhomë ku kishte grumbulluar e vënë florinjtë, argjendurinat, qypat me florinj.

Ai s'fuste asnjeri në atë dhomë. Derën e dhomës e mbante gjithmonë mbyllur.

Padishahu tha: Gjë e çuditshme! Ç'është, vallë, ajo që fsheh ai shërbëtor prej nesh?

Dhe i tha një beu: Shko atje, hape derën në mes të natës dhe hyr në dhomë.

Çfarë të gjesh, grabite, kurse shokëve tregojua sekretin!

Megjithëse ka marrë aq shumë dhurata prej nesh, i kemi bërë aq shumë të mira, na grumbulloka ar e argjend nga koprracia!

Tregon besnikëri, thotë se na do dhe entuziazmohet. Hë, more ti që tregon grurë e shet elb!

Për atë që gjen ringjallje në dashuri, çdo gjë tjetër veç adhurimit është haram!

Në mes të natës, beu bashkë me tridhjetë burra të besueshëm shkoi të hapte dhomën e Ejazit.

Kishin ndezur pishtarë krenarë dhe shkonin për në dhomë me gëzim!

Thoshin me vete: Urdhër padishahu ky! Do ta hapim dhomën dhe do t'i marrim torbat me florinj!

Njëri prej tyre mendonte: Flori? Ç'ne, bre! Margaritarë, gurë të çmuar thuaj!

Sepse ai ishte shërbëtori më i shquar i padishahut! Madje, ai sot ishte si vetë jeta e padishahut!

A mund të bëhet fjalë përballë një dashurie të tillë për margaritar e perla?

Padishahu nuk dyshon për të! Ia kishte hyrë një gjesti me qëllim për ta provuar!

Atë e njihte për njeri të pastër nga çdo e metë. Megjithëkëtë, nga frika, i dridhej zemra!

Ai thoshte: Zoti e faltë! Po sikur me të vërtetë të dalë një gjë e tillë e të preket në zemër? Unë s'dua aspak ta turperoj!

S'besoj ta ketë bërë një punë të tillë, por edhe sikur ta ketë bërë, bukur fort! Ai është njeriu më i dashur për mua; le të bëjë ç'të dojë!

Atë që ka bërë i dashuri im, do të thotë se e kam bërë unë! Unë ndodhem në perde, por, në të vërtetë, ai jam unë vetë, kurse unë, ai vetë!

Pastaj – mendonte padishahu – sa larg tij janë vese të tilla! Kjo është një fjalë e kotë, një fantezi boshe!

Është e pamundur që Ejazi ta ketë bërë një gjë të tillë! Sepse ai është një det që është e pamundur t'ia gjesh fundin!

Shtatë dete janë sa një pikë të atij deti! E gjithë qenia është sa një pikë nga dallga e tij!

Nga ai det i marrin të gjitha pastërtitë. Artist që pikat e ujit i bën një e nga një kristale!

Ai është sovran i sovranëve, burim sovranësh. I është bërë emri Ejaz vetëm që të mos marrë mësysh!

Jo vetëm syri i keq, por edhe syri i mirë e merr mësysh atë. Sepse bukuria e tij s'ka kufi, gjithsesi kanë për ta patur zili!

Dua të kem një gojë të madhe si qiejt që ta lavdëroj atë bukuri që e kanë zili edhe engjëjt!

Madje, edhe sikur të kem një gojë të tillë ose të shtie në dorë një gojë të gjerë njëqind herë sa kjo, prapë atë s'e nxë!

Por, o mik që je mbështetja ime, edhe me kaq sa po them, ka për të më plasur kristali i zemrës!

M'u duk shumë delikat kristali i zemrës, por, për t'u qetësuar qoftë edhe pak, grisa gjithë ato xhybe!

I bukuri im, çdo fillim muaji unë patjetër do të bëhet tri ditë i marrë!

Eja në vete se sot është e para nga ato tri ditë. Sot është ditë fitoreje, jo melankolie!

Për çdo zemër që bie në hallin e padishahut, fillim muaji është çdo çast!

U marrosa dhe, me tregimin për Mahmudin, nuk i thashë dot cilësitë e Ejazit! Por, ç'të bësh, u bë një herë kjo punë!

Të thënat përbëhen nga trajta e jashtme e tregimit, thuhen sipas aftësisë kuptuese të atyre që munden ta kuptojnë trajtën, sipas pasqyrës së imagjinatës së tyre. Po qe se zbres në shenjtërinë e të vërtetës së kësaj historie dhe tentoj ta them, nga turpi edhe koka ka për të më humbur, edhe mjekra, edhe kalemi. Për të mençurin një shenjë mjafton!

Sepse elefanti im pa në ëndërr Indinë. Fshati u bë gërmadhë. Prije shpresën nga haraçi.

Pasi të më jetë prishur mendja, si mund të thur vargje, si mund të sajoj rima?

Me hallet që kam, s'kam vetëm një marrëzi që! Tek unë ka marrëzi brenda në marrëzi!

Qysh kur trupi im e pa qenien në mosqenie, u shkri nga shenjat e fshehta, mbaroi!

O Ejaz, dobësova e u bëra si qime nga dashuria për ty, mbeta pa e treguar historinë tënde, pra, tani, thuaje ti historinë time!

Unë e thashë shumë historinë tënde me ashk. Tashmë unë u bëra histori dhe ti këndoje historinë time!

O person që të shkoj pas, fundja, ti këndon, unë nuk këndoj dot! Unë i ngjaj malit Sina, ti je Musai, kurse ky, zëri.

Ç'të dinë mali dhe fjala e shkretë? Mali është krejt i zbrazët, kurse fjalën e di Musai.

Mali mund të dijë aq sa mundet. Trupi zotëron pak gjë nga transparenca e shpirtit!

Po ta llogarisësh, trupi i ngjet astrolabit, është provë e shpirtit që i ngjet diellit!

Astronomi që nuk i shohin mirë sytë, është i detyruar ta përdorë astrolabin.

Diellin duhet ta llogarisë me astrolab në mënyrë që të nuhasë diçka se ku ndodhet.

Shpirti që e dallon të drejtën me astrolab, sa mund t'i njohë qiellin dhe diellin?

Për sa kohë që ti të vështrosh me astrolabin e syve, ke për ta parë botën shumë të ngushtë!

Ti mund ta shohësh botën me sa ta nxënë sytë. Mirëpo ku bota e ku ti! Pse i shtremëron mustaqet?

Arifët kanë një syrme; kërkoje atë dhe sytë që të ngjajnë me përroin, të të bëhen det!

Edhe sikur të kem mendje dhe zgjuarsi sa një thërrime, ç'sevda është kjo, ç'fjalë e marrë?

Po s'pata mend në kokë, ç'mëkat kam këtu?

Unë s'kam mëkat, por as i dashuri që m'i ka marrë mendtë, s'ka mëkat. Të gjitha mendjet e mendjeve vdesin e mbarojnë para tij!

O ti që u lëshon intrigë mendjeve, që i lë të mahnitura ato, mendjet s'kanë vend tjetër për t'u strehuar përveç se tek ti!

Qysh nga koha kur më marrose mua, nuk e dëshirova fare mendjen. Qysh atëherë kur më stolise e zbukurove mua, nuk e pata fare zili bukurinë!

A s'është e mirë dhe e këndshme të bie pas dashurisë tënde e të marrosem? Zoti të dhëntë mbarësi!

Edhe sikur të flasë arabisht, edhe sikur të flasë persisht, ku është ai vesh e ku është ajo mendje që ta dëgjojnë dhe kuptojnë?

Vera e tij nuk është për çdo mendje! Vëthi i tij nuk është lodra e çdo veshi!

Ja ku erdha edhe një herë tjetër marrëzisht. Ec, ec, o shpirt, sill shpejt një zinxhir!

Mirëpo dijeni se, me përjashtim të cullufeve të së dashurës, këpus edhe dyqind zinxhirë, po të jenë!

Sipas konkluzionit "shihe njeriun pse u krijua", shkaku i shikimit të opingave dhe qyrkut.

Kthehu përsëri te historia e Ejazit! Sepse ajo histori është një thesar i mbushur plot me të fshehta!

Ai shkonte çdo ditë në atë dhomë të bukur për t'i parë postiqen dhe opingat.

Sepse pasuria e deh njeriun mirë e mirë, ia merr mendtë kreje, ia heq ndjenjën e turpit nga zemra!

Sa e sa fise e popuj i shembi përtokë dehja nga kamja dhe pasuria!

Edhe Iblisi, duke menduar se pse Ademi të jetë më i lartë se ai, u bë Azazil!

Unë jam edhe mësues, edhe bir mësuesi. Kam aftësi për qindramijëra mjeshtërira, mund të bëj çdo gjë!

Në mjeshtëri dhe aftësi nuk jam më poshtë se askush që të rri në këmbë para armikut për t'i bërë shërbim!

Unë linda nga zjarri, kurse ai, nga dheu. Ç'vlerë ka dheu ndaj zjarrit?

Ku ndodhej ai kur unë isha më i larti i botës, personi i përlavdëruar i kohës?

Siç është thënë se "Zoti i krijoi xhindet nga zjarri pa tym", gjithashtu, Zoti ka thënë për Iblisin: "Nuk ka dyshim se ai ishte nga lloi i xhindve dhe doli nga urdhri i Zotit!"

Zjarri i shpirtit të shejtanit po flakëron. Eshtë një zjarr i tillë, si origjina e vet! Eshtë thënë se biri është e fshehta e të atit!

Jo, e thashë gabim! Ai zjarr është persekutimi dhe ndëshkimi i Zotit! Ç'nevojë ka për të treguar një shkak në këtë specifikë?

Puna pa shkak dhe që s'ka asnjë lidhje me shkaqet, vjen e tillë qysh në pafillimshmëri!

1930 Në artin e tij pa shkak e pa pasojë s'mund të futet as shkaku i ndonjë gjëje të krijuar spas, as ndonjë gjë vetë e krijuar pas!

Ç'domethënë e fshehta e të atit? Ati ynë është krijimi i tij! Krijimi është brendësia, kurse ati, babai, është një trajtë që i përngjet lëkurës a lëvozhgës!

Dije, o lajthi ashku se miku yt është ashk! Ai dëshiron të ta bëjë shpirtin brendësi, përmbajtje, prandaj ta gris lëkurën, ta derdh!

Lëkurën e personit që ka për të dashur lëkurën, Zoti e ndërron çdo çast e pa pushim.

Shpirtërisht, brendësia jote sundon mbi zjarrin, kurse lëkurët apo lëvozhgët mund të bëhen vetëm dru për zjarrin!

1935 Fuqia e zjarrin ndodhet jashtë shtambës prej druri që ka brenda ujë.

E fshehta e ujit është më e lartë se zjarri. A mund të shkatërrohet në zjarr Sunduesi i xhehennemit?

Prandaj, ti mos e shumëfisho trupin, por kujdesu që kuptimin ta kesh të shumtë që, si Sundimtari, të jesh më i lartë se zjarri!

Mirëpo ti vesh sipër lëkurë mbi lëkurë, kthehesh në krimb me shumë lëkura!

E ngrëna e zjarrit është vetëm lëkura, lëvozhga. Persekutimi i Zotit e gris, e rrjep lëkurën e mendjemadhësisë!

1940 Kjo mbajtje më të madh është rezultat i lëkurës. Pozita dhe pasuria e mendjemadhit formohet nga lëkura, nga ajo e dashur!

Ç'është kjo e mbajtur më të madh? Të mos dish gjë për brendësinë. Si indiferentizmi i ujit të ngrirë ndaj diellit.

Por sa të bjerë dielli mbi të e ta ngrohë, domethënë, uji të mos jetë më indiferent ndaj diellit, nuk i mbetet më akull, ngrohet dhe kullon.

Ta shohësh brendësinë, do të thotë ta nënçmosh krejt trupin, të bëhesh ashik. Sepse, në këtë mënyrë, i gjithë trupi shndërrohet në lakmi. Është thënë se "lakmuesit i bie vlera"!

Por kush nuk e sheh brendinë, mjaftohet me lëkurën. Kushti "kush mjaftohet me pak" i bëhet burg atij!

1945 Këtu, lartësimi është herezi, është nënçmim i fesë. Pa u shkëputur nga qenia gur i thjeshtë, a vihet guri i thjeshtë në unazë?

Edhe je ende gur, edhe pretendon se je diçka. Kurse është pikërisht koha që ti të asgjësohesh!

Mohuesi, heretiku kërkon vazhdimisht pasuri dhe pozitë. Sepse shërbyesi i vatrës së zjarrit e mat veten me jashtëqitje!

Këto dy dado, paburia dhe pozita, e fryjnë lëkurën duke e mbushur me dhjamë, mish, mendjemadhësi dhe egoizëm!

Heretikët nuk i hodhën sytë në brendësi të punës, prandaj e pandehën lëkurën për përmbajtje.

1950 Iblisi është kallauzi i kësaj rruge. Sepse ai është i pari që është kapur në kurthin e pozitës.

Malli dhe pasuria i përngjasin gjarpërit, kurse pozita është kuçedër. Hija e burrave të Zotit është smerald për këto të dyja.

Gjarpërit i merren sytë nga ai smerald, verbohet dhe, atëherë, udhëtari shpëton!

Ai i madhi, domethënë, Iblisi, në fillim ka shtruar gjemba në këtë rrugë. Prandaj çdokush që shpohet, e mallkon shejtanin.

Pra, kjo vuajtje më erdhi mua nga hileja e tij. Në hile, në fillim fare, ai që është këmbë dëshiron të thotë se ai është!

1955 Pastaj kanë kaluar shumë kohë, kanë ardhur shumë e shumë vetë, por çdo njeri ka shkelur në rrugën e tij!

O trim, nëse dikush vë një zakon të keq dhe populli i përshtatet atij zakoni nga verbëria,

Mëkati i të gjithë atyre që e zbatojnë atë zakon i shkruhet atij që e ka vënë i pari atë zakon. Sepse ai është kreu, kurse të tjerët, bishti!

Por Ademi i ka vënë para postiqen dhe opingat ngase ka menduar se është krijuar nga dheu!

Si Ejazi. Edhe ai i mbajti opingat para syve dhe, më në fund, pati një fund të lavdërueshëm!

1960 Qenia absolute krijon vazhdimisht mosqeniet. A ka vend pune që krijon të qenë përveç të paqenës?

A shkruan njeriu mbi letrën e shkruar ose a mbjell fidan në fidanishten e mbjellë?

Për të shkruar, kërkon një letër të pashkruar, për të mbjellë farë kërkon një parcelë ku nuk është hedhur farë!

Edhe ti, o vëlla, bëhu një rrugë ku nuk është hedhur farë, bëhu një letër e pashkruar

Dhe fito nder me shkrimin e ri dhe ai bujar të mbjellë farë tek ti

1965 Dhe mbetu pa e shijuar këtë paluze dhe bëj sikur s'e ke parë gjellëtoren që pe!

Sepse kjo paluze i jep njeriut dehje dhe atëherë atij i dalin nga mendja opingat me postiqen!

Dhe kur të të vijë koha e vdekjes dhe e dhënies së shpirtit, mjerohesh dhe atëherë kujtohesh për opingat dhe postiqen!

Por pa u zhytur në dallgën e shëmtisë, pa u gjetur një strehim për ty,

As e çon nëpërmend atë gjemi të rregullt, as ua hedh sytë opingave dhe postiqes!

1970 Por nëse zhytesh në detin e mosqenies dhe mbetesh i dobët e i paaftë, jepesh pas çështjes së dashurisë dhe nis të thuash "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes!"

Shejtani thotë: Pa shiheni këtë kungull të papjekur! Hiqjani kokën këtij gjeli që këndon pa kohë!

Ky ves është larg zgjuarsisë së Ejazit. Ai nuk fal namaz pa u lutur e përgjëruar!

Ai është gjeli në qiell edhe më parë. Vështrimet e tij janë pikërisht në kohë!

Kuptimi i hadithit "Çdo gjë na e trego siç është", i thënies "Po të ngrihej perdja, nuk do të shihja dhe nuk do të dija më shumë se ç'di dhe se ç'shoh", si dhe i dyvargshit "Kë të shohësh me sy të keq, dije se e sheh nga korniza e qenies tënde, se e sheh keq atë nga që je vetë i keq". Hija e shkallares së shkallës së pjerrët është e pjerrët.

O gjela, mësojeni të kënduarit nga ai që këndon jo për para, por për hir të Zotit!

1975 Zbardhja e rremë nuk e gënjeh dot atë. Zbardhja e rremë është për të bota e së mirës dhe së keqes.

Ngaqë mendja e njerëzve të kësaj bote është e mangët, zbardhjen e rremë, të parakohshme, e pandehin për mëngjes të vërtetë!

Zbardhja e rremë ka prishur sa e sa udhë karvanesh. Duke e pandehur atë zbardhje të rremë për mëngjes të vërtetë, karvanxhinjtë kanë dalë në udhë.

Mëngjesi i rremë të mos bëhet kallauz për popullin. Sepse ua ka dhënë erës sa e sa karvane!

O ti që kapesh pas mëngjesit të rremë, mos e shih mëngjesin e vërtetë si të rremë!

1980 Nëse ke shpëtuar nga hipokrizia dhe e keqja, pse mendon keq për tët vëlla, tregohesh me dy fytyra ndaj tij?

Puna e atij që mendon për keq, është gjithmonë e shëmtuar. Edhe për mikun ai këndon librin e vet!

Personat e poshtër të mbetur në shtrembërira, edhe pejgamberëve u thanë magjistarë dhe njerëz të shtrembër.

Edhe ata bejlerët e ulët me mendime të këqija, u kapër pas mendimeve të tilla të këqija për dhomën e Ejazit.

Thanë se atje ai kishte thesaret. T'i shohësh të tjerët në pasqyrën tënde!

1985 Padishahu e dinte se ai ishte i pastër. Hetimin ai e bënte për ta!

Dhe atij beut i tha: Hape dhomën në mesnatë që ai të mos marrë vesh gjë.

Kështu, t'i dalin në shesh mendimet. Pastaj e di unë se ç'do t'i bëj atij!

Kurse florinjtë dhe margaritarët jua kam falur juve! Vetëm më thoni se ç'do të zbuloni! Vetëm kaq!

U tha, por, megjithatë, i dridhej zemra për atë Ejazin e pashoq!

1990 Dhe thoshte me vete: A unë po i them këto fjalë? Po t'i dëgjojë këto fjalë, në ç'gjendje vjen?

Pastaj thoshte: Për fenë, kujdesi i tij është më shumë se kaq!

Ai nuk nxehet nga qortimi im, nuk preket nga fjala ime, e kupton synimin tim, të fshehtën time!

Kush bie në një ngatërresë ose fatkeqësi, nuk shkatërrohet nga ajo vuajtje, por bën shumë interpretime.

Edhe Ejazi është i durueshëm, bën interpretime. Ai sheh fundin e punës!

1995 Si Jusufi, i shpjegon ëndrrat e këtyre të burgosurve këtu, se shpjegimi i ëndrrave qër të është i qartë.

Kush nuk e shpjegon dot ëndrrën e vet, si mund t'i shpjegojë ëndrrat e të tjerëve?

Edhe po e vura unë në provë atë, edhe po i rashë qindra shpata për shkak të vënies në provë, prapëseprapë, dashuria e atij njeriu të dashur nuk pakësohet!

Ai e di se atë shpatë unë ia ngul vetes. Sepse unë jam ai dhe, në të vërtetë, ai është unë!

Lutja është, në dukje, e kundërta e trillit, por, në të vërtetë,
i dashuruari me të dashuruarin janë Një megjithëse në dukje janë të kundërt.
Kështu, pasqyra nuk ka trajtë dhe mungesa e trajtës është e kundërta e trajtës.
Por mes pasqyrës dhe trajtës ka unitet. Shtjellimi i kësaj vazhdon gjatë.
Për atë që ka mend, një shenjë mjafton.

Nga vuajtja e ndarjes, Mexhnuni u sëmur papritmas.

2000 Gjaku i zjente me flakën e dëshirës, më në fund, u sëmur nga grykët!

Erdhi mjeku për ta mjekuar dhe pa se s'kishte shpëtim tjetër veçse t'i çahej damari dhe t'i merrej gjak.

Ai tha se duhej një kirurg. Atëherë thirrën një kirurg të aftë.

Ai ia lidhi krahun dhe kur do ta shponte vendin e fryrë, ashiku, hallin e të cilit e përbënte ashku, lëshoi një britmë.

Dhe tha: Merri paratë dhe shko, mos më shpo. Po të jetë për të vdekur, le të vdes! U shoftë ky kurm i shuar!

2005 Kirurgu i tha: Pse ke frikë nga kjo? Ti nuk ke frikë as nga luani që bulërin!

Natën të mblidhen përreth luanët, ujqit, arinjtë, e të gjitha kafshët e egra rathë rathë.

Ata nuk shohin tek ti asgjë tjetër veç ashkut dhe vuajtjes; tek ti ata nuk nuhasin erë njeriu!

Edhe ujku, ariu dhe luani e dinë se ç'është ashku. Njeriu i verbuar nga ashku i tepërt është më i ulët se qeni!

Po qe se tek qeni nuk do të kishte damar ashku, a do t'i kërkonte qeni i Shokëve të Shpellës njerëzit e zemrës?

2010 Në botë ka shumë qenër të llojit të tij por që nuk janë bërë të njohur.

Kurse ti nuk ke nuhatur gjë as prej atij që është i llojit tënd, madje! Atëherë, si do ta nuhatësh ashkun nga ujku dhe delja?

Po të mos ishte ashku, si do të kishte ekzistencë? Si do të mundej të vinte buka e të bëhej pjesë e trupit tënd?

Buka t'u bashkua me qenien tënde. Pse? Nga ashku dhe dëshira! Ndryshe, a ka mundësi që buka të bëhet shpirt?

Ashku e bën shpirt dhe jetë bukën pa shpirt, jetën e vdekshme e bën të pavdekshme.

2015 Mexhnuni tha: Unë nuk kam frikë nga plaga. Durimin e kam më të madh se malet prej gurësh!

Madje e kam të pamundur të rri pa plagë. Për plagët kam pasion dhe shkoj pas tyre me vrap!

Por trupin e kam të mbushur me Lejlanë. Kjo guaskë sedefi është e mbushur me cilësitë e asaj perle.

O shërues plagësh, kam frikë se, duke më prerë mua, i hap plagë Lejlasë!

Personi i mençur me zemrën të ndriçuar e di se mes meje dhe Lejlasë nuk ka dallim!

Një e dashur e pyeti të dashurin: A mua më do më shumë, apo veten?
I dashuri i tha: Unë vetë kam vdekur, kam shpëtuar nga vetja, me ty jam ringjallur.
Jam bërë i paqenë nga qenia ime, nga cilësitë e mia dhe me ty jam bërë i qenë.
Diturinë time e kam harruar, me diturinë tënde jam bërë zotërues dijeje.
Forcën time e kam hequr nga mendja dhe kam marrë forcë me ty.
Po të të dua ty, kam dashur vetveten. Personi që ka pasqyrë të njohjes kategorike,
edhe nëse sheh veten në të, ka parë Zotin.
Në këtë mënyrë, është thënë:
"Vishu me cilësitë e mia dhe duku te njerëzit; ai që të sheh ty, më ka parë mua,
ai që të drejtohet ty, më drejtohet mua!"
Ja, gjithmonë kështu shkon kjo!

Për t'ia provuar dashurinë, një e dashur e pyeti kështu një mëngjes të dashurin:

O filani i biri i filanit, o ashik i vuajtur, më thuaj drejt, a mua më do më shumë, apo veten?

Ashiku i tha: Unë aq jam shkrirë tek ti, sa jam i mbushur me ty nga maja e kokës te maja e thoit!

Nga qenia s'më ka mbetur asgjë tjetër veç emrit! O bukuroshja ime, në trupin tim s'ka qenie tjetër veç teje!

Prandaj, ashtu siç asgjësohet uthulla në detin e mjaltit, ashtu dhe unë jam asgjësuar tek ti!

A nuk kthehet guri i zakonshëm në gur të çmuar duke u mbushur me cilësitë e diellit? Ja, ashtu!

Atëherë tek ai s'mbetet më cilësi prej guri të zakonshëm. Ai mbushet edhe para me cilësitë e diellit, edhe pas!

Pas kësaj, nëse e do veten, do të thotë se e do diellin, o bota ime!

Nëse ai e do diellin me gjithë shpirt, nuk ka dyshim se e do veten!

Guri i çmuar le ta dojë veten ose le ta dojë diellin.

Sepse nuk ka dallim në këto dy dashuri. Në të dy anët nuk ka gjë tjetër veç dritës së lindjes!

Por pa u bërë ende gur i çmuar, guri i zakonshëm është armik i vetvetes. Sepse aty ka jo një qenie, por dy qenie.

Sepse guri i zakonshëm është errësirë, është i verbër edhe ditën. Errësira është, në të vërtetë, e kundërta e dritës!

Ai e dashuron veten, është mohues dhe heretik. Sepse vazhdon ta pengojë diellin e madh!

Në këto kushte, të thotë guri i zakonshëm "unë", nuk është diçka e hijshme! Sepse ai është vazhdimisht në errësirë, në mosqenie!

Faraoni tha "unë jam Zot" dhe u poshtërua, Mansuri tha "unë është Zoti", shpëtoi!

Pas thënies "unë" arriti menjëherë mallkimi i Zotit. Por, o njeri që dashuron, pas thënies "unë" arriti menjëherë mëshira e Zotit!

Sepse ai ishte gur i zi, kurse ky, gur i çmuar. Ai ishte armik i dritës, ky i dashuri i dritës.

Thënia e dytë "unë", o llafazan, do të thotë, në të vërtetë, "ai". Por nuk është as si bashkimi i njësuar i dy gjërave, as si hyrja e një gjëje tek tjetra!

Përpiqu që të të pakësohet qenia si gur i zakonshëm, bëhu gur i çmuar që të ndriçuohesh e zbukurohesh!

Bëhu i durueshëm në heqjen e mundimeve të luftës dhe gjej ekzistencë në mosekzistencë!

Që tek ti gjithmonë të pakësohet cilësia si gur i zakonshëm dhe të forcohet cilësia si gur i çmuar!

Që nga trupi të të ikë cilësia e qenies dhe dehja në kokë të të shtohet.

Bëhu vesh krejt si veshi që të të vënë si vath një gur të çmuar.

Nëse edhe ti je burrë si burri që gërmon dhe hap pus, gërmoje pusin e këtij kurmi dhe arri te uji!

Por nëse ujit të kthjellët i vjen një tërheqje prej Zotit, uji shpërthen nga toka edhe pa e gërmuar tokën!

Por ti mos ia vër veshin kësaj dhe vazhdo të gërmosh duke e thelluar dalngadalë vendin.

Kush përpiqet e vuan, e gjen thesarin. Kush punon e përpiqet, arrin lumturinë!

Pejgamberi tha se rukuja dhe sexhdeja trokasin në portën e Zotit.

Dhe kush të trokasë në atë portë, e arrin lumturinë!

Beu prishës shkon natën me ushtarë dhe hap odën e Ejazit
ku sheh të varura opingat dhe postiqen;
duke e pandehur lojë këtë, rrëmon të gjitha anët e dhomës, çan vendet ku dyshon,
sjell gropëhapësit, shpon muret dhe më në fund, pas s'gjen asgjë,
turpërohet dhe e humb shpresën.
Po kështu, ata që u kapën pas mendimeve dhe fantazive,
u thanë magjistarë pejgamberëve dhe velinjve,
thanë se ata e bëjnë atë punë nga vetja dhe se kërkojnë lartësim dhe hyjnitet.
Pastaj, kur e hetuan të vërtetën, u turpëruan dhe nuk patën asnjë dobi!

Ata njerëz të bindur e të sigurt në ç'po bënin, shkuan te dera e dhomës për të gjetur thesare, flori dhe qypa me florinj!

Pas shumë rropatjesh e mundimesh, e hapën drynin.

Sepse dryni ishte shumë i shëndoshë, ishte ndryrë ashtu siç duhej. Gjithashtu, nuk ngjiste me dryna të tjerë!

Ejazi e kishte drynosur atë dhomë jo nga lakmia apo për t'i fshehur pasuritë dhe thesaret, por për ta fshehur sekretin nga njerëzit!

Ai pati thënë: Disa njerëz kapen pas iluzionesh të këqija, kurse disa të tjerë më quajnë hipokrit!

Njerëzit e mirë kanë sekrete të tilla që i fshehin nga njerëzit e ulët siç fshihet minerali i çmuar!

Por për kokëtrashët, floriri është më i mirë se shpirti. Kurse pranë sovranëve shpirtërorë, shpërndahet flori shpirti!

E, kështu, ata vraponin me nxitim pas floririt. Mendja u thoshte të mos nxitonin ashtu, por kush dëgjonte?

Lakmia vrapon kot më kot pas mirazhit, iluzionit optik në shkretëtirë, ndërkaq që arsyeja i thotë njeriut t'i hapë sytë mirë se ajo që sheh nuk është ujë!

Lakmia kishte triumfuar, kurse floriri ishte i dashur si shpirti! Tashmë atë çast, zëri i arsyes ishte bërë që të mos dëgjohej!

Lakmitë dhe grindjet u ishin qindfishuar menjëherë. Maturia dhe orientimi i arsyes ishte fshehur.

Më në fund do të binin në gropën e vetëmashtrimit dhe atëherë do ta dëgjonin qortimin e urtësisë!

Kur, të ngecur në rrjetë, do t'u thyhej krenaria, do të dëgjonin qortimin e vetvetes së maturuar.

Këta lloj njerëzish mbeten të shurdhër gjersa të mos u jetë përplasur koka në murin e ngatërresave dhe fatkeqësive!

Lakmia për hallvë dhe sheqer i bën fëmijët të shurdhër nga të dy veshët ndaj këshillave.

Por kur fillojnë t'u dalin çibanë, veshët u hapen dhe i dëgjojnë këshillat!

Ata pak vetë e hapën derën e dhomës me qindra lakmi, me qindra iluzione!

Dhe u futën brenda duke shtyrë e shkelur njëri-tjetrin si mizat që mblidhen rreth dhallit që ka marrë erë dhe bien brenda!

Edhe mizat hidhen në dhallë me potere e me nxit, por, kur bien brenda, nuk gjejnë mundësi të pijnë se u lagen krahët dhe mbeten brenda!

Edhe ata burra hynë brenda dhe filluan të vështrojnë djathtas e majtas, por aty s'ndodhej gjë tjetër veç një palë opingash të çara e një qyrku të vjetër.

Kurse ata menduan përsëri: Kjo dhomë s'mund të jetë bosh. Këto opinga janë vënë për të maskuar diçka.

Le të sjellim kazma të mprehta dhe ta gërmojmë vendin.

Dhe e gërmuan dhe e shpuan vendin nga të katër anët. Hapën vrima dhe gropa të thella!

Kur po hapnin gropa, gropat u thoshin se aty s'kishte gjë.

Më në fund, pasi s'gjetën gjë, u turpëruan nga pandehma e tyre dhe filluan t'i mbushnin gropat!

Secili thoshte me vete "Lahavle". Zogjtë e lakmisë kishin mbetur pa ushqim!

Vrimat dhe të çarat e derës e të mureve ishin dëshmitare të mbrapshtisë së tyre boshe!

Si të mos ishin mure, muret dëshmonin para Ejazit kundër tyre në mënyrë që të mos mund të gënjenin!

Po qe se hidhet dyshim mbi një të pafajshëm, edhe muret dëshmojnë!

Shkurt, shkuan te padishahu të pluhurosur fund e krye, të zverdhur në fytyrë e të turpëruar!

Keqbërësit shkojnë te padishahu nga oda e Ejazit me torbat bosh dhe të turpëruar.
Kështu, siç thuhet në ajetet
"Ajo ditë është një ditë e tillë kur disa fytyra zbardhen dhe disa nxihen."
dhe "Ata që i kanë atribuar Zotit gënjeshtra, i sheh tek u janë bërë fytyrat sterrë të zeza",
kur u kuptua se pejgamberët ishin të pastër nga të këqijat,
ata që kanë rënë në mendime të këqija për ta, turpërohen.

Duke e fshehur enkas mendimin e vet, padishahu i pyeti: Ju qoftë e mbarë, s'keni nën sqetulla as flori, as torba!

Po qe se paratë dhe copat e shtrenjta i keni fshehur, ku është gëzimi në fytyrat tuaja?

Rrënja prodhon fshehtaz, hapet fshehtaz, por gjethet e blerta që janë "gëzimi i dukur në fytyra", është sheshit!

Dega e ngjitur lart e shpall me të bërtitur helmin apo sheqerin që ka thithur nga rrënjët!

Nëse në rrënjë nuk ka ndonjë tharm, ndonjë pasuri ushqimore, gjethet jeshile ç'janë?

Edhe sikur dheu t'ua vulosë gojën rrënjëve, degët, domethënë, këmbët e duart dëshmojnë!

Ata burra të sigurt në vetvete, ranë menjëherë së bashku si hije me ballin në tokë para padishahut dhe i kërkuan të falur!

Për t'u lutur për ndjesën e asaj nxehjeje, e saj çështjeje egoizmi, shkuan në audiencë me shpata dhe qefine.

Nga turpi, të gjithë kafshonin thonjtë. Secili thoshte: O sundimtar i botës!

Po të na e derdhësh gjakun, të qoftë hallall! Por po na e fale jetën, edhe kjo është një mirësi e madhe, një favor!

Ne bëmë atë për të cilën ishim të denjë! Tashmë, o sundimtar i madh, si të urdhërosh, urdhëro!

O sundimtar që i ndriçon zemrat, po të mos na e falësh fajin, është e drejta jote, po të na e falësh, është e mira jote! Në këtë mënyrë, natën ke vepruar si për natë dhe ditën, si për ditë!

Po na fale, rimbushemi me shpresë, po s'na fale, qindra si ne t'u bëfshin fli!

Padishahu u tha: Unë s'e dua këtë lutje e përgjërim! Kjo është e drejta e Ejazit!

Padishahu ia lë Ejazit t'i pranojë pendesat e keqbërësve,
e atyre që e hapën atë odë,
dhe ia lë opinionit të tij rregullimin e ndëshkimit të tyre.
Në këtë mënyrë, padishahu thotë se kjo e keqe i është bërë Ejazit dhe jo atij vetë.

Kjo e keqe s'më është bërë mua, por atij. Kjo plagë u është hapur damarëve të atij skllavi punëmirë!

Për sa i përket shpirtit jemi njëlloj, por, në dukje, unë jam larg këtij fitimi apo dëmi!

Nuk është turp për sundimtarin që të dyshojë për nënshtetasin. Kjo vetëm sa tregon për butësinë dhe bujarinë e sundimtarit!

Nëse me mirësinë e tij, sundimtari e bën të pasur si Karuni të dyshuarin, ç'mund të bëjë për të pafajshmin?

Mos e pandeh sundimtarin për indiferent! Ai i di bëmat e çdokujt. Vetëm se butësia nuk ia lejon ta nxjerrë jashtë atë që di!

Përballë dijes së tij, "kush mund të bëhet falës"? Kush tjetër përveç butësisë së tij mund të falë pa kursim?

Fundja, faji fillimisht bëhet për shkak të butësisë së tij, ndryshe, frika prej tij kujt do t'i linte fuqi për të kryer faj?

Dëmshpërblimi i gjakut i vrasësit i është lënë butësisë së padishahut!

Vetvetja na ishte e dehur, nuk ishim në vete! Nuk dinte gjë për atë butësi. Shejtani përfitoi nga dehja e tij dhe iu ul mu në vatër!

Po qe se sakiu i butësisë nuk do të kishte shtënë verë, si do të hynte Shejtani në grindje me Ademin?

Kur engjëjve iu dhanë njohuri, Ademi ishte mësuesi i tyre, ai e shihte karatin e parave!

Por meqë piu verën e butësisë në xhennet, iu zverdh fytyra nga loja e Shejtanit!

Ajo ngatërresë ishin perlat e mësimit që i dha Zoti. Zoti e kishte bërë shpejt zotërues të shkathët të dijes.

Gjithashtu, opiumi i fuqishëm i diturisë së Zotit e kishte lëshuar Shejtanin grabitës drejt gjërave të tij.

Arsyeja vjen e strehohet në butësinë e tij duke i thënë: Ti je sakiu im, kapmë për dore!

Padishahu i thotë Ejazit në dashtë t'i falë, në dashtë t'i dënojë.
Përsa i përket drejtësisë dhe favorit, secila është e drejtë dhe në secilën ka përfitime.
Ashtu siç ka në drejtësi mijra favore të fshehura, ashtu dhe "Në ndëshkimin një për një (kisas) për ju ka jetë".
Ai që, përsa i përket jetës së vrasësit, nuk e sheh të përshtatshëm ndëshkimin një për një, sheh vetëm jetën e tij, nuk sheh jetën e qindramijra të pafajshmëve
që do të druheshin për ta bërë një punë të tillë!

O Ejaz, vendos për fajtorët! O Ejaz i pastër që ruhesh e druhesh qindra herë nga të këqijat!

Sikur të të vë në provë duke të zjerë dyqind herë, prapë nuk gjej dot ndonjë hile tek ti!

Njerëz të panumërt turpërohen nga vënia në provë, kurse në provat ti e le të turpëruar çdokënd.

Kjo nuk është vetëm dije, por një det që s'ka fund. Kjo nuk është thjesht butësi, por pothuajse mal, madje, qindra male!

Pasi i tha padishahu këto fjalë, Ejazi tha: Sovrani im, kjo mirësi dhe favor janë mirësia dhe favori yt. Kështu e di unë këtë. Kurse unë s'jam gjë tjetër veçse një palë opinga dhe një postiqe!

Prandaj Pejgamberi e tregoi këtë dhe tha: Kush e njeh veten, njeh Zotin e vet!

Opingat të janë spermë, postiqja, gjak. O mësues, përtej kësaj, gjithçka tjetër është mirësia e tij!

Mos thuaj s'ka tjetër, se kjo është vetëm kaq! Ka dhënë që të kërkosh edhe më shumë.

Kopshtari të jep disa kokrra mollë që të dish për fidanet dhe prodhimet e kopshtit të tij!

Grurëshitësi i jep blerësit një grusht grurë, por ia jep që ta kuptojë se ç'grurë ka në hambar.

Mësuesi të tregon disa shembuj të hollë që t'ia kuptosh diturinë, sasinë e diturisë.

Ndryshe, po the se dituria e tij kaq është, të hedh tutje sikur të shkundte mjekrën nga papastërtitë, dhe të largon nga vetja!

O Ejaz, eja tani dhe jepe dënimin. Vër themelin e një drejtësie të paparë në botë!

Fajtorët e kanë hak vdekjen, por kanë shpresë në butësinë dhe faljen tënde, këtë lakmojnë.

Ta shohim, mëshira do të të dalë më e fortë, apo zemërimi. A eliksiri do të dalë në sipërfaqe, apo flaka!

Për t'i gjuajtur njerëzit, qysh nga marrëveshja e Elestit, ekzistojnë edhe dega e butësisë, edhe dega e ashpërsisë. Që të dyja.

Prandaj, në atë fjalën e hapur të Elestit, miratimi dhe kundërshtimi janë të barazvlershëm mes tyre.

Sepse kjo fjalë është një hetim që bën të ditur miratimin, por në të, fjala "lejse-nuk është" është e groposur.

Mjaft me kaq, me këtë shpjegim të thjeshtë. Mos ua vër njerëzve të thjeshtë para poçen e të shquarve!

Persekutimi i Allahut i ngjet murtajës, kurse favori i tij, flladit të mëngjesit. Njëri tërheq hekurin, tjetri, fijet e kashtës!

Zoti i tërheq të drejtat gjer në udhën e drejtë. Kurse të shtrembërit, tërheqin gjërat e shtrembra!

Stomaku, nëse e pëlqen hallvën, tërheq hallvën; nëse i përket lëngut të tëmthit, kërkon uthullën.

Dyshemeja e nxehtë merr të ftohtit e atij që rri mbi të, kurse dyshemeja e ftohtë ia merr të nxehtit.

Po pe mik, të zjen dashuria, po pe armik, nxehesh, zemërohesh!

O Ejaz, mbaroje shpejt këtë punë, sepse kjo është një lloj shpagimi, gjë që pritet!

Padishahu e urdhëron Ejazin të nxitohet, duke i thënë:
"Merr shpejt një vendim, mos prit dhe mos thuaj
"ditët janë tonat, disa herë ju ndihmojnë juve, disa herë, neve",
sepse pritja është më e keqe se vdekja!"
Përgjigjja e Ejazit.

Ejazi i tha: Sovrani im, i gjithë fermani është yti. Kur ka diell, yjet nuk duken!

Ç'janë Venusi, Mërkuri ose meteorët që të mund të duken ndërsa ka diell?

Po të mundja të hiqja dorë nga hirka dhe postiqja, a do të mbillja kështu farë qortimi?

Pse e hapën drynin e derës së dhomës? Ç'shpresonin nga kjo qindra ziliqarë të kapur pas një iluzioni?

Kanë hedhur duart në ujë duke kërkuar brenda tokë të thatë!

A gjendet tokë e thatë në përrua? A mund të jetojë peshku pa ujë?

Kanë pandehur se ky i varfër është i pabesë. Mirëpo unë jam aq i besës, saqë besa, madje, e sheh besnikërinë time dhe turpërohet!

Po të mos druhesha nga të huajt, do të thosha disa fjalë për besën.

Bota janë njerëz dyshues dhe që kërkojnë një vend ku të kapen. Prandaj dhe ne le të themi disa fjalë të ndryshme nga lëkura!

Po ia thyeve vetes, bëhet bukë dhe ti dëgjon historira mbi bukën, përmbajtjen!

Në lëvozhgën e arrës ka zëra, por ç'punë kanë zërat nëbukën, në vajin e saj?

Edhe ajo ka zërin e vet, por që nuk e dëgjon dot veshi. Zëri i saj është i fshehtë për veshin.

Ndërkaq, zëri i përmbajtjes është shumë i bukur. Ai që e dëgjon atë, a ia vë veshin kërcitjes së lëvozhgës?

Duke heshtur, ti e duron atë kërcitje me qëllim për t'ia marrë bukën!

Bëhu për një farë kohe pa buzë e pa veshë që, pastaj, buza të të shijojë gjëra të ëmbla si buzët!

Pse të thuash një poezi apo prozë, pse t'i nxjerrësh të fshehtat sheshit? O mësues, provoje edhe këtë vetëm sa për një ditë dhe rri pa folur!

Ka shumë kohë që po e vëmë në provë thashethemen; le të provojmë edhe të heshtim për një farë kohe.

Sa kohë u bënë që po gatuan vetëm gjellë djegëse e të forta që të bëjnë kaps; provoje një herë të gatuash edhe gjellë të ëmbla!

Njëri vjen në vete në kiamet. Libri i kundërshtimit i jepet në dorë i zi sterrë.

Si letrat e zisë, sipër i zi sterrë, anash mbushur plot me mëkate.

Mbushur me të këqija e faje fund e krye. Si fusha e luftës e mbushur me mohues, heretikë.

Sigurisht, një libër i tillë i ndyrë dhe i mbushur me përgjegjësi, nuk vjen nga e djathta, por nga e majta!

Mirë, atëherë shihe librin që këtu: a dorës së majtë i ka hije, apo të djathtës!

Po qe se në dyqan ndodhet vetëm një meste e këmbës së majtë dhe vetëm një këpucë e këmbës së majtë, i kupton pa pasur nevojë për t'i provuar!

Edhe ti, meqenë se je i djathtë, dije se je i majtë. Zërat e luanit dhe të majmunit dallohen.

Ndërkaq, mirësia dhe favori i Zotit i cili e bën të bukur trëndafilin dhe i jep aroma të këndshme atij, çdo të majtë e bën të djathtë!

Çdo mëngjarashi i jep shëndet, ujin e kulluar detit ai ia jep!

Në fronin e tij, nëse je i majtë, bëhu i djathtë dhe shihi mirësitë dhe favoret e tij!

A e sheh me vend që ky libër të kalojë nga e majta, në të djathtë? Ti thuaje!

Një libër i tillë i mbushur plot me padrejtësi dhe dhunë, si ndodh që të bëhet i denjë për dorën e djathtë?

Po i pyete qafirët, mohuesit, se kush i ka krijuar qiejt dhe tokën,
të thonë se i ka krijuar Zoti.
Atyre u ngjet edhe njeriu që nuk thotë fjalë të përshtatshme me gjendjen e vet
dhe nuk mbron një çështje të përshtatshme për veten.
Si ndodh që njeriu i cili pranon ekzistencën e një Zoti të vetëm që zotëron fuqi,
i cili i ka krijuar qiejt, tokën dhe të gjitha krijesat,
i cili dëgjon, sheh, është i pranishëm dhe vëzhgues,
i cili vëzhgon çdo gjë dhe ndodhet në çdo vend,
si ndodh, pra, që ky njeri t'i falet një idhulli të gdhendur në gur
dhe të flijojë për të mallin dhe jetën?

Një zahid, njeri i përkushtuar adhurimit, kishte një grua shumë ziliqare si dhe një skllave të bukur si hyri.

Nga zilia, gruaja e mbikqyrte të shoqin dhe nuk e linte kurrë vetëm për vetëm me skllaven.

Për një farë kohe, gruaja i mbikqyri që të dy pa u dhënë rast të mbeteshin vetëm.

Më në fund, ia arriti kaderi dhe kazaja e Zotit. Mendja vetëruajtëse u turbullua e mbaroi.

Kur vjen përcaktimi dhe vendimi i Zotit, ç'është mendja? Edhe hëna zihet!

Gruaja kishte shkuar në hamam. Menjëherë i ra ndërmend se e kishte harruar tasin e hamamit në shtëpi.

Dhe i tha skllaves: Vrapo si zog dhe ma sill atë tasin e argjendtë!

Me ta dëgjuar këtë fjalë, skllavja sikur u ringjall nga mendimi se mund të takohej me zotërinë!

Duke menduar se zotëria do të ishte vetëm në shtëpi, vrapoi tërë gëzim për atje.

Skllavja kishte gjashtë vjet që e ruante zotërinë për ta gjetur vetëm, me këtë sevda jetonte. Ajo arriti në shtëpi pothuajse duke vrapuar! Dhe e gjeti zotërinë vetëm!

Epshi aq i kishte rrëmbyer të dy dashnorët, aq ua kishte verbuar sytë, saqë as nuk u shkoi ndërmend maturia për ta mbyllur derën!

Që të dy u përqafuan e u ngjitën me njëri-tjetrin e u bënë një! Atë çast, të dy shpirtrat pothuaj u bënë një!

Në këtë mes, gruas në hamam i erdhën mendtë: Si u bë që unë vetë e dërgova këtë vajzë në shtëpi?

Me dorën time e hodha pambukun në zjarr! Ia lëshova dashin deles!

E shpëlau menjëherë argjilën me të cilën kishte lyer kokën dhe, si e vdekur, u vu me vrap pas skllaves! Edhe vraponte, edhe e vishte çarçafin!

Skllavja kishte vrapuar e shtyrë nga dashuria, kurse kjo, nga frika! Ku dashuria, ku frika! Sa ndryshim ka mes tyre?

Arifi, njeriu i pajisur me kulturën shpirtërore, arrin për çdo çast gjer në fronin e padishahut. Kurse zahidi, asketi ose oshënari shkon me të ecur; ec e ec, rrugën e një dite e bën për një muaj!

Edhe zahidi e ka një ditë të nderuar, s'është krejt pa të. Por dita e tij përse të bëhet pesëdhjetë vjetëshe?

Në jetën e njeriut të punës, çdo ditë është sa pesëdhjetë vjet sipas viteve të kësaj bote.

Mendjet s'e kapin dot këtë të fshehtë, por mbeten jashtë dere. Nëse kjo e fshehtë ia plas zemrën iluzionit, le t'ia plasë!

Para ashkut nuk ekziston frikë as sa qimja. Në punën e ashkut, secili është kurban!

Ashku është atribut i Zotit. Kurse frika, atribut i robit të kapur nga epshi.

A e ke lexuar në Kur'an fjalën "Ata e duan Zotin"? Kjo është e barabartë me fjalën "Edhe Zoti i do ata!"

Prandaj, edhe dashurinë, edhe ashkun diji si atribute të Zotit. I shtrenjti im, frika nuk mund të jetë atribut i Zotit!

Ku atributi i Zotit, ku atributi i një grushti dheu! Ku atributi i të krijuarit pas, ku atributi i Zotit të pafillim!

Po u vura të tregoj për atributin e ashkut, njëqind kiamete plasin dhe prapë mbetet mangët!

Sepse është një kohë kur do të plasë kiameti që është fundi i kësaj bote! Po ku ka fund atributi i Zotit?

Ashku ka pesëqind flatra. Çdo flatër e tij zë tërë gjithësinë nga arshi gjer nën tokë!

Zahidi frikacak përpiqet të ecë në këmbë, kurse ashikët fluturojnë më shpejt edhe se vetëtimat, edhe se era!

Si do ta arrijnë ata frikacakë pluhurin e ashkut? Halli i ashkut e bën dysheme faqen e qiellit!

Zahidi nuk e arrin dot këtë pozitë. Vetëm nëse i arrin mirësia e dritës së Zotit dhe shpëton nga kjo botë dhe nga kjo ecje në këmbë!

Skifteri i lartë shpëtoftë nga qenia e vet si zog, nga mendimi dhe thashethemet e veta e gjettë rrugë për te padishahu!

Kjo thënie është domosdoshmëri dhe kujdes. Tërheqja e të dashurit vjen pas këtyre të dyve.

Shkurt, gruaja arriti në shtëpi dhe hapi derën. Kur u erdhi zhurma e derës në veshë,

Skllavja e shkretë u hodh përpjetë ashtu siç ishte e hallakatur, kurse burri qëndroi në namaz.

Kur gruaja e pa skllaven të hallakatur, të hutuar e t ngrysur

Dhe burrin, në namaz, dyshoi nga kjo gjendje.

Menjëherë ia ngriti burrit fundin e fustanellës, po ç'të shihte? Vegla dhe topet tërë spermë!

Sperma e tepruar pikonte, kofshët dhe gjunjët krejt ndyrësi!

I ra kokës me grushta dhe tha: Ah, o burrë i poshtër, a kështu duhet t'i ketë topet burri që fal namaz?

A janë të denja për ta përmendur Zotin në namaz kjo vegël, këto tule të ndotura në këtë gjendje?

Edhe ti mos e tepro! A e vlen të jepet nga ana e djathtë libri i punëve i mbushur plot padrejtësi, dhunë, të keqe dhe urrejtje?

Edhe qafirin, mohuesin, po ta pyesësh se kush i krijoi këtë qiell, këta njerëz dhe këtë botë,

Të thotë: Zoti i krijoi! Krijimi është i denjë për Zotin!

Mirëpo, a mund të rrinë bashkë mohimi i tij, shumë e shumë të këqijat e tij, me këtë lloj pohimi?

Ato veprime të këqija e të shëmtuara, ato punë të mangëta, a mund të zënë vend së bashku me këtë lloj pohimi?

Puna ia përgënjeshtron pohimin. Në këtë mënyrë, ai apo ajo meritojnë ndëshkimin e frikshëm!

Ditën e ringjalljes dhe grumbullimit në sheshin e llogaridhënies, çdo e fshehtë del në shesh. Çdo faj e turpëron vetë njeriun.

Duart dhe këmbët nisin të flasin dhe, në prani të Zotit, dëshmojnë për të këqijat që ka bërë njeriu.

Dora tregon se si ka vjedhur, buzët tregojnë se si kanë pyetur.

Këmbët dëshmojnë se si kanë vrapuar për tek epshi, organet gjenitale dëshmojnë se kanë rënë në mëkat.

Sytë thonë: Ne vështruam në haram. Veshët thonë: Ne dëgjuam fjalë të këqija!

Kështu, fjalët e njeriut dalin gënjeshtra fund e krye, gjymtyrët ia nxjerrin gënjeshtrat në shesh!

Po kështu, edhe gënjeshtra e namazit të rregullt në dukje doli në shesh me dëshmimin e topeve!

Prandaj vepro në atë mënyrë që veprimi yt të jetë i njëjtë me dëshminë pa gojë, me thënien "dëshmoj"!

Që i gjithë trupi, çdo gjymtyrë të thonë dëshmojmë në dobi dhe në dëm, o bir!

Që skllavi ta ndjekë gjurmën e zotërisë e të thotë se ndjek urdhrin dhe se ai person është zotëria i tij!

Po qe se e ke nxirë librin e jetës, më parë pendohu për bëmat e tua.

Po të të ketë kaluar jeta, rrënjët e saj janë kjo kohë, pra, menjëherë ujite pemën e jetës me ujin e pendesës.

Hidh eliksir në rrënjët e jetës që pema e jetës të të gjelbërojë!

Të gjitha të shkuarat shërohen me këtë pendesë. Prej kësaj pendese helmi i vjetshëm bëhet sheqer.

Zoti t'i kthen të këqijat në të mirë. Të gjitha fajet e së kaluarës të bëhen adhurim!

O mësues, kapu pas pendesës së vërtetë duke bërë të gjitha përpjekjet për këtë.

Të të tregoj për pendesën e vërtetë; e ke besuar, por besoje edhe një herë nga e para!

Pasi të dalë qumështi nga gjiri, nuk kthehet dot më në gji.
Kështu është edhe pendesa e vërtetë. Pasi të pendohet për një faj,
njeriu s'e sjell më ndërmend atë faj, jo të interesohet për të; çdo çast i shtohet neveria për të.
Neveria është shenjë se pendesa i është pranuar.
Në fillim dëshira bëhet e pakëndshme, pastaj, vendin e saj e zë neveria.
Kështu, kanë thënë: "Ashkun s'e sjell tjetërkush veç një ashku tjetër.
Pse nuk i bëhesh ashik një të dashure më të bukur se ajo që ke?"
Po qe se zemra e njeriut, pas pendesës, priret përsëri nga ai faj,
kjo prirje tregon se pendesa s'i është pranuar,
se kënaqësia e pranimit nuk e ka zëvendësuar atë faj.
Pra, ende nuk është shfaqur konkluzioni "adhurimet e rënda ia lehtësojmë",
por tek ai ende vepron konkluzioni "gjërat e vështira, të këqijat ia tregojmë të lehta".

Na paskësh qenë një njeriu me emrin Nasuh. Ai bënte punën e shërbyesit të banjës dhe, kështu, i gjuante femrat.

Fytyra i ngjante fytyrës së femrës. Nuk kishte qime. E fshihte vazhdimisht që ishte mashkull.

Ai shërbente në hamamin e grave për t'ua fërkuar shpinën. Ishte tepër i shkathët në dredhi e në të këqija.

E bëri për vite të tëra këtë punë dhe askush s'e nuhati dot të fshehtën e tij.

Sepse edhe zëri i ngjante zërit të femrës, edhe fytyra. Kurse në epsh ishte shumë i zgjuar, shumë i fuqishëm.

Vishte çarçaf, mbulonte kokën, vinte perçe. Por ishte një i ri epshor dhe azgan.

Në këtë mënyrë, edhe vajzat e padishahëve i fërkonte mirë e mirë e i lante.

Bënte pendesë dhe përpiqej të rezistonte por nefsi i poshtër ia prishte pendesën.

Ai njeri punëkeq shkonte te një i urtë dhe i lutej: Kujtomë edhe mua në lutjet e tua!

I urti ia kuptoi të fshehtën, por edhe ai, si butësia e Zotit, nuk e shfaqi veten.

Buzët i kishte të drynosura, por në zemër kishte të fshehta. Buzët i kishte mbyllur, por zemrën e kishte plot zëra.

Arifët, të urtët që pijnë verën e Zotit, i njohin të fshehtat, por i mbulojnë.

Kujt t'ia mësojnë të fshehta e punës, ia qepin edhe gojën.

I urti qeshi në mënyrë të çuditshme dhe i tha: O njeri me zemër të keqe, Zoti të shpëtoftë nga gjëja që di, që e mban të fshehtë në zemër!

Kërkesa e diçkaje nga Zoti prej arifit që ka arritur te Zoti,
i ngjet kërkesës prej Zotit të diçkaje prej tij.
Sepse është thënë: "Unë bëhem veshi, syri, gjuha dhe dora e tij"
dhe "kur i gjuajte ata gurë, nuk i gjuajte ti por i gjuajti Allahu".
Ka shumë ajete dhe hadithe mbi këtë çështje.
Krijimi prej Zotit i shkakut e ka kapur fajtorin për veshi
dhe e ka çuar te pendesa e vërtetë!

Ajo lutje i kaloi të shtatë qiejt dhe u pranua. Puna e atij të varfëri më në fund u përmirësua dhe u vu në vijë.

Sepse lutja e shehut nuk i ngjan çdo lutjeje. Shehu është shkrirë, është asgjësuar te Zoti, prandaj fjala e tij është fjala e Zotit!

Po t'i kërkojë Zoti një gjë prej tij, si mund ta hedhë poshtë kërkesën e vet?

Zoti i Lartë krijoi një shkak për ta shpëtuar atë nga kjo punë e mallkuar, nga kjo përgjegjësi!

Në hamam, kur Nasuhi po mbushte tasin, vajzës së padishahut i humbi një margaritar.

I humbi njëri nga margaritarët e vëthëve dhe të gjitha gratë u vunë ta kërkojnë atë margaritar.

Më parë e mbyllën mirë derën e hamamit për t'ia kontrolluar rrobat secilit.

U kërkuan rrobat e të gjithëve, por as margaritari u gjet, as ndonjëri u turpërua.

Pas kësaj, e lanë këtë punë gjysmake dhe u vunë t'i kërkojnë të gjitha vrimat e trupit të secilit.

Dhe nisën ta hetojnë atë margaritar të bukur në të gjitha anët, lart e poshtë.

Dhe thirrën: Të gjithë të zhvishen siç kanë lindur nëne, të rinj e pleq!

Dhe shërbëtorët e sulltanit nisën ta kontrollojnë secilin një e nga një për ta gjetur atë margaritar të çmuar.

Nga frika, Nasuhi u tërhoq në një skaj të vetmuar. Fytyra i ishte bërë dyll e verdhë nga frika, buzët i ishin nxirë!

E shihte vdekjen para syve dhe dridhej si gjethja.

Dhe tha: O Zot, sa e sa herë bëra pendesë, u dëshpërova, por pastaj i prisha.

Unë veprova sipas skokës sime dhe ja ku erdhi puna që koka të ma pësojë!

Kur të më vijë radha për t'u kontrolluar, kush e di se ç'kam për të hequr, në ç'vështirësi kam për të rënë!

Po më digjet zemra! Ndjema erën e djegësirës në lutjen time!

As qafiri mos rëntë në një vuajtje të tillë! I mjeri unë, u kapa pas prehrit të mëshirës sate!

Më mirë të mos më kishte bërë nëna ose të më kishte shqyer luani!

Zoti im, bëje atë që të takon! Nga çdo vrimë është duke më kafshuar një gjarpër!

Ç'zemërgur që paskam qenë, përndryshe, do të isha shkrirë me kohë nga kjo vuajtje!

Koha m'u ngushtua, pra, më eja në ndihmë një çast e më parë!

Ç'bëhet sikur të më mbrosh edhe kësaj here, sikur të ma mbulosh fajin? Kam bërë pendesë nga të gjitha llojet e punëve të këqija!

Pranoma pendesën edhe kësaj radhe dhe kam për të lidhur qindra breza që të qëndroj në pendesë!

Po bëra gabim edhe kësaj radhe, mos ma dëgjo më fjalën, mos ma dëgjo më lutjen!

Dhe, duke thënë kështu, dridhej, derdhte lot dhe klithte se do të binte në duart e xhelatëve!

Dhe thoshte: Asnjë i krishterë mos rëntë në këtë gjendje, asnjë ateist mos klithtë kështu si unë!

Dhe, kështu, rrinte e qante me vete dhe e shihte Azrailin para syve!

Aq shumë e përmendi Zotin duke iu lutur, sa edhe dera dhe muret filluan ta thërresin Zotin bashkë me të!

Ndërsa ai e thërriste Zotin pandërprerë, u dëgjua zëri i kërkuesve të margaritarit:

Radha për ta kërkuar i vjen Nasuhit dhe, kur thuhet "secilin e kërkuam, tani kërkojeni edhe Nasuhin", Nasuhit i bie të fikët nga frika.
Ashtu siç i thoshte Zoti të Dërguarit të tij - Zoti i dhëntë mëshirë dhe paqe –
kur sëmurej ose e kapte ndonjë shqetësim, "nga vështirësia lehtësohesh",
edhe Nasuhi shpëton nga ajo vështirësi.

O Nasuh, secilin e kërkuam, eja edhe ti! Sapo e dëgjoi këtë zë, Nasuhi i humbi ndjenjat, shpirti pothuaj i fluturoi nga trupi!

Dhe u shemb përtokë si muri i prishur. I fluturuan mendtë, u kthye në diçka pa shpirt!

Pasi mendja i iku në mënyrë të pamëshirshme nga trupi, e fshehta arriti te Zoti menjëherë.

Sikur u zbraz nga gjithçka, s'i mbeti më asgjë nga qenia. Zoti ia thirri shpirtin që i ngjante një skifteri.

Me t'iu thyer gjemia e tij tashmë pa të ardhme, ra në breg të detit.

Me të rënë në gjendje pa mendim, pa ide, shpirti i arriti te Zoti. E, ja, në atë kohë mori vrull deti i mëshirës.

Pasi shpirti i shpëtoi nga turpi i kurmit, shkoi tërë gëzim në origjinë. Shpirti i ngjet skifterit, kurse kurmi është kurth. Ai ka rënë në atë kurth dhe ka mbetur ashtu, këmbëlidhur e krahëthyer.

Por kur i iku mendja e mendimi, këmbët iu liruan. Tashmë ai skifter fluturon e shkon në Kejkubad.

Kur detet e mëshirës marrin vrull, edhe gurët, madje, pijnë eliksir.

Molekula e dobët mblidhet, rritet. Kjo dysheme prej dheu shndërrohet në atllas, bëhet një copë me vlerë.

I vdekuri qindvjeçar del nga varri. Shejtani i mallkuar zbukurohet aq sa fillojnë ta kenë zili edhe hyritë.

E gjithë faqja e tokës bleron, druri i thatë merr jetë dhe jep fruta.

Ujku bëhet shok me qengjin. Damarët e të pashpresëve përmirësohen, gjurmët u shenjtërohen!

Margaritari gjendet dhe shërbëtorët dhe shërbëtoret e sulltanit i kërkojnë falje Nasuhit.

Pas asaj frike që ia shkatërroi shpirtin, erdhi lajmi i lumtur se margaritari i humbur ishte gjetur!

Partimas u dëgjua zëri: Iku frika, margaritari i pashoq u gjet!

Margaritari u gjet, edhe ne u kredhëm në hare! Jepni sihariq, margaritari u gjet!

Hamami u mbush me thirrjet e njerëzve, me klithma gëzimi, me duartrokitje!

Nasuhi që i kishte humbur ndjenjat, erdhi përsëri në vete. Sytë i panë qindra ditë të ndriçuara!

Çdokush i kërkonte ndjesë, secili ia puthte dorën!

I thoshin se kishin dyshuar prej tij, e kishin përfolur, prandaj i kërkonin ndjesë!

Meqë ai ishte njeriu më i afërm i grave të pallatit, secili kishte dyshuar më shumë për të!

Nasuhi ishte shërbëtori më intim, gjer atje sa me sulltanin i kishin shpirtrat një, kurse trupat të veçantë.

Nuk kishte femër më të afërt për sulltanin se ai. Vetëm ai do ta kishte grabitur margaritarin!

Në fillim kishin dashur ta kontrollojnë atë, por pastaj, për respekt, e kishin lënë për në fund.

Kishin menduar që, nëse e kishte marrë ai, të gjente mundësinë për ta hedhur diku.

Prandaj i kërkonin ndjesë dhe i paraqisnin justifikime.

Kurse Nasuhi mendonte: Ky është favori i Zotit për mua, ndërsa unë jam më i keq se ç'keni menduar ju!

S'është nevoja të më kërkoni ndjesë, sepse unë jam më fajtori i njerëzve të kësaj kohe!

Të këqijat që më thatë mua janë një përqind e të këqijave që ndodhen tek unë. Mund të jetë dikush që dyshon për këtë, por, sipas meje, kjo është e qartë fare!

Kush di pak të keqe tek unë, pa dyshim që ajo gjë që di është njëra nga mijëra fajet dhe punët e ndryra të miat!

Fajet dhe veprimet e mia të këqija unë i di, si dhe Zoti im që m'i ka mbuluar!

Në fillim Iblisi m'u bë mësues, por, më vonë, edhe ai, madje, m'u bë thjesht një erë para syve të mi!

Të gjitha bëmat e mia m'i pa Zoti, por nuk i tregoi dhe, në këtë mënyrë, nuk ma zverdhi fytyrën!

Pastaj prapë mëshira e Zotit ma qepi qyrkun dhe shpirtit m'ia bëri të mundur pendesën e ëmbël si vetë jeta!

Ç'të kem bërë, m'i quajti sikur s'i kisha bërë, adhurimet e pakryera m'i quajti të kryera.

Dhe më bëri të lirë si selvia. Dhe m'u hapën fati dhe mirëqenia!

Hapin ma shkruajti në librin e të pastërve. Isha për në xhehennem, ma fali xhennetin!

Bëra "ah!", "ah"-u m'u kthye në litar dhe u zgjat poshtë në pusin ku kisha rënë!

U kapa pas atij litari dhe dola jashtë. U gëzova, u lehtësova, u shëndosha, m'u skuq fytyra!

Falenderuar qofsh ti, o Zot! Më shpëtove papritmas nga ankthi!

Sikur çdo qime e trupit tim të kishte gjuhë e të të falenderonte, përsëri pak do të ishte!

Në këtë kopësht, në breg të këtyre lumenjve, po bërtas: Eh, sikur ta dinte populli im se përse më fali Zoti im mua!

Pas pendesës së Nasuhit dhe pranimit të saj,
sulltani e thërret përsëri Nasuhin për detyrën e
shërbyesit të hamamit,
kurse Nasuhi gjen pretekste dhe nuk shkon.

Pastaj te Nasuhi shkoi dikush dhe, duke i bërë komplimenta, i tha: Vajza e padishahut të thërret!

O njeri i pastër, vajza e padishahut ty të kërkon, eja e ia laj kokën!

Zemra s'i do shërbyes tjetër. Eshtë puna jote ta fërkosh atë, ta lash me argjilë.

Nasuhi i tha: Ik, ik, unë shpëtova nga ajo punë. Nasuhi yt u sëmur tani!

Ik, vrapo, gjej një tjetër. Për hir të Zotit, s'më bëjnë duart më tani!

Edhe faji në vetvete e kaloi masën. Si mund të më shuhet nga zemra ajo frikë, ajo dhimbje?

Unë vdiqa një herë dhe erdha në botë përsëri. Unë e shijova vdekjen dhe hidhësinë e mosqenies!

Unë bëra pendesë të vërtetë para Zotit. Unë s'kam për ta prishur skëtë pendesë gjersa të më ndahet shpirti nga kurmi!

Pas heqjes së asaj vuajtjeje, vetëm këmba e atij që është gomar shkon përsëri në atë anë!

Po qe se dikush pendohet, bën pendesë,
pastaj e harron dhe kërkon ta provojë përsëri atë që e
ka provuar, bie në dëm përjetësisht.
Po qe se tregohet i dobët dhe i pavendosur në
pendesë,
po qe se nuk ndjen ndonjë përgjegjësi nga pendesa
dhe pendesa nuk i pranohet, na ruajttë Zoti!
Ai i ngjet një peme pa rrënjë. Çdo ditë zverdhohet
edhe ca, thahet edhe ca!

Një bujk kishte një gomar. Me mesin me plagë, me barkun bosh, ishte një i ngordhur i pashtënë në dhé!

Ditën gjer në darkë përsillej i pangrënë e pa kujdes nëpër shkëmbishte pa bar i pambrojtur nga askush.

Atje s'kishte gjë tjetër veç ujit për të pirë. Gomari ishte ditë e natë në zi!

Në ato anë ishte një kallamishte. Dhe në atë kallamishte ishte një luan, puna e të cilit ishte të gjuante.

Ndërkaq, luani ishte ndeshur me një elefant, ishte lodhur e sëmurur dhe kishte mbetur pa gjah.

Me atë dobësi nuk gjuajti dot për një farë kohe, kështu që edhe egërsirat e tjera mbetën pa ushqimin e drekës!

Sepse ata hanin të mbeturat e luanit. Me t'u sëmurur luani, edhe ata ranë ngushtë!

Dhe luani i tha një dhelpre: Shko e gjuaj një gomar për mua!

Po gjete ndonjë gomar në livadh, këndoi një magji e sille këtu!

Po ta ha mishin e gomarit dhe të marr fuqi, pastaj mund të zë një gjah tjetër!

Unë të ha vetëm pak, kurse shumicën ndajeni mes jush. Në këtë mënyrë, edhe unë bëhem shkak për ushqyerjen tuaj!

Për mua kërko ose një gomar, ose një ka; këndoji nga ato magjitë që di ti, dhe sille këtu!

Gënjeje mirë e bukur dhe tërhiqe për këtu!

Personi i shquar i cili ndodhet pranë Zotit
përsa i përket gjykimit të njerëzve sipas gradëve dhe
shpërblimit nga ushqimi i mëshirës,
me frymëzimin e Zotit, i ngjet luanit.
Edhe kafshët e tjera hanë nga mbetjet e tij dhe
ngopen.
Por afërsia e tyre ndaj luanit nuk është përsa i përket
hapësirës, por vetive.
Hollësitë e kësaj janë të shumta; është Zoti që çon në
rrugë të drejtë!

Luani është kryetari, kurse puna e tij është të gjuajë. Të tjerët hanë ato që lë ai!

Me sa të të lejojë fuqia, përpiqu për hir të kryetarit që ai të fuqizohet dhe t'i gjuajë kafshët e egra!

A është e lejueshme që ai të mbetet i pafuqi si populli? Rizku që hyn në të gjitha grykat, jepet nga dora e mendjes!

Sepse gjëja që mund të gjejë populli, janë vetëm të lënat e tij. Po të kërkojë gjah prej teje, këtë shiko!

Ai është si mendja. Kurse populli u ngjet gjymtyrëve të trupit. Maturia e trupit varet nga mendja.

Dobësimi i kryetarit ndodh fizikisht, jo shpirtërisht. Anija dobësohet, jo Nuhu!

Kryetar, kulm është ai që rrotullohet rreth vetes. Kurse qiejt rrotullohen rreth tij!

Ndihmoje atë për meremetimin e anijes. Përpiqu që të bëhesh një rob e një skllav i vërtetë i tij!

Po e ndihmove atë, kjo është në dobinë tënde, jo në të tijën! Zoti ka thënë: Po ta ndihmoni Zotin, meritoni ndihmën e tij!

Si dhelpra, gjuaj, gjuaj dhe ia flijo atij! Në këtë mënyrë, ke për të marrë mjëfishin e gjahut që i ke dhënë!

Gjuajtja e myritit bëhet si ajo e dhelprës. Çakalli kryeneç gjuan kërma!

Po solle të vdekur para tij, i vdekuri ringjallet. Plehu i hedhur në bostan zhvillon prodhimin!

Dhelpra i tha luanit: Nën urdhrat e tua! Të sajoj dredhi, t'ia marr mendtë prej koke, të të shërbej si të duash ti!

Dredhia dhe magjia janë puna ime. Mjeshtëria ime është të tregoj përralla, ta nxjerr popullin nga udha!

Dhe u nis me vrap nga maja e malit drejt përroit. Ndërkaq, e gjeti atë gomarin e varfër e të dobët.

E përshëndeti nga zemra dhe iu qas pranë atij varfanjaku shpirtpastër.

Dhe i tha: Ç'punë ke këtu në këtë fushë të thatë? Ç'bën në këto shkëmbishte të thata?

Gomari i tha: N'daç të jem në ankth, n'daç në xhennet! Kësmetin ma jep Zoti, atë duhet ta falenderoj!

Mikun e falenderoj edhe në kohë të mirë, edhe në kohë të keqe, sepse në kaza dhe kader ka keq e më keq!

Meqë rizkun e përpjesëton ai, ankimi është herezi. Duhet durim. Durimi është çelësi i arritjes në gjerësi.

Mik është Zoti, të tjerët janë armiq. Atëherë, a është mirë t'i ankohesh armikut për mikun?

Po të më japë dhallë, nuk i kërkoj mjaltë! Sepse çdo dhunti ka vuajtjen e vet!

Kur gomari i druvarit pa në stallë mirëqenien e kuajve arabë,
e dëshiroi atë fat. Në lidhje me këtë histori,
fakti se nuk është e drejtë gjë tjetër veç kërkesës për gjykim dhe favor.
Sepse njëqind lloje shërbimesh, po të jenë si shija e gjykimit,
të gjitha ato mundime janë të kuajve.
Po kërkove fatin e mirë por të paprovuar,
ai ka edhe mundimin e vet të cilin ti s'e sheh dot.
Kështu, në çdo kurth duken kokrrat e vëna aty, jo kurthi.
Kurse ti je shtënë pas një kurthi të vetëm,
kërkon që të gjitha kokrrat të jenë të tuat gjithmonë
dhe thua me vete sikur të shkoje atje e t'i mblidhje të gjitha kokrrat!
Ti pandeh se ato kokrra janë pa kurth!

Ishte një ujitës që kishte një gomar i cili, nga mundimi i madh ishte shtrembëruar.

Nga barra e rëndë, në kurriz i ishin hapur plagë. Pothuaj e donte me pasion vdekjen dhe e priste padurim.

Ku elbi? Ai s'gjente dot as bar të thatë, as me të s'e ngopte dot barkun! Nga njëra anë e vriste barra e rëndë, nga ana tjetër e shponte i zoti me një thupër hekuri!

Imrahori, përgjegjësi i stallës së padishahut, e pa dhe iu dhimbs. Ai kishte miqësi me të zotin e gomarit.

E përshëndeti mikun dhe e pyeti se pse ishte bërë gomari ashtu, dy palë.

Njeriu i tha: Nga varfëria ime, nga taksirati im. Kjo qenie pa gojë nuk gjen dot as kashtë!

Imrahori i tha: Ma jep disa ditë mua që të marrë pak fuqi në stallën e padishahut!

Njeriu ia dha gomarin atij njeriu të mëshirshëm. Dhe ai e lidhi në stallën e padishahut.

Atje gomari pa në të gjitha anët kuajt arabë të shëndetshëm e të bukur që u shkëlqente qimja!

Vendet ku u shkelte këmba, ishin spërkatur dhe fshirë. Pastaj, edhe bari u vinte në kohë, edhe elbi!

Dhe kur pa kushtet e mira të kuajve, e ngriti kokgn drejt qiellit dhe tha:

O Zot i madh, mirë se jam gomar, por a nuk jam krijesa jote? Pse jam kështu, i dërrmuar, pse e kam kurrizin me plagë, pse jam i dobët!

Gjatë netëve, për shkak të dhimbjes së kurrizit, për shkak të urisë së stomakut, çdo çast e kërkoj vdekjen!

Kurse këta kuaj janë për mrekulli! Mirë po pse të jenë fatkeqësitë dhe mundimet të posaçme vetëm për mua?

Ndërkaq, papritmas shpërtheu lufta. Kuajve arabë u vunë shalë dhe i nisën për luftë.

Ata hëngrën shigjeta nga dushmani. Nga të gjitha anët u ngulën maja heshtash e shigjetash.

Kur u kthyen nga lufta, të gjithë ranë në stallë të dërrmuar.

Këmbët ua lidhën me litarë të shëndoshë. Nallbanët u vunë në radhë.

Ua çanin trupin me hanxharë dhe ua nxirrnin majat e hekurta.

Kur i pa këto, gomari tha me vete: O Zot, unë jam i kënaqur me këtë mirëqenie varfërie me të cilën kam ardhur gjer tani!

As ushqimi i tyre s'më pëlqen, plagët! Kush kërkon mirëqenie, e braktis këtë botë!

Gomari i thotë dhelprës se është i kënaqur me kësmetin e vet dhe nuk e pëlqen fjalën e dhelprës.

Dhelpra i tha: Është farz, detyrim fetar, të bësh si thotë urdhri i Zotit dhe të kërkosh rizk hallall.

Kjo botë është botë shkaqesh. Asgjë s'mund të fitohet pa shkak, prandaj patjetër duhet kërkuar!

Zoti ka urdhëruar: "Kërkojeni mirësinë e Allahut!" S'është e lejueshme të ikësh si tigër!

Për rizkun, Pejgamberi ka thënë: "Porta e tij është e mbyllur dhe i kanë vënë një dry.

Çelësi i atij dryni janë veprimet tona, vajtje-ardhjet tona dhe fitimet tona!

Nuk ka rrugë për hapjen e kësaj dere pa çelës! Nuk është zakon i Zotit të japë bukë pa kërkuar!

Gomari i jep përgjigje dhelprës.

Gomari i tha: Ajo që thua ti është nga dobësia e mbështetjes te Zoti. Ndryshe, ai që jep shpirt, jep edhe bukë!

Personit që kërkon sundim dhe fitore, kafshata e bukës s'i vjen pak, o bir!

Ata që gjuajnë me kurthe dhe leqe dhe të gjithë kafshët grabitqare hanë rizk. Këta as vijnë vërdallë për fitim, as përpiqen për të fituar rizk.

Zoti që jep rizk, ia jep secilit kësmetin e vet. secilit ia vë para kësmetin e vet!

Kujt duron, i vjen dhe i arrin rizku. Mundimi që heq ti nga puna dhe përpjekjet e ka shkakun te padurimi yt!

Përgjigjja e dhelprës për gomarin.

Dhelpra i tha: Mbështetja te Zoti gjendet rrallë. Ata që janë të aftë në këtë mbështetje, janë persona të pakët.

Përsjellja rreth gjësë së rrallë shkaktohet nga padija. Si do të gjejë gjithkush rrugë për sundim?

Pejgamberi e ka quajtur kënaqjen me pak, thesar. A mund ta fusë në dorë çdokush thesarin e fshehtë?

Njihe veten dhe mos fluturo lart. Mos fluturo dhe mos bjer në gropën e të keqes!

Gomari i jep përgjigje dhelprës.

Gomari i tha: Ti këtë e thua përsëmbrapthi. Dije se e keqja i vjen njeriut nga lakmia.

Askush s'vdiq nga të kënaqurit me pak. Dhe me ambicje askush s'u bë sundimtar!

Zoti nuk ua kursen bukën as qenve dhe derrave. Reja dhe shiu nuk janë gjëra të fituara nga njeriu!

Siç je ti një ashik i pasionuar pas rizkut, edhe rizku është ashik i pasionuar ndaj ngrënësit të rizkut!

Historia e zahidit, njeriut të devotshëm, i cili, në lidhje me mbështetjen te Zoti,
kërkon ta provojë këtë mbështetje, i lë shkaqet dhe, duke u larguar nga qyteti dhe vendet nga kalojnë njerëzit,
shkon në rrëzë të një mali, e mbështet kokën nga uria mbi një gur dhe thotë me vete:
O Zot, u mbështeta në krijimin e shkaqeve dhe në furnizimin prej teje, i lashë shkaqet.
Në këtë mënyrë, të shoh edhe se si mbështetja tek ti krijon shkaqe.

Një zahid kishte dëgjuar nga Mustafai të thotë se "Rizku i secilit vjen prej Zotit.

Edhe në daç, edhe në s'daç, rizku të vjen me ashkun për ty duke vrapuar dhe të arrin!"

Për provë, zahidi u nis fushave, arriti në rrëzë të një mali, u shtri dhe fjeti.

Le ta shohim – mendonte – a do të më vijë rizku, apo jo? Ta shoh një herë këtë dhe besimi mbi këtë çështje të më fuqizohet!

Një karvan e humbi rrugën. Kërko e kërko dhe arriti te vendi ku ndodhej ky burri. Kur njerëzit e karvanit e panë që po flinte,

Njëri prej tyre tha: Pse ky njeri fle zbuluar në këtë vend larg rrugës dhe qytetit?

Nuk ka frikë as nga ujqit, as nga armiqtë. I vdekur është, vallë, apo i gjallë?

Njerëzit e karvanit e zgjuan. Por ai burrë i shquar enkas nuk u tregoi asgjë.

As trupin s'e lëvizi, as kokën. As dhe sytë i hapi!

Atëherë, ata menduan se ai njeri i varfër ishte në prag të vdekjes nga uria!

I sollën bukë dhe gjellë në një enë. Dhe deshën t'ia hidhnin në grykë.

Për ta kuptuar mirë thënien se rizku i vjen vetë njeriut, zahidi i shtrëngoi dhëmbët fort për të mos e hapur gojën.

Njerëzit e karvanit e mëshiruan. Ata menduan se ai njeri i mjerë kishte ardhur në prag të vdekjes, kishte mbaruar!

Vrapuan e sollën një thikë dhe ia hapën dhëmbët me forcë.

Dhe i hodhën supë në gojë dhe i futën kafshata buke!

Njeriu tha: O zemër, ti po hesht, por të fshehtën e di dhe tani po bën naze!

Zemra iu përgjigj: E di se edhe shpirtit Zoti ia jep rizkun, edhe trupit. Prandaj këtë po e bëj enkas.

Por mos provo më shumë! Pa shih se sa bukur u vjen rizku atyre që bëjnë durim!

Dhelpra i jep përgjigje gomarit dhe e inkurajon për fitim.

Dhelpra tha: lëri këto historira dhe, qoftë edhe pak, luaji duart për të fituar diçka!

Zoti të ka dhënë duar, pra, bëj një punë! Fito dhe ndihmo edhe një shok!

Çdokush ka vrapuar pas një fitimi dhe u jep ndihmë edhe miqve të tjerë!

Gjithë fitimin nuk mund ta marrë vetëm një person! Një person nuk mund të bëhet edhe dylgjer, edhe saka, edhe peshore!

Kështu është rregulli i kësaj bote! Çdokush, për shkak të papasjes, është kapur pas një pune!

Nuk është kusht të ketë gjellë badjava në mes të sheshit! Rruga që është sunnet, traditë, është puna dhe fitimi!

Gomari i përgjigjet kështu dhelprës:
Mbështetja te Zoti është fitimi më i mirë.
Sepse çdokush është nevojtar për të. Çdokush lutet:
O Zot, ma bëj të mundur mua këtë punë! Në lutje ka mbështetje te Zoti.
Mbështetja te Zoti është një fitim i tillë që ai që e fut në dorë këtë fitim,
nuk ka nevojë për asnjë fitim tjetër.

Gomari tha: Unë nuk di fitim më të mirë se mbështetja te Zoti! Ky është fitimi më i mirë në të dy botët!

Unë nuk po mund ta shoh të barazvreshmen e fitimit të falenderimit ndaj tij! Falenderimi ndaj Zotit e shton rizkun!

Diskutimi mes tyre u zgjat. Më në fund, edhe pyetjet i mbaruan, edhe përgjigjet!

Pas kësaj, dhelpra tha urdhrin "Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!"

Eshtë budallallëk të durosh në një djerrinë të thatë e shkëmbore! Bota e Zotit është e gjerë!

Shtegto prej këtu në livadh. Atje, në breg të lumit, kullot barëra të njoma!

Një livadh krejt i gjelbër si xhennet! Atje gjelbërimi ka mbirë dhe është rritur gjer në gju.

Lum për atë kafshë që arrin atje! Deveja, bile, humb në atë gjelbërim!

Atje rrjedh nga një burim në çdo anë! Atje kafshët bëjnë kokrrën e qejfit!

Nga gomarllëku, gomari nuk i tha dot: Moj e mallkuar, ti atje je, po pse je kaq e dobët?

Ku e ke gëzimin, shëndetin, bukurinë, harenë? Pse kaq i dobët ky trupi yt që të ka rënë në shqetësime?

Kjo lakmi, kjo paaftësi për të parë e ka shkakun tek varfëria jote, jo te fisnikëria jote!

Meqë ke ardhur nga burimi, pse je kështu, e thatë?

Meqë je një dre i këndshëm, ku është bukuria jote?

Pse s'ka tek ti asnjë shenjë nga gjërat që the e tregove?

Po qe se te ai që tregon për një mirëqenie,
nuk sheh dot gjurmët dhe dritën e asaj mirëqenieje,
duhet të konkludosh se ai është imitues.
Në lidhje me këtë, po sjellim si shembull historinë e
një deveje.

Dikush i tha devesë: O gjurmëbekuar, nga po vjen?

Deveja i tha: Nga hamami i ngrohtë që ndodhet rreth vendit ku rri ti! Burri i tha: Po, fundja, është e qartë nga gjunjët!

Kur e pa kuçedrën e Musait, Faraoni kryeneç kërkoi afat, tregoi butësi.

Të mençurit thanë: Ky duhej të ashpërsohej më shumë! Sepse, a s'ishte zot?

Mrekullia le të ishte kuçedër apo gjarpër; ç'u bënë mendjemadhësia e tij hyjnore, zemërimi i tij hyjnor?

Kur ulej, thoshte "unë jam zot"! Pse ky dallkaukllëk për një krimb?

Po qe se nefsi yt është i dehur me meze, me verë hurmaje, dije se nuk e ka parë veshulin e botës së fshehtë!

Sepse tek ata që e shohin atë dritë, ka shenja. Për shkak të kësaj krenarie largohen ata.

Zogu apo shpendi që vërtitet rreth ujit të kripur, s'e ka parë ujin e ëmbël!

Edhe besimi i tij është imitim. Shpirti s'ia ka parë fytyrën e besimit!

Për imituesin ka rrezik të madh edhe nga rruga, edhe nga Shejtani i goditur me gurë, i cili pret rrugën.

Por, kur e sheh dritën e të vërtetës, sigurohet. Dyshimi tek ai i tulat dhimbjet.

Shkuma e detit vazhdon të llokoçitet gjersa të mos ketë ardhur te toka ku e ka origjinën.

Ajo shkumë i përket tokës, është e huaj në det. Dhe në gjendjen e huaj nuk ka rrugë tjetër veç heqjes së dhimbjeve.

Po qe se një njeriu i hapen sytë dhe e këndon atë qëndisje, Shejtani nuk hedh dorë dot edhe një herë mbi të!

Gomari i tha të fshehta dhelprës, por ia tha trazuar, me imitim.

E lavdëroi ujin, por nuk kishte dëshirë për të. E çori fytyrën, i grisi rrobat, por nuk ishte ashik!

Justifikimi i hipokritit nuk pranohet. Sepse justifikimin e ka në buzë e jo në zemër.

E zotëron aromën e mollës, por jo mollën. Ajo aromë tek ai është vetëm sa për t'i shkaktuar dëm!

Në luftë gratë nuk çajnë radhët e armikut, por bërtasin e klithin.

E sheh atë në radhë me shpatë në dorë si luan, por dora i dridhet pa pushim!

Mjerë për mashkullin me mendje femër, me nefsin të keq e të shëmtuar, si dhe për atë që është i gatshëm për t'u hedhur!

Në fund, mendja e tij përmbyset. ajo nuk shtegton dot diku tjetër veç dëmit!

Ç'lumturi për atë që e ka mendjen mashkull, që ka nefs të shëmtuar dhe të dobët!

Po qe se mendja e tij e pjesshme është mashkull dhe e lartë, mendja ia mposht nefsin femër!

Në dukje, edhe sulmi i femrës është i fuqishëm, por dëmi i saj është si tek gomari, nga gomarllëku i saj!

Te femra, cilësia prej kafshe mbisundon. Sepse gruaja ka prirje për ngjyrë dhe aromë.

Edhe gomari, kur ndjeu ngjyrën dhe aromën e livadhit, të gjitha argumentet që kishte në dorë, i ikën!

U kthye në një të etur nevojtar për shiun, por re nuk kishte. Arriti urinë e kaut, s'kishte më durim.

Or babush, durimi është mburojë hekuri. Zoti ka shkruar për mburojën shkrimin "Erdhi fitorja..."

Imituesi sjell qindra argumente, por analoge e jo të hapura.

Është ngjitur me aroma të mira, por nuk është vetë aromë e mirë. Ka aromë të mirë, por vetë është vetëm një gjë e fëlliqur!

O myrit, duhet kullotur në atë bahçe për vite të tëra gjersa pisllëku të shndërrohet në aromë të mirë!

Po, nuk duhet ngrënë elb si gomerët! Duhet kullotur jargavan si dre në vendin e Hutenit!

Mos kullot gjë tjetër veç karafili, jasemini dhe trëndafili! Shko në fushën e Hutenit bashkë me drerët!

Mësoje stomakun me ata trëndafila dhe aroma që të gjesh urtësinë dhe ushqimin e pejgamberëve!

Ç'mësoje stomakun nga bari dhe elbi dhe fillo të hash trëndafila dhe bimë aromatike!

Stomaku i trupit e tërheq njeriun te kashta, kurse stomaku i zemrës, te trëndafilishtja!

Kush ha bar dhe elb, bëhet kurban. Kush ushqehet me dritën e Zotit, bëhet Kur'an!

Gjysma jote është pisllëk, gjysma, erëmirë. Eja në vete dhe shtoje pjesën erëmirë!

Te ai imitues ka qindra argumente, qindra fjalë. Por kur i shpreh, sheh se në to nuk ka shpirt

Po qe se tek thënësi nuk ka shpirt, nuk ka gjallëri, pse do të ketë gjethe dhe fruta në fjalën e tij? Fjalë e tillë a mund të ketë ndikim?

I shtyn njerëzit brutalisht në rrugë, por vetë dridhet më tepër se fija e kashtës!

Fjalën e ka mjaft të shkëlqyer, por në fjalën e tij është e fshehur një dridhje!

Ndryshimi mes fjalëve të personave që kanë fituar vlera me të kënduar me ftesë të shehut të përkryer e të arritur te Zoti.

Shehu që ka arritur dritën e Zotit, i tregon rrugë njeriut, e shoqëron fjalën me dritë.

Puno e përpiqu e dehu, arri te drita që nga fjala jote të rrjedhë drita e Zotit.

Ç'të zjejë brenda në pekmez, merr shijen e pekmezit.

Çfarëdo që të zjesh në pekmez, karrotë, mollë, ftua dhe arrë, nga të gjitha merr shije pekmezi.

Edhe dija, por të përzihet me dritën, edhe njerëzit kryeneçë e të këqinj gjejnë dritë nga dija.

Dhe, atëherë, ç'të thuash, bëhet dritë. Sepse nga qielli nuk reshon tjetër veç ujit!

Bëhu qiell, bëhu re dhe lësho shi! Edhe ulluku rrjedh shi, por s'ka dobi.

Uji i ullukut është hua, kurse në re dhe në det ekziston nga krijimi!

Mendimi i ngjet ullukut. Vahji ose zbulesa hyjnore dhe zbulimi shpirtëror mistik janë re dhe det.

Uji i shiut e stolis kopshtin me ngjyra të ndryshme. Kurse ulluku i hedh komshinjtë kundër njëri-tjetrit, shkakton zënie.

Gomari bisedoi tri herë me dhelprën, por ishte imitues, prandaj ra në dredhinë e dhelprës!

Ngaqë ishte i paaftë për të kuptuar, dredhia e dhelprës e bindi.

Lakmia për të ngrënë, e poshtëroi në atë mënyrë, që, megjithëse kishte pesëqind argumente, iu nënshtrua dhelprës!

Ndërsa dikush po i bënte të keqe një djaloshi, e pa hanxharin në belin e djaloshit
dhe e pyeti: "Pse kjo?" Djaloshi i tha:
"Po qe se dikush bie në mendime të këqija kundër meje, ja shpoj barkun me të!"
Dikushi edhe kryente punën e vet, edhe thoshte "shyqyr Zotit që nuk mendoj të keqe për ty!"
"Vargjet e mia poetike nuk janë vargje, por një atdhe.
Tallja ime nuk është tallje, por t'u mësoj një gjë të tjerëve!"
"Nuk ka dyshim se Zoti nuk turpërohet as të sjellë si shembull mushkonjën,
as ata që janë më të lartë se ajo."
Pra, ka provuar ndërrimin e shpirtrave të atyre më të lartë se ajo
për shkak të mohimit të tyre. Ata thonë: "Ku e ka qëllimin Zoti me këtë shembull?"
Si përgjigje për këtë fjalë, ai thotë: "Me këtë, dëshiron që disa t'i tërbojë
e t'i nxjerrë nga rruga, kurse disa të tjerë t'i fusë në rrugë të drejtë."
Sepse çdo provë i ngjet peshores. Shumë vetëve, me atë mjet u skuqet fytyra,
kurse shumë të tjerë nuk e arrijnë dot qëllimin, mbeten të privuar.
Ndërkaq, ai që mendon sadopak mbi këtë çështje, i gjen shumicën e rezultateve.

Një homoseksual çoi në shtëpi një djalosh. E shtriu përmbys dhe nisi ta rregullonte.

Në këtë mes, i mallkuari pa në belin e djaloshit një shpatë dhe e pyeti: Po kjo, ç'është?

Djaloshi iu përgjigj: Po qe se dikush kapet pas një mendimi të keq për mua, ia shpoj barkun!

Homoseksuali tha: Lavdi Zotit, mirë që unë s'pata ndonjë mendim të keq për ty dhe nuk të bëra ndonjë dredhi!

Po s'qe burrë ti, ç'dobi do të të sjellë hanxhari? Po s'pate zemër, ç'do të bëjë kjo?

Le ta zëmë se e trashëgove Zylfikarin nga Aliu; po qe se ty është krahu i luanit të Zotit, tregoje!

Le ta zëmë se mësove një fryrje nga Mesihu, po buzët dhe dhëmbët e Isait ku janë, o burrë i shëmtuar?

Le ta zëmë se bëre një gjemi për të fituar, për të shtënë në dorë ca gjëra, ku e ke një kapiten gjemie si Nuhu?

Le ta zëmë se, si Ibrahimi, thyen idhuj, ku e ke hedhjen e trupit të idhullit në zjarr si ai?

Po të kesh argument, nxirre në shesh dhe shpatën prej druri, madje, shndërroje në Zulfikar!

Po qe se një argument të pengon nga veprimi, kjo gjë është ndëshkim i Zotit!

I bëre të fortë frikacakët në rrugë, por ti vetë ke frikë më shumë se të gjithë, dridhesh më fort se të gjithë!

Çdokujt i jep mësim për t'u mbështetur te Zoti, por, nga ambicja, pyet për damarin e mushkonjës në ajër!

O homoseksual, ti shkon në krye të ushtarëve, por organi yt dëshmon se mustaqet i ke të rreme!

Pasi ta kesh zemrën të mbushur me frikacakëri, me mjekrën dhe mustaqet e tua vetëm mund të qeshet!

Bëj pendesë duke i derdhur lotët si shi dhe shpëtoji mjekrën dhe mustaqet nga tallja!

Përdor ilaçin e mashkullisë dhe kthehu nga dielli i nxehtë!

Lëre stomakun dhe lëshoju nga ana e zemrës. Lëshoju që nga Zoti të të vijë një përshëndetje pa perde.

Hidh nja dy hapa që do të ta ndryshonin veten krejtësisht dhe ashku të të kapë për veshi e të të tërheqë!

Sado që u druajt gomari, më në fund dhelpra doli më e aftë
dhe e tërhoqi atë në pyllin ku ndodhej luani.

Dhelpra nguli këmbë në dredhi. I kapi mjekrën gomarit dhe e tërhoqi.

Ku është ai zoti i teqes që t'i bjerë defit me zjarr dhe të thotë: Gomari iku, gomari iku?

Në qoftë se edhe një lepur e tërheq luanin në pus, si të mos e tërheqë dhelpra gomarin në livadh?

Mbylli veshët dhe mos këndo magji tjetër veç magjisë së atij të urtit mirëbërës e favorizues!

Magjia e tij është më e ëmbël edhe se hallva! Madje, ai është një burrë i tillë që, toka ku shkel, vlen sa qindra hallva!

Goxha qypa plot me verë janë tharmuar nga vera e buzëve të tij!

Shpirti i mbetur larg tij është i dashuruar pas verës së zakonshme ngaqë nuk e ka parë verën në buzët e tij të kuqe!

O zog i verbër që s'e ke parë ujin e ëmbël, mos u vërtit rreth ujit të zi e të hidhur!

Musai i shpirtit e sjell zemrën në gjendje Sinai, ua hap sytë papagajve të verbër!

Husrevi i Shirinit të shpirtit pret në rojë. Në qytet, sheqeri është liruar.

Jusufët e botëıs së padukshme tërheqin ushtritë dhe sjellin dengjet me sheqer.

Fytyra e deveve të ardhura nga Egjipti është kthyer nga ana jonë, o papagaj, dëgjoni zërat e festës!

Qyteti ynë nesër do të mbushet me sheqer. Sheqeri është i lirë, por do të lirohet edhe më.

O ju që e doni ëmbëlsirën, ngjyhuni me sheqer dhe shihni nga sheqeri si papagalli pavarësisht nga verbëria e atyre që kanë sofra!

Rriheni kallamin e sheqerit, kjo është puna. Flijoni jetë, ja i dashuri!

Tani në qytetin tonë s'mbeti as dhe një njeri i vetëm fytyrëthartuar. Sepse shirini i ngjiti në fron Husrevët!

O ti! Verë mbi verë, meze mbi meze! pra, ngjitu në minare dhe këndo salá!

Uthulla nëntëvjeçare po ëmbëlsohet. Guri dhe mermeri po bëhen gur i çmuar dhe flori!

Dielli po jua përplas duart në qiell! Molekulat po luajnë e ledhatohen me njëra-tjetrën si dashnorët!

Burimet u përgjumën nga blerimi, livadhet, lulet. Trëndafilat po hapin mbi degë!

Syri i mirëqenies po bën një magji të vërtetë; shpirti u bë Mansur dhe po thotë "enelhak – unë jam Zoti"!

Po qe se dhelpra ia merr mendtë gomarit, le t'ia marrë! Ti mos u bëj gomar që ta pësosh!

Nga frika, njëri e hodhi veten në një shtëpi. Fytyra i ishte zverdhur krejt,
buzët i ishin mavijosur, duart i dridheshin si gjethe shelgu.
I zoti i shtëpisë e pyeti: Për hajër të qoftë, ç'ndodhi?
Personi iu përgjigj: Jashtë kapin gomarët dhe u ngarkojnë barrë!
I zoti i shtëpisë i tha: Mirë, o i bekuar, kapin gomarët!
Ti nuk je gomar, pse frikësohesh?
Personi i tha: Aq shumë ishin nxehur nga puna, me aq vrull e kishin marrë,
sa ishte e pamundur ta dallonin se kë kishin para
dhe pata frikë se mos më marrin për gomar!

Dikush iku dhe u strehua në një shtëpi. Nga frika i kishte ikur fytyra, i ishin nxirë buzët!

I zoti i shtëpisë i tha: O shpirt i xhaxhait, gomarët po dridhen!

Ç'ndodhi, pse ike? Pse të ka ikur fytyra kështu?

Njeriu i tha: Për ta dëfryer padishahun mizor, sot po i mbledhin të gjithë gomarët që gjejnë nëpër sokakë!

I zoti i shtëpisë i tha: Mirë, o shpirt i xhaxhait, kapin gomarët! Ti nuk je gomar, apo jo? Atëherë, pse të shqetëson ty kjo?

Njeriu i tha: Ashtu është, por aq me zell i kanë hyrë kësaj pune, aq me zjarr e kanë marrë, sa nuk është çudi sikur të më kapin edhe mua duke më marrë për gomar!

Kanë hedhur dorë për të kapur gomerë dhe s'shohin ç'bëjnë!

Njerëzit që s'shohin e s'dallojnë gjë, po të na kalojnë mbi kokë, a e marrin edhe të zotin e gomarit për gomar? E marrin!

Por sunduesi i qytetit tonë nuk bën punë kot. Ai ka ndjeshmëri dallimi. Ai dëgjon çdo gjë e sheh çdo gjë!

Ti bëhu njeri e mos ki frikë nga kapësit e gomarëve! O Isai i kohës, ti s'je gomar, mos ki frikë!

Qielli i katërt është plot me dritën tënde. Zoti mos e thëntë, vendqëndrimi yt nuk është stallë!

Ti ndodhesh në stallë për një punë, por ti je më i lartë edhe se qiejt, edhe se yjet!

Imrahori, përgjegjësi i stallave, është tjetër, gomari, tjetër. Çdokush që futet në stallë s'është gomar!

Pse iu ngjitëm kështu bishtit të gomarit, i ramë pas? Fol për trëndafilishtet, për trëndafilat!

Trego për shegën, për dardhën, për mollën. Trego për verën dhe bukurinë e panumërta!

Ose për atë që i ka dallgët margaritarë, për atë që i flet margaritari, që i sheh deti,

Ose për atë që mbledh trëndafila, ose për zogjtë që i kanë vezët prej floriri, prej argjendi!

Ose për atë që ushqen drerët e drejnushat, ose fol për skifterët që fluturojnë edhe rrafsh, edhe në pikiatë!

Në gjithësi ka shkallë të fshehta, shkallare-shkallare gjer në qiell.

Çdo re ka një shkallë tjetër, çdo kalim, një tjetër qiell!

Secili është i painformuar për tjetrin. Është një botë e gjerë pa krye e pa fund!

Ky habitet se pse ai tjetri është kaq i këndshëm; ai tjetri mendon se pse ky habitet kështu!

Fusha e qiellit është e gjerë. Atje, çdo pemë ka mbirë e ka hedhur shtat nga toka.

Degët dhe gjethet e pemëve falenderojnë se sa i bukur është ai vend, sa i gjerë!

Bilbilat fluturojnë e cicërojnë përreth luleve duke thënë: Na jepni edhe neve nga ato që hani vetë!

Kjo fjalë s'ka fund. Ti prapë kthehu te historia e dhelprës, luanit, sëmundjes dhe urisë!

Dhelpra e çon gomarin te luani, gomari ikën nga luani,
dhelpra e qorton luanin që ishte nxituar kur gomari ndodhej ende larg,
luani i kërkon falje dhelprës
dhe i lutet të shkojë edhe një herë e ta bindë gomarin.

Dhelpra e mori gomarin dhe e çoi në livadh. luani do ta sulmonte dhe bënte copë-copë!

Gomari ndodhej larg luanit. Por, nga lakmia, luani nuk duroi dot që gomari të afrohej.

Dhe, menjëherë bulëroi me një mënyrë të tmerrshme. Mirëpo nuk kishte fuqi as të lëvizte vendit!

Kur e vuri re këtë gjë nga larg, gomari i ktheu patkonjtë nga ana tjetër dhe ia mbathi me vrap gjer në rrëzë të malit.

Dhelpra i tha: O sundimtari im, pse nuk bëre durim në kohën e përleshjes?

Po të të afrohej ai budalla, me një të kërcyer të lehtë e vije poshtë!

Nxitimi është dredhia e shejtanit, kurse durimi dhe maturia, favori i Zotit!

Ai ndodhej larg, por kur pa se ç'bëre ti, iku. Ta kuptoi dobësinë, të turpëroi!

Luani i tha: Pandeha se e kisha fuqinë në vend, nuk pandehja se kisha mbetur kaq i dobët!

Por ja që uria dhe nevoja e kaluan kufirin. Nga uria, edhe mendja më humbi, edhe durimi!

Po të të vijë për doresh, merrja mendtë edhe një herë dhe sille këtu!

Përpiqu ta sjellësh këtu me dredhira dhe do të të jem shumë mirënjohës!

Dhelpra i tha: Po, nëse na ndihmon Zoti duke ia errur sytë!

Sa mirë sikur ta harronte frikën që hoqi! Dhe kjo nuk nuk është larg gomarllëkut të tij!

Por po ta bind e ta sjell këtu, mos u nxito prapë duke i lëshuar erës mundimin tim!

Luani i tha: Po, e kuptova dhe e provova se s'më paska mbetur pikë fuqie!

Pa m'u afruar gomari krejt pranë, as nuk do të lëviz nga vendi. Do të bëj sikur po fle!

Dhelpra u lëshua në rrugë. Ajo thoshte me vete: Aman, sovrani im, ti ndihmomë mua që t'i turbullohet mendja!

Gomari ka bërë pendesë para Zotit se nuk do të mashtrohet nga çdo keqbërës.

T'ia prish pendesën me dredhitë e mia! Ne jemi armiq të arsyes dhe betimit të ndritshëm.

Koka e gomarit është topi me të cilin luajnë fëmijët tanë, kurse mendimi i gomarit, lodër në duart tona!

Ç'vlerë ka para arsyes së përgjithshme arsyeja e formuar nga rrotullimi i Saturnit?

Ajo mendje merr frymëzim dhe dije nga Mërkuri dhe Saturni, kurse ne marrim frymëzim dhe dije nga bujaria e Zotit i cili është mirëbërës dhe favorizues!

Mbishkrimi i stemës sonë është ajeti "Zoti i mësoi njeriut dituri", kurse synimi ynë, dituria në lartësinë e Zotit!

Ai diell i ndritshëm na ka edukuar ne. Prandaj themi vazhdimisht se "Zoti ynë është më i larti"!

Dhelpra thoshte me vete: Edhe nëse gomari e ka vënë në provë dredhinë tonë, ai harron edhe qindra prova të tjera pas kësaj!

Ndoshta ai i plogështi e prish pendesën dhe e pëson të keqen e kësaj!

Prishja e betimit dhe pendesës e çon njeriun në fatkeqësi.
Kështu, për çifutët që e kanë të ndaluar të punojnë të shtunat dhe për ata që kanë ngrënë në sofrën e Isait, është thënë: "Ata i goditëm dhe i shndërruam në majmunë dhe derra!" Në këtë ummet, bashkësi, goditet zemra, kurse në kiamet, trupit i japin trajtën e zemrës.

Prishja e betimit dhe pendesës e bën, më në fund, njeriun, të mallkuar!

Hebrenjtë që u ishte ndaluar të punonin të shtunat, e prishën pendesën, u goditën dhe u shkatërruan.

Zoti e shndërroi atë popull në majmunë. Sepse e prishën betimin para Zotit duke bërë kryeneçësi!

Kjo bashkësi nuk goditet fizikisht, por, o njeri i mençur, goditet në ndjenja, në zemër!

Kur zemra e një njeriu kthehet në zemër majmuni, edhe trupi i bie më poshtë se zemra e majmunit!

Edhe zemra e atij gomarit, nëse do të dinte gjë për të vërtetën, do të kishte ndonjë aftësi, a do të poshtërohej për shkak të pamjes?

Qeni i shokëve të shpellës kishte shprehi të mira, por në pamje ishte qen. Por a mos i dha ndonjë dëm pamja atij?

Hebrenjtë u goditën në pamje me qëllim që populli ta shihte ndëshkimin në pamje!

Por qindramijëra të tjerë u bënë derra dhe gomerë në botën e brendshme për shkak se e prishën pendesën!

Dhelpra shkon përsëri te gomari i ikur për ta bindur për të dytën herë.

Dhelpra e arriti shpejt e shpejt gomarin. Gomari i tha: Nga një mik si ti duhet ruajtur!

O burracake, ç'të bëra që më çove mu në gojë të kuçedrës?

Cili është shkaku i urrejtjes tënde ndaj meje? Ç'shkak tjetër kishte këtu përveç të keqes në krijim?

Si puna e akrepit që ia ngul gëthapët në këmbë djalit pa e ngarë e pa e munduar aspak ai!

Ose si Shejtani që na është armik i shpirtit kur prej nesh atij s'i vjen asnjë e keqe!

Shejtani është në natyrë armik i njeriut. Ai gëzohet për shkatërrimin e njeriut!

Ai e ndjek njeriun pas për çdo çast pa e lënë të qetë asnjëherë. A e lë vesin e tij të keq?

Sepse e keqja brenda tij e tërheq në dhunë, padrejtësi dhe armiqësi pa patur ndonjë shkak.

Çdo çast të thërret ty në livadh me qëllim që të hedhë në gropë!

Për tëtë rrokullisur kokëposhtë në hauz, të thotë pa pushim se në filan vend ka një hauz dhe se atje rrjedhin lumenj.

Ai i mallkuar e rrëzoi në të keqe edhe Ademin, madje, i cili kishte merituar komunikimin hyjnor dhe ishte syçelë!

Ademi nuk kishte bërë ndonjë faj në të kaluarën, nuk i kishte bërë ndonjë dëm atij, ndonjë padrejtësi!

Dhelpra i tha: Ajo ishte një magji që në sytë e tu u duk si luan!

Ndryshe, megjithëse unë jwam më e dobët se ti si trup, natë e ditë atje kullos!

Sikur të mos bënin një magji të tillë, çdo mishngrënës do të vraponte për atje!

Ndërsa ekziston një botë e tërë e uritur plot me elefantë dhe kuçedra, a mund të qëndronte një livadh i tillë i blertë pa magji?

Unë do të të thosha që, nëse do të shihje ndonjë gjë të tillë të frikshme, të mos frikësoheshe,

Por zemra m'u dogj kur të pashë ashtu, rashë në mjerim dhe më doli nga mendja!

Kur të pashë ashtu, si qen të uritur, të dërrmuar, të tërhoqa për të të çuar shpejt e shpejt atje,

Ndryshe, do të ta tregoja magjinë dhe do të të thosha se atje duket një fantazmë, por që s'ka asgjë të vërtetë!

Përgjigjja e gomarit për dhelprën.

Gomari i tha: Ik, moj armike, m'u hiq qafe se s'dua të ta shoh atë fytyrë të shëmtuar!

Zoti që të ka bërë fatzezë, të ka shëmtuar edhe në pamje!

Me ç'surrat po më vjen mua? Edhe fytyra e rinocerontit, madje, nuk është kaq lëkurëtrashë!

Duke bërë sikur deshe të më çosh në livadh, ma vure në shenjë hapur jetën!

Azrailin e pashë me sytë e mi! Pastaj përpiqesh përsëri për të më thurur ndonjë dredhi, për të mashtruar!

Edhe pse jam gomar, edhe nëse jam më i lëni i gomarëve, fundja, edhe unë kam shpirt. Si mund ta flijoj atë?

Po ta kishte parë fëmija atë frikë të tmerrshme që pashë unë, do të mplakej në vend!

Nga ajo frikë, nga ai tmerr, e hodha veten nga mali poshtë si të isha i pajetë!

Sa e pashë atë vuajtje të pamaskuar, m'u prenë gjunjët!

Dhe iu përgjërova Zotit: Zoti im, zgjidhmi këmbët!

Se këtej e tutje askujt nuk do t'i besoj, o Zoti im mirëbërës, o ndihmësi im! Le të jetë ky betimi im!

Atë çast, Zoti m'i çliroi këmbët. Nga ajo lutje e nga ai përgjërim, m'u çliruan gjunjët!

Ndryshe, po të më arrinte ai luan, si do të bëhej halli im? Ç'bëhet gomari nën kthetrat e luanit?

A nuk është po ai luan që të dërgoi përsëri tek unë, o shok i keq?

Betohem në Zotin i cili nuk ia ka nevojën askujt por që gjithkush ia ka nevojën atij, se edhe gjarpri helmues është më i mirë se shoku i keq!

Sepse gjarpri vetëm ia merr jetën njeriut, kurse shoku i keq e shtyn në xhehennem!

Njeriu merr shprehitë dhe veset e njeriut me të cilin rri. si thonë: Më trego me cilin rri, të të them se cili je!

Sa të ta lëshojë hijen ty, meqë vetë është pa tharm, vjedh tharmin tënd!

Edhe sikur ta kesh mendjen një kuçedër sarhoshe, o shok i keq, dije se është smerald!

Shoku i keq ta verbon mendjen. Urrejtja e tij të lëshon në dorën e murtajës!

Dhelpra i përgjigjet gomarit.

Dhelpra i tha: Në radhët tona nuk ka mbeturina. Por edhe fantazitë që i vijnë përfytyrimit, nuk janë gjëra që mund të nënvleftësohen!

O njeri i thjeshtë dhe i patëkeq, të gjitha këto janë fantazitë e tua, kurse unë s'kam asnjë qëllim të keq ndaj teje!

Mos më shih mua duke u kapur pas fantazisë tënde të keqe! Pse mendon keq për miqtë?

Mendove keq dy herë për vëllezërit e sinqertë. Edhe sikur të mundohesh në dukje prej tyre, nuk duhet të mendosh keq për ta!

Po të dalë në shesh kjo fantazi e keqe, kjo pandehmë e keqe, qindramijëra miq i ndan nga njëri tjetri!

Po qe se dikush që të do, të vë në provë, nuk duhet rënë në pandehmë të keqe për të. Kështu ta do mendja!

Pa le që unë s'jam aspak e keqe. Emri më ka dalë për keq, por mos ia vër veshin. Ai që pashë s'ishte luan, por magji!

Edhe nëse ajo që pësove ishte gjë e keqe, prapë, miqtë e falin njëri-tjetrin!

Bota e frikshme e mbushur me fantazira dhe lakmi është një pengesë shumë e madhe për udhëtarin.

Këto vizatime, këto trajta të imagjinuara i dhanë dëm edhe Halilit si mal, madje!

Edhe Halili bujar, madje, kur ra në botën e imagjinatës, tha: "Ky është Zoti im!"

Ja, pra, kështu tha kur e pa yllin ai person i cili e shponte margaritarin e interpretimit.

Bota e frikës dhe imagjinatës që i lidhin sytë, e luajtën nga vendi edhe një mal të tillë!

Edhe ai, madje, tha "Ky është Zoti im"! Dhe, tani, mendo se në ç'gjendje mund ta çojë gomarin!

Edhe mendjet e larta si malet, madje, mbyten në detin e frikës dhe vorbullën e imagjinatës.

Kur ky tufan të keqeje kapërcente malet, kush mund të gjente shpëtim veç atyre që kishin hipur në gjeminë e Nuhut?

Për shkak të kësaj imagjinate, njerëzit e fesë që janë rojet e udhës së faktit, u ndanë në shtatëdhjetë e dy fraksione!

Vetëm njeriu i të vërtetës faktike shpëton nga frika dhe imagjinata. Ai s'e pandeh qimen e vetullës për hënë të re!

Por kur drita e Omerit të mos jetë mbështetje për dikë, vetulla e shtrembër e tij ia zë rrugën.

Qindramijëra anije të mëdha janë bërë copë-copë në detin e frikës!

Më i ligu i këtyre është i mençuri dhe filozofi Faraon. Edhe hëna e tij u zu nga yjësia e frikës dhe mbaroi!

Askush nuk e di se cila grua është orospi. Edhe ai që e di, edhe ai që e njeh mirë atë grua, nuk bie në dyshim për të!

Nëse frika të ka sjellë në gjendje të hutuar, pse vazhdon të përsillesh përreth frikës tjetër?

Unë mbeta në vështirësi nga egoizmi im. Ti pse më qëndron para i mbushur plot egoizëm?

Dëshiroj me mish e me shpirt të shpëtoj nga egoizmi e nga qenia që të bëhem top për atë shkop!

Kush shpëton nga egoizmi, të gjitha egot të tijat bëhen. Meqë s'është mik i vetes, bëhet mik i të gjithëve!

Shndërrohet në një pasqyrë pa vizatime, fiton vlerë, sepse i reflekton të gjitha vizatimet!

Historia e Gazneli Sheh Muhammed Serrezit (k.s. - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!)

Në Gazne ishte një zahid dijetar. Emrin e kishte Muhammed, kurse llagapin, Serrezi.

Çdo natë hante majat e trungut të rrushit, me të bënte iftar. Kjo gjendje kishte shtatë vjet që vazhdonte kështu.

Nga padishahu i ekzistencës pa shumë gjëra të çuditshme, por synimi i tij ishte të shihte bukurinë e padishahut!

Ai burri i ngopur me vetveten u ngjit në majë të një mali. Dhe tha: Ose ma trego veten, ose do të hidhem nga mali poshtë!

Zoti i tha: Nuk ka ardhur koha e asaj mirësie. Edhe po ta hedhësh veten, s'ke për të vdekur se unë s'të lë të vdesësh!

Nga dëshira e thellë, shehu e hodhi veten nga mali i lartë në një ujë të thellë.

Por ai burrë i ngopur me jetën nuk vdiq. Ai filloi të bërtiste e të klithte që kishte shpëtuar nga vdekja!

Sepse kjo jetesë i dukej si vdekje. Sipas tij, punët ishin përsëpërpathi!

Ai kërkonte nga bota e fshehtë vdekjen dhe thoshte papushim "jeta ime është në vdekje".

E pranonte vdekjen si jetë, ia kishte dhënë zemrën vdekjes.

Si Aliut, shpata dhe hanxhari i ishin bërë borzilok, kurse narcizi, armik i jetës!

I erdhi një zë i padëgjuar që i kapërcente edhe urinë, edhe fshehtësinë: Ec tutje, lëre fushën e shko në qytet!

Ai tha: O Zot që i njeh të gjitha të fshehtat sa qimja, ç'të bëj në qytet? Më thuaj!

Zoti i tha: Për ta poshtëruar nefsin, egon, dil e lyp si Abbas Devsi!

Në fillim, për një farë kohe, mblidh para nga të pasurit dhe ndajua të varfërve!

Ky është shërbimi yt për një farë kohe. Shehu tha: Si të urdhërosh ti, o Zot që je streha e shpirtit tim!

Mes Zotit të krijesave dhe atij zahidi ndodhi një pyetje-përgjigje e gjatë, një aventurë e vërtetë.

Ashtu që toka dhe qielli u ndriçuan me to. Të gjitha këto fjalë u bënë legjendë.

Por unë po e pres shkurt në mënyrë që të fshehtat të mos i dëgjojë çdo njeri i ulët!

Pas shumë vitesh, shehu kthehet nga shkretëtira në qytetin e Gaznes;
me urdhrat e ardhur nga bota e fshehtë, shëtit me zembil në dorë
duke mbledhur ndihma për t'ua shpërndarë të varfërve.
Shpirtit që gjen lartësinë sublime të komunikimit hyjnor "Urdhëro, robi im!",
i vijnë letra një pas një, lajmëtarë një pas një.
Po ta ketë dritaren e shtëpisë të hapur, nëpër të hyn edhe dielli,
edhe drita e hënës, edhe shiu, edhe letra,
edhe gjëra të tjera në mënyrë të pandërprerë.

Duke e pranuar urdhrin e Zotitshehu e ndriçoi qytetin e Gaznes me dritën e fytyrës së vet.

Nga kënaqësia, një grup njerëzish i dolën para, por ai hyri në qytet nga një rrugë tjetër të panjohur shpejt.

Të parët e të mëdhenjtë e qytetit u ngritën të gjithë përnjëherë dhe përgatitën qoshke për të.

Shehu u tha se s'kishte ardhur për ta treguar veten, por vetëm për ta poshtëruar dhe për të lypur.

Unë s'kam aspak ndërmend të merrem me fjalë. Unë do të shëtis derë më derë me zembil në dorë!

Unë jam rob që zbatoj urdhrat dhe urdhri më vjen nga Zoti. Unë do të lyp!

Dhe, duke lypur, s'kam për të thënë fjalë të padëgjuara. Nuk do të zë punë tjetër me dorë përveç punës së ulët të lypësve!

Në këtë mënyrë, të poshtërohem krejtësisht dhe të dëgjoj fjalë të këqija edhe nga parësia, edhe nga populli!

Urdhri i Zotit është jetë dhe unë i jam nënshtruar atij. Për lakminë, ai ka thënë: "Kush lakmon, poshtërohet!"

Meqë sunduesi i fesë kërkon lakmi nga unë, këtej e tutje, poshtë të kënaqurit me pak!

Ai më kërkon poshtërimin, si të luftoj unë për t'u lartësuar? Ai më kërkon të bëhem lypës, si mund të mbahem unë për bej?

Këtej e tutje prej meje vetëm lypsari dhe poshtërim kërko. Në trekëmbëshin tim unë kam tre copë Abbasë.

Shehu kishte marrë zembilin në dorë dhe shëtiste rrugë më rrugë e portë më portë dhe u lutej njerëzve: Aga, për hir të Zotit, më fal diçka! A të ka dhënë Zoti ty?

Të fshehtat i kishte më të larta se arshi, më të larta se katedra hyjnore, kurse puna e tij ishte të lutej: për hir të Zotit!

Të gjithë pejgamberët kanë bërë veprime të tilla. Populli ka qenë i falimentuar, megjithatë, ata kanë kërkuar diçka nga populli!

Ata kanë thënë: Jepini hua Zotit, jepini hua Zotit. Pastaj e kanë kthyer punën nga ana tjetër dhe kanë thënë: Po ta ndihmoni Zotin, edhe ai ka për t'ju ndihmuar juve!

Edhe ky shehu bridhte portë më portë dhe lutej. Kurse për shehun kishte në qiell qindra porta të hapura!

Ai e bënte lypësinë jo për fytin e vet, por për hir të Zotit. Ai ishte kapur fort pas kësaj pune!

Fundja, ç'të keqe do të kishte sikur të lutej për fytin e vet? Ai fyt ishte i mbushur plot e përplot me dritën e Zotit!

Ngrënia bukë, mjaltë dhe qumësht nga ai ishte më e mbarë dhe e dobishme sesa vuajtja e njëqind të papasurve, nga agjërimi duke ngrënë iftar një herë në tri ditë!

Mos thuaj se ai ha dritë, ha bukë. Në dukje kullot, por, në të vërtetë, mbjell tulipanë!

Ashtu si flaka që ha vajin e kandilit, edhe ai i ndriçonte ata që kishte përreth, ua shtonte bukurinë!

Zoti i tha "mos shpërdoroni" atij që ha bukë, por nuk i tha "mjaft" atij që ha dritë!

Ai fyt është fyt sëmundjeje, kurse ky, i siguruar edhe nga shpërdorimi, edhe nga teprimi!

Shehu kishte rënë në atë gjendje jo nga ambicja dhe lakmia, por nga zbatimi i urdhrit. Një shpirt i tillë nuk i shkon pas ambicjes dhe lakmisë.

Po qe se kimia i thotë bakrit t'i dorëzohet, nuk e thotë këtë fjalë nga lakmia.

Zoti ia kishte treguar shehut thesaret e tokës gjer në qiellin e shtatë.

Shehu tha: O ti që më ke krijuar! Unë jam ashik. Në daça tjetër veç teje qofsha burrë i keq!

Në më hyfshin në sy tetë xhennetet ose në të bëfsha shërbim nga frika e xhehennemit,

Qofsha një rob besimtar që kërkon vetëm shpëtimin e vet. Sepse edhe xhenneti i përket trupit, edhe xhehennemi!

Po qe se një ashik ushqehet me ashkun e Zotit, sipas tij, qindra trupa nuk vlejnë sa një fletë gazeli!

Edhe trupi i atij shehut të madh u bë diçka krejt tjetër, pra, mos i thuaj trup!

A mund të ndodhë që edhe ashik i Zotit të jesh, edhe pagesë të kërkosh? A mund të bëjë hajdutëri Xhebraili i besueshëm?

Edhe atij ashikut të përzishtë të Lejlasë, madje, salltaneti i kësaj bote iu duk një thërrime!

Në fillim, dheu me floririn ishin një. Po ç'është floriri? Edhe shpirtin nuk e kursente nga rreziku!

Edhe kafshët e egra, si luani, ujku e të tjerë e dëgjuan këtë, e kuptuan dhe iu grumbulluan përreth sikur ta kishin farefis!

Sepse ai u pastrua nga shprehitë prej kafshe. Ai u mbush me ashk. Kurse mishi dhe dhjami iu bënë të helmuar.

Sheqeri i derdhur nga mendja u bëhet kafshëve të egra helm. Sepse e mira e të mirit është e kundërta e të keqit!

Kafshët e egra nuk e hanë mishin e ashikut. Ashku njihet edhe nga të mirët, edhe nga të këqinjtë!

Ta zëmë se ashikun e ha ujku, mishi i bëhet helm dhe e vdes ngrënësin.

Çdo gjë tjetër veç ashkut gëlltit e ha çdo gjë; dhe dy botët janë një thërrime gjë para sqepit të zogut të ashkut!

A mund ta hajë thërrimja zogun? A mund ta kullosë mullari i kashtës kalin?

Adhuro se ndoshta edhe ti bëhesh ashik. Adhurimi është një fitim që arrihet me dorë.

Robi dëshiron të çlirohet nga robëria e adhurimit, kurse ashiku një jetë të tërë nuk kërkon të çlirohet!

Robi dëshiron vazhdimisht rroba, taksa. Kurse rroba e ashikut është gjithmonë bukuria e të dashurit!

Ashkun nuk e nxënë fjalët. Ashku është një det që s'i duket fundi.

Eshtë e pamundur të numërohen pikat e detit. Kurse shtatë detet mbeten sa një liqenth përballë detit të ashkut!

O shpirt, kjo fjalë s'ka fund. Kthehu prapë në historinë e shehut të asaj kohe!

Kuptimi i hadithit të shenjtë "Po të mos ishe ti, nuk do t'i krijoja qiejt!"

Një sheh i tillë u bë një lypsar që shëtiste sokak më sokak. Ashku i erdhi me të gjithë forcën, ç'të bënte? Ruhuni nga ashku!

Ashku e zjen detin si çomlek. Ashku e shtyp malin dhe e thërmon si rërë!

Ashku e plasarit qiellin, i hap qindra të çara. Ashku e bën qiellin të dridhet pa shkak!

Ashku i pastër u barazvlerësua me Muhammedin. Si pasojë e ashkut, Zoti i tha atij "Po të mos ishe ti..."

Shkurt, ai ishte i vetmi në ashk. Prandaj Zoti e zgjodhi ndër pejgamberët!

Dhe i tha: Po qe se ti nuk do t'i përkisje ashkut të pastër, po qe se tek ti nuk do të kishte ashk, a do t'i kisha krijuar qiejt unë?

Unë e ngrita qiellin fuqiplotë me qëllim që ti ta kuptosh lartësinë sublime të ashkut!

Nga qielli vijnë edhe dobi të tjera. Qielli është si veza. Kjo, si zogu i porsadalë nga veza, i përket atij!

Që ti të nuhasësh diçka nga nga përulësia e ashkut, tokën e përula plotësisht, e shtriva përtokë, e vura nën këmbë.

Që ta kuptosh se si ndryshon një i varfër me anë të ashkut, tokës i dhashë blerim dhe njomështi!

Edhe këta male që nuk lëvizin nga vendi, të thonë ty vendosmërinë e ashkut!

Ç'është e vërteta, o bir, ajo është kuptim, këto, trajtë. Por kjo gjë është e domosdoshme për ta bërë të përshtatshme për kuptimin njerëzor!

Vuajtjen ia përngjasojnë gjembit. Vuajtja nuk është vetë gjembi, por ky përngjasim është bërë për të tërhequr vëmendjen, për sqarim.

Zemrës së pandjeshme i thonë gur. Zemra s'ka lidhje me gurin por e sjellin gurin si shembull të ngurtësisë së saj.

Edhe turpi nuk e ka identiken e vet në mendim, prandaj gjeje të ngjashmen e tij duke e përdorur mendimin!

Me urdhrin e Zotit, shehu shkon katër herë brenda
një dite
në shtëpinë e një beu me zembil për të lypur;
beu e qorton dhe e fyen, shehu i kërkon të falur.

Brenda një dite, shehu shkoi si i varfër katër herë në pallatin e një beu.

Me zembil në dorë, i kishte në majë të gjuhës fjalët: Për hir të Zotit që ju ka krijuar, ju lutem për një copë bukë!

O bir, këto janë potkonj të mbathur mbrapsht që e habisin dhe e trullosin edhe arsyen e përgjithshme!

Me ta parë atë, beu i thoshte: O njeri i keq, nuk kam për të të thënë gjë, por edhe ti mos më thuaj koprrac!

Ç'paturpësi, ç'fytyrë që nuk skuqet, ç'punë është kjo? Vjen katër herë me radhë brenda një dite!

O sheh, kush ndodhet këtu që të interesohet për ty? Unë s'kam parë lypës më të paturpshëm se ti!

E fëlliqe fare nderin e lypësve! Ç'Abbasllëk i shëmtuar kjo që bëre?

Abbasi Debs nuk mund të bëhet shërbëtori yt. Ky nefs i ulët mos e pastë të thënë!

Shehu i tha: O bej, hesht, unë jam zbatues urdhri. Ti nuk e di zjarrin që kam brenda, prandaj mos merr vrull kaq shumë!

Po të kisha parë në vetvete ndonjë lakmi për bukë, do ta kisha çarë barkun tim që kërkonte bukë!

Shtatë vjet m'u dogj e m'u përcëllua ky kurm me zjarrin e ashkut. Hëngra gjethe pjergulle, me to u përshkova!

Madje ngjyra e kurmit m'u bë jeshile edhe pa ngrënë gjethe taze ose të thata!

Për sa kohë që të ndodhesh në trajtën, në perden e atit të njerëzve, mos i vështro ashikët ashtu mbrapsht!

Personat e meçur e të zgjuar e kanë ndarë qimen në dyzet pjesë. Ata e mësuan shkencën e kozmografisë.

Edhe nëse dëshiruan t'i mësojnë dhe ngulisin ashtu siç duhet astrologjinë, magjinë dhe filozofinë,

U përpoqën me të gjitha mundësitë, përfituan, i kaluan tërë bashkëmoshatarët.

Ashku e fshehu veten nga zilia. Një diell i tillë mbeti i fshehur prej tyre.

Dielli e fshehu fytyrën nga syri i mprehtë që i sheh yjet edhe ditën!

Lëre edhe këtë dhe ma dëgjo këshillën. Ashikët shihi me sy ashku!

Koha është e ngushtë, kurse shpirti, në dyshim. Tashmë nuk ka mundësi të të sjellë justifikime ty!

Kupto dhe mos e prit atë fjalë. Preki pak zemrat e ashikëve!

Ti nuk e kuptuar dot këtë hare. Të paktën, bëhu i rëndë, mos e lër kujdesin. Ka gjë që duhet bërë patjetër, ka punë që edhe mund të bëhet, edhe mund të mos bëhet si dhe, ka punë që s'ka mundësi të bëhet

Ti mbaj mesin e këtyre të dyjave, mbikqyr atë që është e lejueshme në zgjedhje, o ti që ke ardhur dhe je futur në këtë fis më vonë!

Beu dëgjon këshillën e shehut dhe qan;
drejtësia në thelbin e shehut reflektohet te ai;
pas asaj sjelljeje të keqe, beu ia dhuron thesarin shehut;
shehu nuk e pranon duke i thënë se s'e merr pa urdhër.

Duke i thënë këto fjalë, shehu u vu të qajë me ngashërime, lotët e tij filluan ta lagin truallin.

Drejtësia dhe ndershmëria e shehut u reflektuan në botën e brendshme të beut. Ashku çdo çast e bën të zjejë një çomlek!

Drejtësia dhe ndershmëria e ashikut ndikon edhe mbi gjënë pa shpirt. A mund të jetë e habitshme po ta prekë zemrën e një njeriu që di?

Drejtësia dhe ndershmëria e Musait ndikuan mbi shkopin dhe malin, madje, mbi detin madhështor!

Drejtësia dhe ndershmëria e Ahmedit prekën fytyrën e hënës. madje, ia preu rrugën diellit të shkëlqyer!

Që të dy u vunë fytyrë më fytyrë dhe nisën të qajnë. Edhe i pasuri u vu të qajë, edhe i varfëri!

Dhe, kështu, vajtuan së bashku për një kohë të gjatë. Pastaj beu i tha: O njeri i lartë, ngrihu!

Merr ç'të duash nga thesari! Ti i ke hak qindra mirësi si kjo, por merr atë që të do zemra!

Janë të tuat! Merr ç'të kesh prirje. Fundja ty të vinë ngushtë të dy botët!

Shehu i tha: Mua s'më kanë dhënë një urdhër të tillë. Nuk më thanë merr me dorën tënde ç'të dëshirosh!

Unë nuk ia hyra kësaj paturpësie me dëshirën time që, si ata që ata që futen më pas në një fis, të hy në këtë shtëpi e të marr ç'të dëshiroj!

Dhe duke i marrë për pretekst këto fjalë, u ngrit. Ajo mirësi nuk ishte një mirësi e drejtë, prandaj nuk e pranoi!

Thelbi i beut ishte i drejtë, por i mungonte dukja. Por çdo e drejtë nuk dukej në syrin e shehut, ai nuk e pranonte çdo gjë të drejtë!

Ai tha: Zoti më urdhëroi të lyp bukë!

Shehut i erdhi urdhër nga bota e fshehtë: Me urdhrin tim, dy vjet bëre lypësi dhe more.
Këtej e tutje mos merr, jep. Fute dorën nën rrogos.
Atë rrogos e shndërrova në torbë të Ebu Hurejres.
Me qëllim që njerëzit e kësaj bote të kuptojnë se përtej kësaj bote ka një botë tjetër,
atë që dëshiron e gjen nën atë rrogos. Ajo botë është një botë e tillë që,
sikur të marrësh në dorë dhé, bëhet flori.
Po të hyjë i vdekuri në atë botë, ringjallet.
Pabekueshmëria më e madhe bëhet bekueshmëria më e madhe pasi të hysh atje.
Atje kufri bëhet besim, helmi kthehet në kundërhelm.
Ajo botë nuk është as brenda kësaj bote, as jashtë, as nën të, as mbi të.
Nuk është as ngjitur me këtë botë, as veç.
Ajo është një botë pa sasi e pa cilësi.
Çdo çast nga ajo botë duken mijëra vepra dhe modele.
Kështu, arti i dorës s'është as brenda trajtës së dorës, as jashtë,
as ngjitur me të, as veç; po kështu, shikimi i syrit, aftësia shprehëse e gjuhës;
për njeriun e mençur një shenjë mjafton!

Ai burrë i punës e bëri këtë punë dy vjet. Pastaj i erdhi urdhër nga Zoti:

Pas kësaj, jep, por mos kërko prej askujt. Ne ta dhuruam këtë fuqi nga bota e fshehtë!

Le të të kërkojë dikush çdo gjë nga një në një mijë, fute dorën nën rrogoz e nxirre!

Jep nga ky thesar i pamundim. Në dorën tënde, dheu do të shndërrohet në flori, pra, jepe menjëherë!

Jep ç'të duash pa u menduar fare! Dije se Zoti të dhuroi më shumë se e shumta!

Në mirësitë tona nuk ka as pakësim, as shterim. Nga kjo dhënie as pendohemi, as ndjejmë zili!

O person ku mbështetemi, fute dorën nën rrogoz që mirësitë tona të mbeten të fshehta nga syri i lig!

Mbushe dorën nën rrogoz dhe jepja lypsarit që i është thyer mesi!

Këtej e tutje jep nga mirësitë tona të pafundme. Dhuroju menjëherë atyre që do të të kërkojnë margaritarë të çmuar!

Ec, ty t'u dha e fshehta "Dora e Zotit është mbi dorën e tyre". Shpërnda furnizim pa shkak, pa pretekst, si dora e Zotit!

Shpëtoji borxhlinjtë nga borxhi. Dyshemenë e botës bleroje siç e bleron shiu.

Këtë punë pati edhe këtë vit. Jepte florinj me të tepërt nga qesja e Zotit të fesë.

Dheu i zi bëhej flori në dorën e tij. Pranë tij, Hatem Taj ishte pothuaj një i varfër!

Shehu e di pa folur se ç'mendon personi që kërkon, e kupton se sa borxhe ka borxhliu. Kjo është shenjë e hadithit të shenjtë "Shiheni popullin me atributet e mia!"

Edhe nëse i varfëri nuk ia thoshte, ai e dinte sa nevojë kishte dhe i jepte.

Ai i jepte të varfërit as tepër as mangut nga ajo ç'kishte në zemër!

Atij i thoshin: Ku e di se kaq kërkon, si e kupton këtë?

Ai thoshte: E kam shtëpinë e zemrës krejt bosh, si xhenneti ku s'ka të varfër dhe nevojtarë.

Unë e fshiva shtëpinë nga gjithshka e mirë apo e keqe. Shtëpia e zemrës sime është e mbushur vetëm me dashurinë për Zotin!

Çfarë të shoh atje veç Zotit, nuk është malli im, por i të varfërit i cili kërkon diçka prej meje.

Kur në ujë duket një fidan hurme ose dega e thyer dhe e përkulur si hënë e hurmasë, ai reflektim është reflektimi i fidanit ose degës jashtë.

Po qe se sheh në ujë ndonjë trajtë, ajo është reflektim i gjësë që ndodhet jashtë, o trim!

Por për pastrimin e ujit nga ndyrësitë është kusht të pastrohet e kullohet lumi-trup.

Në këtë mënyrë, aty nuk duhet të mbetet ndonjë turbullirë ose mbeturinë që fytyra të të reflektohet dhe shihet në të!

O i shkreti njeri, ç'ka në trup përveçse ujit të përzjerë me dhé? Thuaj! O armik i zemrës, pastroje ujin nga dheu!

Mirëpo ti, me të ngrënë e me të pirë, i hedh më shumë dhé atij përroi, e turbullon më shumë atë ujë!

Shkaku që shehu dinte se ç'mendonte kushdo.

Meqë brenda atij uji nuk ndodhet asgjë, fytyrat reflektohen dhe duken në të.

Por nuk është pastruar për ty! Shtëpia jote është plot me shejtanë, me qenie jonjerëzore, me egërsira!

O gomar, nga kryeneçësia, mbete në gomarllëkun tënd! Si mund të marrësh nga shpirtrat ndonjë aromë Mesihu?

Po qe se atje nxjerr kryet ndonjë iluzion, ku do ta dish se nga ç'pusi doli?

Për fshirjen e iluzioneve brenda vetes tënde, kurmi të shndërrohet në hipokrizi dhe iluzione!

Gomari bëhet vegël e dhelprës si pasojë e dredhive të saj.

Gomari u përpoq shumë për t'u ruajtur nga dhelpra. Por, ndërkohë, ishte uritur si qen, uria i ishte bërë vetja e tij e dytë!

Lakmia i triumfoi, durimi iu dobësua. Sevdaja e bukës ka shqyer sa e sa grykë!

Pejgamberi të cilit i qenë zbuluar të vërteta, pati thënë: "Edhe për pak, varfëria do të bëhej herezi!"

Gomari qe bërë rob i urisë. Ndërkaq, hileja i tha: Zëre se vdiqe!

Të paktën, të shpëtoj nga kjo vuajtje urie! Nëse kjo është jeta, sipas meje, vdekja është më e mirë!

Në fillim kishte bërë pendesë, ishte betuar, por, më në fund, nga gomarllëku, edhe pendesën e prishi, edhe betimin!

Lakmia e verbon njeriun, ia turbullon mendjen, e bën të paditur, ia lehtëson vdekjen.

Mirëpo vdekja për gomarët nuk është e lehtë se ata s'kanë shpirt të përjetshëm!

Meqë s'kanë shpirt të përjetshëm, janë nga ata që bëjnë keq! Guximin ndaj vdekjes e kanë nga gomarllëku!

Puno për të arritur te shpirti i përjetshëm dhe në ditën e vdekjes të të ndodhet në dorë pak ushqim.

Personi i keq nuk beson te Zoti që jep rizk, furnizim. Ai nuk beson se i vjen furnizimi nga bota e fshehtë bujarisht.

Ç'është e vërteta, kohë pas kohe Zoti i dha një uri por mirësia e Zotit gjer tani nuk e la pa rizk.

Po të mos ishte uria, do të majmeshe dhe atëherë tek ti do të shfaqeshin qindra sëmundje!

Sëmundja e urisë siguristë që është më e mirë se ato sëmundje edhe për sa i përket lehtësisë së trupit, edhe për sa u përket lutjeve e adhurimeve ndaj Zotit!

Mundimi i urisë është më i mirë se sëmundjet, sidomos meqë në uri ka qindra dobi dhe aftësi!

E mira e ngrënies së pakët dhe e urisë.

Eja në vete, uria është mbreti i ilaçeve. Pranoje me gjithë zemër urinë dhe mos e përbuz në këtë mënyrë!

Të gjitha sëmundjet shërohen me uri. Të gjitha ilaçet nuk veprojnë mbi ty nëse nuk je i pangrënë e i uritur!

Shembull.

Njëri hante bukë të mykur. Një njeri e pyeti: Pse je bërë kaq lakmitar dhe sypangopur?

Ai i tha: Kur në përfundim të durimit, uria shtohet dyfish, edhe buka e elbit më vjen si hallvë!

Kështu, po durova, po u bëra i durueshëm, domethënë se ha hallvë!

Fundja uria nuk i mundon të gjithë! Kjo uri është një kullotë e jashtëzakonshme!

Urinë ua kanë dhënë vetëm njerëzve të zgjedhur të Zotit me qëllim që me anë të saj të bëhen si luanë të fuqishëm!

Si do t'ia japin urinë çdo të varfëri të zakonnshëm? A s'e ke pak barin? Ta vënë para!

Dhe të thonë: Ha, se këtë meriton ti! Ti nuk je zog që noton në ujë, por zog që ha bukë!

Një sheh e këndon se ç'ka brenda dervishi dhe ia kupton ambicjen; duke i dhënë këshilla me gojë, me urdhrin e Zotit, ia fal forcën për t'u mbështetur te Zoti.

Një sheh kishte rënë ngushtë me myritin e vet. Në qytet kishte bukë, por atje ku ndodheshin ata, ishte me pakicë.

Për shkak të padijes dhe indiferentizmit, myritit i shtohej çdo çast në zemër frika nga zia dhe uria!

Shehu e kishte kuptuar dhe e dinte se ç'mendonte myriti me vete. Dhe i tha: Gjer kur do të vazhdosh të vuash kështu?

Po digjesh nga halli i bukës! Pothuajse e ke mbyllur syrin e mbështetjes te Zoti!

Ti nuk je nga ata të përkëdhelurit e mëdhenj që të të mos japin arra dhe rrush të thatë!

Uria është ushqimi i të zgjedhurve të Zotit. Si do t'i jepesh asaj një i varfër kokëtrashë si ti?

Mos ia var; ti nuk je nga ata që të presësh pa bukë në këtë gjellëtore!

Këtyre personave të ulët e të dhënë pas stomakut u nxjerrin gjithmonë e vazhdimisht qase mbi qase, bukë mbi bukë!

Po vdiq një lloj njeriu i tillë, buka ecën para dhe thotë: O ti që e vdiqe veten me varfëri dhe pashpresi,

Ja. ti vdiqe, buka mbeti! Eja, ngrihu e merre bukën o ti që e vide veten me dhimbje!

Eja në vete që të të mos dridhen këmbë e duar. Rizku yt është i dashuruar pas teje më shumë se çje dashuruar ti pas tij!

Eshtë i dashuruar, e njeh padurimin tënd dhe të vjen këmbadoras, o llafazan!

Po të kishe durim, do të të vinte rizku dhe, si dashnorët, do të ta dorëzonte veten!

Ç'është kjo dridhje nga frika e urisë? Mund të rrohet fare mirë i ngopur me mbështetjen te Zoti!

Në një ishull të madh na paska qenë një ká.
Zoti i madh e mbushte atë ishull me barëra e gjelbërime
dhe kau kulloste gjer në mbrëmje duke i ngrënë të gjitha,
fryhej si një shkëmb i madh, kurse natën e kalonte pa gjumë me shqetësimin
se e kishte ngrënë çdo gjë dhe të nesërmen nuk do të kishte ç'të hante
dhe, kështu, nga vuajtja, dobësohej për gjithë natën dhe bëhej si drapër.
Pastaj, kur ngrihej në mëngjes, e gjente të gjithë ishullin plot bar e gjelbërim
dhe gjer në mbrëmje e kulloste të gjithë, pastaj në mbrëmje nuk flinte dot tërë natën
nga shqetësimi për të nesërmen dhe dobësohej e tretej si drapër.
Megjithëse kishte vite që e vinte re këtë, prapë nuk i besonte Zotit!

Na ishte në botë një ishull krejt gjelbërim ku jetonte i vetëm një ka që ishte llupës i madh.

Nga mëngjesi në mbrëmje e lëpinte tërë të shkruarën, kulloste, ngopej e fryhej sa s'tregohet.

Por, kur bëhej natë, kridhej në mendime se ç'do të hante të nesërmen dhe ky mendim e dëshpëronte aq shumë, sa, për gjithë natën, tretej e bëhej si drapër!

Kur bëhej mëngjes, e shkruara kishte bleruar përsëri. Barërat ishin rritur gjer në brez!

Kau që ishte uritur si ka, e kulloste tërë livadhin gjer në mbrëmje pa lënë fije bari mbi tokë!

Kështu, fryhej, majmej e fuqizohej.

Ndërkaq, përsëri, sapo bëhej natë, binte nën frikën e urisë, niste të dridhej nga frika e urisë dhe prapë dobësohej nga kjo vuajtje!

Dhe mendonte: Ç'do të ha nesër, vallë? Ja, pra, kishte vite kau në këtë gjendje!

Thoshte me vete: Ka vite që po kullos në këtë blerim e shëtis në tërë këtë livadh.

Por asnjë ditë s'mu pakësua rizku. Megjithëkëtë, as nuk mendoj se ç'është kjo frikë, ç'është ky dëshpërim që ma djeg zemrën!

Dhe, kështu, kur bëhej mbrëmje e pllakoste nata, kau llupës dobësohej përsëri nga halli se mos i mbaronte rizku!

Ja, pra, nefsi është kau, kurse e shkruara, bota! Nefsi vazhdimisht dobësohet me frikën e bukës!

Ç'do të ha në ditët që do të vijnë? Si do ta siguroj ushqimin e të nesërmes?

Për vite hëngre dhe ushqimi s't'u pakësua! Prandaj lëre pak mendimin për të nesërmen dhe shih të shkuarën!

Sill ndërmend furnizimet që ke ngrënë, mos shih të ardhmen dhe qahu më pak!

Luani e kap dhe nis ta hajë gomarin, e merr etja
dhe shkon në një burim për të pirë ujë. Ndërkohë, dhelpra ia ha gomarit
copat më të mira, mëlçitë, zemrën dhe veshkat.
Kur kthehet luani dhe nuk i sheh mëlçitë dhe zemrën e gomarit pyet:
Ku i ka ky zemrën dhe mëlçitë? Dhelpra i thotë: Po të kishte zemër dhe mëlçi,
a do të vinte prapë këtu pasi pa atë ditë atë gjendje të tmerrshme
dhe pasi e pati shpëtuar jetën me mijra dredhi?
Edhe Zoti ka thënë: "Qafirët thonë: "Po të kishim dëgjuar,
ose po të kishim pasur mend, nuk do të bëheshim për xhehennem!"

Dhelpra e shpuri gomarin gjer pranë luanit. Luani e bëri gomarin copë-copë!

Kjo e lodhi shumë mbretin e egërsirave, e eti për ujë! Dhe ai shkoi gjer te burimi për të pirë ujë.

Ndërkaq, dhelpra gjeti rast dhe ia hëngri gomarit mëlçitë dhe zemrën!

Pasi piu ujë dhe u kthye, luani kërkoi mëlçitë dhe zemrën e gomarit, po s'gjeti asgjë!

E pyeti dhelprën: Ku i ka mëlçitë, ç'iu bë zemra? Kafshët e egra i pëlqejnë shumë këto dy organe!

Dhelpra i tha: Po të kishte patur mëlçi dhe zemër, a do të vinte edhe një herë këtu?

Ai e kishte parë kiametin, e kishte vëzhguar rëzimin nga mali, e kishte shijuar frikën, kishte ikur me të gjitha forcat!

Po të kishte patur zemër ose mëlçi, a të vinte përsëri pranë ty?

Po qe se te një zemër nuk ka dritë zemre, ajo s'është zemër! Po qe se në një trup nuk ka shpirt, ai trup është dhé.

Po qe se në një kandil nuk ka dritë shpirti, do të thotë se ka shurrë, ka pisllëk! Mos i thuaj më kandil asaj cope qelqi!

Ai qelq, ajo enë është punë e duarve të njerëzve, por drita e kandilit është dhuratë e Zotit, epiqendrës së madhështisë sublime!

Shkurt, shifrat dhe sasia janë te enët, kurse te flaka ka vetëm njësi, unitet!

Sikur në një vend të vënë gjashtë copë kandilë, në dritën e tyre nuk ka shifra dhe sasi!

Ai çifut i pa enët dhe u bë politeist. Kurse tjetri e pa dritën dhe besoi, u bë i kuptueshëm.

Po qe se shpirti sheh enët, Shishin dhe Nuhun i sheh nga dy!

Përroi është përrua po pati ujë. Njeri është ai që ka shpirt!

Këta nuk janë njerëz, por vetëm trajta. Këta janë të vdekur buke, këta i ka vdekur epshi!

Prifti që shëtit ditën me kandil ngaqë pati rënë në një hall.

Dikush shëtiste ditën me kandil në dorë, me zemrën të mbushur me dashuri dhe djegien e dashurisë.

Një llafazan i tha atij: O njeri, eja në vete dhe mos kërko ashtu çdo dyqan.

Pse shëtit vazhdimisht me kandil në dorë në mes të ditës? Ç'marrëzi është kjo?

Njeriu i tha: Kërkoj një njeri nga të gjitha anët. Kush është ai njeri i gjallë me frymë?

Një burrë i tha: Ky pazar është i mbushur plot me njerëz të tillë!

Dikushi që kërkonte njeriun e gjallë me frymë, i tha: Në rrugën kryesore ku nisin dy rrugë të tjera, kërkoj njeriun i cili tregohet i qëndrueshëm në kohë zemërimi dhe lakmie.

Ku është njeriu i cili mundet ta përmbajë veten në kohën e zemërimit dhe epshit? Ja, pra, po kërkoj një njeri të tillë sokak më sokak, vatër më vatër!

Ku ka në botë një njeri të tillë që të mundet të përmbahet në këto dy raste, të cilit t'ia flijoj jetën!

Kush e dëgjoi, i tha: Po kërkon diçka që gjendet rrallë, por s'di gjë për kazanë dhe kaderin!

Ti sheh dukjen por pa ditur gjë për thelbin. Ne jemi dukja, kurse thelbi janë vendimet e kaderit!

Kazaja dhe kaderi ia humbin rrugën edhe qiellit që rrotullohet pa pushim. Qindra planete si Mërkuri, kazaja dhe kaderi i budallallepsin!

E ngushtojnë botën e zgjidhjeve, i shkrijnë edhe hekurin me mermerin, i bëjnë ujë!

O njeri që ke vendosur ta masësh me hapa këtë rrugë, ti je i papjekuri i të papjekurve!

E ke parë se si rrotullohet guri i mullirit, të paktën eja e shihe edhe përroin që i çon ujë!

Je duke i parë dheun e pluhurin të ngritur në ajër, por mes tyre shih edhe erën!

Je duke i parë të zjejnë enët e mendimit; mblidh mendtë në kokë dhe shihe edhe zjarrin!

Duke ia treguar mirësitë Ejubit, Zoti i tha: Unë i dhashë durim çdo qimes tënde!

Eja në vete dhe mos e shih kaq shumë durimin. Po ta kesh parë durimin, shihe edhe dhënësin e durimit!

Gjer kur do ta shohësh rrotullimin e rrotës së mullirit? Ktheje kokën dhe shihe edhe ujëvarën që rrjedh me vrull!

Ti po thua vazhdimisht se je duke e parë, por ai që e sheh ka disa shenja mjaft të dukshme!

Sapo të shohësh shkumën e detit, duhet të mahnitesh që ta shohësh edhe detin!

Kush e sheh shkumën, thotë gjëra të fshehta. Por kush sheh detin, mbetet si i hutuar!

Kush sheh shkumën, vë qëllime; kush sheh detin, e sjell zemrën në gjendje deti!

Kush sheh shkumat, i numëron. Kurse atij që sheh detin nuk i mbetet më vullnet dhe aftësi zgjedhjeje!

Kush sheh shkumën, bie në rrotullim, kurse te ai që sheh detin s'mbetet më asnjë shenjë lëvizjeje!

Muslimani fton në fe një zoroastrian. Gjendja e shejtanit në derë të Zotit.

Një njeri i tha një zoroastriani, adhuruesi të zjarrit: Or ti, eja, bëhu musliman dhe futu në radhët e muslimanëve!

Zoroastriani i tha: Në dashtë Zoti, do të besoj. Po ta shtojë mirësinë e tij, e kuptoj të vërtetën!

Muslimani i tha: Zoti dëshiron që ti të besosh, që ta shpëtosh shpirtin nga xhehennemi.

Por nefsi yt i keq, ai Shejtani i shëmtuar, të tërheq nga ana ku ndodhet kisha!

Zoroastriani i tha: O njeri i matur, meqë ata janë më të aftë, edhe unë bëhem mik me më të aftin e më të fortin!

Mund të bëhem mik me më të fortin, mund të shkoj atje ku ndodhen ata që tërheqin më me aftësi dhe forcë!

Zoti kërkoka prej meje fare mirë drejtësi dhe ndershmëri me thelb. Ç'dobi ka nëse dëshira e tij s'vihet në vend?

Nëse nefsi dhe Shejtani e vënë në zbatim dëshirën e tyre, kjo do të thotë se mirësia e Zotit u shkatërrua, u bë copë-copë!

Ti bën një qoshk, një pallat dhe e stolis dhe e zbukuron atë me lloj-lloj vizatimesh, dekoracionesh dhe pikturash.

Dhe pastaj ti dëshiron që ta bësh atë banesë mirëbërësie ose faltore, por del e vjen dikush tjetër dhe e bën atë kishë ose manastir!

Ose ti end një copë dhe dëshiron të bësh me të një kaftan për ta veshur për vete.

Ti dëshiron kaftan, por armiku, për kryeneçësi dhe kundër dëshirës tënde, bën një palë shallvare me atë copë!

Imzot i dashur, ç'të bëjë copa e stofit veçse ta shkojë sipas dëshirës së tij?

Pronari i copës u dëshpërua shumë, por copa ç'faj ka? Kush është ai që i del kundër më të fortit?

Po qe se dikush vjen pa dëshirën e të zot të shtëpisë dhe mbjell gjemba në trojet e tij,

I zoti i shtëpisë mbetet i detyruar të nënshtrohet. Ky poshtërim i vjen atij papritmas dhe pa u penguar nga asgjë!

Ç'vlerë ka se unë jam i ri e i freskët? Ja ku u poshtërova! I dashuri kështu dëshiron dhe unë ja ku u bëra!

Pasi të kryhet ajo punë që dëshiron nefsi, të thuash se bëhet ajo që dëshiron Zoti, është tallje!

Edhe nëse unë mund të jem i fundit i zoroastrianëve ose heretik, prapëseprapë nuk formoj një pandehmë të tillë për Zotin!

Është e pamundur që dikush të shëtisë e të urdhërojë në vendin e vet pa dëshirën e Zotit!

Nuk mund të ndodhë që dikush ta shtijë në dorë truallin e Zotit dhe Zoti që është krijuesi i frymës, të mos marrë një frymë, të mos thotë një gjë!

Po qe se Zoti dëshiron ta përzërë Shejtanin nga dikushi dhe, përkundër kësaj, Shejtani ia shton vuajtjen çdo çast atij,

Ky Shejtan duhet adhuruar, atij i duhet nënshtruar! Sepse ai është që del në krye të çdo kuvendi!

Po qe se unë rri e them vazhdimisht "aman, Shejtani të mos ma marrë këtë gjë mua", pse Zoti, zotëruesi i mirësive s'më kap për dore?

Po qe se bëhet ajo që dëshiron Shejtani, punën time kush e rregullon?

Gjendja e shejtanit në derë të Zotit.

Mos qoftë e thënë! Bëhet ajo që dëshiron Zoti! Ai është sundues edhe në botën e hapësirës, edhe në botën e mungesës së hapësirës!

Askush nuk mund të lëvizë dot nga vendi asnjë qime në truallin e tij pa urdhrin e tij!

Pasuria është e tij, fermani, i tij! Shejtani është qeni më i përbuzur në portë të tij!

Po qe se në portë të turkmenit ndodhet një qen, po qe se ai qen vë kokën e shtrihet në portë të tij,

Nuk lëviz edhe sikur fëmijët e shtëpisë ta kapin dhe tërheqin për bishti dhe ai bëhet lodër në duart e tyre!

Por po qe se në rrugë kalon një i huaj, i hidhet si luan.

Sepse "është i ashpër me qafirët, është trëndafil për miqtë dhe gjemb për armiqtë!"

Edhe sikur turkmeni t'i japë vetëm lëng çorbe, ai e pranon dhe vazhdon ta bëjë detyrën e rojes!

Mirë! Edhe qenin Shejtan Zoti e ka krijuar. Dhe me të ka krijuar qindra mendime, qindra dredhi.

Dhe ia ka bërë ushqim atij nderin dhe dinjitetin e njerëzve me qëllim që t'ua marrë nderin dhe dinjitetin të mirëve e të këqinjve!

Nderi dhe dinjiteti i njerëzve është ai lëngu i çorbës që i jepet qenit. Këtë ha Shejtani dhe me këtë ngopet!

Megjithëkëtë, si ndodh që shpirti i tij të mos bëhet kurban në krye të kullotës së fuqisë së Zotit?

Turma-turma njerëz të mirë e të këqinj ka që i kanë shtrirë këmbët përtokë dhe i janë drejtuar asaj porte si qentë!

Që të gjithë janë shtrirë si qenër në prag të shpellës së Hyjnitetit dhe presin në radhë me veshët ngritur!

O Shejtan qen, po qe se njerëzit vënë këmbën në këtë udhë, vëri në provë!

Hidhju atyre, mos i lër këtu! Në këtë mënyrë, të shohim, kush është mashkull e kush është femër në nder dhe dinjitet!

Përse thuhet "mbështetem te Zoti"? Sepse dhe kur qeni të jetë zemëruar dhe të ketë filluar të të hidhet sipër, apo jo!

O turk stani! Të thuash "mbështetem te Zoti", do të thotë të të thuash ty bërtiti qenit dhe hape rrugën

Që të të vij në derë të çadrës dhe të lutem për një nevojë nga bujaria jote!

Ndërkaq, nuk është punë me vend që turku të thotë "mbështetem te Zoti" e të bërtasë nëse bëhet pre e sulmit të qenit!

Po qe se edhe turku thotë "mbështetem te Zoti nga ky qen", "mbeta i dobët në vendin tim nga ky qen,

Kurse ti nuk më ndihmon që të vij në këtë portë, edhe unë nuk dal dot nga kjo portë",

Atëherë, u mbuloftë me dhé edhe turku, edhe miku. Kjo do të thotë se qeni ua ka lidhur qafën të dyve!

Mos qoftë e thënë! Për hir të Zotit, po qe se turku lëshon një të bërtitur, ç'është qeni? Edhe luani, madje, vjell gjak!

O ti që i thua vetes luan i Zotit, u bënë shumë vite që ke mbetur qen!

Kur ti i je bërë haptazi gjah qenit, si mund të gjuajë ky qen për ty?

Muslimani sunni i jep përgjigje një qafiri determinist dhe ia argumenton
se njeriu ka vullnet (aftësi zgjedhëse). Sunneti është një rrugë
nëpër të cilën kanë ecur të gjithë pejgamberët (Zoti u dhëntë paqe),
të cilët e kanë shkelur me këmbë dhe e kanë hapur.
Në të djathtë të asaj rruge është shkretëtira e determinimit.
Atje njeriu nuk sheh vullnet në veten e vet, mohon urdhrat dhe ndalimet
dhe bie në interpretim. Mirëpo nga mohimi i urdhrave dhe ndalimeve
del mohimi i xhennetit që është vendi i zbatuesve të urdhrave,
dhe mohimi i xhehennemit që është vendqëndrimi dhe ndëshkimi i moszbatuesve të urdhrave.
Atëherë, gjer ku arrin puna? Unë mos të ta them; të mençurit një shenjë i mjafton.
Gjithashtu, në të majtë të asaj rruge është shkretëtira e Kaderit.
Ai që devijon këtu, di që fuqia e njeriut është mbi fuqinë e krijuesit.
Dhe nga kjo dalin në shesh ngatërresa të tilla
që ai zoroastriani determinist i ka numëruar e thënë.

Muslimani tha: O determinist, dëgjoma fjalën, e bëre të ditur mendimin tënd, i the ç'kishe për të thënë! Tani po të jap përgjigje, vëma veshin!

O ti që luan shah, ti pe lojën tënde. Tani shihe gjer e gjatë edhe lojën e kundërshtarit tënd!

E lexove defterin e justifikimeve të tua, lexoje edhe defterin e sunniut; pse ngrive ashtu?

Mbi çështjen e kazasë dhe kaderit the fjalë të holla sipas determinizmit. Tani dëgjoje aventurën dhe të fshehtën e saj mësoje nga unë!

Nuk ka dyshim se ne kemi aftësi kuptuese dhe zgjedhëse. Ti nuk mund ta mohosh ndjenjën. Kjo është sheshit.

Askush nuk i thotë gurit "eja këtu". Askush nuk shpreson besë nga një copë guri.

Askush nuk i thotë njeriut "fluturo", po kështu, askush nuk i thotë qorrit eja e më shih mua!

Zoti ka thënë se për qorrin nuk ka propozim. Zoti që i zgjidh vështirësitë, a e fut kënd në vështirësi?

Askush nuk i thotë gurit "ke ardhur vonë" ose shkopit "pse më qëllove!"

Nga ai që është i detyruar, gjëra të tilla nuk mund të kërkohen; po kështu, askush nuk i thotë fjalë të tilla njeriut të gjymtuar ose të justifikuar, nuk e rreh.

O person me jakë të re e të pastër, urdhri, ndalimi, zemërimi, favori dhe qortimi janë për atë që ka nevojë për to!

Edhe në padrejtësi kemi masë, edhe në qortim. Këtë pata parasysh unë me Shejtanin dhe nefsin.

Masa është brenda teje. Ai nuk mundet ta zgjasë dorën pa parë një Jusuf!

Masa dhe lutja janë në nefs. Sheh fytyrën e gjësë që dëshiron, pastaj hap krahët.

Qenin e ka zënë gjumi, por mos pandeh se i ka humbur kujdesi. Sa ta ndjejë erën e plëncit, fillon ta tundë bishtin.

Edhe kali, sapo të shohë elb, fillon të hingëllijë. Edhe macja, sa të shohë se lëviz një mish, fillon të mjaullitë.

Shikimi është shkak për futjen në veprim të zgjedhjes ashtu siç është caliku shkak për nxjerrjen e shkëndijave nga zjarri!

Prandaj, aftësia zgjedhëse të luan ty si Iblisi. Të bën ndërmjetësim ty, të sjell lajmet dhe përshëndetjet e Ndërmjetësit.

Po ia tregoi njeriut atë që dëshiron, aftësia zgjedhëse që ka fjetur i hap menjëherë sytë!

Edhe engjëjt i lëshojnë klithma në zemër për inat të Shejtanit.

Në këtë mënyrë, kërkojnë ta vënë në veprim aftësinë zgjedhëse për të mirë. Sepse pa t'u treguar kjo, të dyja këto shprehi tek ti janë në gjumë.

Në këto kushte, për t'i vënë në veprim damarët e aftësisë zgjedhëse tek ti, edhe engjëlli t'i tregon gjërat që janë për t'u bërë, edhe Shejtani!

Zgjedhja për të mirë ose për të keq tek ti, nga njëfish, bëhet dhjetëfish dhe ti bëhesh zotërues i aftësisë zgjedhëse të dhjetë vetëve!

O njeri i ëmbël, që të të bëhen hallall punët jashtë namazit, duhet t'u japësh selam engjëjve duke dalë nga namazi.

Ky selam do të thotë: "E fala këtë namaz me dëshirën time dhe për shkak të frymëzimit dhe lutjes suaj të mirë!"

Edhe pas fajit, nis e e mallkon Iblisin. Sepse në këtë veprim të shtrembër re për shkak të tij.

Pas perdes së të fshehtës, shejtani dhe engjëlli t'i tregojnë ty fshehurazi të mirën dhe të keqen.

Por kur të ngrihet perdeja e së fshehtës, ti i sheh fytyrat e atyre që të kanë shtyrë në të mirë apo në të keqe!

Nga fjalët e tyre e kupton se këta janë ata që flasin fshehtas.

Shejtani të thotë: O rob i natyrës dhe kurmit, unë këtë ta tregova, por nuk të shtrëngova!

Edhe engjëlli të thotë: A nuk të thashë se do të të shtohet ankthi për shkak të këtij gëzimi?

A nuk të thashë kështu në filan ditë? Rruga e xhindve është rruga që shkon nga ajo anë.

Ne jemi miq të shpirtit tënd, të shtojmë shpirt shpirtit tënd. Atit tënd i kemi bërë sexhde me sinqeritet.

Edhe tani po të shërbejmë ty, po të thërresim ty në rrugën e shërbimit!

Këta shejtanë kanë qenë armiq edhe të atit tënd. Nuk iu përgjigjën urdhrit "bëni sexhde!"

Por ti bëre siç të tha ai dhe nuk na pyete ne. Madje nuk na i njohe të drejtat e shërbimit!

Tani edhe ne jemi në shesh, edhe ata. Shihna dhe njihna nga fjala dhe zëri!

Po qe se në mes të natës dëgjon një të fshehtë nga miku, po qe se dëgjon se ai ka folur, në mëngjes e kupton se ai që ka folur është mik!

Po qe se natën dy vetë të sjellin lajm, në mëngjes i njeh që të dy nga zëri.

Po qe se natën dëgjon zërat e luanit dhe qenit, fytyrat nuk ua sheh në errësirë, por

Kur të bëhet mëngjes e të bërtasin përsëri, zërat e tyre i dallon me mend dhe e kupton se të cilave kafshë janë!

Shkurt, Shejtani dhe shpirti të tregojnë ty të keqen dhe të mirën. Që të dy janë prova se tek ti ekziston aftësia zgjedhëse.

Tek ne ka një aftësi zgjedhëse të fshehtë. Sapo të shohësh dy gjëra, vihet në veprim.

Hoxhallarët, mësuesit, i rrahin nxënësit. Po guri i zi, a pranon edukim?

A mos i thonë ata gurit "eja nesër se, po nuk erdhe, të ndëshkoj keq"?

A ndodh që njeriu i mençur ta rrahë copën e dheut, ta shajë gurin?

Për nga logjika, determinizmi është një punë më e turpshme se mosbesimi në kaderin! Sepse deterministi mohon ndjenjën e vet!

Ai që e mohon kaderin, të paktën ndjenjën e vet s'e mohon. O bir, puna e Zotit nuk përfshihet dot nga ndjenja, apo jo!

Por ai që e mohon punën e Zotit të Lartë, pothuajse do të thotë se e mohon gjënë që e argumenton argumenti.

Ai që e mohon kaderin thotë se tym ka, por nuk do të thotë se aty ku ka tym ka zjarr, se drita e kandilit është e ndritshme vetvetiu pa qenë e ndezur.

Deterministi e sheh zjarrin por, nga inati, thotë se s'ka zjarr!

Zjarri ia ndez fundin e rrobës, ia djeg, por ai prapë thotë se s'ka zjarr. Errësira e rrethon nga të gjitha anët, ai mbetet mu në mes të rrugës, por prapë thotë se s'ka errësirë!

Shkurt, kjo çështja e determinizmit është sofizëm. Prandaj është më e keqe se mohimi i Zotit!

Ai që e mohon Zotin, thotë se botë ka, por Zot nuk ka. Ai nuk i përgjigjet atij që thotë "O Zot!", sepse thotë nuk ka!

Mirëpo ky, sofisti, thotë se nuk ka botë! Sofistët janë në lëkundje dhe vuajtje!

Gjithë bota e pohon aftësinë zgjedhëse dhe thotë se urdhri dhe ndalimi, domethënë, këtë bëje e atë mos e bëj, janë të drejta e të vërteta,

Kurse ai vazhdimisht thotë se urdhër dhe ndalim nuk ka dhe ato çka ndodhin, nuk ndodhin sipas dëshirës sonë.

O shok, ndjenjën e pranon edhe kafsha. Por prova lidhur me këtë specifikë është mjaft e hollë.

Sepse ne e ndjejmë aftësinë tonë zgjedhëse. Propozimi që mund të na bëhet neve për ndonjë punë, është me vend!

Njohjet ndërgjegjësore, si dëshirimi i një gjëje dhe bërja apo mosbërja e saj,
ose mbetja në vështirësi, përballimi i zemërimit dhe mirëkuptimi,
gjendja e ngopur dhe e uritur zënë vendin e ndijimeve,
si dallimi i të verdhës prej të kuqes, i të voglës prej të madhes,
i të hidhurës prej të ëmbëls, i erëmirës prej erëkeqes,
me shqisën e të prekurit,
i gjësë së fortë nga gjëja e butë, i të nxehtit nga të ftohtit,
i gjësë djegëse e përvëluese nga gjëja shumë e nxehtë,
i gjësë së njomë nga gjëja e thatë, i murit nga druri.
Në këto kushte, ai që e mohon njohjen dhe kuptimin ndërgjegjësor,
mohon ndijimin dhe ndjenjën, madje, më keq.
Njohja dhe kuptimi ndërgjegjësor janë më të hapur se ndijimi dhe ndjenja.
Sepse është e mundur që ndjenja të lidhet, që ndijimi të pengohet.
Por pengimi i njohjes dhe kuptimit ndërgjegjësor është i pamundur.
Të mençurit i mjafton një shenjë.

Kuptimi ndërgjegjësor qëndron në vend të ndjenjës. Që të dy rrjedhin nga një kanal.

Prandaj është me vend ta urdhërosh këtë kuptim për të bërë ose për të mos bërë diçka, t'ia hysh aventurave me të, të debatosh me të!

Të thuash se nesër do të bëj këtë e atë gjë, është argument dhe provë për ekzistencën e aftësisë zgjedhëse.

Edhe pendimi për të keqen që ke bërë, provon se ke aftësi zgjedhjeje, pra, tregon se u pendove për zgjedhjen që bëre dhe e gjete rrugën e drejtë!

I gjithë Kur'ani është urdhra, ndalime, frikësime! Kush i jep urdhër gurit të mermerit? Ku është parë një gjë e tillë?

Njeriu me mend në kokë, a urdhëron mbi copër e dheut, mbi gur?

A thotë: "O të vdekur, o të paaftë, ju thashë ta bëni këtë e atë, pse s'e bëtë?"

A e urdhëron mendja copën e dërrasës? A tenton njeriu me mend në kokë ta urdhërojë njeriun në pikturë: "O trim këmbëthyer, ngrihu, merr heshtën dhe eja në luftë?"

Mirë... Si mund të urdhërojë dhe të ndalojë në mënyrë injorante Zoti i cili ka krijuar yjet dhe qiellin?

Tentove ta eliminosh mundësinë e dobësisë nga Zoti duke thënë se te robi nuk ka aftësi zgjedhëse, mirëpo e bëre robin injorant, kokëtrashë dhe të hutuar.

Në thënien se nuk ka kader, robi vepron me aftësinë e vet zgjedhëse, të paktën nuk ka dobësi e paaftësi, madje, edhe sikur të ketë, injoranca është më e keqe se dobësia e paaftësia.

Me bujarinë e vet, turku i thotë mikut "eja në portën time pa qen, mos eja me pelerinë të shqyer"!

Eja nga filan vend me urtësi dhe edukatë që qeni im ta mbyllë gojën për ty!

Kurse ti bën krejt të kundërtën e kësaj fjale dhe drejtohesh për në derën e çadrës. Sigurisht që qeni ka për të të kafshuar!

Si të kenë shkuar robtë, ashtu shko që qeni të tregohet i mëshirshëm ndaj teje.

Ti merr dhe çon me vete një qen ose dhelpër dhe, atëherë, sigurisht që nga çdo çadër ka për të dalë një qen dhe të gjithë bashkë kanë për të t'u hedhur sipër!

Nëse te askush tjetër veç Zotit nuk ka aftësi zgjedhëse, pse zemërohesh me fajtorin?

Pse rri e mpreh dhëmbët kundër armikut? Ku e sheh të metën apo fajin e tij?

Po qe se nga çatia e shtëpisë thuhet një dru, të bie e të plagos ty mirë e mirë,

A nxehesh me atë copë druri, a e urren atë?

A thua se "pse më ra e ma theu dorën"? A thua se "ajo është armiku i jetës sime"?

Pse fëmijët e vegjël i rreh, kurse të mëdhenjtë s'i prek?

E tregon vjedhësin që të ka vjedhur mallin dhe thua: Kapeni këtë, thyejani duar e këmbë, lidheni e bëjeni rob!

Kundër atij që ia vë syrin gruas tënde, qindramijëra herë merr vrull e shfryn me zemërim!

Por po të vijë rrebeshi dhe të ta rrëmbejë mallin, a zemërohet mendja kundër rrebeshit?

Ose po të fryjë era e të ta rrëmbejë çallmën, a të formohet në zemër tërbim kundër erës?

Zemërimi të tregon pa pushim se ke aftësi zgjedhëse, në mënyrë që të mos ndërhysh në mënyrë të përdhunshme kundër të paaftëve e të justifikuarve!

Po qe se devexhiu rreh një deve, ajo i sulet rrahësit,

Nuk nxehet me shkopin e rrahësit. A e sheh, edhe deveja, madje, ka një farë aftësie zgjedhëse!

Gjithashtu, po t'i hedhësh një gur qenit, përpiqet t'i shmanget goditjes dhe të merr hov ty!

Po kështu, edhe nëse i sulet gurit dhe e kafshon, e bën këtë nga zemërimi kundër teje e jo kundër gurit dhe vepron kështu po qe se ti je larg dhe s'të arrin dot!

Edhe mendja e kafshës, di të dallojë e të zgjedhë, prandaj, o mendje njerëzore, ki turp e mos thuaj nuk ka aftësi zgjedhjeje!

Aftësia zgjedhëse është sheshit, por ai llupës, me lakminë për gjellën e syfyrit, i mbyll sytë ndaj dritës!

Sepse e gjithë prirja e tij është të hajë bukë, prandaj i mban sytë në errësirë për të thënë se s'është bërë ditë akoma!

Pasi që lakmia ta fshehë edhe dritën e ditës, s'është për t'u habitur që ua kthen shpinën provave e argumenteve!

Tregim mbi vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të njeriut dhe mbi faktin që kazaja dhe kaderi nuk e asgjësojnë vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të njeriut.

Një hajdut i tha nëpunësit të sigurimit, Zotëri, puna që bëra ishte vendim i Zotit!

Nëpunësi i sigurimit i tha: O drita e syve të mi! Edhe kjo që po bëj unë (duke të arrestuar ty) është urtësia dhe vendimi i Zotit!

Po qe se dikush vjedh nga dyqani një rrepë dhe të thotë ty "o njeri i mençur, ky është vendimi i Zotit",

Ti i bie nja dy grushta kokës duke i thënë "edhe kjo është vendimi i Zotit, prandaj vëre rrepën ku e more"!

O llafazan, kur edhe bakalli nuk e pranon këtë veprim forcërisht për një rrepë,

Si i beson ti kësaj dhe vjen vërdallë rreth kuçedrës?

Me një justifikim të tillë, o njeri i pamend, edhe gjaku të shkoi humbur, edhe malli, edhe gruaja! Apo jo!

Në këto kushte, sikur dikush të të vijë e të ta shkulë mjekrën e të të sjellë justifikim për këtë, të të thotë se ka qenë i detyruar të veprojë ashtu, a do t'ia pranosh?

Po qe se vendimi i Zotit mund të jetë justifikim për ty, mrekulli! Mësoje dhe ma trego edhe mua!

Edhe unë kam qindra kërkesa dhe epshe, mirëpo i kam duart të lidhura nga frika, nga impresionimi ndaj Zotit!

Ki mirësinë dhe ma mëso edhe mua këtë justifikim dhe m'i zgjidh duar e këmbë!

Ke zgjedhur një art dhe e ke bërë punë për vete! Kjo do të thotë se ke një mendim, një aftësi zgjedhëse!

Ndryshe, o njeri i punës, pse e zgjodhe atë zanat apo art mes zanatesh apo artesh të tjera?

Por kur të të vijnë krizat e egos, dëshirave dhe pasioneve, të vijnë forca të njëzet burrave!

Po qe se miku yt të bëhet pengesë për një thërrime interes, menjëherë zgjedh luftën dhe hyn në përleshje me të!

Mirëpo kur vjen radha për të falenderuar për të mirat, s'ke më aftësi zgjedhëse, bëhesh më i ngurtë se guri!

Më në fund, edhe xhehennemi do të të djegë dhe do të të thotë: Mos ma merr për të keq, më shih të justifikuar!

Pasi që askush nuk të sheh ty të justifikuar me këtë argument, ky argument s'të shpëton dot nga dora e xhelatit!

Kështu është krijuar bota e kështu shkon. Pasi ta shohësh botën, do të thotë se gjendja e botës është bërë e njohur edhe për ty!

Përgjigje deterministit; prova e vullnetit dhe aftësisë zgjedhëse,
drejtësia e urdhrave dhe ndalimeve;
justifikimi i determinizmit është i papranueshëm në asnjë sheriat dhe fe
dhe ky justifikim s'ka për ta shpëtuar atë nga ndëshkimi i punës që ka bërë;
tregim mbi mospranimin e shprehjes së Iblisit "Zoti im, ti më tërbove mua".
E pakta është provë e të shumtës.

Dikush kishte hipur në majë të pemës dhe, hajdutërisht, e shkundte pemën dhe i rrëzonte frutat përtokë.

Erdhi i zoti i kopshtit dhe i tha: O i poshtër, a s'ke turp nga Zoti? Ç'është kjo që po bën?

Hajduti i tha: Po qe se robi i Zotit ha nga kopshti i Zotit hurmanë që ia falë Zoti,

Pse më qorton ultësisht, pse e ke zili mirësinë e Zotit të pasur?

Pronari i kopshtit i tha shërbëtorit: Ajbek, sille litarin që t'i jap përgjigje këtij njeriu!

Kur ia sollën litarin, e lidhi hajdutin mirë e mirë pas peme dhe nisi ta rrihte mirë duke e e goditur nga shpina e nga këmbët.

Hajduti i tha: Or ti, të kesh turp nga Zoti që po e vdes në dru këtë rob të pafaj e të pamëkat!

Kopshtari i tha: Robi i Zotit po e rreh mirë e mirë me shkop një rob tjetër të Zotit!

Edhe shkopi është i Zotit, edhe shpina, edhe ana. Unë jam vetëm robi i tij dhe vegël e urdhrit të tij!

Atëherë, hajduti tha: Po bëj pendesë për determinizmin. Aftësia dhe mundësia zgjedhëse ekzistojnë, ekzistojnë!

Aftësinë zgjedhëse të robve i bëri të qena aftësia zgjedhëse e tij. Aftësia zgjedhëse e tij është kalorës që ua ka shaluar aftësive tona zgjedhëse!

Aftësia zgjedhëse e Zotit ka nxjerrë në shesh aftësinë tonë zgjedhëse. Urdhri mbështetet vetëm në aftësinë zgjedhëse!

Çdo krijesë e ka një urdhërues të aftë për të vepruar, por që duket si pasiv,

I cili e tërheq atë në mënyrë të pavullnetshme; e kap Zejdin për veshi dhe e tërheq më një anë.

Por Zoti i cili s'ka nevojë për asgjë, pa përdorur asnjë mjet, e bën aftësinë zgjedhëse të robit lidhëse për vete.

Zejdin e lidh vullneti i vet dhe Zoti e gjuan atë pa qen e pa kurth!

Dylgjeri urdhëron mbi dërrasën, piktori urdhëron mbi bukurinë.

Kovaçi urdhëron mbi hekurin, skulptori, mbi veglën.

E çuditshme, e paparë është se vullnete të panumërim i bëjnë sexhde vullnetit të tij!

Ti ke fuqi mbi gjërat jo të gjalla, mirëpo kjo fuqi, a e eliminon jogjallërinë tek to?

Po si kjo, fuqia e tij nuk e eliminon vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të robve!

Po deshe, shpjegoji fuqinë, vullnetin dhe aftësinë zgjedhëse të tij me përsosmërinë e tij; kjo nuk është determinizëm dhe devijim.

Ti thua se herezia jote është dëshira e tij, por dije se edhe ti ke një dëshirë në këtë herezi!

Sepse ti nuk bëhesh mohues dhe heretik po s'deshe vetë. Herezia pa dashje është kontradiktë. Edhe je heretik, edhe heretizmin nuk e do! Gjë që bëhet, kjo?

T'i japësh urdhër njeriut të paaftë, domethënë, të gjymtuar, të sëmurë, të paralizuar, etj., është edhe gjë e keqe, edhe gjë e shëmtuar. Kurse të zemërohesh me të paaftin e ta ndëshkosh atë, është më keq, pa le nëse Zoti i mëshirshëm zemërohet dhe e ndëshkon!

Kaun e rrahin po të mos futet nën zgjedhë. Por a rrihet, a qortohet kau pse s'fluturon?

Edhe kau nuk justifikohet po të ikë nga shërbimi, atëherë, pse të quhet i justifikuar i zoti i kaut?

Meqë nuk je i sëmurë, mos e lidh kokën; ti ke vullnet dhe aftësi zgjedhëse, pra mos u qesh mjekrës dhe mustaqeve të tjetrit!

Puno, pije verën e Zotit, gjej një njomështi dhe atëherë bëhesh i pavullnetshëm dhe i pavetëdijshëm!

Atëherë, vera bëhet gjithë vullneti dhe aftësia jote zgjedhëse. Edhe ti, krejt si një sarhosh, quhesh plotësisht i justifikuar!

Atëherë, çfarëdo që të thuash, fjala jote është fjala e verës. Atëherë, çfarëdo që të fshish e të marrësh me vete, janë të fshirat e të përfshirat e verës!

Sarhoshi që pi verë nga kupa e Zotit, a mund të bëjë gjë tjetër veç të drejtës dhe drejtësisë?

Kur Faraoni do t'ua priste magjistarëve këmbët e duart, ata i thanë njëzet herë Faraonit: S'kemi të metë nga prerja e duarve dhe këmbëve.

Duart dhe këmbët tona janë ai Zot i vetëm! Gjëja formale është hije, mund të pakësohet!

Kuptimi i hadithit "U bë ajo që deshi Allahu!"
Pra, dëshira është dëshira e tij, pëlqimi i tij. Pëlqimin e tij kërkojeni.
Të mos ju ngushtohet zemra nga armiqësia e të tjerëve,
nga kundërshtimi i të tjerëve.
Fjala "kane - u bë" e hadithit është folje e shkuar, por në punën e Zotit nuk ka të shkuar e të ardhme.
Sepse "te Zoti nuk ka as mëngjes e as mbrëmje!"

Kur thotë robi "u bë ajo që deshi Zoti", nuk do të thotë "bëhu dembel".

Kjo fjalë është mbajtja e zemrës të fortë dhe nxitje për të punuar e për t'u përpjekur. Do të thotë "bëj më shumë përpjekje në atë shërbim, mësohu më shumë me atë punë dhe kapu më fort pas asaj pune!

Po të të thoshin "dëshiro ç'të duash, se do të bëhet ashtu si të dëshirosh ti",

Atëherë do të kishe të drejtë të bëheshe dembel, sepse do të bëhej ç'të dëshiroje!

Por po të të thoshin se "u bë ajo që deshi Zoti, se vendimi është i tij në mënyrë absolute dhe të përjetshme",

Pse nuk kapesh pas asaj pune si qindra njerëz të tjerë, pse nuk i vjen rrotull asaj pune si rob i Zotit?

Po të të thonë se "ç'të dëshirojë veziri, ajo bëhet, se vendimi i kapjes dhe mbajtjes është i tij",

A vjen menjëherë rrotull tij sa për njëqind vetë, përpiqesh të bësh ç'të të vijë për dore me qëllim që ai të derdhë mbi ty favore e të mira,

Apo largohesh e ikën nga veziri, nga pallati i vezirit? Po të veprosh kështu, kjo nuk është të kërkosh ndihmën dhe favorin e tij!

Ti e kuptove përsëmbrapthi këtë punë, u dembelose, u krijua një situatë në kundërshtim me arsyen dhe t'u turbullua mendja!

Ç'do të thotë se urdhri është i filan zotërie? Kujdes, rri pak me tjetërkënd veç tij!

Përsillu rreth tij. Urdhri është urdhri i tij, ai do ta vrasë armikun, ai do të ta shpëtojë jetën e mikut!

Mund të arrish vetëm atë që të dëshirojë ai, prandaj mos shko rrallë tek ai, mos e humb atë, atë zgjidhe!

Meqë vendimi është vendimi i tij, vajtja pranë tij, përsjellja rreth tij nuk do të thotë se libri i punëve nuk ka për të t'u bërë i zi dhe fytyra, e verdhë dyll!

Ajo fjalë duhet interpretuar në mënyrë që të të nxisë ty, të të mbushë me shpresë, të të bëjë të fortë e shkathët, të të bëjë të kesh ndjenjën e turpit dhe drojtjes!

Po qe se të jep plogështi, dije se kjo të fut në një gjendje tjetër ty, nuk është interpretim!

Kjo fjalë ka ardhur për të të dhënë zell ty, për t'i kapur nga të dyja duart të pashpresët!

Për kuptimin e Kur'anit pyet vetë Kur'anin ose njeriun që u ka vënë zjarr dëshirave dhe pasioneve,

Që është përulur para Kur'anit, është bërë kurban, që shpirti i është bërë Kur'an!

Po qe se një esencë i flijohet krejtësisht trëndafilit dhe bëhet trëndafil, në daç merri erë si esencë trëndafili, në daç si trëndafil!

"Kalemi i shkroi gjërat që do të bëhen dhe boja, madje, iu tha!"
Kjo do të thotë se kalemi e plotësoi atë që duhej thënë dhe për të cilën nuk ka diskutim. Për shembull:
Kalemi shkroi
dhe u tha se adhurimi dhe mëkati s'janë një!
Kalemi shkroi dhe u tha se besueshmëria dhe vjedhja nuk janë një.
Kalemi shkroi dhe u tha se falenderimi dhe mosmirënjohja nuk janë një.
Kalemi shkroi dhe u tha se nuk ka dyshim që Zoti nuk e humbet shpërblimin
e njerëzve që bëjnë mirësi!

Edhe shprehja "kalemi shkroi, edhe boja, madje, iu tha" është për ta nxitur dhe inkurajuar njeriun për punën më me rëndësi.

Kështu, kalemi ka shkruar shpërblimin dhe ndëshkimin e merituar për punën e secilit.

Po ece shtrembër, edhe kalemi të shkruan shtrembër. Po erdhe drejt, edhe kalemi ta shton bekueshmërinë.

Po të bësh keq, je i keq, je i mprapshtë, shkove mbrapsht. Këtë shkroi kalemi dhe boja iu tha. Po të sillesh me drejtësi, trajtohesh me drejtësi; këtë shkroi kalemi dhe boja, madje, iu tha.

Po të vjedhësh me dorë, ndëshkohesh. Kalemi e shkroi, edhe boja iu tha. Po të pish verë, bëhesh dehur. Kalemi e shkroi dhe boja iu tha.

A e sheh me vend që Zoti ta lërë punën, të mos mund të bëjë asgjë?

Dhe të thotë: puna doli nga dora ime, tashmë nuk mund të bëj më asgjë! Mos më eja kaq shumë, mos u qaj kaq shumë!

Kuptimi i fjalës "kalemi u tha" do të thotë "te unë, drejtësia dhe qortimi nuk janë një".

"Unë vura një ndryshim mes të mirës dhe të keqes. Domethënë se edhe më të keqen e dallova nga e keqja!"

Nëse edhe një thërrime ta shton ty edukatën dhe ndjenjën e turpit, nëse bëhesh edhe një thërrime më me edukatë se miku yt, dije se ky është favori i Zotit, e mira e Zotit!

Ajo thërrime ta shton vlerën. Ajo thërrime shkel si mal në hapësirë.

Në qoftë padishah dhe nëse për të nuk ka ndryshim mes njeriut të besueshëm e të drejtë dhe njeriut të padrejtë e mizor,

Po qe se ai nuk i dallon nga njëri-tjetri njeriun që dridhet nga frika se mos e mohon me njeriun që e dënon punën e tij,

Pra, po qe se këta të dy kanë të njëjtën vlerë për të, s'është padishah. E mbuloftë dheu atë njeri!

Nëse përpjekjen tënda ta shton edhe një thërrime, ajo ka peshë dhe peshohet në peshoren e Zotit!

Mirëpo ti vazhdon të rrish e të heqësh shpirt para këtyre padishahëve! Sepse këta nuk e njohin tradhtinë me të vërtetën, s'kanë haber, bile, nga to!

Me fjalën e një përfolësi, e humbi aty për aty shërbimin e vazhduar për vite.

Por padishahu që e dëgjon dhe e sheh çdo gjë, as nuk ua vë veshin fjalëve të përfolësve!

Të gjithë përfolësit e presin shpresën prej tij, bëhen pesimistë. Por kur na vijnë neve dhe na përfolin të tjerët, kjo na e shton lidhjen ndaj tyre!

I përfolin shumë padishahut mu para nesh, i thonë se jemi të këqinj. I thonë: Ec, tashmë kalemi u tha, bëhu pak besëtar!

Kuptimi i fjalës "kalemi shkroi, boja iu tha" nuk do të thotë se poshtërsia me besnikërinë janë një!

Për poshtërsinë, poshtërsi. Kalemi shkroi, boja iu tha. Për besnikërinë, besnikëri. kalemi shkroi, boja madje, iu tha!

Ka falje, por ku është shkëlqimi i shpresës që robi të bëhet faqebardhë me drojtjen nga Zoti?

Vjedhësi e shpëton jetën po të falet. Por a mund të bëhet i besuari, kujdestari i vezirit dhe thesarit?

O i besuari i fesë, o njeri i Zotit, eja se çdo kurorë, çdo flamur formohet nga besueshmëria!

Edhe sikur dikush të jetë i biri i padishahut dhe të bëjë tradhti, dije se padishahu ia heq kokën!

Kurse po të tregohet i besës, edhe një skllav zezak indian siguron fat të mirë dhe të ardhme, i zgjatet jeta!

Ç'skllav? Edhe qeni roje i një porte, madje, po të tregohet besnik, fiton pëlqimin e të zot!

Dhe, prandaj ia puth edhe gojën qenit. Atëherë, krahaso dhe kupto se ç'do të bënte për luanin besnik në portë!

Vetëm hajduti nëse bën adhurime dhe i shkul me rrënjë drejtësinë e poshtërsinë...

Si pirati Fuzejl. Edhe ai e luajti mirë lojën. U kap pas pendesës jo si një, por si dhjetë njerëz. Edhe ky lloj hajduti lartësohet, arrin lumturinë!

Kështu, magjistarët, me durimin dhe besnikërinë e tyre, ia nxinë fytyrën faraonit

Në fillim flijuan këmbët e duart si ndëshkim për fajin. A i ngjet kjo punë kryerjes së adhurimeve për qindra vjet?

Ti bën adhurim për pesëdhjetë vjet, por si do ta arrish një drejtësi dhe ndershmëri të tillë?

Në Herat, një i varfër pa skllevërit e stolisur e të zbukuruar të amidit të Horasanit.
Kishin hipur mbi kuaj arabë, kishin veshur rroba me qëndisje ari,
kishin vënë në kokë qylafë me ar, dhe plot stoli të tjera.
Ai pyeti se prej nga ishin ata bejlerë e padishahillarë.
I thanë se s'ishin bejlerë, por skllevër, skllevërit e Amidit të Horasanit!
I varfëri ngriti kokën drejt qiellit dhe tha:
"O Zot, mëso nga Amidi se si duhet kujdesur për robin!"
Atje, amidi është si një farë ministër i financave.

Në qytetin Herat, një i varfër i paturpshëm pa një skllav me pozitë të lartë.

Në shpinë kishte një rrobë atllasi dhe në bel, një brez të artë. Ndërsa skllavi kalonte në rrugë, i varfëri e ngriti fytyrën ndaj qiellit dhe tha:

O Zot, pse s'e mëson nga ky zotëri mirëbërës se si duhet trajtuar robi?

O Zot, të paktën mësoje kujdesin për robin nga ky njeri i lartë, i zgjedhur nga padishahu ynë!

I varfëri ishte nevojëtar, lakuriq, nuk kishte asgjë. Dimrit dridhej nga të ftohtit.

Ai njeri që s'dinte gjë as për veten e vet, prandaj pati një guxim të tillë!

Ai kishte besim në mijëra të mira të Zotit, se ai ishte ndihmësi i tij, se merrte pjesë mes të diturve.

Po që se ndihmësi i padishahut bën një paturpësi, mos i mbaj shënim këtë veprim.

Zoti i tha bel. Sigurisht, beli është më i mirë se brezi. Por njeriu që jep kurorë, a mund të japë kokë?

Më në fund, një ditë, padishahu e kapi atë zotërinë (Amidin) në faj e sipër dhe e lidhi këmbë e duar.

Dhe nisi t'u bëjë tortura skllevërve: Ku është thesari i zotërisë sonë? Tregoni!

Dhe i torturoi natë e ditë, një muaj me radhë:

O njerëz të poshtër, thomani të fshehtën e tij mua. Ndryshe, jua preva gjuhën, jua hoqa kokën!

Dhe i bëri copë-copë! Por asnjëri nuk ia thanë të fshehtën e zotërisë së tyre!

Në këtë mes, ndërsa po flinte, të varfërit i erdhi një zë i lehtë: O njeri i madh, eja dhe ti dhe mësoje nga këta se çdo të thotë rob e shërbëtor!

O ti që ia rope lëkurën Jusufit, po qe se edhe ty të rrjep ujku, këtë dije se e ke prej vetes!

Vish ç'ke endur gjatë një viti, korr ç'ke mbjellur gjatë tërë vitit!

Këto mjerime që të bien në kokë çast pas çasti, janë ndëshkim për bëmat e tua. Ja, ky është kuptimi i shprehjes "kalemi shkroi, boja, madje, iu tha"!

Zakoni ynë nuk ndryshon, ne tregojmë rrugën e drejtë. Të mirë, për të mirën, të keqe, për të keqen!

Çfarëdo që të bësh, më parë mendoje, pastaj bëje, sepse Sulejmani është i gjallë. Po të bëhesh ti shejtan, ai e nxjerr shpatën nga milli!

Por kur njeriu bëhet engjëll, është i sigurt ndaj shpatës; ai nuk ka frikë nga Sulejmani!

Vendimi i Sulejmanit është kundër jo engjëllit, por Shejtanit. Mundimi dhe vuajtja janë në tokë, jo në qiell!

Lëre këtë bindje determinizmi se është krejt boshe. Lëre këtë bindje dhe kuptoje ç'është e fshehta e determinizmit!

Lëre këtë determinizmin që është malli i të gjithë dembelëve dhe mëso diçka nga determinizmi që është si jeta!

O ti që e pandeh veten për të bukur e të lartë, lëre pretendimin për të qenë i dashuruar dhe bëhu dashurues!

Në kuptim, ti je më i pagojë se nata! Atëherë, pse t'i kërkosh fjalës sate myshteri?

Ata të tundin para syve gjellë dhe ty të kaloi jeta me sevdanë për to!

Më thua që të mos përpëlitem nga zilia, por a ka zili njeriu pse humbi një hiç?

O syuritur, mësimi i diçkaje nga njerëzit e ulët i ngjet bërjes së dekoracioneve e vizatimeve në një copë tokë!

Mësoja vetes se ç'janë dashuria dhe vështrimi! Kjo dije është si vizatimi dhe dekoracioni në gur!

Nefsi, egoja, të pështëriti një besë. Çdo gjë tjtër u asgjësua. Ç'kërkon ti dhe ku e kërkon?

Të tjerët i bën zotërues dijeje, i lartëson, kurse veten e bën me vese të këqija dhe të zbrazët!

Po qe se zemra ta shëtiti atë xhennet dhe u njësua me atë burim, eja në vete dhe mos ki frikë nga zbrazja!

Zoti tha: O pejgamber fjalëdrejtë, thuaj që ky është det, nuk pakësohet.

Prapë u tha: "Heshtni dhe dëgjoni!" Pra, ejani në vete, mos e lodhni ujin, kopshti është pa ujë!

Or babush, kjo fjalë s'ka fund. lëre fjalën dhe shih fundin!

Zelli s'më mjafton, le të rrinë para teje dhe le të qeshin me ty edhe pse s'janë ashikë!

Pas perdes së bujarisë, ashikët thërrasin për ty çast pas çasti!

Edhe ti bëju ashik atyre ashikëve të së fshehtës, mos ua var shumë këtyre ashikëve për pesë ditë!

Këta të hanë ty me hile dhe dredhi. Për vite të tëra një thërrime, madje, s'pe prej këtyre!

Pse do të lodhesh në rrugën e njerëzve? Këmba jote e çalë nuk arriti asnjë synim!

Në kohë të mirë e të këndshme, të gjithë të bëhen shokë e miq! Por në kohë dëshpërimi kë ke shok e mik veç Zotit?

Kur të dhembin sytë apo dhëmbët, a ka tjetërkush veç Zotit që të mban për dore?

Edhe ti kujtoje atë kohë sëmundjeje e vuajtje dhe, si Ejazi, shih postiqen dhe merr mësim!

Gjendja e postiqes është gjendja jote kurbie në atë hall. Prandaj e kishte ruajtur Ejazi atë!

Prapë ai deterministi qafir i jep përgjigje muslimanit sunnit
i cili e fton në Islam dhe e inkurajon ta braktisë bindjen deterministe;
pyetja dhe përgjigjja zgjaten nga të dy anët.
Gjënë e vështirë dhe fuqinë për të dhënë përgjigje e zgjidh vetëm ashku,
pasioni hyjnor i vërtetë. Ashku nuk pengohet nga pyetja dhe përgjigjja.
"Dhe kjo është mirësia e Zotit që ia jep kujt të dëshirojë!"

Mohuesi dhe heretiku determinist ia hyri dhënies së një përgjigjeje të tillë që logjika e muslimanit pothuajse mbeti e paaftë, u hutua.

Por nëse unë do t'i them të gjitha ato pyetje-përgjigje, duhet ta lë fjalën që kam për të thënë!

Mirëpo ne kemi për të thënë gjëra shumë më të rëndësishme se to, me të cilat aftësia kuptuese shtohet.

Prandaj, atë pyetje-përgjigje e treguam shkurt. Fundja, e tëra del në shesh me të paktën!

Në fakt, ky diskutim mes atij që nuk beson në kaderin dhe deterministit, vazhdon gjer në ringjallje!

Po të mos e kishe vënë poshtë hasmin, do të ndiqje doktrinën e tij, do të zije rrugën e tij!

Edhe ata, po të kishin mbetur të paaftë në përgjigje, do të ktheheshin nga ajo rrugë e prishur.

Mirëpo kjo ecuri duhet të jetë e tillë, në mënyrë që të gjithë ata të binden me argumente për drejtësinë e rrugës së tyre!

Askush s'duhet t'i lërë pa përgjigje pyetjet e vështira të kundërshtarit; kundërshtari dhe armiku duhet të turpërohen nga e ardhmja, nuk duhet ta shohin të ardhmen, në mënyrë që këto shtatëdhjetë e dy fraksione të mbeten në këtë botë gjer në kiamet!

Sepse kjo botë është botë e errësirave dhe e të fshehtave. Për hijen duhet një sipërfaqe toke!

Nuk mbetën këto shtatëdhjetë e dy fraksione gjer në kiamet, që thashethemet e atij që ka zënë rrugën e sajimeve, të mos pakësohen.

Thesari i çmuar ka disa dryna. Vlera e thesarit nga kjo kuptohet!

Edhe lartësia e synimit tënd, o njeri që je vënë në provë, bëhet e qartë nga shqetësimi i rrugës, nga kalimet e pakalueshme dhe prania e piratëve dhe grabitësve.

Nderi i Qabes është në ato shqetësime, në piratërinë e arabëve të shkretëtirës dhe gjatësinë e shkretëtirës!

Çdo ecuri e mirë, çdo rrugë ka një rrezik, një pengesë, një piratëri.

Kjo ecuri shkakton zilinë e tjetrit, i bëhet armik. Dhe, atëherë, imituesi mbetet i shushatur në mes të rrugës.

Në ecje, drejtësia e çdo rruge duket e kundërt me tjetrën. Çdo fraksion është i kënaqur me rrugën e vet.

Po qe se udhëtari i një udhe nuk jep përgjigje, fillon grindja dhe zënia. Kështu ka ardhur kjo qysh në fillim e kështu do të shkojë gjer në kiamet!

Eshtë vetëm ashku që ia mbyll gojën e dyshimit dhe lëkundjes. Kurse kush ka mundur ta lidhë dyshimin dhe lëkundjen?

Kërko dilber fytyrëbukur dhe bëhu ashik. Përsillu lumë më lumë dhe zër një zog uji.

Ç'mund të përfitosh nga uji që të turpëron? Ç'kupton nga gjëja që e shkatërron aftësinë kuptuese?

Përveç gjërave që kuptohen me këtë mendje, në ashk ka edhe shumë gjëra të shkëlqyera e të bukura që kuptohen me mend.

Tek Zoti ka edhe mendje të tjera veç mendjes tënde që shkaqet e qiellit me to hyjnë në masë.

Me këtë mendje ti merr furnizimet e tua. Sa për mendjen tjetër, me të, shtatë kat qiejt i bën dysheme për vete.

Po qe se bie në dashurinë e Zotit dhe luan me mendjen tënde, Zoti të dhuron ty shumë më tepër se ajo mendje, madje shtatë fytyrat e atyre mendjeve!

Gratë luajtën me mendjet e tyre dhe rrëshqitën në gabimin e ashkut për Jusufin.

Sakiu i jetëgjatësisë ua mori për një çast mendjet atyre, u ngopën me mendje gjer në fund të jetës dhe emrin, madje, nuk ia kujtuan!

Kurse bukuria e Zotit të Lartë është edhe origjina e bukurisë së qindra Jusufëve. O burrë që je më poshtë se një grua, për atë bukuri flijohu!

O shpirt, diskutimin vetëm mendja e ndërpret. Ku është ai që do ta shpëtonte njeriun nga llafet dhe do t'i shkonte në ndihmë klithmës së tij?

Eshtë një mahnitje që i vjen asaj fjale për shkak të ashkut dhe s'i mbetet më fuqi për ta treguar aventurën!

Sepse po dha një përgjigje, ka frikë se mos i bie margaritari që ka brenda.

Dhe nga ajo mahnitje i ka mbyllur buzët fort, edhe nga e keqja. Ka frikë se mos i bie margaritari nga goja.

Kështu, edhe miku i Pejgamberit ka thënë: Kur Pejgamberi na lajmëronte për diçka, na thoshte diçka,

Ai Pejgamber i zgjedhur, kur i shpërndante ato margaritarë, kërkonte nga ne qetësi të madhe, seriozitet të madh...

Sikur të të qëndrojë mbi kokë një zog dhe ti të mos bësh asnjë lëvizje nga frika se trembet e fluturon...

Dhe ti nuk lëviz nga vendi që të mos ngrihet në ajër ai zog i bukur!

Nuk merr frymë, e shtrëngon veten edhe po të erdhi kolla, nuk kollitesh nga frika se mos fluturon ai zog me fat!

Po qe se në atë kohë dikush të thotë ty një fjalë të ëmbël apo të hidhur, vë gishtin në buzë duke i treguar se duhet të heshtë.

Ja, ai zogu është mahnitja që të bën ty të heshtësh. Ia mbyll gojën tenxheres dhe fillon të të zjejë ty!

Padishahu e pyet Ejazin enkas që ta bëjë të flasë: "Pse ua thua dhimbjet dhe gëzimet gjërave pa shpirt si opingat dhe postiqja?"

O Ejaz, ç'është kjo dashuri për një copë opingë? Pse tregohesh i pasionuar pas tyre si pas një idhulli?

Si Mexhnuni, e ke kthyer fytyrën nga Lejlaja dhe ke bërë një palë opinga fe e besim për vete!

Gjer kur do t'u thuaj fjalë të njoma opingave të vjetra dhe, kështu, do t'ia hapësh të fshehtën e përjetshme një gjëje të pajetë?

O Ejaz, ti po u flet gjatë e gjatë, si arabët, nga dashuria, vendeve të çadrave të mbetura në shkretëtirë, rrënojave të atjeshme!

Nga cili i dashur i shtegtuar e i ikur të kanë mbetur opingat? Postiqja jote sikur është këmisha e Jusufit!

Si krishterët... Shkon dhe i rrëfehet priftit për fajet e një viti, për kurvërimet, për të këqijat e menduara e të ndjera!

Po e fali prifti, ai e quan faljen e tij si faljen e Zotit!

Mirëpo prifti nuk di as faj, as drejtësi. Por ashku dhe besimi janë magjistarë shumë të fuqishëm!

Miqësia dhe iluzioni krijojnë qindra Jusufë. Fundja, magjia ka mbetur nga Haruti dhe Maruti!

Me kujtimin e të dashurit, njeriu krijon një trajtë. Tërheqja e asaj trajte të shtyn ty në thashetheme.

Shkon para trajtës dhe i derdh qindramijëra të fshehta siç i tregon miku mikut të fshehta.

Mirëpo aty nuk ka as trajtë, as statujë. Megjithatë, prej atje dëgjohen qindra Elest, kurse prej këtu, qindra Bela.

Po kështu, një nënë me zemrën të plagosur thotë nga zemra qindra të fshehta

Mbi varrin e të birit të porsavdekur. Ai dhe i pajetë i duket asaj i gjallë!

Atë dhe e pandeh të gjallë e me shpirt, kapet pas pandehmës se ai grumbull dheu ka sy e veshë.

Kujton se ai dhé dëgjon dhe sapo të nisë e të vajtojë ajo, dheu ia dëgjon klithmën dhe vajtimin!

Pandeh se dheu dëgjon! Pa shihe këtë ashk magjepsës!

Nëna mbështet fytyrën e përlotur mbi dheun e varrit të të birit, e fërkon fytyrën pas atij dheu!

Nuk e pati fërkuar kështu fytyrën në trupin e të birit sa qe gjallë!

Megjithëkëtë, pasi të kalojnë disa ditë nga ajo vdekje, zjarri i dashurisë së saj tulatet.

Se ashku ndaj të vdekurit nuk mund të jetë i përjetshëm. Ti duaje të gjallin që i jep jetës jetë!

Pasi të kalojë ajo dhimbje, nga qëndrimi përballë varrit vjen lodhje dhe gjumë. Nga një gjë e pajetë vetëm një gjë e pajetë mund të dalë!

Sepse ashku e ka vjedhur magjinë e vet dhe ka ikur. Pasi të shuhet zjarri, mbetet hiri!

Atë që i riu e sheh në pasqyrë, plaku e sheh plotësisht në qerpiç.

Piri është ashku yt, jo ai me mjekër të bardhë pse ka mjekër të bardhë! Piri është ai që i kap për dore qindramijëra të pashpresë.

Ashku radhit trajta në botën e ndarjes. Por kur njeriu takohet me të dashurin e vërtetë, del në shesh një e vërtetë që nuk mund të përfytyrohet, që nuk mund të përshkruhet,

Dhe thotë: Unë jam thelbi edhe i mendjes dhe të të mençurit, edhe i të dehurit. Ajo bukuri te trajta është reflektimi ynë.

Tani, duke i ngritur perdet, e treguam pa ndërmjetës bukurinë tonë!

Sepse shumë u more me reflektimin tim dhe, më në fund, e gjete fuqinë izoluese të personit!

Kur tërheqja ime të vijë nga kjo anë, krishteri nuk e sheh priftin që ndodhet në mes!

Mirëpo ai prift lutet për faljen nga favori i Zotit pas perdes, lutet nga ai favor që ta ndjejë për gabimin dhe mëkatin.

Po qe se nga një gur del një burim dhe nis të rrjedhë, atëherë guri mbetet i fshehur brenda asaj rrjedhe!

Pastaj askush nuk i thotë më gur atij, sepse nga ai gur del dhe rrjedh ai margaritar!

Këto trajta diji si qase. Ato mbushen me atë që Zoti derdh në to!

Të afërmit i thonë Mexhnunit:
"Bukuria e Lejlasë nuk është kush e di se çfarë,
në qytetin tonë ka shumë vajza më të bukura se ajo.
Të të tregojmë një a dy prej tyre dhe zgjidhe njërën që të duash
dhe shpëtoje edhe veten nga ky hall, na shpëto edhe ne!"
Mexhnuni u përgjigjet.

Nga padituria, kokëtrashët shkuan te Mexhnuni dhe i thanë: Lejlaja nuk është diçka aq e përsosur!

Në qytetin tonë ka qindramijëra vajza si hëna e plotë, shumë më të bukura se ajo!

Mexhnuni u tha: Trajta është shtamba, kurse bukuria, vera. Zoti më jep të pi mua verë nga trajta e saj.

Kurse juve ju ka dhënë uthull nga shtamba e saj, prandaj dashuria e saj jua tërheq veshin!

Nga një shtambë, Zoti jep edhe helm, edhe mjaltë. Eshtë Zoti që ia jep këtij këtë dhe prapë Zoti që ia jep atij atë!

Ti e sheh shtambën, por ajo verë nuk duket për syrin që është i padrejtë.

Kënaqësia shpirtërore nuk e vështron të panjohurin, nuk i jep shenjë tjetërkujt veç të afërmit.

Ajo verë nuk sheh tjetër veç të të njohurit. Kurse këto mbulesa u ngjajnë çadrave që e fshehin atë!

Ai det është një çadër, brenda së cilës jetojnë rosat, kurse mjellmat vdesin!

Helmi është ushqim për gjarprin. Kurse për dikë tjetër është mjerim, vdekje.

Trajta e çdo mirësie dhe mundimi është xhennet për mua, kurse për atë, xhehennem!

Prandaj, në të gjitha trupat që shihni, ka edhe ushqim, edhe helm, por ju s'e shihni dot.

Çdo trup i ngjet një tasi, një shtambe. Në to ka edhe ushqim, edhe një element zemërpërvëlues!

Tasi është sheshit, kurse ushqimi në të, i fshehur. Vetëm ai që ha nga ai tas e di se ç'ka ngrënë!

Trajta e Jusufit ishte një kupë e bukur. I ati pinte nga ajo kupë qindra verëra gëzimi.

Kurse të vëllezërit pinë një ujë të helmuar, prandaj iu shtua zemërimi dhe urrejtja për të!

Më vonë, Zelihaja hëngri sheqer prej tij, gëlltiti nga ashku një lloj tjetër opiumi.

Ajo bukuroshe mori nga Jusufi një ushqim tjetër, të ndryshëm nga ushqimi që pati marrë Jakubi.

Sherbete lloj-lloj, por shtamba po ajo. Dhe, në këtë mënyrë, ty s'të mbetet asnjë dyshim mbi botën e fshehtë, apo jo!

Vera është nga bota e fshehtë, kurse shtamba, e kësaj bote. Shtamba është sheshit, kurse vera, dy herë e fshehur!

Eshtë shumë e fshehur për jokonfidentët e saj, por për konfidentët, është e hapur, sheshit!

Zoti im, sytë na u bënë si të dehur, zemrat na e thyen mesin, falna ne!

O Zot i fshehtë, e mbushe edhe këtë botë, edhe atë tjetrën, u lartësove edhe mbi dritën e lindjes edhe mbi dritën e perëndimit!

Ti je një e fshehtë që na i njeh e na i nxjerr të fshehtat tona në shesh. Ti je një agim që na i bën lumenjtë të gurgullojnë e të rrjedhin!

O Zot me individualitetin të fshehur por që të dëgjohet mirësia, ti je si uji, kurse ne i ngjajmë gurit të mullirit!

Ti je si era, kurse ne, si pluhuri. Erën e fsheh, kurse pluhuri është sheshit.

Ti je pranverë, kurse ne, të blertë si kopësht, të kënaqur... Ti je i fshehtë, mirësia jote, e dukshme!

Ti je si shpirti, kurse ne u ngjasim këmbëve e duarve. Dora kap dhe tërheq me anë të shpirtit.

Ti je si mendja, kurse ne i ngjasim gjuhës. Gjuha e merr dhe e fikson tregimin nga mendja!

Ti je si gëzimi, kurse ne, si e qeshura. Pra, si rezultat i gëzimit, qeshim dhe gëzohemi.

Lëvizjet dhe veprimet tona të japin ty çdo çast një dëshmi, janë dëshmitarë që i dëshmojnë Zotit të Lartë.

Edhe rrotullimi i mundimshëm i gurit të mullirit është dëshmitar i pranisë së ujit.

O Zot që ndodhesh jashtë iluzioneve dhe thashethemeve të mia, dheu është për kokën time, kurse shembulli që solla, është për ty!

Robi s'bën dot durim por bën përshkrime të bukura. Çdo çast, shpirti im është për ty si dyshemeja e shtruar ndër këmbë!

Si ai çobani. Edhe ai thoshte: O Zot, eja te çobani që të kërkon ty!

Eja që të t'i qëroj morrat në këmishë. Të t'i qep opingat, të ta puth prehrin!

Askush nuk mund të barazohej me të në ashk dhe afërsi, por ai s'dinte si ta madhëronte Zotin, si t'i fliste atij!

Ashku i tij kishte ngritur çadër në qiell. Shpirti që i ngjet qenit, ishte kthyer në qen që rrinte në hyrjen e çadrës së tij!

Kur mori vrull deti i ashkut për Zotin, ia goditi zemrën atij, kurse preku në veshin tënd!

Xhuhai vesh çarçaf, futet mes grave dhe dëgjon predikim;
pastaj, për shkak të një veprimi të tij, njëra nga gratë e njeh dhe bërtet.

Ishte një predikues me fjalën të fuqishme dhe tërheqjen, siç duhej. Ishte ngjitur në minber dhe po predikonte. Nën minber ishin mbledhur burra e gra.

Xhuhai veshi një çarçaf, e mbuloi fytyrën dhe u fut mes grave. Askush nuk e njihte!

Një grua e pyeti predikuesin fshehur: Qimet e të poshtmeve a bëhen shkak për prishjen e namazit?

Predikuesi i tha: Po të jenë të gjata, namazi bëhet mekruh, i papëlqyeshëm.

Duhet t'i heqësh ose me bar hamami, ose me brisk që namazi të të bëhet i saktë, të të pranohet.

Gruaja e pyeti: Sa të gjata duhet të jenë që të mos më pranohet namazi?

Predikuesi i tha: Po të jenë të gjata sa një kashtë elbi, është farz, e detyrueshme të hiqen.

Xhuhai menjëherë i tha gruas: Motër, pa shihe, a më është bërë mua qimja e të poshtmeve sa një kashtë elbi?

Për hir të Zotit, zgjate dorën dhe kontrolloje. Ta shohim, a është zgjatur sa për t'u bërë mekruh?

Gruaja pranë, sa e futi dorën brenda shallvareve të Xhuhasë, i preku dora veglën.

Dhe menjëherë lëshoi një klithmë të fuqishme. Hoxha predikues i tha: Fjala ime të preku në zemër!

Xhuhai tha: Jo, nuk e preku në zemër, por në dorë. O more i mençur, mjerë po ta kishte prekur në zemër!

Ai preku pak në zemrën e magjistarëve dhe dhjetra shkopinj u bënë një, po ashtu dhe duart.

Sovrani im, po e more shkopin e plakut, shkopi preket shumë meqë është dora dhe këmba e tij!

Mirëpo ata, edhe pse do t'u priteshin duar e këmbë, bërtitën "neve s'na vjen ndonjë dëm" dhe britma e tyre arriti në qiell. Eja, na i pri – thanë – se shpirti na shpëton pa vuajtje!

Ne e mësuam se s'përbëhemi prej këtij kurmi. Ne jetojmë me Zotin edhe pa kurm!

Ç'lumturi për atë person që e njohu vetveten dhe ngriti një pallat në fushën e sigurisë së përjetshme!

Fëmija qan për arra dhe rrush të thatë. Mirëpo për njeriun e madh, këto s'janë asgjë!

Edhe për zemrën, kurmi është arra dhe rrush të thatë!

Si do t'i dijë fëmija ato që dinë të mëdhenjtë?

Kush të jetë pas perdes, është fëmijë. Burrë i thonë atij që s'thyhet.

Po qe se burri do të ishte burrë për mustaqet dhe qimet, edhe cjapi ka mustaqe e qime; edhe ai do të bëhej burrë!

Mirëpo cjapi bëhet kallauz i keq se ata që i shkojnë pas, i tërheq e i çon vetëm te kasapi!

E kreh mjekrën duke dashur të thotë se është nga parësia! E drejtë, je nga parësia, por për vdekje dhe vuajtje!

Eja në vete dhe hiq dorë nga mjekra. zër një udhë për vete dhe lëri këtë egoizëm e këtë turbullim.

Dhe, në këtë mënyrë, bëhu esencë trëndafili për ashikët, bëhu kallauz për në trëndafilishte, dil para!

Ç'është aroma e trëndafilit? Fryma e mendjes, kallauzi i mirë i vendit të përjetësisë!

Padishahu i thotë përsëri Ejazit ta shpjegojë punën e opingave dhe të postiqes në mënyrë që shokët të marrin këshillë, sepse "Feja është këshillë!"

Ejaz, thuaj, ç'është e fshehta e opingave? Ç'është kjo lutje e shumtë për një palë opinga?

Thuaj dhe Sunkuri dhe shoku yt Bekbaruk të dëgjojnë dhe ta kuptojnë të fshehtën e të fshehtës së postiqes dhe opingave!

Ejaz, figura e robit u ndrit prej teje. Drita jote shpëtoi nga bota e ulët dhe u lartësua në qiell!

Për shkak tënd, robëria u bë një gjë që ta kenë mall njerëzit e lirë! Qysh kur ti i dhe jetë robërisë, edhe të lirët u bënë që t'i marrë malli për robërinë!

Besimtar i thonë atij që, në çdo specifikë, edhe mohuesi, madje, ta ketë zili për besimin, t'i mbeten sytë te ai!

Në kohën e Bajezidit, kur një qafiri i thanë "bëhu musliman", ai dha një përgjigje për këtë.

Në kohën e Bajezidit ishte një mohues, heretik. Një musliman i bekuar i tha atij:

Sa mirë do të ishte të bëheshe musliman, të shpëtoje e të lartësoheshe!

Heretiku i tha: Po qe se muslimanllëku është muslimanllëku i Bajezidit, shehut të botës,

Unë s'kam fuqi për të. Ai qëndron shumë lart në krahasim me punët e mia!

Unë s'besoj në fe e besim, por e kam besuar fare mirë besimin e tij!

Unë kam një besim shumë të hollë, shumë të ndritshëm, më të lartë se të çdokujt.

Gojën e kam të vulosur fare mirë, prandaj nuk mund ta shpreh besimin, por fshehurazi, unë jam besimtar i besimit të tij!

Kurse sa për besimin tuaj, në qoftë besim, për të s'kam as prirje, as oreks!

Kush ka qindra prirje për besim, sapo ju sheh juve, ftohet!

Sepse njeriu sheh vetëm një emër në besimin tuaj, një emër pa kuptim. Si ndodh që shkretëtirës t'i thuhet vend shpëtimi?

Dashuria për besimin e personit që e sheh besimin tuaj, ftohet e mbaron!

Një muezin me zë të shëmtuar këndon ezan në një vend jomusliman dhe një qafir i bën një dhuratë.

Ishte një muezin me zë shumë të shëmtuar. Ai këndonte ezan në një vend jomusliman.

Megjithëse i thanë se këndimi i ezanit do të shkaktonte luftë, armiqësia do të zgjatej,

Këmbënguli dhe u vu të këndojë ezan pa u ndalur në atë vend qafirësh!

Ndërsa populli frikësohej nga një rrëmujë e përgjithshme, veç ç'të shohin, doli një qafir me një rrobë në duar!

Si miqtë, kishte marrë në duar qiri dhe hallvë dhe po e sillte si dhuratë atë rrobë të bukur!

Dhe pyeti: Më thoni, ku është ai muezini? Ezani dhe salaja e tij mua më dhanë prehje!

I thanë: Or ti! Si është e mundur? A mund t'i japë prehje e qetësi ai zë i shëmtuar njeriut?

Qafiri tha: Kur zëri i tij arriti në kishë, ja se ç'ndodhi. Unë kam një vajzë shumë të mirë e shumë të bukur por që ka kohë që dëshironte të bëhej muslimane.

Dhe kjo sevda kurrsesi s'i dilte nga koka! Sa e sa nga tanët e këshilluan!

Por dashuria për besimin musliman i kishte zënë vend në zemër në atë mënyrë, që ky hall na ishte bërë një vorbull që na kishte përfshirë të gjithë brenda!

Ndërsa ajo i drejtohej besimit çdo çast e më shumë, edhe mua më shtohej hidhërimi e dëshpërimi!

Dhe s'më vinte doresh asgjë për të bërë. Por, më në fund, kur ky muezin këndoi ezan,

Vajza më tha: Ç'është ky zë i shëmtuar? Më erdhi në veshë e më bëri si mos më keq!

Sa jam gjallë, gjer më sot nuk kam dëgjuar zë kaq të shëmtuar në këtë kishë e në këtë manastir!

E motra i tha: Ky është ezani i muslimanëve. E këndojnë muslimanët për t'i thirrur muslimanët në falje!

Nuk besoi, pyeti një tjetër dhe kur edhe ai i tha të njëjtën gjë,

E besoi, iu zverdh fytyra e iu bë dyllë dhe nuk i mbeti më dëshirë për muslimanllëk.

Atëherë, edhe unë shpëtova nga kjo turbulli e vuajtje dhe mbrëmë bëra një gjumë të qetë e pa frikë!

Prandaj thashë se zëri i tij më kishte qetësuar. Prandaj i solla një dhuratë. Ku është ai njeri?

Sa e pa muezinin, i tha: Të lutem, pranoje këtë dhuratë se më shpëtove nga vuajtja, më dhe dorën!

Më bëre një të mirë aq të madhe, sa të jam bërë skllavi yt që s'pranon çlirim!

Po të isha i vetmi në mall e pasuri, do të ta kisha mbushur gojën me flori!

Ja, pra, besimi juaj është, si kjo, hipokrizi, një gjë e përkohshme, pirat që grabit udhëtarët, si ai ezan!

Kurse për besimin e Bajezidit, ndaj drejtësisë dhe ndershmërisë së tij, kam shumë mall në zemër!

Si puna e asaj gruaje... Pa çiftëzimin e një gomari me një gomaricë dhe tha: Amani, shihni çfarë mashkulli!

Po qe se ky duhet të jetë çiftëzimi, burrat tanë nuk çiftëzohen me ne, vetëm sa na përshurrin brenda!

Bejazidi i përmbante të gjitha kushtet e besimit! I lumtë këtij luani të vetëm!

Sikur një pikë e besimit të tij të binte në det, deti do të mbytej në atë pikë!

Po kështu, sikur në pyll të binte një grimcë zjarr, ajo grimcë do ta digjte gjithë pyllin!

Si imagjinata në zemrën e padishahut ose të ushtrisë së tij. Edhe ajo imagjinatë është imagjinatë, por në luftë i shkatërron armiqtë!

Në fytyrën e Muhammedit shkëlqeu një yll dhe elementët e qafirëve dhe çifutëve u asgjësuan!

Kush e arriti besimin, gjeti shpëtim, kurse dyshimi i atyre që nuk besuan, u dyfishua.

Parësisë nuk i mbeti mohimi i vërtetë, prandaj vendin e tij e zuri ose muslimanllëku, ose frika!

Dhe kjo është ta përzjesh me dredhi ujin me vaj. Këta shembuj nuk barazohen as me thërrmijën e së vërtetës!

Thërrmija nuk është gjë tjetër veç një copëz e vogël e shkëputur nga një trup. Thërrmija nuk është diell që nuk pranon përpjesëtim!

Kur them thërrmijë, dije se kam një synim të fshehtë. Ti nuk je det hë për hë, por vetëm shkumë.

Po qe se dielli i shkëlqyer i besimit i shehut shfaqet nga lindja e shpirtit të shehut,

E gjithë bota e ulët gjer në fund të dheut shndërrohet në thesar, kurse tërë bota e lartë kthehet në xhennet krejt të jeshiltë.

Ai ka një shpirt nga drita e shkëlqyer dhe një trup nga dheu i ulët e i varfër.

Mbeta i hutuar: kjo, apo ajo? Mbeta në vështirësi.

O vëlla, ç'është ky që shtatë kat qiej të mbushen me dritën e tij?

Por nëse jo, ky trup ç'është atëherë? Cili, vallë, nga këta të dy?

Një grua i tha të shoqit se mishin e kishte ngrënë macja;
burri e peshoi macen në peshore dhe, pasi macja erdhi gjysmë oke,
burri i tha gruas se mishi peshonte gjysmë oke dhe ca më tepër,
dhe, në këtë ras, mungon ose macja, ose mishi!

Një burrë kishte një grua. Ishte një grua shumë dredharake, me vese të ulta dhe grabitqare.

Çdo gjë që sillte burri në shtëpi, e shpenzonte, e prishte. Megjithëkëtë, burri s'e nxirrte zërin!

Një ditë, burri, për të pritur një mik, bleu me qindra vështirësi pak mish dhe e solli në shtëpi.

Dhe gruaja e bëri qebap dhe e përlau të tërin duke e shoqëruar me verë. Pastaj, kur erdhi burri, filloi t'i fliste fjalë pa lidhje.

Burri i tha: Miku erdhi, po mishi, ku është? Duhet t'i nxjerrim bukë mikut!

Gruaja i tha: Atë mishin e hëngri macja, shko e sill mish tjetër!

Burri e urdhëroi shërbëtorin: Abejk, sille peshoren ta peshoj një herë këtë macen!

Peshorja erdhi, e peshoi macen dhe macja erdhi gjysmë oke. Atëherë, ai i foli gruas:

Moj bushtër dhelparake, mishi ishte gjysmë oke, kështu që duhet të dilte gjysmë oke më shumë se edhe macja erdhi gjysmë oke!

Në qoftë se kjo është macja, mishi ku është? Ose, në qoftë se kjo është mishi, dil dhe kërkoje macen buxhak më buxhak!

Në qoftë se ky është Bejazidi, shpirti ç'është? Në qoftë se ai është shpirti, kjo trajtë ç'është?

O mik, mbeta pa mend! Kjo s'është as puna jote, as puna ime!

Që të dyja janë ai. Por thelbi i prodhimit është kokrra, kurse kashta është teprica.

Urtësi Zoti kjo, i shkriu bashkë këto dy të kundërta! O kasap, nuk ka mish pa kocka!

Shpirti nuk bën dot punë pa trupin. Edhe kallëpi yt pa shpirt ftohet, ngrin!

Kallëpin e ke sheshit, kurse shpirtin, të fshehur. Edhe shkaqet e kësaj bote janë rregulluar me këta të dy!

Po qe se i hedh dikujt dhé në kokë, koka nuk i çahet. Po kështu, nuk i çahet po i hodhe ujë.

Po deshe të çashë kokë, duhet të përzjesh dhé me ujë e të bësh qerpiç.

Pasi ta çash kokën, uji i qerpiçit shkon në origjinë, kurse në dítën e ndarjes, dheu bashkohet me dhé.

Urtësia e Zotit në bashkimin e ujit me dheun del në shesh nga lutja me kryeneçësinë.

Pastaj formohen bashkime të tjera që as veshi i ka dëgjuar, as syri i ka parë!

Po t'i kishte dëgjuar veshi, do të mbetej vesh ose a do të mund të dëgjonte fjalë të tjera?

Po qe se bora dhe akulli do ta kishin parë diellin, do ta kishin prerë shpresën nga akullimi!

Do të bëheshin ujë gjer në damarë e në palcë dhe ajri Daut do të bënte mburojë me to.

Do të bëheshin derman për shpirtin e çdo druri. Çdo dru e çdo pemë do të merrte jetë me to.

Mirëpo akulli i ngrirë ashtu mbeti dhe filloi t'u thoshte drurëve e pemëve "mos më ngani"!

Edhe trupi i njeriut të ngrirë si akull as përshtatet e bashkohet me diçka, as diçka afrohet me të. Ai vetëm sa është në kërkim të frymës së vet!

Edhe ai s'është pa dobi, se prej tij rinohen mëlçitë, por nuk është as shërbyes blerimi, as padishah blerimi!

O Ejaz, ylli yt është shumë i lartë. Çdo yjësi nuk mund t'i bëhet atij vendqëndrim!

A e pëlqen mirësia jote një besë të tillë? Thjeshtësia jote e kulluar a e zgjedh dhe e pranon një thjeshtësi çfarëdo?

Një bej i thotë skllavit të shkojë e t'i sjellë verë.
Duke e sjellë verën, gjatë rrugës, skllavi e dëgjon
këshillën e një zahidi
dhe e thyen shtambën me gur. Kur beu e mori vesh si
qëndroi puna,
e ndëshkoi zahidin. Kjo ngjarje ka ndodhur në kohën
e Isait (a.s.)
kur vera s'ishte e ndaluar, por zahidi që sillej me
devotshmëri,
e pengonte popullin nga dëfrimet dhe kënaqësitë e
këtij lloji.

Ishte një bej i gëzuar dhe i dhënë pas verës. Ishte një person te i cili mbështetej çdo i përgjumur, çdo i pashpresë.

Ishte mirëbërës, i mbronte të varfërit, ishte i drejtë, dhuronte florinj e gurë të çmuar, ishte një burrë fjalëgjerë.

Ishte mbret i burrave, zotëria i besimtarëve, që e njihte rrugën, që e kupton të fshehtën, që kujdesej për miqtë e shokët.

Ishte koha e Isait, periudha e Mesihut. Një natë, te ai zotëri i mirë që ia kishte fituar zemrën popullit dhe që përpiqej të mos ngacmonte askënd,

Shkoi papritmas një mik. Edhe miku ishte si ai, zotëri i mirë e i këndshëm.

Për të ardhur në qejf, deshën të pinin verë. Atëherë, vera ishte hallall, e lejuar.

Por në shtëpi kishin pas verë, prandaj i zoti i shtëpisë i tha shërbëtorit të vraponte, ta mbushte shtambën me verë e t'ua sillte.

I thanë: Te filan murg ka verë të të mirë! Merr prej saj që shpirti të na pastrohet edhe nga halli i parësisë, edhe nga halli i populllit!

Një pikë e verës së atij murgu bën punën e verës së mijëra shtambave, e mijëra qypeve!

Në atë verë ka një tharm të fshehtë ashtu siç ka disa burra që nën gunë janë sulltanë!

Ti mos ia shih fort gunën! Edhe floririt ia nxijnë sipërfaqen që të mos njihet!

Guri i çmuar në pamje duket i turbullt, por kjo, me qëllim që të mos e pëlqejë syri i keq!

A mbahen brenda shtëpisë thesaret dhe stolitë? Thesaret janë gjithmonë nën rrënoja!

Edhe thesari i Ademit qe groposur në një vend të rrënuar, prandaj syri i atij Shejtani të mallkuar nuk e pa dot!

Ai e pa dheun me përbuzje, por shpirti i thoshte se ai dhe i ishte bërë një pengesë.

Skllavi mori dy shtamba dhe doli në rrugë dhe menjëherë arriti në manastirin e murgjve.

Dha flori e mori verë si floriri. Dha gurin dhe me të bleu elementin e kulluar!

Atë verë që u bie në kokë padishahëve dhe atëherë ata i vënë sakiut në kokë kurorë të artë!

Atë verë që shkakton intriga e zënie dhe që i hedh robtë dhe padishahët kundër njëri-tjetrit!

Atë verë që i tret eshtrat dhe i bën plotësisht shpirt dhe atëherë, dërrasa dhe froni prej dërrase bëhen një!

Të kulluar, robi me padishahun janë si uji me vajin, por kur dehen, kthehen në shpirtin e fshehur në trup!

I ngjajnë qeshqekut, s'u mbeten më dallime, por ai që s'ndodhet në atë gjendje, nuk e vë dot re këtë gjë.

Ja, pra, të tillë verë kishte marrë shërbëtori dhe po shkonte në pallatin e atij zotërie me emër e nam të mirë.

Mirëpo në rrugë i doli para një zahid i vuajtur, trutharë, i zhytur në ngatërresa.

Trupi i zahidit ishte i djegur me zjarret e zemrës, e kishte fshirë shtëpinë prej çdo gjëje tjetër veç Zotit.

U ishte nënshtruar sa e sa mundimeve pa shpresë, kishte djegur male mbi male!

Zemra i kishte rënë çdo çast në luftëra, natë e ditë merrej me mundimin e trupit.

Për vite e muaj ishte zhytur në gjakra, ishte përlyer me dhera! Me ta parë atë shërbëtorin në mes të natës,

I tha: Ç'është ajo që ke në shtamba? Shërbëtori i tha: Verë është. Zahidi e pyeti: Kujt po ia çon?

Shërbëtori i tha: Eshtë vera e zotërisë së madh. Atje po e çoj. Zahidi i tha: A kështu vepron personi i cili dëshiron Zotin?

Edhe dëshiron Zotin, edhe pi dhe dëfrehet! Verë shejtani, pastaj gjysmë mendje, kështu, ë?

Mendja jote është e turbullt edhe kështu, pa verë! Duhet të vësh mend!

Po kur të dehesh, në ç'gjendje të bëhet mendja, o njeri i kapur në kurthin e dehjes siç kapet zogu në kurth?

Zija Delki e kishte shtatin shumë të gjatë.
Kurse i vëllai shehislam Taxh Belhi ishte mjaft shtatshkurtër.
Shehislami turpërohej shumë nga i vëllai. Një ditë, Zijai shkoi në mësim te i vëllai.
Aty ndodheshin e gjithë parësia e Belhit. Zijai nderoi dhe kaloi.
Shehislami i ngrit përgjysmë nga vendi.
Atëherë, Zija i tha: Po, je shumë shtatgjatë, vidh një copë prej shtatit!

Zija delki ishte një person fjalëmbël dhe përgjigjeshpejtë. Ishte vëllai i shehislam Taxh Belhiut.

Taxh Belhiu ishte shumë shtatshkurtër, i ngjiste një zogu.

I njihte të gjitha shkencat, ishte dijetar dhe i virtytshëm, por Zijai qëndronte mbi të për sa i përket fjalës dhe kuptimeve të holla.

Ishte shumë i shkurtër, kurse Zijai, më i gjatë se ç'duhej. Shehislami ishte një burrë shumë i përkëdhelur, shumë krenar.

Kurse Zijai, një predikues me forcë fjale të madhe!

Në ditë kuvendi, Zijai shkoi në kuvend. Kuvendi ishte i mbushur me kadinj, dijetarë dhe njerëz të shquar.

Shehislami vetëm sa lëvizi pak me krenari nga vendi meqë erdhi i vëllai, dhe u ul përsëri menjëherë në vend.

I prekur nga sjellja e tij, Zija i tha: Je shumë shtatgjatë, prandaj të paktën vidh një copë të vogël nga ai shtati yt si selvi!

Ku i ke mendtë ti, o armik i diturisë që kërkon të pish verë?

Fytyrën e ke shumë të bukur, të paktën lyej pak çivit. Çiviti, ç'është e drejta, bëhet pak qesharak në fytyrë të zezakut abisinas!

O azgan, ku e ke dritën e bukurisë ti që e kapërcen vetveten dhe kërkon errësirë?

Hijen e kërkojnë ditën, kurse ti ke dalë natën me re për të kërkuar hije!

Vera është hallall për popullin si ushqim, por është haram qër ata që kërkojnë dashurinë hyjnore.

Vera e ashikëve është gjak i zemrës. Sytë e tyre janë në rrugë, në konak.

Në një shkretëtirë të tillë të frikshme, kallauzi mendje ngec në vend!

Edhe ti, atëherë, po ndoqe kallauzët, e humb rrugën dhe e shkatërron karvanin.

Edhe buka e elbit është në të vërtetë haram. Nefsit vëri para bukë të përzjerë me krunde!

Armikun e rrugës së Zotit përbuze. Mos e ngjit hajdutin në minber, por tërhiqe në vend të ngushtë!

Preja dorën hajdutit. Po qe se je i paaftë t'ia presësh, të paktën lidhe!

Po s'ia lidhe ti duart atij, t'i lidh ai ty! Po s'ia theve ti këmbët atij, t'i thyen ai ty!

Mirëpo ti i jep armikut verë dhe kallam sheqeri. Pse? Jepi helm më mirë, pse s'thua?

Zahidi mori guxim, i ra shtambës me gur dhe e theu. Shërbëtori e hodhi shtambën dhe iku nga frika e zahidit.

Kur shkoi te beu, beu i tha: Ku është vera? Shërbëtori ia tregoi ngjarjen një për një!

Beu shkon me zemërim për ta ndëshkuar zahidin.

Beu u bë zjarr, u ngrit menjëherë nga vendi dhe i tha shërbëtorit: Ma trego, ku e ka shtëpinë ai zahidi?

Ma trego që t'ia shtyp kokën me këtë hekur të rëndë! T'ia thyej kafkën e patru atij të birit të bushtrës!

Ku di ai qen se ç'është rruga e drejtë? Ai vetëm sa kërkon famë!

Me këtë fanatizëm dhe hipokrizikërkon t'i bëjë vetes një pozitë, të gjejë një pretekst për ta treguar veten!

Ai s'ka asnjë aftësi përveç hipokrizisë ndaj këtij e atij!

Në qoftë i çmendur, nëse kërkon të shkaktojë grindje, ilaçi i të çmendurit është kamxhiku i bërë nga vegla e kaut!

Duhet qëlluar në kokë qeratai që t'i dalë shejtani që ka në kokë! Po s'bërtitën shërbëtorët e gomerëve, ai luajnë gomerët nga vendi?

Beu mori në dorë një topuz dhe doli në sokak. Në mes të natës, gjysmë i dehur, hyri në shtëpinë e zahidit.

Nga zemërimi, kish bërë me mend ta vriste zahidin. Zahidi hyri nën turrat e leshit që ndodheshin në shtëpi e u fsheh.

Prej aty ku ndodhej, zahidi i dëgjonte fjalët e beut.

Aty ku ishte, mendoi: Shëmtinë atij njeriu mund t'ia thotë në fytyrë vetëm pasqyra, se fytyra e tij është shumë e ashpër!

Duhet një fytyrë e hekurt si pasqyrë që të të thotë: Shihe fytyrën tënde të shëmtuar!

Delkaku e zë mat Sejjid Shah Tirmidhiun.

Padishahu luante shah me Delkakun. Sapo që Delkaku ta zinte mat, padishahu nxehej.

Nuk ia pranonte dot krenaria humbjen, merrte gurët dhe ia hidhte kokës Delkakut duke i thënë: Allahu ta dhëntë atë që meriton!

Merre, pra, shahun, se është i yti! Kurse Delkaku duronte dhe vetëm sa i thoshte: "Aman, padishahu im!"

Një ditë, padishahu prapë u zu mat. Atëherë, e urdhëroi Delkakun të luanin edhe një lojë tjetër. Delkaku dridhej si i zhveshuri në mes të dimrit!

U luajt edhe një lojë dhe prapë padishahu humbi! Sapo padishahu do t'i bërtiste e do t'ia hidhte gurët kokës,

Delkaku u ngrit me të shpejtë dhe iku në një qoshe dhe u fsheh nga frika nën gjashtë halli.

I fshehur e i mbuluar nën ato halli dhe jastëkë, gjeti shpëtim nga gurët e shahut!

Padishahu i tha: Ç'po bën, ç'është kjo? Delkaku i tha: Padishahu im, Allahu ta dhëntë hakun!

Po më lëshon zjarr! A mund të thuhet fjalë e drejtë vetëm se nën dysheme ndaj një padishahu zemërak si ti?

Ti u zure mat, por edhe unë po zihem mat nga goditjet e shahut! Prandaj që nga poshtë hallinjve po të them ta dhëntë Zoti hakun!

Mëhalla u mbush me të bërtiturat e atij beut dhe me zhurmën e derës nga shqelmat.

Njerëzit dolën jashtë nga e djathta e nga e majta! O i madhi ynë, është kohë ndjese!

Truri i tij është tharë. Tani, mendja e tij është më e pakët se e fëmijëve!

Edhe zahid, edhe plak! Zahidllëku në këtë gjendje e ka dobësuar atë shumë herë. Veç kësaj, as ka marrë ndonjë frymëzim nga ky zahidllëk!

Ka hequr mundime, por nuk ka marrë dot ndonjë thesar nga i dashuri! Punë ka bërë, por kurrgjë s'ka fituar!

Ose ajo punë s'paska qenë për të, ose nuk i ka ardhur ende koha e shpërblimit!

Ose puna e tij është çifutllëk, ose arritja e shpërblimit ka një kohë, një orë të caktuar!

Kjo vuajtje, kjo fatkeqësi mjafton për të. Ka mbetur pa njeri në këtë fushë!

Me sytë e rënduar, është tërhequr në një vatër e është ulur, e ka thartuar fytyrën, e ka varur surratin!

As një mjek sysh ka që t'ia qajë hallin, as mend ka që të marrë një ilaç e t'ua lyejë syve!

Bën siç pandeh vetë, punon e përpiqet, është kapur pas një shprese se do t'i përmirësohet gjendja!

Mirëpo mes rrugës së zënë prej tij dhe bashkimit me të dashurin, ka një largësi të madhe. Sepse ai nuk kërkon kokë, por kërkon të bëhet i parë!

Një çast, pothuajse krijon fërkim me Zotin duke menduar se a vetëm mundim paska qenë pjesa e tij në këtë llogari?

Një çast tjetër grindet me fatin duke i thënë: Vetëm fluturon, nuk zbret tek unë, m'i thyen duar e krahë!

Kush mbetet i burgosur në ngjyrë dhe aromë, edhe sikur të jetë zahid, nuk i përmirësohen shprehitë, është zemërngushtë!

Gjersa të mos ketë dalë nga ky stacion i ngushtë, si mund të ndodhë që t'i rregullohet morali e t'i qetësohet zemra?

Nuk është aspak me vend t'u jepet zahidëve thikë dhe brisk pa dalë në shesh të gjerë, vetëm për kohën kur ndodhen!

Nga ngushtica, ngaqë nuk ia kanë arritur dot synimit, nga vuajtjet, e çajnë barkun!

Për shkak të dukjes me vonesë të Xhebrailit (a.s.), Mustafai (a.s.) mërzitet dhe kërkon të hidhet nga mali Hira. Xhebraili (a.s.) i bën zë të mos hidhet se para vetes ka fat të madh.

Kur Mustafain e zinte vuajtja e ndarjes dhe veçimit, kur i ngushtohej zemra, tentonte të hidhej nga mali poshtë.

Dhe kur Xhebraili i thoshte që të mos e bënte atë gjë në asnjë mënyrë, që në urdhrin "Kun – Bëhu" për të ishin caktuar të mira të mëdha,

Qetësohej dhe hiqte dorë nga mendimi për t'u hedhur! Por pastaj, kur e zinte prapë dhimbja e ndarjes,

Kur turbullohej nga ankthi dhe vuajtja, donte përsëri ta hidhte veten nga mali poshtë!

Këtë herë xhebraili i shfaqej dhe i thoshte: O sovran i pashoq, mos e bëj këtë!

Dhe kjo gjendja vazhdoi gjersa u zbulua mbulesa dhe atë margaritar e gjeti në gji.

Ndërsa populli e vriste veten për shkak të çdo lloj mundimi, si do ta vuante ai këtë ndarje që ishte thelbi i mundimeve?

Populli çuditet për atë që e flijon jetën. Por secili nga ne kemi shprehi flijantësh!

Ç'lumturi për atë person që e ka flijuar trupin për një mik që e vlen të flijohesh!

Çdokush është flijanti i një shkence, i një arti. E shpenzon jetën në atë rrugë gjer në vdekje.

Qoftë tek lindorët, qoftë tek perëndimorët, çdokush, më në fund, një ditë vdes. Atëherë s'mbetet as i dashuruar, as dashurues!

Të paktën, ky fatbardhë e ka flijuar veten vullnetarisht për këtë mjeshtëri. Në vdekjen e tij ka qindra jetë!

Për të, edhe ashiku, dashuruesi, është i përjetshëm, edhe mashuku, i dashuruari, edhe ashku, dashuria pasionante për Zotin. Në të dy botët ka arritur ç'ka dëshiruar, ka fituar një emër dhe famë të mirë!

O njerëz të mëdhenj, t'ju vijë keq për ashikët. Fama e tyre është gati të shkatërrohet dhe pasi është shkatërruar një herë!

Imzot, fale sjelljen e tij të trashë! Shih hallin dhe fatin e tij të keq!

Fale atë që edhe Zoti të të falë ty, të t'i falë fajet e mëkatet!

Edhe ti s'ke thyer pak shtamba pa dashje ose nga padituria. Edhe ti ke lidhur shpresën pas faljes!

Fal që në ahiret, në jetën e pasme, edhe ti të falesh. Në dhënien e ndëshkimit, kaderi e ndan qimen në dyzet pjesë!

Beu u thotë ndërmjetësuesve dhe komshinjve se nuk do ta falte zahidin që kishte treguar paturpësi duke e thyer shtambën. Ai u thotë se është betuar ta ndëshkojë.

Beu u tha: Kush është ai që e qëllon me gur dhe e thyen shtambën tonë?

Përreth trojeve të mia edhe luani, madje, kalon me qindra drojtje, duke u frikësuar!

Pse ia preku zemrën shërbëtorit tonë, e turpëroi pranë mikut që na kishte ardhur?

E derdhi verën që ishte më me vlerë se gjaku i tij dhe, pastaj, iku e u fsheh si gratë!

Por edhe sikur të fluturojë si zogu, s'ka për të shpëtuar dot nga dora ime!

Me shigjetën e ndëshkimit tim ia thyej krahun dhe pjesën e mbetur ia këpus nga vendi.

Edhe sikur të ikë prej meje e të futet nën gur e të fshihet, prapë do ta kap e do ta nxjerr prej aty!

Dhe do t'i heq një të goditur me shpatë që të marrin mësim të gjithë rrugaçët!

T'u shesë fanatizëm të gjithëve dhe, sikur të mos mjaftoka kjo, të ngrihet e të na shesë edhe neve! Atij do t'ia jap dënimin mu tani; atij dhe sikur njëqind të tjerëve si ai!

Aq ishte nxehur beu, aq e kishte zënë gjaku, që nxirrte zjarr nga goja!

Zahidi me komshinjtë dhe ndërmjetësuesit i bien ndër këmbë për të dytën herë beut dhe i luten.

Përballë zemërimit të tij, ndërmjetësit ia puthën disa herë beut këmbë e duar

Dhe i thanë: O beu ynë, ty s'të ka hije të bësh urrejtje. Nëse u derdh vera, ç'u bë? Ti je i lumtur edhe pa verë!

Vera prej teje e merr pasurinë e gëzimit dhe haresë. Kthjelltësia e ujit e ka zili kthjelltësinë tënde!

Tregohu zemërgjerë si sovran, o i mëshirshëm, o i mëshirshmi, i biri i të mëshirshmit! Fal!

Çdo verë, kjo bojë janë skllevër të kësaj fytyre! Të gjithë të dehurit ta kanë zili!

Ti s'ke aspak nevojë për verën ngjyrë trëndafili! Lëre ngjyrën e trëndafilit, ti je vetë ngjyra e trëndafilit!

O zotëri që i ngjet Venusit, me fytyrën si dielli i paraditës, o ti që ngjyra e trëndafilit mbetet e varfër para ngjyrës së fytyrës tënde,

Vera në enë zjen e gurgullon fshehurazi me dëshirën për fytyrën tënde!

Ti je krye e fund det, ç'e do lagështirën? Ti je plotësisht i qenë! Pse e do mosqenien?

O hënë e shkëlqyer, ç'do ta bësh pluhurin? Edhe hëna, madje, sheh fytyrën tënde dhe zverdhet!

Ti je i këndshëm, i bukur, je esenca e çdo kënaqësie. Pse i tregohesh mirënjohës verës?

Në kokë ke kurorën "Ne e lartësuam njeriun", kurse në qafë, gjerdanin "Ne të kemi dhënë ty lumin e eliksirit"!

Njeriu është element, qielli është simptoma e tij. Çdo gjë është e dyta e tij, te çdo gjë njeriu synohet!

O bej që je robi dhe skllavi i mendjes, idesë, maturisë, meqë je i tillë, pse po e shet veten kaq lirë?

E gjithë bota e ka për detyrë të të shërbejë ty! Pse të kërkojë mirësi elementi nga simptoma?

Sa keq, kërkon njohuri nga librat, dëshiron kënaqësi nga hallva!

Je një det diturie i fshehur në një lagështirë; je një botë e futur në një trup të gjatë tre arshin!

Ç'është vera, ç'është dëgjimi i orkestrës dhe këngëtarit ose ç'është takimi me një bukuroshe, që ti shpreson hare dhe përfitim prej tyre?

A kërkon dielli borxh prej molekulës? A i lutet Venusi një kupe vere?

Ti je një shpirt me cilësi të panjohur, je burgosur në botën e cilësisë. Ti je një diell, por je kapur pas një përpjekjeje; ja, kjo s'të ka hijë! Sa keq!

Beu u jep përgjigje prapë.

Beu u tha: Jo, jo... Unë jam njeriu i asaj vere. Unë nuk mund të kënaqem me kaq.

Unë dëshiroj të jem si jasemin, të përkulem sa në njërën anë, në tjetrën.

Duke shpëtuar nga të gjitha frikërat, nga të gjitha shpresat, dua të përkulem si shelg nga të gjitha anët!

Duhet të kthehem djathtas e majtas si degë shelgu, si ajo, të bëj lojëra të ndryshme në erë!

Ai që është mësuar me harenë e verës, si do ta pëlqejë këtë hare, o mësues?

Pejgamberët qenë kredhur në harenë e Zotit, me të ishin gatuar, prandaj hoqën dorë nga kjo hare!

Ngaqë shpirti i tyre e kishte parë atë hare, atyre u qenë dukur lojëra këto hare!

Ai që bën miqësi me një bukuri të gjallë, si do ta përqafojë të vdekurin?

Komenti i ajetit "Dijeni se ahireti është vendbanesa e jetës së përhershme."
Pra, dera, muri, uji, shtamba, fruti, pema e asaj bote janë gjithmonë të gjalla.
Flasin dhe dëgjojnë. Prandaj Mustafai (a.s.) ka thënë: "Bota është kufomë, kurse ata që e duan atë, janë qenër!"
Po të mos kishte gjallje në ahiret, edhe ai do të bëhej kufomë.
Kufomës i thonë kështu se është i vdekur, jo nga era e keqe dhe ndyrësia.

Ajo botë është e gjallë në çdo molekulë të saj. Çdo molekulë e saj kupton nga ideja, thotë fjalë.

Ata nuk rrinë, nuk dëgjojnë në botën e vdekur. Sepse bari është vetëm për kafshët.

Kush ngre kuvend në trëndafilishte dhe e bën vendbanimin atje, a pi verë në vatër të hirit?

Pozita e shpirtit të pastër është bota e lartë. Kurse ai që bën vendbanim në ndyrësi, është krimb!

Të përhumburit pas Zotit i jepet kupë vere të pastër, kurse këtyre zogjve të verbër, ky ujë i zi e i kripur!

Kush nuk ndihmohet nga drejtësia e Omerit, të gjithë katilët e përgjakur Haxhxhaxh janë të drejtë.

Vajzave të vogla ua japin kukllat si lodra. Sepse ato nuk marrin vesh nga kuklla e gjallë!

Djemtë e vegjël nuk kuptojnë gjë nga mashkulliteti i tyre, nuk kanë fuqi mashkulli. Prandaj për ta është më e mirë shpata prej druri!

Qafirët mjaftohen me portretet e profetëve nëpër kisha.

Por meqë për ne ato copa hëne janë krejt të ndritshme e të gjalla, ne as që duam të dimë për portretet e tyre!

Një trajtë e tyre është në këtë botë, kurse një trajtë tjetër e tyre, në qiell si hëna!

Goja e tyre në trajtën e këtushme flet me ata që shoqërohen me të, thotë mendime dhe ide. Kurse me gojën e trajtës së atjeshme, ata flasin me Zotin.

Veshi që shihet, e dëgjon dhe e fikson këtë fjalë, kurse veshi i shpirtit dëgjon të fshehtat e urdhrit "Kun – Bëhu!"

Syri i trupit sheh dhe fikson formën e njeriut. Syri i shpirtit vëren të fshehtat shpirtërore dhe mbetet i mahnitur!

Këmba që shihet qëndron në radhën e faltores, kurse këmba ideore bën tavaf sipër qiellit.

Ja, kështu numëroji të gjitha gjymtyrët. Ky është brenda kohës, i varur nga koha, kurse është veç atij tjetrit.

I varuri prej kohës qëndron gjer në vdekje, kurse tjetri është bashkëshoqërues i përjetësisë.

Një emër i tij është zotërues i dy shteteve, një cilësi e tij, imam i dy kibleve.

Ai s'ka nevojë as për mbyllje në vetmi, as për vetëmundim. Asnjë re nuk e mbulon dot atë!

Vendi i mbylljes në vetmi është orbitë diellore; si mund të ndodhë që nata e huaj t'i bëhet perde atij?

Koha e sëmundjes dhe përkorësisë kaloi, s'mbeti më mundim. Mohimi u bë besim, mohim dhe herezi s'mbeti!

Si shkronja elif, ngaqë është i drejtë, ka kaluar para. Tek ai s'ka mbetur asgjë tjetër veç cilësive të veta.

Ka dalë nga shprehitë e veta, është bërë një i vetëm. Kurse e dashura, shpirti i së cilës i shton jetës jetë, është kthyer në lakuriq!

Dhe kur shkon lakuriq në prani të padishahut të vetëm e të pashoq, padishahu i vesh një rrobë prej cilësive të tij të bekuara!

Është veshur me një rrobë nga cilësitë e padishahut dhe ka dalë nga gropa, mbi nivelin e pozitës dhe mirësisë.

Kështu ndodh kur një gjë e turbullt bëhet e kulluar. Krejt si ajo, edhe ai ka dalë nga fundi i tasit, sipër.

Kur ndodhej në fund të tasit, ishte me llum, ishte përzjerë me copa dheu dhe ishte turbulluar.

Miku krejt i pakëndshëm ia kishte lidhur duart e krahët. Por, në të vërtetë, ai ishte i lartë.

Kur erdhi zëri "Zbrisni në tokë", e vari atë kokëposhtë si Haruti.

Haruti ishte nga engjëjt e qiellit; për shkak të një qortimi mbeti ashtu, i varur.

Shkaku i mbetjes varur kokëposhtë ishte humbja e arsyes, pandehja e vetes si krye dhe vetëm tentimi për të dalë në krye!

Kur shporta e pa veten mbushur me ujë, u përkëdhel, nisi të tregohej indiferente, pra, u tërhoq nga uji.

Mirëpo në mushkëri nuk i mbeti pikë uji dhe, atëherë, detit i erdhi keq për të dhe e ftoi përsëri.

Nga deti vjen mëshirë pa shpërblim. Çfarë çasti i lumtur që është ky!

Për hir të Zotit, duhet ardhur përreth detit dhe s'duhet vënë re edhe nëse fytyrat e atyre që shëtisin në det janë të verdha!

Duhet shëtitur përreth detit në mënyrë që të vijë favori dhe falja e Zotit dhe fytyra e zverdhur, duke gjetur një stoli, të skuqet.

Ngjyra e verdhë e fytyrës është më e mira e ngjyrave. Sepse pret të bashkohet me fytyrën!

Kurse kuqëlia që ndrit në fytyrën e një njeriu, është ngaqë ai njeri është i kënaqur që ka shpirt.

Kurse është lakmia që e dobëson njeriun, që e ul, që e zverdh. Kjo zverdhje dhe zbehje nuk është nga sëmundjet trupore!

Po të shihte një fytyrë të verdhë të pasëmundje, edhe mendja e Galenusit, madje, do të habitej!

Por nëse e lidh lakminë, kridhesh në bukuritë e Zotit. Prandaj Mustafai ka thënë se "Atij që bie në lakmi, i poshtërohet vetja"!

Bukuria pa hije është transparente, e lartë. Bukuria që bie kafaz më kafaz është e buruar nga një kurrizo. Hija në trajtë kafazi është hija e kurrizos.

Ashikët duan që ta kenë trupin lakuriq. Por për atë që s'është mashkull, n'daç të ketë rroba, n'daç të mos ketë!

Ajo bukë dhe ajo sofër del për të agjëruarit. Ç'janë supa dhe tenxhereja për mizën e kalit?

Padishahu e urdhëron edhe një herë Ejazin që ta shuajë
kureshtjen e kureshtarëve dhe vështirësinë e atyre që e qortojnë
dhe i thotë se lënia e tyre në pozitë të vështirë nuk është burrëri.

Kjo fjalë nuk ka kufi e llogari... O Ejaz, ti tani thuaje si e ke hallin!

Halli yt krijohet nga thelbi i një gjëje të re. Po ti, si mund t'i pranosh këto të reja?

Eja, tregona të mirën e hallit tënd, kurse hallin e pesë shqisave dhe gjashtë anëve mbuloje me dhé!

Po qe se halli yt i brendshëm nuk thuhet dot me fjalë, unë po të tregoj hallin e jashtëm pas perdeve tek dhe çift!

Dije se, me favorin e të dashurit, edhe dhimbjet e vdekjes, madje, të vijnë më të këndshme se kallami i sheqerit!

Po qe se nga ajo bimësi e ëmbël fluturon një pluhur në det, detit s'i mbetet më kripësirë, por ëmbëlsohet fund e krye!

O mik i sigurt, si kjo vijnë qindramijëra halle dhe, pastaj, khehen prapë në botën e fshehtë siç kanë ardhur!

Halli i çdo dite i ngjet të djeshmes. Gjendja rrjedh si lumi dhe s'ka gjë që ta ndalë!

Hareja e çdo dite është e një lloji tjetër. Në mendimin e çdo dite ka një shenjë tjetër!

Trupi i njeriut i ngjan shtëpisë së miqve, mendimeve të ndryshme
dhe miqve të ndryshëm. Arifi është dakord me ato mendime të gëzuara e të dëshpëruara,
pothuaj i ngjet pejgamberit Halil që i kënaq të vetmuarit.
Edhe porta e tij ishte gjithmonë e hapur për të pritur dhe respektuar edhe qafirin,
edhe besimtarin, edhe të besueshmin, edhe tradhtarin.
Të gjithë miqve u tregonte fytyrë të qeshur.

O djalosh, kjo është shtëpi miqsh. Çdo mëngjes aty vjen me vrap një mik i ri.

Kurrsesi mos thuaj "ky më mbeti mua në qafë"! Se tani menjëherë fluturon dhe shkon në botën e mosqenies!

Ç'të të vijë në zemër nga bota e fshehtë, është mik, pra, mbaje mirë!

Në një shtëpi shkoi një mik.
Gruaja e të zot të shtëpisë tha: Filloi shiu, miku na mbeti në qafë!

Dikujt i shkoi papritur një mik. I zoti i shtëpisë e priti mikun siç varet gjerdani në qafë!

I nxori sofrën, e respektoi. Atë natë, në mëhallën e tyre kishte synetllëk.

Burri i tha gruas fshehtas: Këtë natë shtro dy dyshekë.

Dyshekun tonë shtroje pranë derës, kurse të mikut, në anën tjetër.

Gruaja i tha: Punë që bëhet, o drita e syve, si të urdhërosh! Ju shërbej, tregohem fytyrëqeshur, mos ki merak!

I shtroi dyshekët dhe shkoi në synetllëk.

Miku i lartë mbeti me burrin. Në mbrëmje nxori fruta e fara të njoma e të thata për të kaluar kohën.

Hëngrën e pinë. Ata dy burra të mirë ndenjën e biseduan gjer vonë duke i treguar njëri-tjetrit për ç'u kishte ngjarë.

Më në fund, miku u ngrit për të fjetur dhe shkoi e ra drejt e në dyshekun e shtruar pranë derës.

Nga turpi, i zoti i shtëpisë nuk i tha asgjë, nuk i tha se shtrati i tij ishte në anën tjetër.

Nuk i tha dot se atij i kishin shtruar atje për të fjetur!

Në kundërshtim me ç'e kishin vendosur me gruan, miku ra në shtratin e tyre, kurse ai vetë, në shtratin e shtruar për mikun!

Atë natë nisi një shi i furishëm. Dendësia e reve të habiste.

Kur u kthye, me mendimin se burrin e kishte te shtrati te dera kurse miku flinte në anën tjetër,

Gruaja u zhvesh lakuriq, u fut në shtrat dhe e puthi disa herë mikun me dëshirë.

Dhe i tha: A s'kisha frikë prej diçkaje? Ja që më ra në kokë!

Nga shiu dhe balta, miku na mbeti në derë! Eshtë e pamundur ta nxjerrim prej dore si sapun!

Ku do të shkojë në këtë shi e në këtë baltë? Lavdi qoftë, njeriu i huaj na mbeti në kokë!

Me t'i dëgjuar këto fjalë, miku u hodh menjëherë dhe i tha: Zonjë, më lër! Unë kam këpucë, pra, s'kam frikë nga balta!

Unë po shkoj! Allahu ju dhëntë të mira! Shpirti në udhëtim nuk dëfrehet qoftë edhe për një çast!

Udhëtari duhet të kthehet menjëherë nga ka ardhur. Po të mbetet diku e të dëfrehet, ia presin rrugën!

Gruaja u pendua që e kishte thënë atë fjalë të ftohtë. Sepse ai vizitor i pashoq, i frikësuar, po dilte në rrugë!

Gruaja po i lutej: Të lutem, më fal, i thashë ato fjalë për shaka…

Iu lut e iu përgjërua, por s'bëri dobi. Miku doli në rrugë duke i lënë të përmalluar!

Prandaj, edhe burri u kredh në zi, edhe gruaja. Sepse fytyrën e atij miku e kishin parë jo nga reflektimi në legen, por drejtpërdrejt.

Miku shkonte rrugës, kurse fusha ndriçohej si xhennet me bukurinë e tij!

Pas asaj dite, nga turpi, burri e ktheu shtëpinë në shtëpi miqsh.

Por edhe në zemrën e gruas, edhe në zemrën e burrit, iluzioni i atij miku u thoshte:

Unë jam miku i Hizrit dhe juve do t'ju lëshoja qindra thesare bujarie, por ç'të bëj? S'paska qenë kësmeti juaj!

Mendimi që i vjen zemrës çdo ditë, i ngjet mikut që vjen qysh në të zbardhur,
i jep urdhra të zot të shtëpisë, sillet i shkujdesur.
Fama e të qenit zot shtëpie është pikërisht në pritjen
dhe respektimin e mikut
dhe në durimin e trilleve të tij.

Ashtu siç vjen çdo ditë një mik i lartë në shtëpinë e miqve, ashtu dhe ty të vjen çdo çast një mendim.

Supozoje se mendimi është një mik. Sepse njeriu me mendimet e tij ka vlerë, me mendime është i gjallë!

Po qe se mendimi i mërzitjes ia zë rrugën gëzimit, mos u mërzit, sepse, në të vërtetë, ai përgatit gëzime të tjera!

Me qëllim që nga origjina e mbarësisë të vijë një gëzim i ri e një hare e re, ai e fshin mirë e mirë shtëpinë nga të tjerët!

Ai i veçon gjethet e zverdhura e të thara nga dega e zemrës duke ndihmuar që nga dega të dalin gjethe të reja të jeshilta!

Ai e shkul me rrënjë gëzimin e vjetër me qëllim që nga kjo botë të shkojë në atë botë një kënaqësi e re!

Mërzitja e shkul me rrënjë trungun e vjetër të kalbur e të thërrmuar me qëllim që të mbijë një kërcell i ri i mbuluar me degë e gjethe!

Çfarëdo që të derdhë ose të shkulë mërzitja nga zemra, patjetër që, si shpërblim, do të japë një më të mirë.

Veçanërisht, halli dhe mërzitja i bën favore më të mëdha atij që e di mirë se është rob i atyre që e njohin faktin.

Po qe se reja dhe bubullima nuk tregojnë fytyrë të varur e të thartuar, a i tregon gjethja e pjergullës buzëqeshjet e saj që i ngjajnë lindjes së diellit?

Bekueshmëria dhe pabekueshmëria janë miq të zemrës; këta u ngjajnë yjeve që shkojnë nga shtëpia në shtëpi.

Po bëri konak në konstelacionin tënd, ashtu si fati i tij, edhe ti eja në gjendje të ëmbël, shkathtësohu!

Vepro kështu dhe sapo që ai yll shkoi dhe arriti në hënë, ta falenderojë atë sulltanin e zemrës nga ana jote!

Ejjubi që ishte i durueshëm dhe i kënaqur me çdo gjë, e mbajti plot shtatë vjet mikun e Zotit, e trajtoi mirë belanë!

Edhe ai mik i ashpër e syvranët, kur u kthye te Zoti, i përcolli atij qindra lloje falenderimesh

Dhe tha: Megjithëse ia vrava të dashurit, Ejubi nuk e ktheu fytyrën mënjanë prej meje qoftë edhe një herë të vetme!

Ai u tregua besëtar ndaj dijes së Zotit dhe, nga turpi, pothuaj përzjeu e ngjizi belanë me qumësht e mjaltë!

Edhe nëse në zemrën tënde vijnë herë pes here bela, ngatërresa, priti me të qeshur ato!

Dhe thuaj: Zoti im, mbromë nga e keqja e asaj belaje. Të mirat që kanë për të ardhur prej saj, mos m'i bëj haram, por falmi mua!

Zoti im, më bëj favor që të falenderoj përballë belave që do të më zënë dhe, kur të ikin, të mos ndjej mall për to!

Ruaje atë vuajtje fytyrëvarur. Atë hidhësirë konsideroje të ëmbël si sheqer.

Edhe reja është fytyrëvarur në dukje, por e stolis trëndafilishten, kurse shkurret i thyen e i shkul.

Njihe vuajtjen për re dhe me atë surrat të varur mos tento t'i varësh turinjtë.

Ndoshta ai margaritar është në dorën tënde, gjë që bëhet, prandaj përpiqu për të që të mbetet i kënaqur me ty!

Madje edhe sikur të mos jetë kështu, bëje shprehi këtë gjë, pajisu me këtë shprehi të bukur, forcoje atë

Sepse mund të ndodhë që të veprosh kështu edhe në vende të tjera dhe, një ditë, e arrin papritmas gjënë për të cilën je nevojtar!

Mendimi që të bëhet pengesë për gëzimin, vjen me urdhrin e Zotit, me urtësinë e Zotit!

Ti mos i thuaj fatkeqësi asaj, djaloshi im! Ndoshta është një yll, ndoshta është lumturi!

Ti mos i thuaj asaj gjë e dytë, por mbaje për thelbësore dhe me të arrije gjithmonë qëllimin, dil ngadhnjimtar!

Po qe se e konsideron të dytë dhe e zë të mërzitshëm, syri yt, sytë thelbësorë ndalen.

Mirëpo pritja është pothuaj helm për cilësinë. Me këtë ecuri mbetesh gjithmonë në gjendje të vdekur!

Njihe atë për thelb, përqafoje dhe shpëto nga vdekja e pritjes.

Padishahu i shfaq konsideratë Ejazit.

O fjalëdrejti Ejaz, o ti që vazhdimisht lutesh e përgjërohesh, drejtësia dhe ndershmëria jote janë më të shumta edhe se të detit, edhe se të malit!

As bie në gabim në kohë dëshire, as mendja si mal të fluturon si fije kashte!

As në kohë zemërimi dhe urrejtjeje durimi të plogështohet dhe t'i braktis vendosmërinë dhe qëndresën!

Ja, kjo është burrëri! Ndryshe, burri nuk bëhet burrë me mjekër e vegël mashkullore; po të ish ashtu, vegla mashkullore e gomarit bëhej mbreti i burrave!

Kujt i tha burra Zoti në Kur'an? Ku është ky trup që do të arrijë atje?

O babush, ç'vlerë ka shpirti kafshëror? Kalo nëpër pazarin e kasapëve dhe shihe!

Qindra koka janë vënë mbi trung. Vlerën ua gjej nga dhjami dhe bishti!

Ndodh që, për shkak të vërtitjes së veglës mashkullore, kurvarit i kthehet mendja në mi, kurse epshi, në luan!

Një baba e paralajmëron kështu të bijën: "Ruaje veten të mos mbetesh me barrë me tët shoq!"

Ishte një burrë i pasur. Ai kishte një vajzë me faqe si të Venusit, me fytyrë si të hënës, me trupin të argjendtë!

Vajza arriti në moshë që ta njohë veten dhe i ati e çoi te burri. Por burri nuk ishte i sërës së saj.

Po qe se pjepri e shalqini piqen, po s'i çave, prishen e shkojnë!

Edhe i ati u frikësua se mos vajza i humbte mendtë, prandaj ia dha dikujt që s'ishte i sërës së saj.

Ai i tha të bijës: Ruaje veten të mos mbetesh me barrë me tët shoq!

Ç'të bëj? Mbeta i detyruar të të jap te ky i varfër. Këtë burrë quaje të vetëm; nga i vetmuari nuk ka besë.

Se papritmas e lë çdo gjë dhe ikën. Kurse fëmija i tij të mbetet mbi krye e të bëhet vuajtje!

Vajza i tha: Do të bëj siç më thua; këshilla jote është e drejtë, e pranoj!

Pastaj, në çdo dy-tri ditë, i ati ia përsëriste këshillën: Moj bijë, ki kujdes!

Ndërkaq, vajza papritmas mbeti me barrë! Që të dy ishin të rinj!

Por vajza e fshehu këtë nga i ati. dalëngadalë, fëmija në bark iu bë pesë a gjashtë muajëshe.

Atëherë, u duk fare mirë. I ati i tha: Ç'është kjo? A s'të pata të thënë ta ruash veten prej tij?

Këshillat e mia a mos ishin erë që s'të bënë dobi?

Vajza i tha: Baba, si të duroja? Mashkulli me femrën janë si zjarri me pambukun.

Si mund të ruhet pambuku nga zjarri? Ose si mund të ndodhë që zjarri të mos e djegë pambukun?

I ati i tha: Moj vajzë, unë nuk të thashë mos bjer me të, vetëm të ruhesh prej spermës së tij!

Ti duhet ta kishe tërhequr veten mu në çastin e kënaqësisë kur atij do t'i derdhej sperma!

Vajza i tha: Mirë, po ku ta dija unë se kur do t'i vinte sperma atij? kjo është gjë shumë e fshehtë, nuk kuptohet!

I ati i tha: Kur t'i fikeshin sytë, duhet ta kuptoje se po i vinte sperma.

Atëherë vajza ia ktheu: Gjersa atij t'i fiken sytë, mua të dy sytë më janë verbuar, o baba!

Çdo mendje e ulët nuk rri dot në vend në kohë zemërimi dhe furie!

Ishte njëri që kishte luftuar me nefsin, me vetveten,
kishte vuajtur nga ashku,
ishte rritur nën hije dhe kishte hyrë në rrugën e sofizmit
ngaqë populli i bënte sexhde vetëm atij, ia puthte dorën, e shihte me respekt
dhe e tregonte me gisht si sofiun e kohës. Ashtu siç e sëmurën fëmijët mësuesin
duke i thënë je i sëmurë, edhe ky, duke u krenuar e duke fantazuar, thoshte:
Unë jam burrë i xhihadit, mua më thonë pehlivan i kësaj rruge.
Në luftën e madhe nuk kam shok, kurse lufta e vogël për mua s'është gjë.
Tha se duhet të shkonte në luftë me gazinjtë dhe të tregonte trimëri.
Shkoi në luftë, por atje u tregua i paaftë dhe frikacak.
Mirëpo ai mbahej si luan, kurse gjendja e luanit i thoshte:
"S'është ashtu... Së afërmi do ta shihni dhe do ta kuptoni...
Prapë, së afërmi do ta shihni dhe do ta kuptoni!"

Një sofi shkoi me ushtarët në luftë. Dhe ja ku lufta filloi papritmas.

Sofiu mbeti në çadër me të dobëtit dhe të ngathtët. Kurse burrat i nganë kujt gjer në vendin e luftimit.

Njerëzit e ngathët mbetën në vend si copa dheu, kurse të parët e të parëve shkuan para.

Luftuan, fituan dhe u kthyen me shumë plaçkë lufte.

Ata i dhanë plaçkë edhe sofiut duke i thënë "merr edhe ti!" Por ai e hodhi dhuratën, nuk mori asgjë!

Pse je i nxehur? – I thanë. Se mbeta jashtë lufte – U tha.

Sofiu mbeti i pakënaqur nga konsiderata e tyre sepse s'e kishte zhveshur shpatën dhe s'kishte luftuar!

Atëherë i thanë: Kemi sjellë robër, merre njërin dhe vraje!

Preja kokën dhe bëhu gazi, fitimtar. Sofiu u gëzua pak për këtë, mori zemër.

Abdesti i marrë me ujë, ka shumë vlera, por, po të mos ketë ujë, bëhet tejemmum.

Sofiu e mori robin e lidhur dhe e çoi prapa çadrës për ta ekzekutuar.

Mirëpo u vonua pak. Të tjerët u bënë kureshtarë se pse ishte vonuar aq shumë ai i varfër.

Kishte marrë me vete një rob me duar të lidhura dhe duhet ta kish vrarë menjëherë. Po pse u vonua? Ç'ishte shkaku?

Njëri prej tyre shkoi prapa çadrës për ta parë si qëndronte puna. Kur ç'të shohë? Qafiri i kishte hipur sofiut sipër!

Siç hipën mashkulli mbi femrën, edhe ai i lidhur kishte hipur si luan mbi sofiun e varfër!

Me duart të lidhura, po ia kafshonte me forcë qafën sofiut.

Po ia dërrmonte qafën me dhëmbë. Sofiu kishte rënë nën qafirin dhe i kishte ikur mendja vendit!

Qafiri me duart të lidhura, si një mace, e kishte bërë atë për faqe të zezë!

Ishte duke e vrarë. Nga gjaku që i ridhte prej qafe, mjekra i ishte ngjyer në të kuqe!

Edhe ti, sikurse sofiu, ke rënë nën nefsin, egon tënde me duart të lidhura dhe e ke humbur vetëdijen.

Ke mbetur i paaftë për ta kapërcyer një kodër të vogël që të ka dalë në rrugë! Mirëpo para vetes ke qindramijëra male që duhen kapërcyer!

Kur u frikësove e u bëre si i vdekur nga një kodër kaq e vogël, si do t'i kapërcesh gjithë ato male?

Gazinjtë erdhën me të shpejtë dhe pa e zgjatur e pa u ardhur keq, e prenë me shpatë qafirin!

Kurse sofiut i hodhën ujë në fytyrë që të vinte në vete, e spërkatën me ujë trëndafili!

Dhe kur sofiu erdhi në vete e i pa ata, e pyetën: Ç'u bë, jahu?

O i shtrenjtë, për hir të Zotit, ç'është kjo gjendje? Pse e humbe veten gjer në këtë gradë?

Pse u frikësove nga një rob gjysmë i vdekur, me duar të lidhura, pse të iku mendja dhe re në këtë gjendje?

Sofiu u tha: Kur do t'ia prisja kokën, ai syuritur më pa me aq urrejtje,

I hapi sytë fort dhe më lëshoi një shikim të tillë, që më iku mendja nga koka!

Kur i rrotullonte sytë, m'u duk sikur kisha para një ushtri. Atë frikë nuk mundem t'jua tregoj dot!

Le ta presim shkurt, ja nga ai vështrim u frikësova! Dhe e humba vetëdijen dhe u shemba për tokë!

Gazinjtë e këshillojnë:
"Ty të bie të fikët vetëm nga pulitja e syve të një qafiri
dhe të bie shpata nga dora.
Duke pasur një zemër të tillë, një zjarr të tillë, mos eja
në luftë të demaskohesh,
por kujdesu për kuzhinën e teqes!"

Gazinjtë i thanë: Kur ke këtë zemër, kurrsesi mos tento të hysh në luftë!

Vetëm me vështrimin e një qafiri duarlidhur, t'u thyen gjunjët, u mbyte!

Kur sulmojnë luanët, nga shpatat e tyre kokat rrokullisen si top përdhé!

Ti s'je i mësuar me luftën e burrave; në një kohë të tillë, si mund të notosh në det gjaku?

Zhurma që bëjnë shpatat kur bien mbi eshtrat e zverkut janë më të forta se zhurmat që dëgjohen që përtej kur gratë rrahin rrobat me lasë duke i larë!

Sa e sa trupa pa kokë përpëliten përtokë... Sa e sa koka pa trup kthehen në copëra notuese në detin e gjakut!

Qindra trima që vrasin njerëz, marrin fund në luftë nën këmbët e kuajve!

Si mund të futesh ti në radhët e luftës me këtë mendje që frikësohet nga miu e fluturon?

Lufta nuk është gjellë bollguri që të përveshësh mëngët për ta gatuar!

Lufta s'i ngjan trazimit të gjellës me lugë. Pa eja e shihe shpatën se ç'bën këtu! Në këto radhë duhet një Hamza i krijuar prej hekuri!

Lufta s'është punë e çdo zemërlepuri që ia mbath prej çdo hijeje!

Lufta është punë e turqve, jo e grave të përkëdhelura. Vendi i grave të përkëdhelura është shtëpia, edhe ti në shtëpi shko!

Ajjaziu që e mëshiroftë Zoti, me shpresën për të rënë dëshmor,
shkon shtatëdhjetë herë në luftë me gjoksin hapur;
më në fund, kur i pritet shpresa për të rënë dëshmor në luftën e vogël,
drejtohet nga lufta e madhe dhe mbyllet në vetmi.
Në këtë mes, dëgjon daullen e gazinjve, ndjen nefsin që kërkon të këpusë zinxhirët
e të shkojë në luftë dhe, për shkak të kësaj dëshire, e vë nefsin nën dyshim.

Ajjaziu tha: Me shpresën se ndoshta do të plagosesha nëntëdhjetë herë,

Hyra në luftë lakuriq, dola para shigjetave duke menduar se, sido që të bëhet, njëra do të më ngulet!

Mirëpo ja që shigjeta nuk qëllon në fyt ose në ndonjë vend tjetër jetësor dhe nuk i bie në pjesë tjetërkujt veç dëshmorit me fat!

Në trup nuk kam vend pa plagë. Trupi më është bërë vrima-vrima nga shigjetat!

Por kjo nuk është as trimëri, as punë zgjuarsie. Eshtë punë fati! Kurrsesi s'më takoi shigjeta në një vend jetësor!

Dhe kur e kuptova se nuk e kisha kësmet të bija dëshmor, u tërhoqa në vetmi dhe në përkorësi!

E hodha veten në luftën e madhe, u vura të bëj jetë të përkorë e të dobësohem!

Ndërsa ndodhesha në vetmi, në vesh më erdhën zërat e daulles që i binin gazinjtë që shkonin në luftë.

Ishte koha e mëngjesit; e dëgjova ma veshin e zemrës, nefsi, vetvetja, më bëri zë nga brenda:

Ngrihu, erdhi koha e luftës, ec, hidhe veten në luftë!

I thashë: O nefs i ndyrë e i pabesë, ku drejtimi për në luftë, ku ti!

O nefs, thuaj të drejtën, ç'është kjo dredhi? Apo nefsi i dhënë pas epshit nuk e ka qejf as adhurimin!

Po s'më tregove të drejtën, do të të hidhem sipër dhe do të të shtrëngoj mirë e mirë me përkorësi!

Atë çast, nefsi më bëri zë nga brenda pa gojë, por me një gjuhë krejt të qartë:

Je duke më vrarë këtu çdo ditë e nga pak. Po më bën po ato mundime që u bën edhe qafirëve!

Askush nuk di gjë për hallin tim, kurse ti po më vdes vazhdimisht pa gjumë e pa ngrënë!

Të paktën të shpëtoj në luftë nga ky trup dhe populli të ma shohë burrërinë dhe sakrificën!

I thashë: O nefs, edhe po jeton si hipokrit, edhe po vdes si hipokrit! Ç'je ti?

Me dy fytyra në të dyja botët, në të dy botët s'vleke për asgjë!

Dhe u betova të mos dilja nga vetizolimi gjersa ky kurm të ishte gjallë!

Sepse çfarëdo që të bëjë në izolim, kurmi nuk e bën për t'u dukur para grave e burrave!

Edhe lëvizjet e tij në izolim janë vetëm për hir të Zotit, edhe heshtja dhe qetësia e tij. Aty, në qëllimin e tij nuk mund të gjendet gjë tjetër!

Kjo është lufta e madhe, ajo është lufta e vogël. Që të dyja janë punë të Hajdarit dhe Rustemit!

Nuk janë punë të njeriut me mend i cili ikën e fluturon me një lëvizje të miut!

Ai njeri duhet të qëndrojë si gratë, larg luftës dhe shpatës!

Edhe ai është sofi, edhe ky! Turp për atë sofi! O vdiste me një gjilpërë, ky u del përballë shpatave!

Pamjen e ka sofi, por shpirt nuk ka! Këta lloj sofinjsh u nxjerrin emër të keq edhe të tjerëve!

Në derë e në mur të këtij kurmi të përzier me dhé, Zoti bëri me zell qindra vizatime sofinjsh

Duke thënë që ato vizatime të luajnë me magji dhe shkopi i Musait të fshihet.

Drejtësia e shkopit i ha e i fshin figurat. Por syri faraonian është i mbushur me dhé e pluhur!

Sofiu tjetër hyn njëzet herë në radhët e luftës për t'u plagosur.

Në kohën e luftës, bashkë me muslimanët sulmon mbi qafirët pa u kthyer pas asnjëherë!

Plagoset, e lidh plagën, prapë sulmon e lufton.

Plagoset njëzet herë në luftë me mendimin se trupi nuk vdes me një plagë!

Eshtë gati ta japë jetën me një plagë dhe dëshpërohet nëse shpirti i shpëton lehtë nga dora!

Një trim lufte, çdo ditë, nga torba plot me para argjendi,
nxirrte një grosh dhe e hidhte në hendek.
Nga nefsi iu këput një ambicje dhe një dëshirë:
Meqë i hedh këto para në hendek, hidhi menjëherë
dhe të shpëtojmë nga ky mundim.
Prerja e plotë e shpresës është njëra nga dy prehjet.
Por ai trimi i tha nefsit se nuk do t'ia jepte as këtë prehje!

Dikush kishte në dorë dyzet grosh. Çdo natë hidhte në det një copë!

Në këtë mënyrë, kërkonte ta mundonte mirë e mirë nefsin dhe t'ia zgjaste agoninë!

Shkonte në luftë bashkë me muslimanët dhe nuk kthehej pas edhe sikur të tjerët të ktheheshin!

Plagosej prapë dhe prapë e lidhte plagën. Ndoshta njëzet herë iu thyen shigjetat dhe heshtat në trup!

Më në fund, iu shterrën fuqitë dhe ra përdhe. Me drejtësinë e ashkut, arriti në pozitën e drejtësisë!

Drejtësia është të japësh shpirt. Ejani në vete dhe shkoni para në këtë specifikë. Këndoni nga Kur'ani ajetin "Ka burra që nuk e prishën fjalën e dhënë Zotit, u kapën me ndershmëri ndaj betimit!"

Meqë ky trup është mjet për shpirtin, kjo vdekje nuk është vdekje e vërtetë.

Sa e sa vetë të paformuar ka që në dukje kanë derdhur gjakun, por nefsi i tyre ka kaluar i gjallë në anën tjetër.

Mjeti iu thye, por pirati mbeti i gjallë. Kali ku kishte hipur spërkati gjakra, por nefsi, i gjallë!

Kali ngordhi, rruga nuk u kalua, kurse njeriu i paformuar mbeti i dërrmuar!

Po qe se çdokush që derdh gjak do të bëhej dëshmor, edhe qafiri i vrarë do të quhej një dëshmor i bekuar!

Sa e sa vetë të besueshëm që janë bërë dëshmorë ka që ndonëse kanë vdekur në këtë botë, shëtisin të gjallë!

Pirati është bërë shpirt, trupi i tij që është shpata e tij është i përjetshëm dhe ndodhet në dorën e atij burri që kërkon luftë!

Shpata është po ajo shpatë, por ai burrë, jo. Ndërkaq, kjo dukje ty të habit.

Po të ndërrojë nefsi, kjo shpatë trupi është në dorë të Zotit mirëbërës e shpërblyes!

Eshtë një burrë i tillë që qëndron plotësisht pa ngrënë, kurse burrëria tjetër, një gjë me mesin vrimë si pluhur!

Një njeri i tregon kalifit të Egjiptit portretin në letër të një skllaveje.
Kalifi dashurohet pas portretit dhe dërgon një bej me ushtri
për ta sjellë atë vajzë që ishte shërbëtorja e emirit të Musulit.
Në këtë luftë vriten shumë njerëz dhe shemben shumë vende.

Një përfolës i tha kalifit të Egjiptit se padishahu i Musulit kishte një skllave si hyri:

Ai ka një skllave që s'i gjendet shoqja në botë!

Bukuria e saj nuk ka kufi, nuk përshkruhet me fjalë, nuk tregohet dot! Ja portreti i saj, në këtë letër!

Kalifi i madh, kur e pa portretin në letër, u mahnit dhe i ra kupa nga dora!

Dhe menjëherë dërgoi në Musul një njeri me ushtri të madhe!

Dhe e porositi kështu: Po qe se s'ta dorëzon atë copë hëne, digje e shembe krejtësisht atë vend!

Po ta dha, mos bëj gjë, vetëm atë copë hëne sille që ta përqafoj hënën duke qenë këtu, mbi tokë!

Njeriu u nis për rrugë me mijëra trima, me daulle e flamurë dhe shkoi në Musul.

Ushtarë të panumërt u mblodhën si karkalecat në fushë për ta shembur atë vend!

Në çdo anë u ngritën katapulta për të luftuar.

Pastaj filluan të bien shigjetat si shi, të bubullojnë si bubullimë gurët e hedhur me katapulta, të vringëllojnë si rrufe shpatat e përveshura!

Lufta vazhdoi plot një javë, u derdh gjaku si lumë. Kalaja prej guri shkriu si qiri dhe u rrafshua përtokë!

Padishahu i Musulit, përballë kësaj lufte, i dërgoi prijësit të sulmuesve një përfaqësues me këto fjalë:

Me ç'qëllim kërkoni të derdhni gjakun e muslimanëve?

Po patët qëlllim ta merrni qytetin, kjo punë bëhet edhe pa gjak!

Unë po dal nga qyteti, eja ti. Të mos të zërë gjaku qoftë edhe i një të pafajshmi të vetëm!

Ose, në paç qëllim të rrëmbesh pasuri, flori dhe stoli, kjo është punë edhe më e lehtë!

Për të mos u derdhur më shumë gjaku i muslimanëve, emiri i Musulit ia fal shërbëtoren kalifit.

Kur përfaqësuesi doli para prijësit të sulmuesve, ky ia dha portretin e skllaves.

Shih në këtë letër, këtë kërkoj. Dorëzojeni menjëherë, përndryshe unë jam më i fortë.

Kur përfaqësuesi u kthye dhe ia tregoi padishahut si qëndronte puna, padishahu i tha: Le të mbetet mangët kjo fytyrë! Çoje shpejt!

Unë në besim nuk jam idhujtar, nuk adhuroj idhujt. Është më e drejtë që idhulli të adhurojë idhullin.

Pasi përfaqësuesi e solli vajzën, ai burrë u dashurua menjëherë pas saj me pasion, iu bë ashik.

Ashku, dashuria pasionante, është det, kurse qielli është shkumë. Ashku e lë të mahnitur njeriun siç mbeti e mahnitur dhe e humbi mendjen Zelihaja për Jusufin!

Por dije se zemrat lëvizin me anë të ashkut. Po të mos ishte ashku, bota do të ngrinte!

Po të mos ishte ashku, si do të ktheheshin gjërat jo të gjalla në bimësi? Si do të rriteshin bimët dhe pastaj do të bëheshin fli për gjallesat?

Si do të bëhej fli shpirti për atë frymë dhe nga ajo frymë Merjemja do të mbetej me barrë?

Secili do të ngrinte në vend si akull e ashtu do të mbetej. Përse do të fluturonte si karkalec për të kërkuar ushqim?

Ata që i bëhen ashikë asaj lartësie sublime, vrapojnë drejt asaj lartësie siç lartësohet fidani drejt qiellit duke u rritur thërrime-thërrime!

Ky vrapim i tyre është "madhërim i Zotit". E pastrojnë trupin për shpirtin!

Edhe ai burrë e pati pandehur gropën për rrugë, i pati pëlqyer vendi djerr dhe kishte nisur të mbillte farë aty.

Ai që fle, sheh në ëndërr një iluzion, takohet me të dhe ëndrra zhvillohet më tej.

Por kur zgjohet dhe vjen në vete, sheh se ajo lojë iluzive nuk paskej ndodhur zgjuar.

Dhe thotë me vete: Sa keq, e shpenzova më kot ujin mashkullor duke u kapur pas mashtrimit të atij iluzioni!

Edhe ai burri ishte trim kurmi, nuk kishte trimëri thelbësore. Prandaj e hodhi ujin mashkullor në një rërë të tillë.

Kali i shalës i ashkut që ua kishte kaluar qindra anijeve, madje, bërtiste se nuk kishte frikë as nga vdekja!

Ai thoshte me vete: Në ashku dhe sevda nuk ndalem edhe nga kalifi. Jeta dhe vdekja ime janë e njëjta gjë!

Megjithëkëtë, mos tento të mbjellësh kështu, me zjarr. Këshillohu me një burrë që e njeh punën!

Por ku është këshillimi, ku, mendja? Rrebeshi i lakmisë e bën njeriun të gërmojë në gërmadha, t'i zgjaten thonjtë!

Ai që i është bërë ashik një bukurosheje ka edhe para vetes pengesë, edhe pas, por pak i sheh!

Kur rrebeshi i zi të vijë për ta marrë shpirtin, dhelpra e bën luanin të hidhet në pus!

Luanë si mal shohin në pus një iluzion dhe e hedhin veten poshtë!

Askënd mos e mbaj konfident me gratë, sepse mashkulli me femrën i përngjasin zjarrit me pambukun.

Duhet një zjarr i kufizuar me ujë hyjnor që, gjatë pjekurisë seksuale, të ruhet nga e keqja si Jusufi!

Që ta tërheqë veten si luan nga Zelihaja e hijshme shtatselvi!

Edhe ai burrë trim u kthye nga Musuli dhe u vu në rrugë. Gjatë rrugës, arriti në një pyll, në një lëndinë.

Zjarri i ashkut i ishte ndezur me aq shkëlqim, sa nuk e dallonte dot tokën nga qielli!

Dhe brenda në çadër ia vuri syrin asaj cope hëne! Ku mendja e ku frika nga kalifi!

Po qe se në atë fushë epshi i binte daulles, mendjes i dukeshin

Qindra kalifë më të dobët se një mizë!

Ai burrë që e kishte adhuruar atë femër, i hoqi shallvaret dhe u ul në majë të këmbëve të skllaves.

Dhe kur vegla e tij do të shkonte drejt e në vendin e vet, në ushtri u dëgjua një potere, shpërtheu një kiamet i flaktë!

Burri u hodh përpjetë dhe, me kokë e bythë zbuluar, me shpatë në dorë, doli jashtë nga çadra.

Po ç'të shohë? Nga pylli kishte hyrë brenda ushtrisë një luan i zi!

Kuajt ishin trembur, çdo çadër dhe stallë ishte shembur, të gjithë kishin rënë mbi njëri-tjetrin!

Luani ishte hedhur nga një vend i fshehtë i pyllit dhe kishte fluturuar në ajër si dallgë deti plot njëzet arshin.

Burri ishte trim i vërtetë. Pa iu trembur syri, si luan i dehur, ia preu udhën luanit të pyllit!

I dha një të goditur me shpatë duke ia çarë kokën përgjysmë. Pastaj vrapoi menjëherë në çadër ku ndodhej ajo bukuroshe fytyrëhënë!

Kur arriti pranë asaj hyrie, vegla i rrinte ende drejt e në këmbë!

Megjithëse luftoi me një luan të atillë, epshi nuk iu shua.

Dhe ajo bukuroshja e ëmbël dhe fytyrëhënë u mahnit nga forca mashkullore e atij burri!

Dhe me plot dëshirë ia dha veten atij. Dhe atë çast, dy shpirtrat u bashkuan e u bënë një!

Nga bashkimi i atyre dy shpirtrave me njëri-tjetrin, nga bota e fshehtë vjen dhe arrin një shpirt tjetër.

Po qe se në mitrën e gruas nuk ka ndonjë gjë si pengesë për ta pranuar spermën, ky shpirt vjen me rrugën e lindjes dhe e tregon veten.

Kurdo që dy njerëz të bashkohen me dashuri ose urrejtje, patjetër që do të lindë një shpirt tjetër!

Por ato trajta lindin në botën e fshehtë. Kur të arrish atje, ke për të parë edhe me sytë e tyre.

Ato përfundime lindën nga bashkimet e tua. Eja në vete dhe mos u gëzo për çdo bashkëshorte.

Prite kohën tënde. Të jesh i sigurt se ata pasardhës do të arrijnë tek ti!

Ata kanë lindur nga veprimet dhe shkaqet. Secili ka fjalën e vet, vendin e vet.

Nga pas perdeve të bukura u arrijnë zërat: O ti që s'di gjë për ne, eja shpejt e lartësohu!

Edhe shpirti i gruas pret ditën e kiametit, edhe i burrit! Ç'është përpjekja jote në këtë botë? Hidhi hapat më shpejt!

Ja, kështu, ai burrë e humbi rrugën për shkak të atij mëngjesi të rremë dhe ra si miza në dhallë!

I penduar për krimin që kishte bërë, kryekomandanti e vë shërbëtoren të betohet se nuk do t'ia tregojë këtë punë kalifit.

Disa ditë me radhë u kënaqën me njëri-tjetrin, por pastaj ai u pendua për fajin e madh që kishte bërë!

Ai i tha skllaves të betohej se nuk do t'i thoshte gjë kalifit për këtë punë.

Kur e pa skllaven, kalifi u deh; edhe atij i ra tasi nga çatia!

Ajo iu duk njëqind herë më e bukur se ç'ia kishin përshkruar. A ngjan shikimi me dëgjimin?

Lavdërimi është përshkrim për veshin e mendjes. Por dije se trajta është punë e syrit, jo e veshit!

Dikush pyeti një të ditur: O burrë fjalëbukur, ç'është e drejta dhe ç'është e shtrembra?

I dituria ia zu veshin pyetësit dhe, duke ia tërhequr, i tha: Kjo është e shtrembra, kurse syri është e drejta sepse syri ka faktet e veta!

Pra, në raport me shikimin, dëgjimi është i shtrembër. O njeri i besueshëm, edhe shumica e fjalëve janë relative.

Po qe se lakuriqi i natës fshihet nga dielli dhe hyn pas perdes, nuk do të thotë se është fshehur nga përfytyrimi i diellit.

Frika i shkakton një përfytyrim i cili është pikërisht ai që e tërheq atë në errësirë!

Përfytyrimi i dritës e tremb atë dhe bëhet shkak që ai të mbahet fort pas netëve të errëta!

Ti je kapur pas të dashurit dhe mikut për shkak të përfytyrimit dhe përshkrimit të armikut.

O Musa, drita që t'u zbulua ty, e goditi malin, por ai mal që ngrinte përfytyrime, nuk e duroi dot dritën e të vërtetës tënde!

Eja në vete dhe mos u kreno se ke forcë përfytyruese, mos shpreso se ke për t'ia arritur të vërtetës me këtë rrugë!

Askush nuk ka frikë nga përfytyrimi i luftës. Nuk ka trimëri para luftës, dije këtë, mjafton.

Edhe pushti kapet pas përfytyrimeve të luftës dhe kalon nëpërmend trima si Rustemi.

Çdo njeri i papjekur mund ta sulmojë portretin e Rustemit të vizatuar në murin e hamamit!

Por kur ky përfytyrim i ardhur pa u dëgjuar, del para syve, ç'është pushti? Rustemi, madje, mbetet i dobët!

Përpiqu dhe shihe gjënë që dëgjove që e shtrembra të bëhet e vërtetë!

Pastaj veshi fiton natyrën e syrit dhe veshët e tu që janë si lëmsh leshi, bëhen sy!

Madje, i gjithë trupi të kthehet në pasqyrë. Nga të gjitha anët bëhesh sy dhe zemër.

Veshi krijon një iluzion dhe ai iluzion është ndërmjetës për të arritur bashkimin me atë bukuri!

Përpiqu që ky iluzion të shumohet dhe ky iluzion që është ndërmjetës, të bëhet kallauz për Mexhnunin.

Edhe ai kalifi kokëtrashë u dha një kohë pas asaj skllaves, u lidh me zemër pas saj.

Ta zëmë se i pushtove lindjen dhe perëndimin dhe ngrite një sulltanat të madh. Ndërkaq, meqë ky sulltanat, në fund të fundit s'ka për të mbetur, quaje si shkreptimë: shkrepi dhe u shua!

O zemër, pasurinë që s'ka për të mbetur përjetë, dije ëndërr!

Ç'do ta bësh madhështinë, famën dhe popullaritetin që të kanë kapur për fyti?

Dije se në këtë botë ka një strehë sigurie. Ndërkaq, fjalën e hipokritit dëgjoje sa më pak, se, fundja, ajo nuk është fjalë!

Argumentet e atyre që e mohojnë ahiretin dhe dobësia e atyre argumenteve që përbëhen nga shprehja "ne nuk shohim botë tjetër veç kësaj".

Argumenti i atij që e mohon ahiretin, domethënë, ringjalljen dhe jetën tjetër pas ringjalljes, është vetëm ky: Po të kishte një botë tjetër, do ta shihnim!

Meqë fëmija nuk i sheh shenjat e mendjes, a nuk ia tregon atij njeriu i mençur gjërat që i përkasin mendjes?

Edhe nëse njeriu i mençur nuk e sheh gjendjen e ashkut, hëna e shenjtë e ashkut nuk hollohet!

Sytë e të vëllezërve nuk e panë dot bukurinë e Jusufit! Por ajo bukuri nuk mbeti dot e fshehur nga sytë e Jakupit!

Syri i Musait e pa shkopin shkop, kurse syri i të fshehtës e pa gjarpër, e pa katastrofë!

Syri i ballit me syrin e shpirtit ishin në luftë, syri i ballit doli fitues dhe tregoi argument.

Syri i Musait e pa dorën dorë, por në syrin e shpirtit shkëlqeu një dritë nga ajo dorë!

Kjo fjalë është e pafundme si përkryerje. U duket fantazi të privuarve që s'kanë haber nga e vërteta!

Sepse dhjetra të vërteta përbëhen prej grykës dhe prapanicës. Pranë tij përmendi pak të fshehtat e të dashurit!

Sipas nesh, gryka dhe prapanica janë fantazi dhe prandaj shpirti na e tregon çdo çast bukurinë e tij!

Ajo çka mbetet për t'i thënë atij që ka rënë pas grykës dhe prapanicës dhe e ka kthyer në zakon këtë gjë, është shprehja "Feja jote është e jotja, feja ime, e imja!"

Përballë një mohimi të tillë, preje fjalën shkurt! O Ahmet, fol pak me qafirët e vjetër!

Kalifi shkon pranë bukuroshes për t'u takuar me të.

Kalifi dëshiroi të takohej dhe, me këtë synim, shkoi pranë shërbëtores.

E përfytyroi atë dhe e ngrehu veglën. E vuri për qëllim të takohej me atë bukuroshe që u jepte shpirt shpirtrave, që e shtonte gjithmonë e më shumë dashurinë.

Dhe u ul mes shalëve të asaj femre. U ul, por fati ia preu rrugën e kënaqjes!

Në vesh i ra gërvima e miut. Vegla iu shkreh, i ra në gjumë, epshi i iku krejt!

Ndoshta fishkëllima ishte fishkëllimë gjarpëri, sepse rrogozi po lëvizte me forcë.

Skllavja, duke parë dobësinë e epshit të kalifit, i kujtohet forca e beut dhe fillon të qeshë; kalifi kupton diçka nga kjo e qeshur.

Duke parë dobësinë e kalifit, shërbëtorja nisi të qeshte me të madhe.

Ajo kujtoi se vegla e atij trimit s'kishte qenë ulur ende edhe pasi e kishte vrarë luanin dhe qe kthyer!

E qeshura me ha-ha-ha po i shtohej gjithnjë e më shumë. Përpiqej ta mbante veten, mirëpo kurrsesi s'po i mbyllte dot buzët.

Po qeshte si ata që mësohen me drogë. Hahaha-ja e saj po e tejkalonte edhe dobinë, edhe dëmin.

Solli nëpërmend shumë gjëra, por asnjëra s'i bëri dobi, përkundrazi, kujtimet ia shtuan të qeshurën. Sikur rrebeshi ta kishte shembur menjëherë argjinaturën e një ujëmbledhësi dhe uji i rrëmbyer të derdhej jashtë me rrëmbim!

Qarja dhe e qeshura janë ankthi dhe gëzimi i zemrës. Dije se secila e ka një burim të veçantë!

Secila ka një depo nëntokësore më vete, çelësi i së cilës ndodhet në dorën e Zotit i cili i hap dyert!

E qeshura e saj s'po qetësohej kurrsesi. Më në fund, kalifi u prek dhe u ashpërsua.

Dhe menjëherë e nxori shpatën prej milli. Dhe i tha: "Moj e ndyrë! Pse qesh, pa ma thuaj!

Nga kjo e qeshur, në zemër më ra një dyshim. Mos dredhoj, por fol drejt!

Po qe se tenton të më bindësh me gënjeshtra ose po shpike një pretekst të zbrazët,

Unë kam për ta kuptuar, sepse në zemër kam një dritë që e kupton këtë. Duhet folur drejt!

Dije se në zemrat e padishahëve ka një hënë të madhe. Dije se, disa herë, ajo hyn pa dashje nën re, por kjo s'ka rëndësi!

Në zemër është drita e një kohe shëtitjeje që, në kohën e zemërimit dhe furisë, fshihet nën legen.

Kjo aftësi kuptimi është miku im. Po s'e the fjalën që duhet thënë,

Ta heq qafën me këtë shpatë. Justifikimi yt s'të bën dobi!

Po fole drejt, do të të jap lirinë. Për hir të Zotit, s'kam për të ta thyer gëzimin!

Dhe, duke vënë shtatë mus'hafe njëri mbi tjetrin, u betua se do ta mbante fjalën!

Kalifi e kërcënon se do ta vrasë skllaven po s'ia tregoi sekretin e të qeshurës dhe ajo, nga frika e shpatës, ia zbulon sekretin.

Pasi mbeti ngushtë, shërbëtorja ia rrëfeu gjendjen. I vuri përballë të fortin me të dobëtin.

Ia tregoi një për një marrëdhënien në rrugë, zhvillimin e ngjarjes pas vrasjes së luanit dhe mbetjen e organit seksual të trimit ende të tendosur si bri rinoceronti!

Pastaj i foli për dobësinë e kalifit të turpshëm, për faktin se, duke parë që organi seksual i tij ishte shkrehur nga një lëvizje e miut, s'kishte duruar dot dhe kishte filluar të qeshte me të madhe!

Zoti i nxjerr sekretet sheshit. Meqë s'ka për të vlejtur, mos mbill farë të keqe!

Uji, reja, zjarri dhe ky diell i nxjerrin të fshehta nga nëndheu!

Pranvera e cila vjen pas derdhjes së gjetheve, është provë e ekzistencës së kiametit dhe ringjalljes.

Pranvera i vë ato të fshehta sheshit, ç'të ketë ngrënë toka, zbulohet!

Të ngrënat dalin nga goja e nga buzët, ç'të ketë brenda, del në shesh!

E fshehta e rrënjës së çdo peme dhe fruti i saj duken mbi të plotësisht.

Çdo ankth që ta prek zemrën, është nga veprimi i verës që ke pirë.

Mirë, po ku do ta dish se nga ç'verë erdhi ajo përgjumje, ajo dhimbje koke?

Kush ka mend në kokë, e kupton se kjo dhimbje koke është nga fryti i asaj peme!

Dega dhe fruti nuk u ngjasin rrënjëve. A mos i ngjet sperma trupit të njeriut?

Kur përfytyrimi s'i ngjet objektit të përfytyruar, a i ngjet rrënja pemës?

Sperma formohet nga buka që hamë, por a mos është si buka? Njeriu bëhet nga sperma, por a mos është si sperma?

Xhindi është krijuar nga zjarri, por ku i përngjet zjarrit? Reja formohet nga avulli, por s'është avull.

Isa i u trupëzua nga fryrja e Xhebrailit, por nga pamja, a mos është si ai apo mos i ngjet atij?

Ademi (njeriu) është i krijuar nga toka, por s'i ngjet tokës. Asnjë lloj rrushi s'është pjergull!

Vjedhësi a mos u ngjet këmbëve të trikëmbëshit? A mos i ngjet adhurimi xhennetit të përjetshëm?

Asnjë esencë nuk i ngjet shenjave të pasojave të saj. Prandaj, nuk mund ta dish origjinën e mundimit dhe dhimbjes së kokës!

Ndërkaq, rezultati nuk formohet pa pasur një bazë. Zoti nuk ngacmon asnjë rob të pafajshëm.

Eshtë origjina, baza ajo që e tërheq gjënë. Gjëja nuk i ngjet origjinës, por është prej saj!

Prandaj, dije se mundimi që ke hequr, është rezultat i fajit që ke bërë. Kjo shuplakë që të ra është për shkak të një epshi!

Edhe nëse nuk merr mësim, edhe në se s'e di fajin, të paktën nis të qash e të vajtosh!

Bjer në sexhde, thirre Zotin qindra herë se ky ankth është vetëm shpërblimi i fajit që ke bërë!

O Zot, ti je i pastër nga dhuna dhe qortimi! Atëherë, si mund të ndodhë që t'i japësh njeriut ankth dhe vuajtje pa pasur faj?

Unë nuk di gjë për deklarimin e fajit, por di që, patjetër, është një faj si shkak i kësaj vuajtjeje! Siç e ke mbuluar shkakun, mbuloje edhe fajin!

Sepse ndëshkimi vë në shesh fajin tim dhe hajdutëria ime del në shesh me rastin e ndëshkimit tim!

Pasi e kupton punën, padishahu vendos ta mbulojë atë pabesi
dhe, meqë i bëri padrejtësi emirit të Musulit, siç thonë ajetet "Kush bën të keqe ia bën vetes"
dhe "Nuk ka dyshim se Zoti yt të sheh e të vëzhgon ty",
e kupton se e ka zënë kjo e keqe dhe mendon se, po të marrë shpagim,
do ta pësojë edhe nga kjo dhe prandaj vendos t'ia kthejë skllaven emirit të Musulit.

Duke e kuptuar fajin që kishte bërë, këmbënguljen për ta futur vajzën në dorë, padishahu bëri pendesë dhe deshi të gjykohej nga Zoti.

Dhe tha: Gjërat që ua bëra të tjerëve m'u kthyen pas si ndëshkim.

Duke i besuar pozitës, synova gratë e të tjerëve. Ky synim m'u kthye kundër meje dhe unë rashë në gropë.

I rashë portës së tjetrit, pastaj ai më kapi dhe i ra portës sime.

Dije se kush i bën të keqe gruas së tjetrit, i bën pezevenlik gruas së vet!

Sepse ndëshkimi i një faji është pësimi i të njëjtës të keqe. Ndëshkimi i fajit është pësim i atij faji.

Po qe se ti e tërheq gruan e tjetrit nga vetja për ndonjë shkak çfarëdo, je një djall edhe më i keq se ajo!

Unë e mora me detyrim shërbëtoren e padishahut të Musulit, pastaj atë e morën menjëherë nga unë!

Lala im, njeriu te i cili kisha besim, më doli tradhtar, më bëri tradhti!

Nuk është kohë urrejtjeje dhe shpagimi. Unë bëra një punë të trashë me dorën time!

Po qe se ushqej urrejtje kundër atij njeriu, prapë do të më bjerë kokës!

A më ra një herë në kokë ky ndëshkim? Këtë e provova, prandaj nuk e përsëris më provën!

Mjerimi i padishahut të Musulit pothuajse ma theu kryet! Tashmë s'kam për të ngacmuar kënd!

Zoti na e tregoi shpërblimin. Ai na tha: "Po qe se ktheheni dhe bëheni të këqinj, edhe Ne jua japim dënimin!"

Të shkosh para këtu, është pa dobi. Nuk ka punë më të mirë se durimi dhe mëshira!

Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes, bëmë gabim. O Zot i madh e i mëshirshëm, të të vijë keq për ne!

Unë e fala atë, edhe ti falma fajin tim të ri si dhe fajet e vjetra!

Pastaj i tha shërbëtores të mos ia thoshte kurrsesi askujt fjalën që kishte dëgjuar prej saj.

I tha: "Do të të martoj me zotërinë tënd! Për hir të Zotit, mos e kujto më këtë ngjarje!

Mos e kujto që ai të mos turpërohet prej meje, sepse ai bëri një të keqe, por bëri edhe qindra të mira!

Unë e vura disa herë në provë atë dhe i sigurova femra shumë herë më të mira se ti!

Por ai nuk i preku! Kjo që ndodhi është është ndëshkimi i bëmës sime!

Pastaj e thirri atë beun në takim. E mundi armiqësinë që mendon ta shkatërrojë botën!

Dhe i gjeti atij një pretekst të pranueshëm. Dhe i tha: Unë u ftoha nga kjo shërbëtore!

Shkaku është ky: Nëna e tim biri e kishte zili këtë shërbëtore, zjente pothuajse si tenxhere nga zilia dhe inati, hoqi qindra shqetësime!

Ajo është nëna e tim biri dhe ka të drejtat e saj. Ajo s'i meritonte këto vuajtje e shqetësime!

Nga smira që ndjente, sikur gëlltiste gjak! U dëshpërua shumë për shkak të kësaj shërbëtoreje!

Shkurt, këtë shërbëtore do t'ia jap dikujt. Pasi të kem marrë vendim për këtë, s'mund të gjej më të mirë se ti, o i shtrenjti im!

Ti luajte me shpirtin tënd për të. Tashmë s'është e drejtë t'ia jap tjetërkujt veç teje!

Kështu, padishahu i vuri kurorë shërbëtores me atë beun duke ia thyer e shuar zemërimin dhe armiqësinë!

Sipas konkluzionit "Ne i përpjesëtuam furnizimet e tyre",
Zoti i jep dikujt epshin dhe fuqinë e gomarëve, dikujt tjetër, fuqinë e pejgamberëve dhe engjëjve.
Të hedhësh nga koka iluzionet dhe dëshirat është shenjë lartësie.
Braktisja e iluzioneve dhe dëshirave është fuqi e posaçme e profetëve.
Farërat që s'kanë epsh, nuk shpërthejnë gjë tjetër veçse kiamet.

Te ai nuk kishte forcë dhe fuqi gomarësh. Por pejgamberët kanë pasur burrëri.

Braktisja e zemërimit, epshit, ambicjes është burrëri. Ky është damar pegamberik.

Thuaj, në damar të mos ketë burrëri gomari dhe Zoti ta thërrasë vazhdimisht bejlerbej i madh!

Eshtë më mirë të jem një i vdekur që e sheh dhe e mban nën kujdes Zoti, sesa një i gjallë i përzënë larg prej Zotit!

E brendshmja e kësaj burrërie është e fshehta e saj, tjetra përbëhet prej lëkurës. Ajo e çon njeriun në xhennet, kjo, në xhehennem!

Është thënë se xhenneti është rrethuar dhe veshur me gjëra të papëlqyeshme, është njoftuar se xhehennemi është formuar prej illuzioneve dhe dëshirave.

O Ejaz, o luan që e ke mbytur shejtanin, pakësoje burrërinë e gomarit dhe shtoje burrërinë e mendjes!

Gjëja që nuk e kuptuan kaq botë, u bë, sipas teje, një lodër fëmijësh. Ja, pra, për ty, burrë!

O ti që gjete shijen e urdhrit tim, o ti që dhe shpirtra për t'i qëndruar besnik urdhrit tim!

Dëgjo tani ngjarjen moralo-shpirtërore mbi urdhrin, mbi shijen e urdhrit!

Padishahu u tregon pjesëmarrësve në Divan një margaritar
dhe ia jep vezirit duke e pyetur se ç'vlerë ka.
Veziri e mbiçmon vlerën e margaritarit.
Atëherë, padishahu e urdhëron që ta thyejë margaritarin,
kurse veziri nuk pranon duke sjellë justifikime të ndryshme.

Një ditë, padishahu shkoi në Divan. Atje i gjeti të mbledhur të gjithë burrat e shquar të vendit.

Ai padishah i ndritshëm nxori një margaritar dhe duke ia dhënë vezirit në dorë, i tha:

"Ç'margaritar është ky, ç'vlerë ka?" Veziri iu përgjigj: "Është një margaritar me vlerë njëqind barrë gomari me flori!"

Padishahu i tha: "Thyeje këtë margaritar!" Veziri iu përgjigj: "Si mund ta thyej? Unë jam një person që dëshiron të mirën e thesarit dhe të mallit tënd!

Si mund ta shoh me vend dëmtimin e një margaritari të tillë të paçmuar?"

Padishahu e miratoi fjalën e vezirit dhe i dhuroi një rrobë. Padishahu e mori prapë margaritarin.

Padishahu bujar, përveç rrobave që i veshi vezirit, i dha edhe rroba të tjera të rënda.

Një farë kohe i mbajti të pranishmit me biseda mbi gjërat e reja, mbi ngjarjet e vjetra.

Pastaj tha se, në qoftë se do të pyetej perdexhiu, ç'vlerë do të kishte?

Perdexhiu tha: "Ky margaritar ka vlerë sa gjysma e vendit. Zoti e mbrojttë vendin nga rreziqet!"

Padishahu i tha: "Thyeje këtë margaritar!" Perdexhiu iu përgjigj: "O padishahu im, shpata e të cilit shkëlqen si dielli, ta thyesh e zvogëlosh këtë është shumë keq, shumë keq!

Jo vetëm vlera. Pa shiheni këtë shkëlqim! Drita e ditës, madje, i shkon pas!

Si mund të më shkojë dora ta thyej këtë? Si mund të ndodhë që të bëhem armik i thesarit të padishahut?"

Padishahu i dha rroba dhe ia shtoi të ardhurat. Filloi t'ia lavdërojë mendjen.

Pas pak, margaritarin ia dha në dorë një beu. E provoi edhe atë.

Edhe ai ashtu tha, ashtu thanë edhe të gjithë bejlerët. Secilit i dhuroi rroba të rënda.

Ua shtoi rrobat, i nxori nga rruga ata njerëz të ulët, i hodhi në gropë.

Pesëdhjetë-gjashtëdhjetë bejlerë, duke imituar vezirin, ashtu thanë.

Ç'është e vërteta, vlera e botës është imitim, por çdo imitues demaskohet në provë.

Duke kaluar dorë më dorë, margaritari erdhi te Ejazi.
Ejazi e theu margaritarin pa bërë si të tjerët, pa u gënjyer për mallin e pasurinë
që mund t'i jepte padishahu, pa u kapur pas rrobave të shumta
dhe lavdërimit të mendjes së atyre që ranë në gabim.
Nuk është e drejtë që imituesi të quhet musliman.
Rrallë, edhe imituesi, me mbrojtjen e Zotit,
mbështetet në bindjen e tij
dhe shpëton shëndoshë nga provat, sepse e Vërteta (Zoti) është një,
por ka shumë të kundërta të saj që i ngjajnë asaj dhe e gënjejnë njeriun.
Imituesi nuk e njeh dot atë të kundërtin, prandaj nuk e njeh edhe të Vërtetën.
Por edhe sikur ai të mos e njohë të Vërtetën, po ta shohë e Vërteta me sy të mirë,
kjo mosnjohje nuk i jep dëm imituesit.

Padishahu i tha: "O Ejaz, a s'po thua, cila është vlera e një margaritari me këtë shkëlqim e me këtë bukuri?

"Më tepër se ç'mund të them!" - u përgjigj Ejazi. Padishahu i tha: "Mirë, atëherë, thyeje atë e bëje copë-copë!"

Në mëngët e Ejazit kishte gurë. Ai i nxori menjëherë gurët dhe e theu margaritarin dhe e bëri copë-copë!

Ndoshta ai djalë i ri i pastër e i thjeshtë e kishte parë këtë punë në ëndërr dhe kishte fshehur dy gurë në mëngë nën sqetull.

Si Jusufi. Edhe ai, qysh në fundin e pusit e kishte parë se gjer ku do të shkonte ajo punë!

Kujt t'i njoftohet fitore dhe triumf, ai është njëlloj si në arritjen, si në mosarritjen e qëllimit.

Kush të ketë mbështetje, të ketë arritjen e takimit me Zotin, pse do të frikësohet nga thyerja e nga lufta?

Ai që e di mirë se ka për ta bërë mat kundërshtarin, a pyet se i kanë ikur kali e fili? Fundja, të gjitha këto janë marrëzira!

Kush kërkon kalin dhe ta marrë, thotë e mora, por s'ka për t'i rënë para ndonjë kalë me të vërtetë!

A mund të jetë njeriu në një soj me kalin? Dashuria e njeriut për kalin është për të kaluar para!

Mos vuaj kaq shumë për trajtat. Arrije kuptimin pa u bërë trajta dhimbje koke!

Zahidi (i devotshmi) mendon fundin e punës. Ai mërzitet se si ka për t'iu bërë halli ditën e llogarisë!

Kurse arifët (njerëzit e pajisur me kulturën shpirtërore) janë të njoftuar qysh në fillim; ata kanë shpëtuar nga vuajtja për ta menduar fundin.

Te arifi, para se të bëhej arif, ka pasur edhe frikë, edhe lutje. Por meqë e ka ditur vlerësimin e Zotit, meqë ka qenë i njoftuar për fillimin e punës, kjo njohuri i ka shmangur që të dyja.

Ai që e di qysh në fillim se ka mbjellë bishtaja, e di edhe se ç'prodhim ka për të marrë.

Ai është arif, ka shpëtuar edhe nga frika, edhe nga drojtja. Shpata e Zotit e ka prerë atë lëkundje, e ka ndarë përgjysmë.

Në fillim kishte frikë nga Zoti dhe shpresonte. Frika u asgjësua dhe doli në shesh lutja, përgjërimi.

Edhe kur Ejazi e theu margaritarin, nga bejlerët shpërthyen qindra klithma e vajtime!

Ata thanë: "Ç'mungesë frike, kjo? Për Zotin, ai që e thyen këtë margaritar të bukur, është qafir!"

Të gjithë ata, për shkak të verbërisë së tyre, e kishin thyer urdhrin si margaritar të padishahut!

Vlera e margaritarit dhe përfundimi i dashurisë kishin mbetur të fshehura nga zemrat!

Bejlerët e qortojnë Ejazin pse e theu margaritarin dhe ai u jep përgjigje.

Ejazi tha: "O burra të mëdhenj e të shquar, a urdhri i padishahut vjen më parë, apo margaritari?

Për hir të Zotit, thoni, sipas jush, urdhri i padishahut është më i lartë, apo ky margaritar i bukur?

O bejlerë që shihni margaritarin dhe as që pyesni për padishahun, para vetes keni trëndafil, jo rrugë të madhe!

Unë nuk e heq syrin nga padishahu. Unë nuk ia ngul sytë gurit si politeist!"

Në shpirtin që zgjedh gurin me ngjyrë dhe lë mënjanë urdhrin e padishahut, nuk ka asnjë margaritar, asnjë vlerë!

Lodrën ngjyrë trëndafili hidhe pas. Sill ndërmend atë që u ka dhënë ngjyrë atyre dhe habitu!

Hyr në lumë, përplase shtambën për guri! Aromës dhe ngjyrës jepu zjarr!

Nëse në rrugën e fesë nuk je nga grabitësit, mos iu fal ngjyrës dhe aromës si gratë!

Pas këtyre fjalëve, ata burra të mëdhenj i përkulën kokat para si shenjë kërkimi faljeje për gabimin e tyre.

Në atë çast, nga zemra e secilit ndoshta dyqind herë doli një "ah" që, si tym, arriti gjer në qiell!

Padishahu i dha urdhër xhelatit plak: "Largoji nga rezidenca ime e lartë këto plehra!

Këta njerëz të ulët nuk janë të denjë për këtë rezidencë. Për një gur e hodhën poshtë urdhrin tim!

Për shkak të këtyre lloj njerësizh që shohin të përfitojnë nga rasti, urdhi im u poshtërua për një gur me ngjyrë!"

Padishahu urdhëron vrasjen e bejlerëve, kurse Ejazi ndërmjetëson duke thënë se "falja është më e drejtë".

Pas këtyre fjalëve, i mëshirshmi Ejaz u hodh nga vendi dhe vrapoi drejt fronit të padishahut të lartë.

Ra me ballin në tokë, mbërtheu grykën me duar dhe tha: Padishahu im, edhe qielli është bërë admirues i mbretërimit të një padishahu të lartë si ti!

O zog parajse, parajsorët prej teje e marrin shenjtërinë, bujarët prej teje e arrijnë bujarinë!

O bujar, bujaritë dhe mirësitë në botë e humbin vlerën e shuhen përballë ndjenjës sate të faljes!

O favorizues i madh, me të të parë ty, trëndafili i kuq, nga turpi, e gris këmishën!

Falja është ngopur me faljen tënde, dhelprat, me faljen tënde, janë bërë eprorë mbi luanë!

Ai që vepron pa frikë përballë urdhrit tënd, ku të mbështetet tjetërkund veç faljes tënde?

Padituritë dhe paturpësitë e këtyre fajtorëve, o padishah që je esenca e vetë faljes, u shfaqën nga gjerësia e faljes tënde!

Padituria dhe indiferentizmi shkaktohen gjithmonë nga paturpësia. Respekti e shëron dhimbjen e syrit.

Harresa që është indiferentizëm dhe shprehi e keqe, digjet me zgjarrin e respektit.

Impresionimi i saj i jep njeriut zgjuarsi dhe kuptim dhe harresa dhe gabimi brenda njeriut dalin dhe prej tyre s'mbetet gjë.

Në kohën e grabitjes, popullin s'e zë gjumi. Askush nuk fle me frikën se mos ia vjedhin hirkën.

Po qe se gjumi ikën edhe me frikën e hirkës, kush fle kur ka frikë për shpirtin dhe jetën?

Argument për këtë është ajeti: "Zoti ynë, mos na quaj fajtorë për fajet që bëjmë duke harruar!" Sepse edhe harresa, në një aspekt, është faj.

Ai që harron, e ka respektuar atë ashtu siç është i denjë. Ndryshe, a mund ta zërë gjumi njeriun në luftë?

Harresa vjen në mënyrë të pashmangshme, por edhe për të mos u kapur pas kësaj, duhet kapur fort pas shkaqeve.

Sepse po të tregojë përtaci në respektimin e tij, te njeriu shkaktohet ose harresë, ose gabim.

Si puna e të dehurit. Në atë çast bën krime, pastaj thotë isha i justifikuar, ç'të bëj?

Atij i thonë: Drejt, por, o punëkeq, atë helm e pive vetë, me dëshirën dhe kërkesën tënde u helmove!

Dehja nuk të erdhi vetvetiu, ti e ftove atë. Edhe dëshirën vetë e sajove!

Dehja ishte synimi yt. Po të mos përpiqeshe dhe të të vinte vetvetiu, sakiu i shpirtit do të ta ruante besën, do të kujdesej për ty!

Do të bëhej mbështetje, ai do të kërkonte falje në emrin tënd. Iu bëfsha rob dehjes ndaj Zotit!

O Zot, prej të cilit fitohet çdo gjë, falja dhe mirësia e të gjithë botës është sa një grimcë nga falja dhe mirësia jote!

Faljet lavdërojnë faljen tënde. O njerëz, ruhuni, nuk ka të ngjarë e të barabartë me të!

Faljua jetën atyre dhe mos i përze nga prania jote! O ti që e arrin qëllimin tënd, ata janë shija jote!

Të të dhimbset ai që i shohin sytë! Si mund të ndodhë që ai që të sheh ty, ta vuajë dhimbjen e ndarjes prej teje?

Po flet për ndarje! Bëj ç'të bësh, por këtë mos e bëj!

Edhe rënia në kurthin tënd dhe vdekja qindramijra herë nuk barazohen me ndarjen prej teje!

O ti që u shkon në ndihmë thirrjeve të fajtorëve, largoje dhimbjen e ndarjes edhe nga burrat, edhe nga gratë!

Eshtë kënaqësi të vdesësh duke shpresuar bashkimin me ty! Por dhimbja e ndarjes është mbi zjarrin!

Edhe qafiri, madje, në xhehennem rri vazhdimisht duke thënë: "Sikur të më shihje, a vuaja se isha në xhehennem, apo jo!"

Sepse ai shikim i ëmbëlson të gjitha vuajtjet. Ai shikim është dëmshpërblimi i duarve dhe këmbëve të magjistarëve.

Kur Faraoni do t'i vriste magjistarët, ata thanë: "S'ka gjë, ne do të kthehemi te Zoti ynë!" Komenti i kësaj.

Faqja e qiellit dëgjoi zërin "S'ka gjë!" Faqja e qiellit sikur u bë top për atë shkop!

Dhe thanë: Goditja e faraonit nuk na dëmton ne; favori i Zotit është mbi persekutimin e të tjerëve!

O njeri me syrin e shpirtit të verbër i cili i shtyn njerëzit në rrugën e mbrapshtisë dhe kryelartësisë, po ta dije të fshehtën tonë, do ta kuptoje që po shpëtojmë veten tonë!

Eja në vete, afrohu këtej dhe dëgjoje zërin: "Sikur populli im ta dinte se përse më fali Zoti im mua!"

Mirësia e Zotit na dha një faraonizëm, kështu që faraonizmi yt s'vlen, mbretërimi yt është kalimtar!

O ti që kapesh pas Egjiptit dhe lumit Nil dhe krenohesh! Ngrije kokën dhe shihe mbretërimin e lartë e të përjetshëm!

Po e braktise ti këtë hirkë të fëlliqur, lumin Nil e mbulon në nilin e shpirtit!

O faraon, eja në vete dhe hiq dorë prej Egjiptit! Brenda Egjiptit të shpirtit ka qindra Egjiptë!

Ti i thua vazhdimisht popullit "unë jam Zoti juaj" por nuk i di as këto dy fjalë!

Ai që është zot, si dridhet nga personi që i bëhet zot? Ai që di të thotë "unë", si ndodh që të mbetet lidhur pas lidhjes së trupit dhe shpirtit?

Ja, shih, mu këtu ne themi "unë", sepse shpëtuam nga egoizmi, u qëruam nga egoizmi plot mundime e ngatërresa!

O qen, ai egoizëm nuk të erdhi i bekuar ty. Por, sipas nesh, u bë një shtet i vulosur.

Po qe se ky egoizëm nuk do të ndiqte urrejtje kundër teje, a do të bëhej për ne një mbarësi e tillë e bukur, një fat i mirë?

Ne po shpëtojmë nga vendi i mosqenies; si falenderim për këtë, po të japim një këshillë ty në krye të këtij trekëmbëshi:

Trekëmbëshi ynë i vdekjes është kalë shale i mërgimit. Kurse vendi i mbretërimit tënd është krenari dhe padituri!

Kjo mënyrë jetese është e fshehur në trajtën e vdekjes. Kurse ajo vdekje është e fshehur në lëvozhgën e jetës!

Nuri (drita) duket në formë zjarri dhe zjarri, në formë drite. Ndryshe, a do të bëhej bota vendi i krenarisë, vendqëndrimi i gënjimit?

Eja në vete, mos u nxito. Në fillim asgjësohu. Po u fundose, duku në drejtim të dritës!

Nga egoizmi i pafillimshmërisë, zemra ra në mahnitje; ky egoizëm erdhi në gjendje të ftohtë, u bë turp dhe ndjenjë turpi.

Nga ai egoizmi pa ego, shpirti mori një gjendje të këndshme, u hodh dhe doli nga egoizmi botë.

Shpëtoi nga "uni" dhe tani u bë "unë". I lumtë egoizmit pa mundim!

Në atë ikje, egoizmi i ka rënë pas. Ngaqë e ka parë atë pa të, nuk po e lë të qetë, por vazhdon të vrapojë pas tij.

Po ta duash ti atë, ai s'të do ty. Por pasi të vdesësh, e arrin atë që dëshiron.

Kur të jesh i gjallë, a të lan ty larësi i vdekur? Kur ti të dëshirosh, a të kërkon ty ai që dëshiron?

Po qe se në këtë temë, mendja do të ishte udhërrëfyese, Fahri Raziu do ta dinte sekretin e fesë.

Por "kush nuk shijon, nuk di"! Prandaj, mendja e tij dhe fantazitë që ngriti, vetëm sa ia shtuan habinë.

Me ç'mendim do të hapet, do të gjendet ky "unë"? Ai do të hapet e do të gjendet pas mosqenies.

Për shkak të kërkimit dhe hetimit, këto mendje bien në greminën e njësimit dhe inkarnacionit.

O Ejaz që, për shkak të afrimit ke arritur në mosqenie, që, si yll, je kredhur në dritërat diellore!

Medje, o mik që ke ardhur jo në gjendje njësimi dhe inkarnacioni, por në gjendje kurmi, si sperma!

O person që e ke marrë faljen nën pronësinë tënde, fal! Ti je më i përparuari në favor. Të gjithë ata që bëjnë favor, janë pas teje.

Po kush jam unë që të të them "fal!"? O sovrani im, o përmbledhësi i urdhrit "bëhu!"

Kush jam unë, o ti, sovrani im me të gjithë "unët" mbështjellë pas prehrit tënd, që të ndodhem bashkë me ty pa lënë "unin" tim?

Ejazi e quan veten fajtor për ndërmjetësimin dhe kërkon falje për këtë faj;
edhe në kërkimin e faljes e di se është fajtor.
Ky lloj dëshpërimi shkaktohet nga njohja e madhështisë së sovranit.
Pejgamberi ka thënë: "Unë e njoh më mirë nga ju Zotin dhe e kam frikë Zotin më shumë se ju!"
Edhe Zoti i lartë ka urdhëruar: "Kjo është fjalë, përtej kësaj nuk ka.
Nga Zoti frikësohen robtë që e njohin atë!"

Si tentoj unë t'ia mësoj dhembshurinë atij që është i mbushur plot butësi? Si mund t'ia tregoj unë udhën e butësisë atij që di?

Edhe sikur të më zësh me shpulla, ke të drejtë. Unë jam një rob i denjë për qindramijra shpulla!

Ç'mund të them unë para teje dhe të tentoj të të tregoj ty diçka? Ose me ç'fytyrë të nis të ta kujtoj ty kushtin e bujarisë?

Sipas teje, ç'ka të panjohur? Ç'ka në botë që s'e ke ti në kujtesë?

Ti je i pastër nga mosdija; edhe dija jote është e pastër nga harresa e diçkaje nga ato që ndodhen në botë!

Merrni një që është hiç, bëjeni njeri dhe shkëlqejeni me dritëra si dielli.

Meqë më bëre mua njeri, po t'u luta, ki mirësinë e ma dëgjo lutjen!

Ndërmjetësimin për falje që e shfaqe me fytyrën time, prapë ti e bën!

Sepse ky vendbanim s'përmban asgjë nga malli e pasuria ime, këtu unë s'kam asgjë. Çdo gjë që më ndodhet në shtëpi, s'është e imja!

Lutjen time e rodhe si ujë, falma vendosmërinë dhe pranoje atë lutje!

Je ti në fillim që ma frymëzove atë lutje mua dhe, më në fund, prapë ti pranoje lutjen time!

Pranoje dhe të them se sovrani i botës e fali fajin e fajtorëve për këtë robin e tij!

Mua më pëlqen vetja, jam fund e krye dëshpërim. Sovrani im i dha shërim çdo të dëshpëruari!

Isha i xhehennemit, isha plot të këqija. Dora e mirësisë e tij më shndërroi mua në Keuther, në eliksir.

Këdo që ta djegë xhehennemi, unë i nxjerr përsëri në kufomë ato gjërat e djegura.

Cila është puna e eliksirit? Me ndërmjetësinë e tij të ribëhet dhe rinohet çdo gjë e djegur.

Eliksiri e shpall bujarinë e tij pika-pika. Dhe thotë: Gjërat që ka djegur xhehennemi, unë i zëvendësoj prapë.

Xhehennemi i ngjet të ftohtit të vjeshtës. Kurse eliksiri, o trëndafilishte, është si pranvera!

Xhehennemi i ngjet vdekjes, dheut të varrit. Kurse eliksiri është si fryrja e Bririt për ringjallje!

O ju që ju digjen trupat në xhehennem, bujaria e Zotit ju thërret në eliksir.

O Zot i gjallë që je gjithmonë aktiv, ke thënë: "I krijova
njerëzit që të përfitojnë prej meje,

Jo që të përfitoj unë prej tyre!". Kjo është bujaria jote; të
gjitha mangësitë rregullohen me atë bujari!

Fali këta robtë e tu që adhurojnë trupin. Falja që bën deti
i faljes është një punë me vend.

Fale popullin si lumi, si rrebeshi, laje, pastroje, kridhe në
detin tënd dhe pastroje!

Faljet dalin çdo natë nga kjo zemër dhe, si pëllumbat,
fluturojnë dhe arrijnë tek ti!

Në kohën e zbardhjes së dritës, ti i fluturon përsëri ata
dhe i mbyll në këta trupa gjer kur të bëhet natë.

Prapë, natën, me ashkun e atij pallati dhe të asaj strehe,
hapin krahët e fluturojnë.

Sa ta këpusin nga trupi perin e bashkimit, vijnë tek ti,
në praninë tënde. Sepse prej teje kanë arritur në mirësi
dhe lumturi.

Të sigurt se nuk do të kthehen kokëposhtë, rrahin
krahët në ajër duke thënë: "Nuk ka dyshim se ne do të
rikthehemi te Zoti ynë!"

Edhe nga ai bujari vjen zëri: "Ejani, lartësohuni!" Pas atij
kthimi, s'mbetet më ambicje dhe vuajtje!

Në botë hoqët shumë gjëra të çuditshme. O njerëz të
mëdhenj, dijani vlerën vetes!

Zgjatini këmbët nën hijen e kësaj peme si të dehur plot
naze!

Këmbët që ju hoqën keq në rrugën e fesë, zgjatini në
prehër e në duar të hyrive të përjetshme!

Duke i bërë shenjë njëra-tjetrës me mëshirë, hyritë thonë
se këta sofi u kthyen nga fushata.

Sofitë e pastër si drita e diellit ranë një farë kohe në tokë
dhe u përzien me fëlliqësira.

Por të pastër si drita e diellit, pa asnjë fëlliqësi në këmbë,
trup dhe kokë, arritun në katedrën e lartë të diellit.

O Zot i madh, edhe këta fajtorë e përplasën kokën në
mur.

I kuptuan gabimet dhe fajet e veta. U bënë mat në lojën
e padishahut, por

Tani, duke u mjeruar, e kthyen fytyrën nga ti si Zoti që u
tregon udhë fajtorëve!

Ki mirësinë dhe pastroji sa më shpejt në lumë, në burimin
e ujit të pastër ata që janë fëlliqur gjatë rrugës!

Laji që të pastrohen nga faji i kryer për një kohë të
gjatë, të marrin pjesë në radhët e të pastërve dhe të falin
namaz.

Ata që ndodhen në ato radhë jashtë numrit, të mbulohen
nga drita "Ne jemi në radhë!"

Me të ardhur fjala në lavdërimin e kësaj gjendjeje, edhe
kalemi u thye, edhe letra u gris.

A mund ta nxërë ndonjë enë detin? A mund ta kapë dhe
ta rrëmbejë qengji luanin?

Nëse ndodhesh pas perdes, dil dhe shihe atë mbretërim
për t'u mahnitur.

Fisi i dehur e thyen kupën, por ata që janë të dehur pas
teje, kanë justifikim!

Dehja e tyre nuk është me mbarësi dhe pasuri, o punë
ëmbli Zot; ata janë dehur me verën tënde!

O sovrani i sovranëve, ata janë bërë të dehur nga e
veçanta jote. O Zot që fal, fale të dehurin tënd!

Kur i flet ti, shija e veçorive të tua e deh aq shumë njeriun,
sa njëqind kupa verë nuk e dehin ashtu.

Meqë më dehe mua, mos më ndëshko! Sheriati nuk i
ndëshkon me rrahje të dehurit.

Të më vinë mendtë në kokë dhe atëherë më rrih. Fundja,
unë nuk dua të vi në vete!

O Zoti i favoreve dhe mirësive, kush pi verën tënde jo
vetëm shpëton përjetësisht nga mendja, por edhe nga
rrahja.

Ata mbeten përjetësisht në mosqenien që u jep dehja.
Përveç atyre që asgjgësohen në dashurinë për ty, të tjerët
nuk përmenden e nuk ngrihen dot në këmbë!

Mirësia jote na thotë të ecim; ec, o ti që je kapur pas
dhallit të dashurisë sonë!

Ke rënë si miza në dhallin tonë. Ti nuk je e dehur oj
mizë, ti je vetë vera!

O mizë, shpendët grabitqarë bëhen të dehur prej teje
sepse ti e ke ngarë kalin në detin e mjaltit.

Malet, ashtu si dhe thërrimet, janë të dehurit e tu. Edhe pika është në dorën tënde, edhe kompasi, edhe vija.

Intriga nga e cila dridhet populli, dridhet prej teje. Çdo margaritar i çmuar është shumë më i lirë se ti!

Të më jepte Zoti pesëqind gojë dhe të të përshkruaja ty o shpirt dhe o botë!

Mirëpo kam vetëm një gojë, edhe ajo, o Zot që i di të fshehtat, nga turpi prej teje, copë-copë!

Por nuk bëhem më shumë copë-copë se mosqenia. Sa e sa ummete, bashkësi, u shfaqën nga goja e tij!

Qindra vepra të fshehta, me favorin dhe mirësinë e Zotit, presin të dalin jashtë nga mosqenia.

O Zot që t'u bëfsha kurban bujarisë tënde, koka më vjen rrotull me havanin tënd!

Interesimi për ty bëhet me dëshirën tënde. Ku të ketë një udhëtar, atë e tërheq forca tërheqëse e Zotit.

Pa pasur erë, a ngrihet dheu lart? Pa pasur det, a lëviz anija vendit?

Para eliksirit askush nuk vdes. Mirëpo, pranë ujit tënd, eliksiri është një gjë pa vlerë!

Eliksiri është kible e jetës. Miqtë, vreshtat, kopshtet me ujë blerojnë e qeshin.

Ata që e pijnë vdekjen, ringjallen me ashkun për të; zemrat i kanë hequr edhe prej jetës, edhe prej eliksirit.

Meqë uji i ashkut tënd na dha dorë, tashmë eliksiri për ne nuk ka asnjë vlerë.

Çdo jetë është e gjallë nga eliksiri. Por edhe uji i eliksirit je ti!

Çdo çast më dhe mua një vdekje, një ringjallje dhe e pashë se ç'bëri ajo bujaria jote!

Jam i sigurt se ke për të më ringjallur përsëri, prandaj kjo vdekje më duket si gjumë, o Zot!

Sikur çdo çast të bëhet iluzion për shtatë dete, o uji i ujit, ti e kap atë për veshi dhe e sjell.

Mendja dridhet nga vdekja, mirëpo është në ashk dhe gëzim. A mund të frikësohet nga shiu si guri dhe dheu?

Ky vëllim është vëllimi i pestë i Mesnevisë. Shpirti u ngjet yjeve në yjësitë e qiellit.

Ndjenjat e tjetërkujt përveç gjemixhiut që i njeh yjet, nuk e gjen dot rrugën me anë të yjeve!

Të tjerët veçse i sodisin yjet; ata nuk dinë gjë as për të shenjtët, as për të zakonshmit!

Krijo afërsi me yjet që i djegin shejtanët nga natën gjer në mëngjes!

Secili, për ta përzënë shejtanin me pandehma të këqija, pothuajse i hedh naftë nga kalaja e qiellit!

Yjet janë si akrepë për shejtanin, por për myshteriun janë miku më i afërt!

Harku e qëllon shejtanin me shigjetë, por po të duhet për të ujitur të mbjellat dhe pemët, dërgon ujë me kova!

Edhe sikur ta thyejë gjeminë e azganisë, për mikun peshku mbjell si ka.

Edhe sikur dielli ta copëtojë natën si luan, nata meriton rroba prej atllasi!

Çdo qenie që shfaqet nga mosqenia, për njërin është helm, për tjetrin, sheqer.

Bëhu mik, largohu nga vesi yt i keq dhe ha sheqer edhe nga kupa e helmit, madje!

Kundërhelmi Faruki qe bërë sheqer për të, prandaj helmi nuk i bëri dëm Farukut!

